AVOKATIA

Periodike e pavarur

26

Botim
i Dhomës Kombëtare
të Avokatisë

AVOKATIA
Periodike e pavarur
(*Publikim i përtremuajshëm)*
Nr. 26 (2), Viti VII i botimit, 2018

AVOKATIA
An independent periodical
(*Quarterly publication*)
Nr. 26 (2), VII Year publication, 2018

Bordi editorial:

Kryetar **Av. Prof. Dr. Maksim R. HAXHIA**
Anëtarë **Av. Prof. Dr. Aurela ANASTASI**
Av. Dashamir KORE
Av. Dr. Gavrosh ANDONI
Av. Prof. Asoc. Dr. Fehmi ABDIU
Av. Prof. Dr. Skënder KAÇUPI
Av. Prof. Asoc. Dr. Sokol SADUSHI

Kryeredaktor **Ilir Dh. DHIMA**

Design and layout Aida Kumi

© Copyright DHOMA KOMBËTARE E AVOKATISË

Adresa e Redaksisë:

Pranë DHKA
Rr. "Murat Toptani"
Qendra e Biznesit 'Eurocol'
Kati 9, Tiranë (Albania)
Tel: + 355 4 22 51 876
Fax: + 355 4 22 52 057
Cel: + 355 069 27 42 425
E - mail: av.literum@gmail.com
Web site: http://avokatia.al

Non in legendo sed intelligendo leges consistant
Ligjet kanë vlerë jo në leximin, por në kuptimin e tyre

PËRMBAJTJA

Faqe

EDITORIAL
Pavarësia, besimi dhe integriteti, detyrime profesionale për avokatin 9

DOKUMENTE
Deklaratë e CCBE mbi aplikimin ekstraterritorial të urdhrave të kontrollit 15

KUSHTETUTSHMËRI
Ndalimi i të drejtës së votës në një këndvështrim të ri kushtetues 17
Nga **Av. Dr. Viktor Gumi**

OPINIONE
Rireformimi kushtetues i drejtësisë administrative 37
Nga **Av. Vasil Bendo**
Për një ndërhyrje normative të nxituar dhe jo të mirëmenduar 57
Nga **Av. Përparim Kalo**, **Av. Aigest Milo**

PENALE
Analizë e standardeve ndërkombëtare dhe e praktikës vendase për zbatimin e masës së arrestit në burg 69
Nga **Av. Erida Skëndaj**

SHKENCA LIGJORE
Përdorimi me efektivitet i ekspertimeve për zbatimin e të vërtetës në procesin penal 85
Nga **Av. Prof. asoc. Dr. Fatmir Tartale**

E DREJTA FAMILJARE
Sfidat e bioteknologjisë në fushën juridike, impakti në shoqërinë shqiptare 105
Nga **Prof. asoc. Dr. Hemion Braho**, **Prof. asoc. Dr. Juelda Lamçe**

C I V I L E
Pohimi dhe heshtja si mjet prove në gjykim 121
Nga **Ina Hoxhaj**

P R O N Ë S I A I N T E L E K T U A L E
Mbi agjencitë e administratimit kolektiv për të drejtën e autorit 141
Nga **Av. Dr. Oltion Spiro**

H A R M O N I Z I M E
Kuptimi dhe përdorimi i Amicus Curiae 163
Nga **Alket Jaupi**

H O R I Z O N T E
Edukimi ligjor i publikit dhe roli i avokatit..... 179
Nga **Eda Noçka**

E T I M O L O G J I
Fjalor Shpjegues 193
Hartuar nga **Av. Vladimir Molla**

H U M O R & S A T I R Ë
Përsiatjet e Kalamandreit 201
Shqipëruar nga **Dr. Henrik Ligori**

N J O F T I M E
Ftesë për botim 205
Nga **Redaksia**

TABLE OF CONTENT

Page

EDITORIAL
The independence, trust, and integrity – professional obligations for lawyers *9*

DOCUMENTS
CCBE press release on the extraterritorial application of search warrants 15

CONSTITUTIONAL LAW
Prohibition of the right to vote from a new Constitutional perspective 17
By **Av. Dr. Viktor Gumi**

OPINION
The Constitutional reform of the administrative law 37
By **Av. Vasil Bendo**
A hasty, and not well-thought, normative intervention 57
By **Av. Përparim Kalo**, **Av. Aigest Milo**

CRIMINAL LAW
Analysis of the international standards and local practice regarding application of arrest in prison 69
By **Av. Erida Skëndaj**

LEGAL SCIENCES
The effective use of expertise in discovering the truth in criminal proceedings 85
By **Av. Prof, asoc. Dr. Fatmir Tartale**

FAMILY LAW
The biotechnology challenges in law and their impact on the Albanian society 105
By **Prof. asoc. Dr. Hemion Braho**, **Prof. asoc. Dr. Juelda Lamçe**

CIVIL LAW
Assertion and silence as proof in court proceedings 121
By **Ina Hoxhaj**

INTELLECTUAL PROPERTY
Agencies of collective administration of copyright..... 141
By **Av. Dr. Oltion Spiro**

HARMONIZATION
Meaning and use of Amicus Curiae 163
By **Alket Jaupi**

HORIZONS
Public legal education and the role of lawyers..... 179
By **Eda Noçka**

ETYMOLOGY
Glossary 193
By **Av. Vladimir F. Molla**

HUMOR & SATIRE
Eulogy of Calamandrei 201
Translated by **Dr. Henrik Ligori**

ANNOUNCEMENTS
Invitation for publications..... 205
By the **Editorial Office**

SUMMARY..... 207

PAVARËSIA, BESIMI DHE INTEGRITETI, DETYRIME PROFESIONALE PËR AVOKATIN

Tashmë është bërë e qartë dhe pranuar gjithësisht edhe në Shqipëri, se avokatët kanë rol të veçantë në një shoqëri demokratike të krijuar mbi respektimin e shtetit të së drejtës. Aq më tepër merr vlerë ky përcaktim në kohën kur është miratuar dhe ka nisur të zbatohet një reformim i thellë në sistemin e drejtësisë, pikërisht në prag të çëljes së bisedimeve për anëtarësimin e vendit tonë në Bashkimin Evropian.

Në këto kushte, detyrat e avokatit nuk fillojnë dhe as përfundojnë vetëm me kryerjen ndershmërisht të asaj çfarë është instruktuar të bëjë për aq sa e lejon ligji. Është e domosdoshme që një avokat t'u shërbejë interesave të drejtësisë, ashtu sikurse edhe atyre që të drejtat dhe liritë ia kanë besuar atij për t'i deklaruar dhe mbrojur. Ndërkohë që është barrë e pashkëputur e avokatit jo vetëm për të bërë apel mbi çështjen e klientit, por edhe për të qënë këshilltari i tij.

Pra, respektimi i fumksionit profesional të avokatit përbën një kusht thelbësor për forcimin e shtetit të së drejtës dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike. Për rrjedhojë, ky funksion vendos një sërë detyrimesh ligjore dhe morale që bien mbi avokatin në një rreze të gjerë veprimi, si: përkundrejt klientit; gjykatave dhe institucioneve të tjera, para të cilave avokati paraqet çështjen e klientit apo vepron në emër të tij; profesionit ligjor në përgjithësi dhe çdo anëtari të tij në veçanti; publikut, për të cilin ekzistenca e një profesioni të tillë, të lirë dhe të pavarur, i mbështetur te respektimi i rregullave të vendosura nga vetë profesioni përbën element esencial të mbrojtjes së të drejtave të njeriut përballë autoritetit të organeve shtetërore, si edhe interesave të tjera të shoqërisë.

Parimet kryesore të sjelljes profesionale të avokatëve në Komunitetin Evropian (EC) janë përcaktuar fillimisht në dokumentin e njohur si Deklarata e Peruxhias, miratuar që në 1977 nga Organizata

e Dhomave të Avokatisë (Bareve) dhe Shoqatave Ligjore në hapësirat Evropiane – CCBE, në përbërje të së cilës aktualisht Dhoma Kombëtare e Avokatisë Shqiptare ka Statusin e Vëzhguesit. Qëndrimi i Deklaratës së Peruxhias mbi funksionin e avokatit në shoqërinë ku ai vepron përbën platformën për rregullat që qeverisin performancën e këtij funksioni.

Më pas, rregullat e Deontologjisë janë parashikuar në Kodin e Sjelljes së Avokatëve Evropianë, për t'u zbatuar më mënyrë të vazhdueshme dhe progresive nga tërë anëtarët e Bareve të përfaqësuara në CCBE. Dhe, pavarësisht statusit që mbajnë në këtë Organizatë kontinentale, Anëtare me të drejta të plota apo edhe Vëzhguese, ato (Dhomat Kombëtare të Avokative) janë të detyruara të depozitojnë pranë Sekretariatit të CCBE kodet e tyre të sjelljes, me qëllim që çdo avokat të pajiset me kopje të kodit aktual. Por, rregullat apo normat deontologjike të parashikuara në 'to vendosen dhe miratohen sipas procedurave gjyqësore, administrative dhe të gjithë legjislacionit vendas/kombëtar. Megjithatë, ndonëse të veçanta te secili Shtet, ato janë të shprehura në vlera të njëjta dhe në shumicën e rasteve demonstrojnë një bazë të përbashkët, që identifikohet më së pari në pavarësinë, besimin dhe integritetin, si detyrime profesionale të përbashkëta dhe në harmoni me njëra - tjetrën për avokatin.

Pikërisht në këtë kuadër kërkohet që avokati të ketë pavarësi absolute, të jetë i lirë nga të gjitha llojet e ndikimit, veçanërisht ato që mund të krijohen nga interesat e tij/saj personale apo prej presionit të jashtëm. Një pavarësi e tillë është domosdoshmëri për të krijuar dhe rritur besimin në procesin e drejtësisë dhe në pavarësinë e gjyqtarit. Prandaj, avokati duhet të shmangë çdo cënim të pavarësisë së tij/saj dhe të tregohet i kujdesshëm për të mos kompromentuar standardet profesionale, për t'i bërë qefin klientit, gjykatës apo edhe palëve të treta. Pavarësia është e domosdoshme, gjithashtu, edhe për çështjet që gjenerojnë apo jo debate. Këshilla që avokati i jep klientit nuk ka asnjë vlerë profesionale nëse ajo jepet prej avokatit për t'i krijuar këtij ndonjë favor apo për të kënaqur interesat e veta personale, ose kur këshilla jepet në përgjigje të presionit të jashtëm.

Ushtrimi i profesionit me pavarësinë e duhur dhe me obligimin për të marrë pjesë në administrimin sa më të mirë të drejtësisë krijon mundësinë që një avokat të ndalohet të marrë përsipër punësime të caktuara. Ndryshimet e rregullave për këtë sanksion, në të vërtetë reflektojnë kushtet specifike lokale/kombëtare dhe perceptime alternative mbi funksionimin

korrekt të rolit të avokatit në shoqëri. Nga ana tjetër, në çdo Shtet të BE, Anëtar apo Aspirues është vendosur detyrimi për respektimin e rregullave për punësimet e ndaluara, ose të papajtueshme me çështje të caktuara. Dhe këto rregulla duhet t'i marrë parasysh edhe çdo avokat rezident i përkohshëm apo jo në një Shtet Pritës, në rastet kur dëshiron të marrë pjesë drejtpërdrejt në aktivitete tregtare apo në veprimtari të tjera, që nuk janë të lidhura me praktikimin e ligjit, ashtu siç aplikohen për avokatët e atij Shteti.

Detyrime profesionale për avokatin janë edhe marrëdhëniet e besimit, që mund të ekzistojnë vetëm nëse nuk ka asnjë dyshim mbi respektin, ndershmërinë dhe integritetin personal të tij. Në këtë kuptim, thelbi i funksionit të avokatit është që këtij duhet t'i tregohen prej klientit të vet ato gjëra që ky i fundit nuk do t'ua tregonte të tjerëve. Pra, që avokati do të mund të merrte edhe informacione të tjera mbi baza konfidenciale. Mirëpo, pa patur siguri në këto marrëdhëne të ndërsjella nuk mund të ketë besim. Prandaj, konfidencialiteti është një e drejtë, por edhe detyrim primar dhe kryesor i avokatit. Ky detyrim i shërben administrimit më të mirë të drejtësisë, ashtu sikurse edhe interesave të klientit. Për rrjedhojë, ku virtyt tradicional gëzon mbrojtje të veçantë nga Shteti.

Sidoqoftë, një avokat duhet ta respektojë konfidencialitetin jo vetëm për të dhënat e lidhura me një çështje të caktuar, por edhe për të gjitha informacionet që i bëhen atij të ditura gjatë ushtrimit të profesionit. Gjithashtu, ky detyrim nuk është i limituar nga një periudhë në tjetrën. Ndërkohë që avokati duhet t'u kërkojë edhe avokatëve të asociuar, stafit të tij dhe çdo personi tjetër të përfshirë në ofrimin e shërbimeve profesionale, që të kenë dhe të ndjekin të njëjtin detyrim për të mbajtur në konfidencialitet informacionet apo të dhënat përkatëse. Këto detyrime theksohen për vetë kuptimin e një parimi të përgjithshëm, sipas të cilit një avokat duhet të veprojë gjithmonë në interesin më të lartë të klientit, për ta vendsosur këtë interes përpara interesave të veta personale apo edhe të kolegëve, por përherë duke pasur parasysh rregullat ligjore dhe ato të sjelljes përgjatë ushtrimit të profesionit të tij.

Ky përcaktim bën të qartë, se nuk ka ndonjë rrethanë dominuese për të kufizuar përgjegjësinë e avokatit ndaj klientit, madje edhe në praktimin ndërkufitar, qoftë me kontratë, ose duke përdorur një shoqëri të kufizuar, partneritet të kufizuar apo partneritet me përgjegjësi të kufizuar. Megjithatë, kjo mund të konsiderohet në rastet kur e lejojnë legjislacioni

përkatës dhe rregullat përkatëse, përkundër një numri juridiksionesh ku ligji apo rregullat profesionale e ndalojnë apo e limitojnë kufizimin e përgjegjësisë së avokatit ndaj klientit.

Gjithashtu, e nevojshme është që një avokat ta këshillojë dhe ta përfaqësojë klientin në kohën e duhur, me ndershmëri dhe me kujdes. Ai duhet të marrë dhe të mbajë përgjegjësi personale për mosmarrjen parasysh të instruksioneve nga klienti i vet, ndërkohë që duhet ta mbajë klientin të informuar për progresin e çështjes që i është besuar. Nëqoftëse avokati e di apo duhej të ishte në dijeni që vetë nuk ka kapacitete të nevojshme për trajtimin e një çështjeje të caktuar, ai nuk duhet ta marrë përsipër këtë, pa bashkëpunuar me një koleg tjetër të tij, i cili ka kompetencat e nevojshme në atë drejtim. Por, avokati nuk duhet të ushtrojë të drejtën për të hequr dorë nga një çështje në mënyrën apo në rrethanat kur klienti i tij mund të mos jetë në gjendje të gjejë tjetër asistencë ligjore në kohën e duhur, për të parandaluar kështu diskriminimin që mund të vuajë klienti.

Parashikimet e rregullave të sjelljes nuk e ndalojnë avokatin që të veprojë për dy ose më shumë klientë në të njëjtën çështje, vetëm nëse ai sigurohet që interesat e tyre në fakt nuk janë në konflikt dhe nuk ekziston një rrezik i konsiderueshëm që ky konflikt të ndodhë. Por, kur më pas krijohet një konflikt interesi ndërmjet atyre klientëve apo lind rreziku i thyerjes dhe shkeljes së konfidencës, ose edhe rrethana të tjera që mund të dëmtojnë pavarësinë, besimin dhe integritetin e avokatit, atëhere ky duhet të ndalojë veprimin për llogari të dy apo të të gjithë klientëve.

Megjithatë, mund të ekzistojnë situata që nxjerrin në pah diferencime të dy apo më shumë klientëve, që përfaqësohen nga i njëjti avokat, në të cilat rekomandohet që ky i fundit të përpiqet të veprojë si arbitër. Në këto raste i takon pra avokatit që të gjykojë vetë nëse ekziston një konflikt interesi midis klientëve të tij. Nëse jo, atëhere është e udhës që avokati të marrë në konsideratë t'u shpjegojë pozicionin klientëve të vet, të marrë miratimin e tyre dhe të veprojë si arbitër për të sheshuar ndryshimin ndërmjet klientëve, dhe nëqoftëse përpjekja e avokatit për ndërmjetësim do të dështojë, ai duhet të ndalojë së vepruari në emër të atyre klientëve.

Për sa u trajtua më lart dhe në të tjera drejtime, si: marrëdhëniet e avokatëve me gjykatat; komunikimi me palët kundërshtare; raportet ndërmjet avokatëve; bashkëpunimi midis avokatëve të vendeve të ndryshme; zhvillimi i trajnimeve të vazhdueshme etj., rregullat e sjelljes profesionale janë hartuar në të gjitha Shtetet e hapësirave Evropiane, pra

edhe në Shqipëri, nëpërmjet pranimit me dëshirën e vetë avokatëve, ndaj të cilëve ato aplikohen për të siguruar perfomancën e nevojshme nga ana e tyre gjatë ushtrimit të këtij profesioni, i cili është esencial në të gjitha shoqëritë e civilizuara. Dështimi i avokatit apo një grupi avokatësh për të ndjekur dhe zbatuar këto rregulla mund të çojë në marrjen e sanksioneve disiplinore, siç ka vcepruar edhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë Shqiptare, e cila mund edhe t'i dendësojë ato më pas, sipas parashikimeve të ndryshimeve në ligjin për Avokatinë, që pritet të miratohen së shpejti nga Kuvendi i Shqipërisë.

DEKLARATË E CCBE MBI APLIKIMIN EKSTRATERRITORIAL TË URDHRAVE TË KONTROLLIT

- Dhënë për Shtyp më 25 janar 2018 -

CCBE shpreh mbështetjen për Microsoft Corporation në një çështje lidhur me kontrollin dhe konfiskimin ekstraterritorial të komunikimeve elektronike.

Këshilli i Shoqatave të Avokatisë të Evropës (CCBE) ka depozituar një opinion *amicus curiae* në Gjykatën Supreme të ShBA-së në mbështetje të Microsoft Corporation për një çështje që lidhet me kontrollin dhe konfiskimin ekstraterritorial të komunikimeve elektronike.

Çështja *Shtetet e Bashkuara kundër Microsoft Corp.* shqyrton nëse Microsoft, një ofrues shërbimi emaili, duhet të jetë objekt i një urdhri të lëshuar sipas Aktit të Komunikimeve të Regjistruara (më poshtë: Akti), i cili kërkon bërjen të njohur në Shtetet e Bashkuara të komunikimeve me email të ruajtura në Irlandë.

EUROPEAN LAWYERS
EUROPEAN BARS
CCBE
BARREAUX EUROPÉENS
AVOCATS EUROPÉENS

Council of Bars and Law Societies of Europe
The voice of the European legal profession

Rue Joseph II, 40/8 - B-1000 Brussels
T.: +32 (0)2 234 65 10 - ccbe@ccbe.eu - www.ccbe.eu

PRESS RELEASE

The CCBE argues against the position of the United States on the extraterritorial application of search warrants.

25/01/2018

Sipas këtij Akti, qeveria mund t'i detyrojë ofruesit e shërbimeve si Microsoft-i që të ekzekutojnë urdhrat e lëshuar në bazë të Aktit të mësipërm, duke kërkuar, duke mbledhur dhe duke riprodhuar komunikime elektronike. Microsoft-i nuk pranoi t'i nënshtrohet këtij urdhri, duke kundërshtuar kështu vendimin e gjykatës.

CCBE-ja argumenton në *amicus curiae* e depozituar se, analiza e qeverisë së Shteteve të Bashkuara bazohet thellësisht në një gjykim të gabuar. Kjo çështje ka potencialin ta zgjerojë në mënyrë dramatike mundësinë e qeverisë amerikane për të konfiskuar komunikime elektronike të ruajtura jashtë territorit të Shteteve të Bashkuara.

Aplikimi ekstraterritorial i urdhrave të kontrollit mund të rrezikojë të drejtat e privatësisë së evropianëve, si edhe të drejtat e avokatëve dhe klientëve të tyre për t'u angazhuar në komunikime konfidenciale. Paprekshmëria e komunikimeve avokat - klient përbën një parakusht të domosdoshëm për një proces dhe gjykim të drejtë. Ky është gjithashtu një kriter madhor në vendosjen e besimit mes avokatit dhe klientit të tij, që është aspekt themelor i shtetit të së drejtës.

Presidenti i CCBE-së, Antonin Mokry pohon, se: "*Qëndrimi i qeverisë amerikane nuk merr në konsideratë si duhet ligjin e vendeve të tjera sa i përket sekretit profesional. Klientët, ose avokatët në disa raste, korrespondenca e privilegjuar e të cilëve e ruajtur në servera evropianë konfiskohet përmes një urdhri amerikan kontrolli, do të duhet të kërkojnë vënien në vend të së drejtës së tyre. Ata mund të mos kenë mundësinë të ndërhyjnë, për shkak se qeveria nuk do të ishte e detyruar të bënte ndonjë njoftim paraprak për konfiskimin*."

Opinioni i CCBE-së mban emrin e partnerit të Cleary Gottlieb Nowell Bamberger dhe bashkëpunëtorët e tij, në konsultim me CCBE-në (Iain Mitchell, Kryetar i Grupit të Punës së Mbikqyrjes, James MacGuill, Kryetar i Komisionit të Legjislacionit Penal dhe Simone Cuomo, Këshilltar Ligjor i Nivelit të Lartë).

CCBE përfaqëson shoqatat e avokatisë së 45 vendeve, dhe përmes tyre më shumë se 1 milion avokatë evropianë. Në të gjithë këtë çështje, CCBE-ja ka vënë vazhdimisht në dukje kërcënimin potencial që përbën qëndrimi i Shteteve të Bashkuara ndaj rendit ndërkombëtar.

NDALIMI I TË DREJTËS SË VOTES NË NJË KËNDVËSHTRIM TË RI KUSHTETUES

Av. Dr. Viktor GUMI
Anëtar i Dhomës së Avokatisë,
Tiranë

Hyrje

Diskutimet në favor dhe kundër të drejtës për të votuar nga personat që vuajnë/kanë vuajtur burgim për shkak të kryerjes së një vepre penale kanë qënë dhe vijojnë të jenë të pranishme gjërësisht si në debatet akademike, ashtu edhe në diskursin politik. Tashmë është pohuar edhe në vendet me demokraci të konsoliduar, se vendosja e kufizimeve në ushtrimin e së drejtës së votës dhe/ose për t'u zgjedhur për shkak të shtetësisë, moshës, kapacitetit mendor (zotësisë për të vepruar) dhe rezidencës janë gjerësisht të pranuara. Por, cilat janë këto kufizime konkrete dhe kush mund t'i vendosë ato? Në rastin e personave që vuajnë dënimin, heqja e së drejtës së votës që duhet të vendoset nga gjykata, mund të urdhërohet automatikisht nga një akt i Parlamentit apo nga ndonjë akt tjetër i pushtetit ekzekutiv? A duhet që heqja e së drejtës për të votuar dhe/ose për t'u zgjedhur të jetë pasojë e pandashme dhe automatike e vendimit të dënimit nga gjykata apo ky kufizim mund të jetë pjesë e veçantë e dispozitivit të vendimit? Në fund të fundit, një pyetje e përgjithshme ka nevojë për përgjigje: a duhet të votojnë të burgosurit?

Pyetje të tilla dhe përpjekja për përgjigje të tyre të çojnë pashmangshmërisht në një sërë konsideratash të tilla, si: qëllimi dhe objektivat shoqërorë të dënimit, përfshirja dhe përjashtimi social i atyre që dënohen nga gjykata e një vendi, nevoja e një reformimi penal të sistemit të drejtësisë etj.

Pavarësisht që fusha e debatit për një temë të tillë është shumë

e gjerë, ky artikull fokusohet vetëm në rolin e "garantit", pra, të atij që bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës - Gjykatës Kushtetuese - në shqyrtimin e një çështjeje të tillë.

Pikënisja dhe analiza kushtetuese në këtë shkrim është thelbësisht e fokusuar te përmbajtja e ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funskione publike", duke mos vënë aspak në pikëpyetje domosdoshmërinë e tij në realitetin shqiptar, por duke analizuar përmbajtjen e vet dhe raportin e përputhshmërisë së tij me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe me vetë Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Si në çdo fushë tjetër rregullimi normativ dhe procedura ligjvënëse duhet të respektojë disa standarte të mirëkonsoliduara europiane të cilat shkrimi i evidenton që në fillim të tij dhe në vijim analizohet, nën vështrim kritik, mosrespektimi i tyre në përmbajtjen e neneve të caktuara të ligjit nr. 138/2015.

Interpretimi konsistent i dispozitave të Kushtetutës dhe epërsia e të drejtave themelore të garantuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Gjykata Kushtetuese ka theksuar në jurisprudencën e saj, se çdo normë kushtetuese ka një lidhje të caktuar me normat e tjera dhe, së bashku, ato formojnë një tërësi normash të harmonizuara. Çdo normë e saj duhet të interpretohet, në mënyrë që të jetë e pajtueshme me parimet themelore kushtetuese. Nëpërmjet interpretimit që i bën normave, ose termave konkretë të Kushtetutës, Gjykata ka për qëllim të përcaktojë standardet kushtetuese mbi të cilat duhet të mbështetet veprimtaria e organeve kushtetuese dhe kërkesat në ushtrimin e veprimtarisë së tyre vendimmarrëse.[1]

Teksti i Kushtetutës dhe roli i Gjykatës Kushtetuese duhet të udhëhiqet nga parimi juridik i *Interpretimit Konsistent*. Sipas këtij parimi, gjykatat e një vendi, përfshirë edhe Gjykatën Kushtetuese, duhet të interpretojnë

1. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 29, datë 30.06.2011. Një rast ilustrues i zbatimit të këtij parimi është vendimi nr. 29, datë 21.10.2009 i Gjykatës Kushtetuese në të cilin ajo ka theksuar, se: "*Gjykata vlerëson të shprehet fillimisht për lidhjen që ekziston midis nenit 78, pika 1 të Kushtetutës dhe parimeve të sanksionuara nga nenet 1, 2 dhe 4 të Kushtetutës. Kjo për arsye se norma kushtetuese që përcakton rregulla për vendimmarrjen e Kuvendit nuk mund të interpretohet si një normë e izoluar, por duhet parë në harmoni me normat që sanksionojnë parimin e sovranitetit të popullit dhe shtetit të së drejtës.*"

ligjin e brendshëm, përfshirë edhe Kushtetutën, në përputhshmëri dhe jo në kontradiktë me detyrimet ndërkombëtare që ka marrë përsipër shteti. Ky parim është ndërkombëtarisht i njohur në legjislacion dhe në jurisprudencën e vendeve të tjera, për shembull, të Mbretërisë së Bashkuar, [2] Hollandës,[3] Polonisë,[4] Shteteve të Bashkuara të Amerikës[5]etj. Ky parim është rrjedhojë e logjikshme e kryerjes në mirëbesim të detyrimeve ndërkombëtare të shtetit, ose *pacta sunt servanda,*[6] si edhe e neneve 5 dhe 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Parimi *pacta sunt servanda* presupozon se, shteti është i detyruar të sigurojë një mekanizëm efektiv të implementimit të detyrimeve ndërkombëtare që ai merr përsipër me vullnetin e tij të lirë. Duke iu referuar dhe thirrur në ndihmë parimin e interpretimit konsistent të Kushtetutës, gjykatat e brendshme, përfshirë edhe Gjykatën Kushtetuese, mund dhe duhet të ndalojnë organet dhe pushtetet e tjera të thyejnë dhe shkelin detyrimet e veta ndërkombëtare, veçanërisht në fushën e të drejtave të njeriut, të njohura dhe të pranuara në katalogun kryesor të tyre - Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut.

Gjykata Kushtetuese Federale e Gjermanisë më 2014, në çështjen *Gorgülü* theksoi, se: *"Teksti i Konventës dhe jurisprudenca e zhvilluar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut shërben në nivelin e ligjit kushtetues, sepse udhëheq në interpretim për të vendosur përmbajtjen dhe qëllimin e të drejtave themelore dhe parimeve kushtetuese të Ligjit Themeltar, duke siguruar se kjo gjë nuk të çon në kufizim apo reduktim të mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut sipas Ligjit Themeltar. Përsa kohë që të gjitha standardet metodologjike lënë mundësi për interpretim dhe peshim të interesave, gjykatat gjermane duhet t'i japin prioritet*

---

2. Ligji për të Drejtat e Njeriut 1998, parashikon në nenin 3: "*1. Për aq sa është e mundur të bëhet kjo gjë, ligji dhe aktet nënligjore duhet të lexohen dhe t'u jepet interpretim në mënyrën që është e përputhshme me të drejtat e Konventës [Evropiane për të Drejtat e Njeriut]*"
3. Gjykata e Lartë e Hollandës (Hoge Raad der Nederlanden) *TSM Compagnie d'Assurance Transports vs. Geisseler Transport AG.* 16.11.1990. NJ 1992/107
4. Gjykata e Lartë e Polonisë (Sad Najëyższy) Ëyrok z dnia 29 listopada 2005 r. II PK 100/05
5. Gjykata e Lartë e SHBA (United States Supreme Court), *Murray v. The Charming Betsey*, 6 U.S. 2 Cranch 64, 118 (1804) ("*... Një akt i Kongresit nuk duhet kurrë të interpretohet se shkel ligjin ndërkombëtar, në rast se mbetet ndonjë interpretim tjetër")*
6. Konventa e Vjhenës "Për të drejtën e traktateve", nenet 26 dhe 27

interpretimit në përputhje me Konventën."[7]

Një përqasje e tillë e interpretimit të Kushtetutës prej Gjykatës Kushtetuese duhet të sigurojë, në masën më të madhe të mundshme, interpretimin përfundimtar të dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në lidhje me traktatet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe në përputhje me jurisprudencën e zhvilluar nga mekanizmat garantues të zbatimit të tyre, siç është Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Interpretimi i Kushtetutës "*në harmoni me Konventën në mënyrë të tillë që të koordinohen efektet e tyre dhe të shmanget ndonjë konflikt mes tyre*" është standard i zbatimit të këtyre dy dokumenteve themeltare, i vendosur tashmë nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen *Anchugov and Gladkov vs. Russia*.[8] Një deklarim i tillë normativ të dikton, *a contrario,* se në ato raste kur interpretimi i supozuar i një të drejtë themelore të njeriut që paraqitet në tekstin e Kushtetutës së Shqipërisë, siç është rasti i nenit 6/1 dhe nenit 179/1 të saj, garanton një nivel më të vogël mbrojtjeje sesa ai që të ofron dispozita analoge në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kjo duhet të përbëjë shkak që kjo situatë të shihet nën këndvështimin e lirive të të drejtave themelore të njeriut dhe kufizimeve të tyre të parashikuar në nenin 17, në nenin 5 dhe në nenin 122 të Kushtetutës, me qëllim që mbrojtja që i ofrohet individit të sillet në standardin e kërkuar të respektimit të tyre nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare dhe të detyrimit të shtetit shqiptar ndaj Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ky konkluzion është nxjerrë gjithashtu edhe nga Gjykata Kushtetuese, kur kjo ka arritur në përfundimin, se*: "Sipas parimeve kryesore të së drejtës ndërkombëtare, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre të plotë në Kushtetuten e Re, shtetet si subjekte të kësaj të drejte, janë të detyruara të përmbushin të gjitha angazhimet, që ato i kanë marrë përsipër për t'i realizuar. Përndryshe, në rast mospërmbushje të këtyre detyrimeve dhe angazhimeve ndërkombëtare, shtetet përkatëse nuk do të mund t'i shmangen përgjegjësisë, e cila zakonisht shfaqet shumëplanëshe, por që ndikimin më të madh e ka kryesisht në aspektin politik, juridik, ekonomik*

7. Gjykata Kushtetuese Federale e Gjermanisë (Das Bundesverfassungsgericht), 14.10.2004, 2 BvR 1481/04. § 32, 62

8. Vendim i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen *Anchugov and Gladkov vs. Russia*, aplikimet nr. 11157/04 dhe 15162/05, vendim i datës 4 korrik 2013, paragrafi 111 i vendimit

dhe social. E parë në këtë këndvështrim, Kushtetuta është hartuar duke u bazuar edhe në parimet që sanksionon Statuti i Këshillit të Evropës, ku në nenin 3 të tij thuhet: "Çdo anëtar i Këshillit të Evropës pranon parimin e përparësisë të së drejtës dhe parimin në bazë të të cilit çdo person nën juridiksionin e saj duhet të gëzojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore".[9]

21. *Çdo dispozitë e Kushtetutës duhet të interpretohet në mënyrë që të jetë e pajtueshme me parimet themelore kushtetuese. Kjo për arsye se çdo dispozitë kushtetuese ka një lidhje të caktuar me dispozitat e tjera dhe së bashku ato formojnë një tërësi normash të harmonizuara. Për pasojë, asnjë dispozitë e Kushtetutës nuk mund të nxirret jashtë kontekstit të saj dhe të interpretohet më vete".*[10]

Neni 6/1, neni 45 (paragrafi i tretë) dhe neni 179/1 i Kushtetutës nuk duhet të shihen dhe të interpretohen si norma të izoluara të saj, përkundrazi, ato kanë një lidhje të caktuar me normat e tjera kushtetuese, që së bashku formojnë një tërësi normash të harmonizuara dhe duhet të interpretohen në atë mënyrë që të jenë të pajtueshme me parimet themelore kushtetuese, të përcaktuara konkretisht në Preambulën e Kushtetutës, për garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në nenin 4, nenin 5, nenin 15, nenin 17, nenin 29, nenin 30 dhe nenin 122 të Kushtetutës.

I vetmi rast kur një marrëveshjeje ndërkombëtare i njihet statusi i normës kushtetuese është ai i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe kjo për të drejtat që kjo Konventë parashikon (neni 17 i Kushtetutës). Nën këtë këndvështrim, paragrafi i tretë i nenit 122 të Kushtetutës parashikon epërsinë e normave të nxjerra nga organizata supranacionale mbi "*të drejtën e vendit*". Në këtë rast, nuk është përdorur në Kushtetutë termi "*ligj*", por "*e drejta*". Nga ana tjetër, "*e drejta e vendit*" është në radhë të parë Kushtetuta. Pra rezulton se këto norma të nxjerra në rastin konkret nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nga jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut kanë epërsi mbi vetë normat kushtetuese. Gjithashtu, epërsia e dispozitave të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut zbatohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë ne Republikën e Shqipërisë, pikërisht për shkak të parashikimit të tyre në nenin 17, dhe kjo përbën kushtin e parë të epërsisë së vet edhe mbi nenin 6/1, nenin 45 (paragrafi i tretë) dhe nenin 179/1 të Kushtetutës, në rastin më të keq të interpretimit të tyre si norma

9. Vendimi nr. 65, datë 10.12.1999 i Gjykatës Kushtetuese
10. Vendimet nr. 24, datë 9.06.2011 dhe nr. 29, datë 21.10.2009 te Gjykatës Kushtetuese

të izoluara.

Në ato raste, kur mund të lindin interpretime të ndryshme për tekstin e neneve të saj në raport me rrethanat konkrete në gjykim, Gjykata Kushtetuese duhet t'i japë preferencë dhe të udhëhiqet prej parimit, sipas të cilit, normat kushtetuese, legjislacioni i brendshëm dhe çdo akt tjetër që del në zbatim të tyre nuk duhet të eleminojnë të drejtat themelore të individit, veçanërisht në raport me Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut.

Edhe akti administrativ mund të jetë *dënim penal*

Për herë të parë në jurispridencën e saj, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 33, datë 8.06.2016, në çështjen e shqyrtimit të kushtetueshmërisë së gjobave administrative shume të larta të parashikuara në ligjin "Për procedurat tatimore ne Republikën e Shqipërisë" (ligji 99/2015) krahasoi sanksionin penal me sanksionin administrativ dhe përcaktoi rastet kur ky i fundit duhet të konsiderohet për nga natyra e tij si "sanksion penal". Gjykata Kushtetuese konstatoi se masat administrative të gjobës sipas ndryshimeve më të fundit të ligjit "Për procedurat tatimore" jo vetëm ishin disa herë më larta se sa ato të përcaktuara për kundërvajtjet penale në fushën e taksave dhe tatimeve, por e tejkalojnë kufirin e gjobave të parashikuara për krimet në atë fushë. Gjykata mbajti qëndrimin se natyra e legjislacionit nuk është përcaktuese e natyrës jopenale të çështjes tatimore dhe se nisuar nga ashpërsia e dënimit, që subjekti tatimpagues rrezikon të marrë, gjobat përveçse janë konceptuar si dënime fikse, ato janë ashpërsuar dukshëm krahasuar me kuadrin e mëparshëm ligjor.

Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerësoi se ashpërsia e gjobave në rastin konkret është e tillë aq sa ato në thelb shndërrohen në dënime penale. Bazuar në karakteristikat dhe qëllimet e ndryshme midis dënimeve administrative me gjobë të vendosura për një shkelje me natyrë administrative dhe atyre të parashikuara për të njëjtën shkelje kur ajo kualifikohet si vepër penale, Gjykata çmoi se kjo masë e ligjvënësit e ka kapërcyer logjikën normale të synimit dhe qëllimit të një mase administrative në fushën e taksave dhe të tatimeve.

Edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në jurisprudencën e saj ka theksuar se, për të vendosur mbi ekzistencën e një "*akuze/dënim penale*", e nevojshme është të merren në konsideratë tre faktorë: (i)

kualifikimi ligjor i masës në fjalë në ligjin e brendshëm; (ii) thelbi i natyrës së masës së dhënë; (iii) natyra dhe shkalla e ashpërsisë së sanksionit. Ky njihet në këtë jurisprudencë si *Testi Engel*.[11]

Për më tepër, këto kritere janë alternative dhe jo kumulative. Që të zbatohet neni 6 (paragrafi 1) dhe neni 7 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në zbatim të fjalëve "*akuzë penale*", mjafton që shkelja në fjalë të jetë "*penale*" në natyrën e saj për nga këndvështimi i Konventës, ose duhet ta ketë bërë personin në fjalë përgjegjës për një sanksion që për shkak të natyrës dhe shkallës së ashpërsisë i përket në përgjithësi "*sferës penale*".[12]

Në çështjen *Grande Stevens vs. Italy* Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut përcaktoi se, gjobat e vëna nga COSNOB [Komisioni i Kompanive Kombëtare dhe Bursës] kishin natyrë penale, duke theksuar se: *"gjobat e vëna dhe ndalimet e bëra bazoheshin në rregulla, të cilat ishin së bashku siguruese, përkatësisht t'i ndalonin aplikantët për të rimarrë përsëri aktivitetin e tyre në fjalë, si edhe ndërshkuese, sepse ndërshkojnë një sjellje që është sjellje e paligjshme.*

Gjithashtu, në rastin në shqyrtim aplikantët kanë marrë përfundimisht gjoba që variojnë nga 500. 000 euro deri në 3. 000 000 euro dhe zoti Grande Stevens dhe zoti Marrone janë të ndaluar nga administrimi, menaxhimi apo supervizimi i kompanive të listuara në bursë për një periudhë nga dy deri në katër muaj. Ky sanksion i fundit [domethënë, ndalimi për të administruar, menaxhuar dhe supervizuar kompani] ishte i tillë që kompromentonte integritetin e personave në fjalë dhe, gjithashtu, edhe në konsideratë me shumat e gjobës ato ishin në mënyrë të padiskutueshme të ashpra dhe kishin implikacione financiare për aplikantët.

Për sa më sipër, duke marrë në konsideratë ashpërsinë e dënimeve të dhëna dhe për të cilat aplikantët ishin përgjegjës, Gjykata konsideron se sanksionet në diskutim për shkak të ashpërsisë ishin penale për nga natyra e tyre".

---

11. Vendim i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen *Engel and Others vs. the Netherlands*, aplikimet nr. 5100/71; 5101/71; 5102/71; 5354/72; 5370/72, vendim i datës 8 qershor 1976 (paragrafi 82)

12. Vendim i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen *Jussila vs. Finland*, aplikimi nr. 73053/01, vendim i datës 23 nëntor 2006 (paragrafi 30-31) dhe çështjen *Zaicevs vs. Latvia*, aplikimi nr. 65022/01, vendim i datës 31 korrik 2007 (paragrafi 31)

Vendosja e këtyre sanksioneve administrative përbënte (sipas ligjit italian) edhe humbje të përkohshme të nderit për përfaqësuesit e kompanive te përfshira, dhe në rast se këto të fundit do të listohen në bursë, përfaqesuesit e tyre janë përkohësisht të ndaluar nga administrimi, menaxhimi ose supervizimi i kompanive të listuara për periudha që variojnë nga dy muaj në tre vjet. CONSOB mund të ndalonte kompanitë e listuara për të përfituar shërbimet e shkelësve për nje periudhë deri në tre vjet dhe t'i kërkonte Urdhërave Profesionalë të pezullonin, në bazë të përkohshme, të drejtën individuale të tyre për të kryer aktivitet profesional.[13]

Në vendimin nr. 33, datë 8.06.2016 Gjykata Kushtetuese për herë të parë permendi dhe zbatoi në jurisprudencën e saj *Testin Engel*, madje në këtë vendim ajo konkludoi: "*Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se ashpërsia e gjobave në rastin konkret është e tillë sa ato në thelb shndërrohen në dënime penale*."

Një masë ndëshkuese që jepet ndaj një personi për shkak se ka kryer një veprim që është i ndaluar të kryhet, ose nuk ka kryer një veprim që kërkohet të kryhet si detyrim prej tij, nuk pushon së qëni *ndëshkim* (*penality*) në zbatim të nenit 6 (paragrafi 1) dhe nenit 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për shkak se është hartuar me bazë ligjore një ligj i ndryshëm nga Kodi Penal, ose është miratuar nga një organ administrativ. Në jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut të tillë shembuj janë me dhjetëra, për shembull:

i) gjobë për shkak të shkeljes së kodit rrugor; [14]

ii) gjobë për shkak të shkeljes së ligjit të taksave;[15]

iii) urdhër që i përket privilegjeve dhe kompetencave të parlamentit.[16]

Koncepti i "*dënimit*" në nenin 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut është i njëjtë me atë që parashikohet në nenin 6 (paragrafi 1) i Konventës, dhe që përbën për këtë jurisprudencë një koncept autonom.[17]

---

13. Vendim i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen *Grande Stevens vs. Italy*, aplikimi nr. 18640/10, vendim i datës 4 mars 2014 (paragrafët 97-98-99)

14. Cështja *Öztürk v. Germany, paragrafët* 9, 11, 18-21, 51-53

15. Vendim i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen *Bendenoun vs. France*, aplikimi nr.12547/86, vendim i datës 24 shkurt 1994, dhe çështja *A.P., M.P. and T.P. v. Sëitzerland*, aplikimi nr. 71/1996/690/882, vendim i datës 29 gusht 1997

16. Vendim i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen *Demicoli vs. Malta*, aplikimi nr.13057/87, vendim i datës 27 gusht 1991, paragrafi 9, 11, 12-13, 20, 32-33

17. Vendim i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen *Grande Stevens vs. Italy*, aplikimi nr. 18640/10, vendim i datës 4 mars 2014 (paragrafi 94) dhe çështjen Ëelch

Duke qënë se përfshihet në këtë fushë, pra si sanksion penal, edhe aktet administrative që dalin nga zbatimi i ligjit - të kujtdo institucioni qofshin - përbëjnë ndërshkim me natyrë penale. Pikërisht për këtë shkak, aktet administrative që dalin në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen, ose ushtrojnë funksione publike" për ndalimet për t'u zgjedhur dhe/ose për të zgjedhur përbëjnë "*sanksion me natyrë penale*" që mbështetet në një ligj, që i është dhënë fuqi prapavepruese, i cili ka shkelje të nenit 7 te Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të nenit 29 të Kushtetutës, çka ndalon absolutisht dhënien e sanksioneve penale me natyrë paravepruese, domethënë, dënim që nuk ka qënë parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale.

Në një rrafsh më praktik, aplikantëve në çështjen *Grande Stevens vs. Italy,* për shkak se ishin dënuar me gjobë dhe me ndalim për të qënë menaxher, administrator, ose supervizues në kompanitë e listuara në bursë për një periudhë dy - katër mujore, Gjykata e Strasburgut konsideroi që ndalimi dhe gjoba përbënin sanksione me natyrë penale, për pasojë gëzojnë mbrojtjen e nenit 6 (paragrafi 1) dhe, për këtë shkak, edhe të nenit 7 të Konventës Evropiane, prandaj ndërshkoi shtetin italian për shkelje.

Ligji nr. 138/2015 dhe zbatimi i parimit të mirënjohur të proporcionalitetit

Gjykata Kushtetuese ka evidentuar në vijimësi kriteret kushtetuese që duhet të respektohen nga ligjvënësi në rastin e kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. *Sipas nenit 17 të Kushtetutës, kufizime të të drejtave dhe lirive kushtetuese mund të vendosen nëse përmbushen disa kushte*: të caktuara me ligj, për një interes publik, ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve; duhet të jenë në përpjesëtim me gjendjen që i ka diktuar ato (parimi i proporcionalitetit/përpjestueshmërisë); të mos cënojnë thelbin e lirive dhe të drejtave; dhe në asnjë rast të mos tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Pra, kjo dispozitë kushtetuese kërkon vlerësimin e domosdoshmërisë së ndërhyrjes ligjore të shtetit, në varësi të natyrës së të drejtës, të karakterit të interesit publik që duhet të mbrohet, të rrethanave konkrete që e diktojnë një ndërhyrje në minimum dhe sa më pak të dëmshme nga pikëpamja e të

v United Kingdom, aplikimi nr. 17440/90, vendim i datës 9 shkurt 1995, paragrafi 27

drejtave të njeriut.[18]

47. *Kushtetua, nëpërmjet referimit te KEDNJ, i ka dhënë këtij dokumenti vlerën e standardit kushtetues përsa i përket kufizimit të të drejtave të njeriut. Ligjvënësi nuk mund të vendosë kufizime që tejkalojnë ato të parashikuara nga KEDNJ, por ai nuk pengohet, që nëpërmjet legjislacionit, të zgjerojë hapësirën e të drejtave dhe lirive dhe t'i japë një dimension më të madh realizimit të mbrojtjes së individit. Në këtë kuptim, Gjykata merr parasysh dhe jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, e cila i ka dhënë jetë standardeve të KEDNJ nëpërmjet zbatimit të tyre në çështjet konkrete. GJEDNJ është shprehur "sa herë që një shtet mundohet të mbështetet në parimin e "demokracisë së aftë të mbrojë vetveten" në mënyrë që të justifikojë ndërhyrjen në të drejtat e njeriut, ai duhet të vlerësojë me shumë kujdes qëllimin dhe pasojat e masave që ndërmerr, për të siguruar arritjen e balancës së lartpërmendur.*[19]

48. *Parimi i proporcionalitetit kërkon që periudha e përjashtimit të jetë e kufizuar dhe të marrë në konsideratë rrethanat individuale. Kohëzgjatja e përjashtimit nga një funksion publik duhet të varet nga njëra anë prej progresit në vendosjen e një shteti demokratik të së drejtës dhe nga ana tjetër prej mundësisë për një ndryshim pozitiv në sjelljen dhe qëndrimin e subjektit. Gjykata vëren se sanksionet që parashikon ligji [për pastërtinë e figures] vendosen për një kohë të papërcaktuar. Ajo thekson se, përderisa qëllimi është të largojë nga detyra personat me sjellje antidemokratike, periudha kohore gjatë së cilës do të shtrihet kontrolli duhet të jetë e kufizuar, pasi aktivitetet e kryera në të kaluarën nuk përbëjnë një provë përfundimtare të sjelljes aktuale apo të sjelljes në të ardhmen të individit.*[20]

Shtetet - Palë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut gëzojnë një marzh të gjerë vlerësimi përsa u takon kushteve për të drejtën e votës së përgjithshme (këtu përfshihet edhe e drejta për t'u zgjedhur). Gjithsesi, këto kushte kurrsesi nuk mund të jenë tilla që të zvogëlojnë të drejtën e votës në atë masë që eleminojnë thelbin e saj dhe të deprivojnë nga efiktiviteti i saj. Ato duhet të ndjekin një qëllim legjitim dhe mjetet e

18. Vendimet nr. 39, datë 16.10.2007 dhe nr. 41 datë 16.11.2007 të Gjykatës Kushtetuese
19. Vendimet nr. 24, datë 13.06.2007 dhe nr. 9, datë 23.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese
20. Vendimi nr. 9, datë 23.03.2010 i Gjykatës Kushtetuese

përdorura nuk duhet të jenë joproporcionale.[21]

Ligji nr. 138/2015 në tekstin e tij - neni 2, neni 3, neni 4 dhe neni 15 - parashikon pa asnjë dyshim kufizim të së drejtës për t'u zgjedhur. Kufizimet e vendosura nga ligjvënësi duhet të përmbushin kriteret e përcaktuara në nenin 17 të Kushtetutës dhe pikërisht që kufizimi duhet të bëhet me ligj për një interes publik, ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë, të mos cënojë thelbin e së drejtës dhe të mos tejkalojë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Strategjia e ndërhyrjes së ligjvënësit duhet të respektojë kriteret e mëposhtme:

(i) nëse objektivi i ligjvënësit është mjaftueshëm i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës;

(ii) nëse masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin - ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta, ose të bazuara mbi vlerësime alogjike;

(iii) nëse mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa duhen për të arritur objektivin e kërkuar: sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër duhet të jetë i rëndësishëm objektivi për t'u arritur, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme.

Pra, në thelb të parimit të proporcionalitetit qëndron ekuilibrimi i drejtë i interesave, vlerësimi objektiv i tyre, si edhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre.[22] Jurisprudenca kushtetuese, veçanërisht për sa u takon mjeteve të përdorura është shprehur që ligjvënësi duhet të zbatojë mjete të tilla ligjore, të cilat duhet të jenë efektive, domethënë, të zgjedhura në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme për realizimin e synimeve që ndiqen. Përdorimi i këtyre mjeteve duhet të jetë i domosdoshëm, gjë që do të thotë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera. Domosdoshmëria ka të bëjë, gjithashtu, edhe me përdorimin e mjeteve më pak të dëmshme për subjektet që u cënohen të drejtat dhe liritë. Kushti i përpjesëtimit të kufizimit me gjendjen që e ka diktuar, konkretizohet në kërkesën e domosdoshmërisë, dobishmërisë

21. Shih për më gjerë vendime të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë: Case C-145/04 *Spain vs. United Kingdom* [2006] ECR I-7917 (Gibraltar) dhe Case C-300/04 *Eman and Sevinger v. College van burgemeester en ëethouders van Den Haag* [2006] ECR I-8055 (Aruba)

22. Vendimet nr. 52, datë 05.12.2012 dhe nr.1 datë 06.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese

dhe proporcionalitetit, në kuptimin strikt të kufizimeve të imponuara. Respektimi i këtyre kushteve kërkon një analizë të kujdesshme në çdo rast konkret, duke ballafaquar interesin publik, i cili dikton kufizimin me ato të drejta, që si rezultat i tij i nënshtrohen kufizimit, duke vlerësuar edhe mënyrën e kufizimit.[23]

Çështja kryesore është nëse ky kufizim në këtë masë dhe me këtë shtrirje respekton thelbin e së drejtës për t'u zgjedhur, dhe se kufizimet janë arbitrare, të padrejta, ose të bazuara mbi vlerësime alogjike. Në kontekstin e nenit 17 të Kushtetutës së Shqipërisë, respekti për thelbin e së drejtës kushtetuese për t'u zgjedhur shërben si një detyrim me natyrë absolute për t'u respektuar, barrierë e pakalueshme kushtetuese dhe "*kufizim të kufizimeve*". Ndërkohë, përcakimet e bëra në nenin 2, nenin 3, nenin 4 dhe nenin 15 të ligjit nr. 138/2015, pa mëdyshjen më të vogël e asgjesojnë totalisht këtë të drejtë dhe kështu nuk bëhet më fjalë për kufizim në ushtrimin e saj, siç e kërkon Kushtetuta dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, por në shkatërrimin tërësor të saj.

Gjykata Kushtetuese ballafaqoi në vendimin nr. 33, datë 8.06.2016 pasojat që vijnë për individin, duke iu referuar veprave penale në lidhje me taksat dhe tatimet të përcaktuara në Kodin Penal dhe sanksioneve që ishin parashikuar në ligjin nr. 99/2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë". Gjykata Kushtetuese konstatoi se fshehja e të ardhurave dhe mospagimi i taksave dhe tatimeve, sipas neneve 180 dhe 181 të Kodit Penal janë krime të dënueshme me gjobë dhe burgim, dhe masa e gjobës që duhet të paguajë tatimpaguesi në rast të kryerjes së këtyre krimeve varion nga 100 mijë lekë deri në 10 milionë lekë. Ndërsa ndryshimi në aparatet matëse dhe prishja e shenjave të bllokimit apo pezullimit të veprimtarisë tregtare përbëjnë kundravajtje penale, sipas neneve 182 dhe 182/a të Kodit Penal, dhe tatimpaguesi mund të gjobitet nga 50 mijë lekë deri në 3 milionë lekë.

Gjykata Kushtetuese, duke krahasuar masën e gjobave për krimet në fushën e taksave dhe tatimeve sipas Kodit Penal, që varion nga 100 mijë lekë deri në 10 milionë lekë, me masën e gjobave të parashikuara nga ligji nr. 99/2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", konstatoi se këto të fundit jo vetëm janë disa herë më larta se ato të

23. Vendimet nr.16, datë 25.07.2008 dhe nr. 52, datë 05.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese

përcaktuara për kundërvajtjet penale në fushën e taksave dhe tatimeve, por e tejkalojnë kufirin e gjobave të parashikuara për krimet në atë fushë. Për rrjedhojë, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se ndërhyrja e ligjvënësit në çështjen konkrete nuk ishte në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe, si e tillë, cënonte lirinë ekonomike dhe të drejtën e pronës së tatimpaguesve, duke sjellë për pasojë një ndërhyrje thelbësore në gjendjen e tyre financiare dhe në thelbin e veprimtarisë ekonomike që ata ushtronin.

Besojmë se një analizë e tillë është e nevojshme të kryhet edhe në çështjen konkrete të kushtetushmërisë së ligjit nr. 138/2015. Sipas nenit 35 të Kodit Penal: "*Heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike, për një kohë jo më pak se pesë vjet, jepet detyrimisht ndaj personit që ka kryer një krim, që lidhet me detyrën, duke shpërdoruar funksionin publik ose ka kryer një krim, për të cilin gjykata ka caktuar një dënim me burgim jo më pak se dhjetë vjet.*

Heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike mund të jepet për një kohë nga tre deri në pesë vjet, kur gjykata ka caktuar një dënim nga pesë deri në dhjetë vjet burgim, dhe nga një deri në tre vjet, kur është caktuar dënimi deri në tre vjet burgim."

Sipas ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen deputetë në Kuvendin e Shqipërisë kryetar bashkie apo këshilltar në këshillin bashkiak, dhe në çdo rast nuk mund të marrin një funksion gjatë gjithë jetës personat që janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për një sërë veprash penale të përcaktuara ose 20 vjet për kryerjen e disa veprave të tjera caktuara të parashikuara në Kodin Penal. Sipas këtij ligji gjithashtu ndalimi është i vlefshëm edhe për personat që janë dënuar me një vendim jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor i një Shteti Anëtar të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë, ose për të cilët është vendosur masë sigurimi personal dhe/ose është lëshuar një urdhër kërkimi ndërkombëtar nga autoritetet e një prej ketyre shteteve, si edhe në rastet kur për ta ka një urdhër administrativ dëbimi.

Në analizë dhe ballafaqim të këtyre të dhënave, qartazi rezulton se ndërhyrja e ligjvënësit në ligjin nr. 138/2015 nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit, cënon të drejtën për t'u zgjedhur, për të kandiduar për një funksion publik, ose për të ushtruar një funksion publik, duke sjellë për pasojë një ndërhyrje thelbësore në të drejtën për t'u zgjedhur, që shkon paradoksalisht deri aty sa ajo të asgjësohet tërrësisht,

duke iu mohuar për gjithë jetën. Nga ana tjetër, kushtetushmëria apo jo e përcaktimeve të bëra në nenin 2, nenin 3, nenin 4 dhe nenin 15 të ligjit nr. 138/2015 duhet të shihet edhe nën këndvështrimin nëse ky ligj të ofron mundësinë e rishikimit të këtij kufizimi në kohë prej gjykatave të vendit, çështja e masës së shkarkimit dhe/ose përfundimit të mandatit, si edhe mohimi i kandidimit nuk shihet në karakeristikat individuale të çdo rasti konkret, por përkundrazi ofrohen sanksione me natyrë penale automatike dhe shumë drastike.

Kushtetushmëria e përcaktimeve të bëra në nenin 2, nenin 3, nenin 4 dhe nenin 15 të ligjit nr. 138/2015, gjithashtu duhet të shihet edhe në raport me institutin e rehabilitimit të parashikuar në Kodin Penal dhe që përbën një aspekt thelbësor të së drejtës penale. Mosmarrja dhe moskonsiderimi i tij në ligjin nr. 138/2015 e bën atë flagrant dhe unik në shkeljen e ketëj parimi themelor të së drejtës penale.

Shkelja më flagrante e parimit të proporcionalitetit bëhet në rastin e ndalimit për t'u zgjedhur dhe për të zgjedhur të personave që kanë pasur një masë të sigurimit personal. Komisioni i Venecias në studimin e bërë e ka shprehur qartë karakterin antikonventor dhe antikushtetues të një ndalimi të tillë, kur thekson se:

"156. Në rastet kur personi nuk është dënuar ende, parimi i prezumimit të pafajësisë shkon kundër heqjes së të drejtave politike. Në mendimin e Komisionit të Venecias gjithsesi disa përjashtime mund të jenë proporcionale dhe legjitime, për shembull, krimet që parashikohen në Statusin e Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare."[24]

Masa e sigurimit personal në çdo rast ndjek një qëllim të ndryshëm dhe nuk mund të mbizotërojë mbi parimin e prezumimit të pafajësisë, derisa personi të jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë. Prandaj vendosja e masës së sigurimit personal dhe/ose dëbimit si parakusht për përfundimin e parakohshëm të mandatit legjitim të kryetarit të bashkisë dhe heqjen e të drejtës për t'u zgjedhur përjetësisht në çdo funksion publik, përbën shkelje flagrante të parimit themeltar kushtetues të prezumimit të pafajësisë, që është njëkohësisht edhe një nga themelet e garancive europiane për të drejtat e njeriut.

Edhe një argument të fundit, që pavarësisht renditjes nuk është më pak i rëndësishëm. Neni 45 (paragrafi i tretë) i Kushtetutës parashikon,

24. Studim i Komisionit të Venecias në http://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2015)036-e

se: "*Përjashtohen nga e drejta për t'u zgjedhur shtetasit që janë dënuar me burgim, me vendim përfundimtar të formës së prerë për kryerjen e një krimi sipas rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.*" Pëcaktimet e bëra në nenin 6/1 dhe në nenin 179/1 të Kushtetutës, nuk duhet të shihen të ndara, por të lidhura thelbësisht me këtë nen. Përmbajtja e këtyre dy neneve të fundit nuk duhet të kuptohet i distancuar nga formulimi i nenit 45 (paragrafi i tretë) i Kushtetutës, sepse edhe ligji që ka dalë në zbatim të nenit 45 dhe të nenit 6/1 dhe nenit 179/1 të Kushtetutës është i njëjtë dhe i vetëm (ligji nr.138/2015).

Ndërkohë, ligji nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjdhen, emërohen, ose ushtrojnë funksione publike" parashikon në nenin 2 (pika 2) ndalimin e së drejtës për t'u zgjedhur edhe ndaj personave:

"a) që janë dënuar me një vendim jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor i një Shteti Anëtar të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë, apo për të cilët është vendosur masë sigurimi personal dhe/ose është lëshuar një urdhër kërkimi ndërkombëtar nga autoritetet e një prej këtyre shteteve, për kryerjen apo tentativën e kryerjes së një prej veprave penale, të parashikuara në pikën 1, shkronja "a", të këtij neni. ...

b) që janë dëbuar nga territori i një Shteti Anëtar të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë, në lidhje me një prej rasteve të parashikuara në pikën 1, shkronjat "a", "b" dhe "c", të këtij neni, apo janë dëbuar për cënim shumë të rëndë dhe serioz të sigurisë publike të shtetit përkatës."

Ndërkohë, po në nenin 4 të ligjit nr. 138/2015 përcaktohet, se:

"5. Për personat që parashikohen në shkronjën "a", të pikës 2, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të funksionit zgjat derisa nuk ka një vendim pafajësie në favor të tij. .....

6. Për personat e dëbuar sipas parashikimeve të germës "b" të pikës 2 të nenit 2 të këtij ligji, kohëzgjatja e ndalimit për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të funksionit është:

i) përjetë për dëbim, në lidhje me rastet e parashikuara nga neni 2, pika 2, shkronja "a"; ii) 20 vjet për dëbim, në lidhje me rastet e parashikuara nga neni 2, pika 2, shkronja "b"; iii) 10 vjet për dëbim, në lidhje me rastet e parashikuara nga neni 2, pika 2, shkronja "c", pavarësisht uljes së dënimit për shkak gjykimi të shkurtuar apo

procedure të ngjashme me të që passjell uljen e dënimit;

7. Në rastet e dëbimit me akt administrativ për cënim shumë të rëndë dhe serioz të sigurisë publike të shtetit përkatës, ndalimi përcaktohet në përputhje me afatin e dëbimit, por në çdo rast jo më pak se 10 vjet."

Pra, ndërkohë që e drejta për t'u zgjedhur mund të kufizohet sipas Kushtetutës vetëm për personat që janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi, nenet e mësipërme të ligjit nr. 138/2015, të paautorizuar nga delegimi kushtetues dhe në kundërshtim flagrant me përcaktimin kushtetues, ndalimin e shtrijnë për t'u zgjedhur edhe kur nuk ka vendim gjyqësor të formës së prerë, domethënë, që janë dënuar me një vendim jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor i një Shteti Anëtar të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë, ose për të cilët është vendosur masë sigurimi personal dhe/ose është lëshuar një urdhër kërkimi ndërkombëtar nga autoritetet e një prej këtyre Shteteve, ose për personat që parashikohen në shkronjën "a" të pikës 2 të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015. Për këta ndalimi për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të funksionit zgjat derisa nuk ka një vendim pafajësie në favor të tij, dhe ky ndalim është i vlefshëm edhe kur masa përkatëse e sigurisë personale është hequr, por personi vazhdon të ndiqet penalisht apo të gjykohet për veprën për të cilën është vendosur fillimisht masa e sigurisë personale, ose ende nuk është marrë një vendim gjyqësor në lidhje me fajësinë e personit.

Konkluzion

Aktualisht, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut po shqyrton çështjen *Silvio Berlusconi v Italy* dhe i duhet të vendosë mbi bazën e kërkesës së aplikantit për zbatimin prapaveprues të legjislacionit antikorrupsion të Italisë. Më 27 nëntor 2013, ish- kryeministri i Italisë, Berlusconi humbi mandatin në Parlamentin Italian për shkak të dënimit penal të dhënë më 1 gusht 2013 nga një gjykatë italiane, e cila e dënoi atë për evazion fiskal. Humbja e mandatit në Parlament u shkaktua si pasojë e zbatimit të ligjit nr. 190/2013 dhe të dekretit legjislativ të 31 dhjetorit 2013, që parashikonte humbjen e postit publik për ata që janë dënuar me burgim për më shumë se 2 vjet për vepra penale që parashikojnë minimumin e dënimit 4 vjet.

Berluskoni ankohet në Gjykatën e Strasburgut, se humbja e postit të anëtarit të Parlamentit Italian është në thelb një masë me natyrë penale, dhe sipas nenit 7/1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut duhet të jetë subjekt i kërkesës për ndalimin e fuqisë prapavepruese të tij.

Mbetet për t'u parë në vijim se, cili do të jetë vendimi i Gjykatës së Strasburgut për këtë çështje dhe natyrisht ky vendim do të afektojë edhe legjislacionin shqiptar në këtë fushë, përsa kohë e njëjta zgjidhje ligjore si në Itali është aplikuar edhe në Shqipëri me ligjin nr. 138/2015.

Nën dritën e zhvillimeve të jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut dhe ndoshta në një distancë kohore të tillë ku emocionet politike të ditës në Shqipëri do të jenë më pak ndikuese, Gjykata Kushtetuese duhet të rivlerësojë vendimmarjen e saj në këtë çështje. Në rast të kundërt, nuk do të shkojë kohë e gjatë kur Gjykata e Strasburgut të marrë vendim edhe për Shqipërinë.

Literatura:

Akte normative

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut
- Konventa e Vjenës "Për të drejtën e traktateve"
- Kodi penal i Republikës së Shqipërisë
- Ligji shqiptar nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen, ose ushtrojnë funksione publike"
- Ligji italian nr. 190/2013
- Dekreti legjislativ italian i 31 dhjetorit 2013

Doktrinë

- Ewald, A. (2002), *"Civil Death": The Ideological Paradox of Criminal Disenfranchisement Law in the United States*, 'Wisconsin Law Review', 5
- Grayling, C. (2014), *Draft Voting Eligibility (Draft) Bill – Response to the Committee*, në: http://www.parliament.uk/documents/joint-committees/Draft-Voting- Eligibility-Prisoners-Bill/Grayling-letter-to-Chair.pdf
- Mauer, M. (2011), *Voting Behind Bars: An Argument for Voting by Prisoners*, 'Hoëard Laë Journal', 54

- Ramsay, P. (2013), *Faking Democracy ëith Prisoners' Voting Rights*, 'London School of Economics Legal Ëorking Paper' 7/2013, në: : http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=2214813

- Travis, J. (2002), *Invisible Punishment: An Instrument of Social Exclusion*, në Mauer, M. & Chesney-Lind, M. (ed.), *Invisible Punishment: The Collateral Consequences of Mass Imprisonment*. *Neë York: The Neë Press*.

- *Hirst vs. United Kingdom*, (No.1), Aplikimi no. 74025/01 (vendim i 30 Mars 2004) Hirst v United Kingdom, (No.2) [GC], Aplikimi no. 74025/01 (vendim i 6 tetor 2005)

- *Frodl vs. Austria*, Aplikimi no. 20201/04 (vendim i 8 Prill 2010)

- *Scoppola vs. Italy* (No. 3), Aplikimi no. 126/05 (vendim i 22 Maj 2012)

- Studim i Komisionit të Venecias në

http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2015)036-e

Jurisprudencë

- Vendime Gjykatës Kushtetuese: nr. 29, datë 30.06.2011; nr. 29, datë 21.10.2009; nr. 65, datë 1012.1999; nr. 24, datë 9.06.2011; nr. 29, datë 21.10.2009; nr. 39, datë 16.10.2007; nr. 41, datë 16.11.2007; nr. 24, datë 13.06.2007; nr. 9, datë 23.03.2010; Vendimi nr. 9, datë 23.03.2010; nr. 52, datë 05.12.2012; nr.1, datë 06.02.2013; nr.16, datë 25.07.2008; nr. 52, datë 05.12.2012; nr. 24, datë 23.03.2017; nr. 43, datë 5.06.2017

- Vendime të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë: Case C-145/04 *Spain v. United Kingdom* [2006] ECR I-7917 (Gibraltar); Case C-300/04 *Eman and Sevinger v. College van burgemeester en ëethouders van Den Haag* [2006] ECR I-8055 (Aruba)

- Vendime të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për çështjet: *Engel and Others v. the Netherlands*, aplikimet nr. 5100/71; 5101/71; 5102/71; 5354/72; 5370/72, vendim i datës 8 qershor 1976; *Anchugov and Gladkov v Russia*, aplikimet nr. 11157/04 dhe 15162/05, vindim i datës 4 korrik 2013; *Jussila v. Finland*, aplikimi nr. 73053/01, vendim i datës 23 nëntor 2006; *Zaicevs v. Latvia*, aplikimi nr. 65022/01, vendim i datës 31 korrik 2007; *Grande Stevens v Italy*, aplikimi nr. 18640/10, vendim i datës 4 mars 2014; *Öztürk v. Germany; Bendenoun v. France*, aplikimi nr.12547/86, vendim i datës 24 shkurt 1994; *A.P., M.P. and T.P. v.*

Sëitzerland, aplikimi nr. 71/1996/690/882, vendim i datës 29 gusht 1997; *Demicoli v. Malta*, aplikimi nr.13057/87, vendim i datës 27 gusht 1991; *Grande Stevens v Italy*, aplikimi nr. 18640/10, vendim i datës 4 mars 2014; *Welch v United Kingdom*, aplikimi nr. 17440/90, vendim i datës 9 shkurt 1995, paragrafi 27

- Vendim i Gjykatës së Lartë të Hollandës (Hoge Raad der Nederlanden) për çështjen *TSM Compagnie d'Assurance Transports v. Geisseler Transport AG.* 16.11.1990. NJ 1992/107

- Vendim i Gjykatës së Lartë të Polonisë (Sad Najëyższy) për çështjen Ëyrok z dnia. 29 listopada 2005 r. II PK 100/05

- Vendim i Gjykatës së Lartë të SHBA (United States Supreme Court) për çështjen *Murray v. The Charming Betsey*, 6 U.S. 2 Cranch 64, 118 (1804) («*... Një akt i Kongresit nuk duhet kurrë të interpretohet se shkel ligjin ndërkombëtar, në rast se mbetet ndonjë interpretim tjetër)*

- Vendim i Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë (Das Bundesverfassungsgericht), i datës 14.10.2004, 2 BvR 1481/04. § 32, 62

RIREFORMIMI KUSHTETUES I DREJTËSISË ADMINISTRATIVE

Av. Vasil BENDO
Anëtar i Dhomës së Avokatisë,
Tiranë

Hyrje

Kritikat e paraqitura në këte artikull siguroj se kanë për qëllim kryesor vetëm arritje pozitive në drejtim të thellimit të reformave gjyqësore, në mënyrë të veçantë të drejtësisë administrative. Problemi bazik që shtrohet është: A mjafton një ligj që themelon një sistem të ri gjyqësor apo duhet një sistem gjyqësor i mirëthemeluar, që garanton të drejtat administrative të personave fizikë dhe juridikë shqiptarë? Qëndrimet e lëkundura apo ato ekuilibruese politike dhe profesionale ndaj reformave të thella të pushteteve kushtetuese nuk i kam mbështetur dhe nuk pozicionohem si përshtatës i tyre. "Dëmi" më i vogël që mund të bëjë një jurist-profesionist është rikujtesa e vetëvetes si thirrje ndaj politikës dhe publikut për të ndërmarrë aktet e nevojshme reformative, që përmirësojnë apo garantojnë mbrojtjen e lirive dhe të të drejtave të shtetasve në gjykimin administrativ trishkallësh shqiptar.[1] Rithirrja publike për një rireformim të plotë të drejtësisë administrative është një çështje që shtrohet sot për zgjidhje, pas një praktike jo pozitive afërsisht pesëvjecare të zbatuar nga gjykatat administrative të themeluara në vendin tonë në fund të vitit 2012.[2]

Mendoj se është e domosdoshme të bëhet një reformë e plotë e

1. Vasil Bendo, *Plotësimi i drejtësisë administrative*, revista 'Avokatia', Nr. 15, Korrik 2015, faqe 31-51
2. Ligji Nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"; Ligji Nr. 151/2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8588, Datë 15.03.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë"

gjykimit administrativ, por deri tani vërej se ka mangësi në krahasim me sistemet e konsoliduara evropiane. Konstatoj që kjo drejtësi vazhdon të jetë e ndërvarur nga juridiksioni i gjyqësorit të zakonshëm në shkallën e tretë, gjë që është me pasoja juridike negative në të dyja shkallët e ulta dhe të pavarura të gjyqësorit administrativ. Gjatë këtyre 27 viteve të zhvillimit të legjislacionit tonë demokratik janë vërejtur përzjerje në ligj dhe në organizim, por tani ka ardhur koha kur duhet të bëhemi solidë. E vështirë, megjithatë e mundshme kjo, qoftë politikisht dhe legjislativisht, por edhe praktikisht e tradicionalisht. Politika është ajo që prodhon pushtetet kushtetuese. Prandaj, së pari duhet reformuar ajo dhe, së dyti, pushtetet kushtetuese që rrjedhin prej saj. Nga kjo tablo i bëhet thirrje politikës të jetë e kujdesshme në hartimin e reformave afatgjata dhe të qëndrueshme që prekin të drejtat dhe interesat e shtetasve e të subjekteve juridike. Pra, që ajo të hartojë strategji reformative afatgjatë zhvillimi.

Ndërkohë që përkohshmëria reformative sjell gjithmonë pasoja juridike te pjesëshme, që vështirë se rregullohen në një kohë të shkurtër në dobi të publikut drejtësidashës shqiptar. Kjo rrjedh për shkak të ndryshueshmërive politike, specifikave politike dhe papërshtatshmërive koniukturale ligjbërëse të vendit tonë demokratik, por të vonuar në hartimin e strategjive afatgjata të zhvillimit ligjor dhe social.

Objektivi reformativ

Objekt themelor i këtij artikulli është ndryshimi i nenit 141 të Kushtetutës: a ka sjellë apo mund të sjellë ai përmirësimin, efikasitetin dhe lehtësimin e gjykimit në shkallë të tretë të çështjeve administrative, civile dhe penale? Neni 141 i Kushtetutës [3] ka vepruar për një periudhë relativisht të gjatë, afërsisht 18 vjet, por nuk prodhoi efektet e dëshiruara për të ndarë gjykimin ordiner nga gjykimi unifikues, për t'i dhënë përparësi njërit apo

3. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 141 ka patur para ndryshimit përmbajtjen si vijon:

"1. Gjykata e Lartë ka juridiksion fillestar dhe rishikues. Ajo ka juridiksion fillestar kur gjykon akuzat penale kunder Presidentit te Republikes, Kryetarit dhe anetareve te Keshillit te Ministrave, deputeteve, gjyqtareve te Gjykates se Lartë dhe gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

2. Për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë ka të drejtë të tërheqe për shqyrtim në kolegjet e bashkuara çështje të caktuara gjyqësore."

tjetrit gjykim në shkallë të tretë dhe për të vendosur balancat ndërmjet tyre. Sistemi i vendosur nga kjo dispozitë kushtetuese nëpërmjet ligjeve procedurale shtjelluese civile, penale, administrative, etj. e kishin kthyer gjykimin në shkallë të tretë shumë më tepër kasacional sesa unifikues të praktikës gjyqësore. Ndryshimi i nenit 141 të Kushtetutës, pa dyshim që sjell efekte pozitive, por jo esenciale në shkallën e tretë të gjykimit administrativ, civil dhe penal. Ky ndryshim parashikon një reformë në sistemin gjyqësor tri shkallësh, pavarësisht se duket si një ndryshim i thjeshtë i një dispozite kushtetuese.

Ndryshimi përmban konkretisht:

"1. Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit.

2. Për ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë tërheq për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore të vendosura nga kolegjet, sipas ligjit.".[4]

Në zbatim të kësaj dispozite janë bërë edhe ndryshimet e dispozitave përkatëse të tri ligjeve procedurale themelore shqiptare, të Kodit të Procedurës Penale, të Kodit të Procedurës Civile dhe të Ligjit për Gjykatat Administrative. Këto ligje janë ndryshuar në përputhje me detyrimin kushtetues për një qëllim reformues, për të minimizuar gjykimin ordiner në shkallë të tretë dhe maksimalizuar unifikimin e praktikave gjyqësore ne të trija shkallët e gjyqësorit shqiptar.

Natyrisht janë ndryshime pozitive dhe avancuese drejt reformimit, por pyetjet që shtrohen janë: Ndryshimi i kësaj dispozite kushtetuese sjell apo jo efektivitetin e plotë në drejtësinë administrative që kemi në analizë? Ndryshojnë apo jo natyra, kompetencat dhe funksionaliteti i Gjykatës së Lartë, si gjykatë ordinere e shkallës së tretë të deritanishme? Në vijim të reformave gjyqësore, a do të mbisundojë gjykimi ordiner apo unifikimi i praktikave gjyqësore?

Ndryshimi kushtetues, por edhe ndryshimet procedurale mendoj se nuk krijojnë garanci të mjaftueshme në zbatimin e tyre në praktikë. Dega e së drejtës administrative, që përfshin edhe gjyqësorin administrativ tri shkallësh është tepër delikate. Raportet e marrëdhënieve juridike, shtetas ankimues-administratë publike-gjykatë administrative; subjekte juridike

4. Ligji Nr. 76/2016, datë 22.07.2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", neni 141

ankimuese- administratë publike-gjykatë administrative, në praktikën e deritanishme të administrimit publik është konceptuar gjithmonë si dominim i shtetit mbi shtetasit apo personat juridikë privatë, ose/dhe publikë. Dëshiroj të theksoj që shteti, shtetasit dhe personat juridikë dhe fizikë mund dhe duhet të jenë të barabartë në të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre para drejtësisë administrative, të paktën kështu e përcakton ligji ynë material civil shumëvjecar,[5] si edhe vetë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.[6] Kjo drejtësi fillon me aktin administrativ dhe përfundon me vendimin e gjyqësorit administrativ, duke përshkruar një shumëllojshmëri rregullash materiale dhe procedurale të detyrueshme për zbatim nga administrata publike qëndrore dhe vendore.

Parimi themelor i dhënies së drejtësisë administrative është kontrolli gjyqësor për qeverisjen qëndrore dhe vendore, prandaj edhe duhet të përsoset me qëllim që të garantohen të drejtat kushtetuese dhe administrative të të gjithë personave fizikë dhe juridikë, të cilëve u cënohen liritë dhe të drejtat e tyre civile, politike, ekonomike, racore, ngjyrore, fetare, punësimi, etj,. Duhet të kuptohet një herë e mirë se, në një proces gjyqësor administrativ shteti është palë e barabartë me shtetasit dhe nuk duhet kurrsesi të ushtrojë presion mbi gjykatën administrative. Në të kundërt, gjykata administrative merr fund në misionin e saj ndaj kontrollit ligjor mbi ekzekutivin.

Praktika e deritanishme afërsisht pesërvjecare e funksionimit të gjykatave administrative ka lënë shumë për të dëshiruar, pasi - thënë haptazi - po krijojnë kriza të thella sociale, politike dhe ekonomike. Nuk marr përsipër të ilustroj çështjet, sepse ato janë të pafundme, Megtjithatë, kembëngul që sistemi i vendosur nuk ka dhënë frytet e shumëpritura dhe të premtuara, si garanci për negocimin dhe anëtarësimin e Shtetit Shqiptar në BE. Mbi pesë vite më parë, politikës dhe qeverisjes kushtetuese të vendit tonë iu vu një kusht themelor për hapjen e negociatave për anëtarësimin në Unionin Evropian: *Miratoni ligjin dhe krijoni gjykatat administrative, përndryshe jeni të humbur dhe kushedi kur rikujtohemi per ju*! Ky është një perifrazim i imi, por domethënia përmbajtësore është e kuptueshme dhe u drejtohet: së pari, politikes qeverisëse tri partiake ligjbërëse, që

5. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 7850, datë 29.07.1994, Titulli I "Subjektet e së drejtës civile", Kreu I "Personat fizikë", Kreu II "Personat juridikë"

6. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin Nr. 8417, datë 21.10.1998, neni 15 dhe në vijim

nuk thellohet në objektivat reformative afatgjata, të cilat garantojnë stabilitetin ligjor të vendit; së dyti, profesionistëve të fushës së drejtësisë administrative, që duhet të jenë plotësisht të pavarësuar në asistencën e tyre për këtë reformim.

Ligji u miratua në maj 2012 dhe gjykatat administrative tri shkallëshe filluan së funksionuari në nëntor të vitit 2013.[7] Sot shtrohet çështja: sa efektiv është sistemi i drejtësisë administrative i vendosur dhe cilat janë mundësitë për rireformimin e tij në të mirë të publikut? Sistemi i atashuar nuk është perfekt, ai ndoshta ka vendosur hapat themelorë të iniciativës për përsosjen e tij. Siç e kam thënë në krye të herës, mund të kem përsëritje dhe referime të vetvetes me qëndrimet e mëparëshme, por zhvillimet e vrullshme ligjore të këtyre viteve të fundit më inkurarojnë të hedh disa mendime progresive për rireformimin e plotë të shkallës superiore të drejtësisë administrative, sipas kushteve dhe mundësive të vendit tonë. Kërkoj falje nëse hedh ide të parakohshme, ose jo të mirëstudiura, por kërkoj edhe komente për materializimin e propozimeve që do të shtrohen në vijim.

Pamje e përgjithshme sociale dhe politiko-ligjore

Përgjatë këtyre 27 viteve të fundit të zhvillimit reformativo-ligjor të vendit tonë kemi patur rritje dhe ulje qeverisëse, kemi patur kriza politike të jashtëzakonshme, deri në përmbysje shtetërore, kemi patur kriza të rënda sociale që kanë detyruar shtetasit tanë të largohen të pa lumtur nga atdheu i tyre. Padrejtësia e propaganduar si "drejtësi" dha shkas të largohet masivisht truri i kombit, të largohen profesionistët, të mbeten politikanët që "gjuajnë" pasuritë e ligjshme për të "peshkuar", me qëllim gllabërimin e tyre në rrugë të paligjshme. Në fillimvitet 90' është sulmuar dhe pushtuar masivisht prona ish-private, e kthyer padrejtësisht në pronë shtetërore, e rrëmbyer nga pronarë të paligjshëm dhe të pa çertifikuar. Shumë shtetas të zonave rurale dhe jorurale veriore dhe jugore, por jo vetëm këta, edhe shumë shtetas të tjerë të paintegruar zaptuan pasuri, prishën ndërmarrje, shkatërruan pronën publike, vendosën pushkën përballë ish-pronarit, u bënë dypronarë, u vranë, u shitën, u vetëgjyqësuan. Janë të shumta pasojat

7. Dekret i Presidentit të Republikës Nr.8349, datë 14.10.2013 me të cilin u vendos dhe filloi nga data 04.11.2013 funksionimi njëherësh i gjykatave administrative tri shkallëshe në Republikën e Shqipërisë

e katastrofave dhe paaftësive të keqvetështetreformimit shqiptar. Po në vitin 1991 u miratua ligji për ndarjen e tokës, [8] i cili vuri "kazmën" mbi të drejtën e pronësisë. Dy partitë politike udhëheqëse në vend, e majta socialiste e "rithemeluar" dhe e djathta "demokratike" e sapokrijuar, me konsensus të plotë vendosën një reformë të dytë agrare pas asaj të vitit 1946, nga më të ashprat shpronësuese në vend. Prej më shumë se 27 vitesh pronarët konsiderohen jopronarë dhe "zaptuesit pronarë". Kam mendimin se gjithmonë kriza e pronësisë prodhon kriza kushtetuese, politike, sociale edhe në drejtësi. Evropa "dashamirëse" që lakmojmë për anëtarësim nuk të pranon nëse ti "Shteti Shqiptar", nuk je i aftë të zgjidhësh problemet parimore të drejtësisë civile dhe administrative.

Ligji reformativ kushtetues i vitit 1991 me ndryshimet në vijim,[9] miratuar me konsensus të plotë politik, ndonëse ka qenë një ligj i konsideruar tranzitor arriti të prodhojë efekte pozitive dhe të krijotë bazat fillestare për shtimin e një kreu të veçantë për pushtetin gjyqësor dhe miratimin e kodeve materiale dhe proceduriale, si edhe ligjeve organike per Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Kasacionit të Republikës së Shqipërisë. Me ligj kushtetues,[10] por edhe me ligj organik u krijua dhe u organizua Gjykata e Kasacionit,[11] duke parapëlqyer sistemin italian të ndërtimit tri shkallësh të sistemit gjyqësor, por me një ndryshim esencial. Sistemi italian i gjykimit administrativ ka qenë dhe vazhdon të jetë krejtësisht i ndarë nga sistemi i juridiksionit të zakonshëm, kurse sistemi shqiptar mbeti dhe vazhdon të jetë miks dhe i ndërvarur.

Nuk mendoj se u veprua keq, përkundrazi mendoj se pati efekte relativisht pozitive. Në Gjykatën e Kasacionit u krijuan dhe funksionuan katër kolegje: kolegji penal, civil, administrativ dhe ai tregtar, me përbërje të trupës gjyqësore prej tri gjyqtarësh të lartë. Duke u fokusuar në kolegjin administrativ dua të theksoj se ne kemi patur një përvojë disavjecare të ndarjes së gjyqësorit administrativ nga ai penal dhe civil në shkallën superiore të gjykimit, por ai mbeti një gjykim kasacional; për aq sa veproi, nuk prodhoi efektet e dëshiruara, pasi në shkallën e parë dhe të dytë nuk

8. Ligji Nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën"
9. Ligji për Dispozitat Kryesore Kushtetuese, Nr. 7491, date 29.04.1991
10. Ligji Kushtetues Nr. 7561, datë 29.04.1992 "Organizimi i drejtësisë dhe Gjykata Kushtetuese"
11. Ligji Nr. 8362, datë 01.07.1998 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Kasacionit dhe administrimin e shërbimeve gjyqësore"

kemi patur organizime të specializuara të gjykimit administrativ.

Pas qershorit të vitit 1996, kur hyri në fuqi Kodi i Procedurës Civile (KPr.C) u krijuan seksionet e gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative,[12] krahas atyre tregtare dhe të familjes, por përsëri gjykimi administrativ mbeti i ndërvarur. Kush kanë qenë difektet ligjore dhe organizative të atij strukturimi gjyqësor? Kanë qenë shumë, por unë mendoj se dy janë më kryesoret:

- Nuk u pavarësua drejtësia administrative në gjykimin dyshkallësh nga juridiksioni i zakonshëm. Kemi krijuar seksionet e gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative në shkallë të parë me KPrC të vitit '96, por ato nuk patën efekt, pasi gjyqtarët në atë periudhë vështirësisht nuk u përshtatën dhe nuk u pavarësuan nga juridiksioni i zakonshëm.
- Drejtësia administrative në shkallën superiore u inkorporua në përbërjen katër kolegjëshe te Gjykatës së Kasacionit. Kjo nuk dha efekte pozitive për reformimin e gjykimit administrativ tri shkallësh, pasi nuk u pavarësua në të trija këto shkallë gjykimi, sepse Kolegji Administrativ mbeti i ndërvarur.

Me ristrukturimin sot për sotë të drejtësisë administrative në vendin tonë mendoj se jemi ende të vonuar në raport me zhvillimet e vrullshme shumë shekullore evropiane. Aktualisht janë krijuar gjykatat administrative të Shkallës së Parë, Gjykata Administrative e Apelit dhe Kolegji Adminstrativ në Gjykatën e Lartë,[13] kjo e fundit si shkallë e tretë me kompetenca të gjera. Shtrohet kërkesa: a kemi apo nuk kemi nje pavarësim të plotë të drejtësisë administrative nga juridiksioni i zakonshëm i gjyqësorit penal dhe civil ?! Kjo është një çështje tepër delikate që kërkon thellim të mëtejshëm të reformës gjyqësore shqiptare në përgjithësi, dhe asaj administrative në veçanti.

Për të ditur se sa të vonuar jemi, ndoshta më së pari do të duhej të kuptnim termin *"drejtësi administrative"*. Një studiues i njohur i kësaj fushe komenton, se: ""*Termi "drejtësi administrative" në literaturën juridike shqiptare është ndeshur rrallë….thelbin e këtij koncepti e përbën*

12. Ligji Nr. 8116, datë 29.03.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", nenet 324-333

13. Ligji Nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"; Ligji Nr. 151/2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8588, datë 15.03.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë"

shfaqja e interesave të ligjshme dhe kontradiktore të palëve në një gjykim administrativ….Nxjerrja e akteve apo kryerja e veprimeve të ndryshme me natyrë administrative nga autoritetet publike dhe ndikimi që mund të ketë kjo veprimtari administrative në të drejtat dhe interesat e ligjshme të një subjekti, evidenton nevojën për të kontrolluar ushtrimin e ketij pushteti. Në këtë kuptim, qëllimi i rishikimit gjyqësor të akteve dhe veprimeve administrative është të sigurojë respektimin e parimeve themelore demokratike të qeverisjes së shtetit me anë të ligjit, të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në marrëdhëniet e veçanta juridike publike, që krijohen ndërmjet shtetit dhe një personi privat nëpërmjet sigurimit të zbatimit të drejtë, të saktë dhe efektiv të normave të së drejtës"".[14] Pikërisht ky konceptim evidencon nevojën për të kontrolluar gjyqësisht aktet administrative që nxirren në ushtrimin e pushtetit ekzekutiv sipas parimeve dhe zhvillimeve të sotme të konceptimit evropian.

Në opinionin tim, termi "drejtësi administrative" përfshin tri parime themelore të ligjreformimit dhe drejtësidhënies administrative. Ky term perfshin:

- Tërësinë e rregullave ligjore materiale dhe proceduriale për nxjerrjen e akteve administrative me efekte publike që sjellin konflikte gjyqësore;
- Gjykimin administrativ të specializuar të akteve të administratës shtetërore nga ankimet e personave juridikë privatë, publikë dhe shtetasit;
- Dhënien e një vendimi të drejtë gjyqësor adminidtrativ të paanësuar nga ekzekutivi, ligjvënësi dhe gjyqësori i juridiksionit të zakonshëm.

Këto janë tre parime që veshtirë se pranohen nga ekzekutivi ynë shpesh i ndryshueshëm apo i pastabilizuar në ligjbërje, si edhe i pa interesuar për çuarjen deri në fund të reformave ligjore, strukturore dhe gjyqësore administrative. Tani ndodhemi në hapin dhe kohën e duhur për të dhënë një zgjidhje përfundimtare ligjore dhe strukturore për rireformimin e drejtësisë administrative. Duhet vullnet politik, publik dhe profesional për pavarësimin e plotë të drejtësisë administrative me objektivin themelor: sistemi i gjyqësorit administrativ duhet të jetë krejtësisht i pavarur, i specializuar dhe gjykues i akteve të qeverisjes qëndrore dhe vendore pa ndikime politike dhe "përmbajtësore". Mendoj se janë këto

14. Sokol Sadushi, *Gjykata Administrative dhe kontrolli ligjor mbi administratën, Një vështrim krahasues mbi* d*rejtësinë administrative*, Tiranë 2014, fq. 118

kapacitete ligjore dhe organizative për të bërë më të mirën e mundëshme për pavarësimin e plotë të sistemit të gjyqësorit administrativ nga sistemi i gjyqësorit të zakonshëm në të trija shkallët e tij, jo vetëm në dy shkallët e ulta.

Gjykim kasacional ose/dhe unifikues

Kasacionaliteti dhe unifikimi janë dy parime shumë të rëndësishme të gjykimit në shkallë të tretë te konflikteve shumëplanëshe jo vetëm për cështjet administrative, por edhe për ato civile, penale, tregtare, etj. Problemi teoriko-juridik shtrohet në rrafshin doktrinor, strukturor dhe kompetencial në shkallën supreme të gjykimit. Gjithashtu, problemi shtrohet se kush duhet të ketë përparësi ne këtë shkallë gjykimi: kasacionaliteti apo unifikimi gjyqësor?!

Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë, sipas Kushtetutës aktuale dhe ligjit organik është kompozuar me dy funksione juridiksionale: fillestar dhe rishikues.[15] Juridiksioni fillestar parashikon gjykimin në shkallë të parë të akuzave penale ndaj disa funksionarëve publik kushtetues, që deri më sot (pas 19 vjetësh) nuk ka dhënë rezultatin e dëshiruar. Juridiksioni rishikues parashikon njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, ose - përcaktuar ndryshe - marrjen e vendimeve unifikuese nga Kolegjet e Bashkuara për praktika të ndryshme gjyqësore. Krahas këtyre dy funksioineve kryesore kushtetuese, Gjykata e Lartë me kompetencat që i jepen nga kodet e procedurës civile, penale, ligjin për gjykatat administrative dhe disa ligje të tjera organike është e mbingarkuar me kompetenca kasacionale, që do të thotë se gjykon në shkallë të tretë me kolegjet e saj pothuajse të gjitha cështjet që kalojne në dy shkallët e ulta të gjyqësorit të zakonshëm dhe gjyqësorit administrativ.

Historikisht dhe tradicionalisht, sistemi ynë ligjor dhe gjyqësor është i organizuar dhe i destinuar të përfundojë çështjet gjyqësore me tri shkallë gjykimi. Me disa kufizime kompetencash, të gjitha çështjet civile, penale, administrative etj., kalojnë per gjykim kasacional në shkallën e tretë, pra, në Gjykatën e Lartë ku përfundojnë të gjitha çështjet që zgjasin pambarimisht. Dua të them se, **Gjykata e Lartë e vendit tonë është kthyer më shumë si një gjykatë kasacioni se sa një gjykatë e**

15. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin Nr. 8417, datë 21.10.1998, neni 141; Ligji organik për Gjykatën e Lartë Nr.8588, datë 15.03.2000

unifikimit gjyqësor, duke mos u mbajtur kështu balanca dhe prioriteti i nevojshëm ndërmjet funksioneve të saj. Ky kamuflim ligjor, kompetencial dhe praktikësor ka krijuar jo pak pakënaqësi në dhënien e drejtësisë civile, administrative, penale etj.

Studiuesi i sipërpërmendur i drejtësisë administrative komenton për parimin e gjykimit kasacional, se: "*gjykata mund të shfuqizojë aktin administrativ, por në rast se është e nevojshme nxjerrja e një akti te ri, çështja do t'i referohet përsëri autoritetit përkatës administrativ*". Ndërkaq, ai vazhdon me komentin: "*Në mënyrë të veçantë, parimi i gjykimit kasacional konstatohet në procedurën e gjykimit në Gjykatën e Lartë……Detyrë e Gjykatës së Lartë është të verifikojë menyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga gjykatat më të ulta…..*". Për parimin e gjykimit rishikues studiuesi komenton, se: "*Gjykata administrative jo vetëm shfuqizon aktin, por edhe e ndryshon atë. Në një sistem rishikues ekzistojne të dyja zgjidhjet*".[16] Pra, qartësisht e kuptueshme është që sistemi i gjykimit rishikues ka përparësi ndaj sistemit të gjykimit kasacional, sepse ai orienton gjykatat në unifikimin e praktikave të tyre, duke krijuar premisa pozitive për shmangien e shkallës së tretë të gjykimit.

Sistemi ynë i deritanishëm i gjykimit në shkallë të tretë është i përzier dhe kërkohet një zgjidhje përfundimtare. Shtrohen tri pyetje rreformuese kushtetuese dhe ligjore:

- Gjykata e Lartë a mund dhe a duhet të vazhdojë të jetë një gjykatë klasike kasacioni, si pjesë përbërëse e juridiksionit të zakonshëm dhe administrativ, si edhe me rol të dobët unifikues?
- A mund të jetë ajo gjykatë e vetme supreme e unifikimit të praktikave gjyqësore për të trija degët kryesore të gjykimit?
- Apo të jetë një gjykatë supreme e ndarë në tri kolegje, ose seksione: penale, civile dhe administrative, me kompetenca unifikuese të specializuara dhe të ndara nga njëra - tjetra?!

Është praktikuar perkohësisht me tre kolegje, më gjerësisht me dy kolegje dhe aktualisht po praktikohet aktualisht me tre kolegje. Kështu është praktikuar dhe është dështuar, po e praktikojmë dhe po dështojmë. çfarë duhet bërë? Kjo është shumë e vështirë për t'u thënë, për t'u propozuar dhe për t'u projektuar, në mungesë të një studimi shumëplanesh dhe një projekti iniciues.

16. Sokol Sadushi, *Gjykata Administrative dhe kontrolli ligjor mbi administratën", Një vështrim krahasues mbi drejtësinë administrative*, Tiranë 2014, fq. 130-131

Gjykata e Lartë e sotme funksionon maksimalisht si gjykatë kasacioni dhe minimalisht si gjykatë unifikuese e praktikës gjyqësore, kur duhej të kishte ndodhur e kundërta. Mjafton të vërejmë numrin e kufizuar të vendimeve unifikuese te asaj gjykate. Cili mundet dhe duhet të ketë përparësi në profilitetin vendimmarrës të Gjykatës së Lartë: kasacionaliteti apo unifikimi gjyqësor? Jam i mendimit sigurisht, se funksioni i unifikimit gjyqësor është misioni kryesor kushtetues i një gjykate supreme të një vendi evropian që aderon aproksimimin, barazinë dhe pavarësinë në të drejtën vendimmarrëse në çdo juridiksion, shkallë dhe rreth gjykimi.

Një analist juridik që i përket praktikës gjyqësore komenton, se: "*Problem konstatoj të jetë fakti që Gjykata e Lartë mundet të vendosë të kalojë për unifikim vetëm çështjet për të cilat ndërmjet kolegjeve të kësaj gjykate janë mbajtur qëndrime të ndryshme, apo për çështje të cilat kolegjet rrezikojnë të mbajnë qëndrime të ndryshme, duke ndryshuar qasjen që ka mbajtur Gjykata e Lartë deri më sot lidhur me unifikimin e praktikës gjyqësore. Duket sikur unifikimi i praktikës gjyqësore nga legjislatori është parë më shumë si mjet korrektues dhe paqtues i qëndrimeve të kundërta që mundet të kenë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, që si numër s'i kalojnë 20, sesa qëndrimet e shumë e shumëfishta të trupave gjykues të gjykatave të shkallëve të para dhe të apeleve, që si numër i kalojnë gjithsesi 300. Kështu, pavarësisht se gjykatat e shkallëve të para dhe të dyta mundet të ziejnë nga qëndrimet e ndryshme dhe se ligji zbatohet ndryshe dita-ditës për destinatarët, ndoshta Kushtetuta, por me siguri ligjet, kanë parashikuar se unifikimi apo ndryshimi i praktikës gjyqësore do të bëhen vetëm atëhere kur Kolegji Civil, Penal apo Administrativ i Gjykatës së Lartë ndajnë apo rrezikojnë të ndajnë qëndrime të ndryshme mbi ligjin*".[17]

Puqem plotësisht me këtë qendrim dhe analizë juridike kritike, faktike dhe praktike të funksionalitetit të Gjykatës së Lartë së deritanishme. Duam s'duam, sistemi i sotëm kushtetues dhe ligjor i unifikimit gjyqësor nuk jep garanci për pavarësi, profilitet dhe profesionalitet për tria deget e dhënies së drejtësisë, duke dëmtuar së tepërmi drejtësinë administrative të sapo themeluar. Ky sistem mbështetet në qëndrimet interesative të momentit të tre kolegjeve, të rrezikut të ndryshimit të qëndrimit kur anëtarët e tyre ndryshojnë anëtarësimin në kolegje (kjo ndodh shpesh), të paqëndrueshmërisë së vendimeve unifikuese dhe të "çorientimit" të

17. Florjan Kalaja, *Mbi Gjykimin Unifikues*, gazeta 'Panorama' e datës 27 dhjetor 2016, fq. 18

gjykatave, kur ligjvënësi nuk nderhyn. Mbi të gjitha, kjo gjendje krijon mundësinë e ndërhyrjes dhe imponimit të kolegjeve ndërmjet njëri - tjetrit. Nje sistem i tillë i vendosur, minimalisht nuk sjell stabilitetin në uniformitetin e gjykimit në shkallë të parë dhe të dytë, maksimalisht sjell "shthurje" dhe ndërhyrje në degët e specializuara të dhënies së drejtësisë, duke i konfliktuar ato.

Po ashtu, analisti i përmendur vëren, se: "*Gjykimi unifikues duhet të konturohet fillimisht në Kushtetutë e më tej edhe në ligj si një gjykim i pavarur nga çështja, e cila e provokoi, dhe duhet të ndjekë një rregjim juridik krejt të ndryshëm dhe të pavarur nga çështja që e provokoi. Gjykimi unifikues duhet të jetë mjeti jurisprudencial që shërben pro futuro për zgjidhjen nga çdo gjykatë të një çështjeje, e cila është vendosur të unifikohet. Njëkohësisht duhet që ligji të kujdeset që të shquhet krejt e pavarur dhe ekskluzive trupa gjyqësore që vendos mbi unifikimin nga trupa gjyqësore që gjykon çështjen individuale që e provokoi atë*".[18] Duke patur parasysh që unifikimi i praktikave gjyqësore vendoset nga Gjykata e Lartë për të dyja gjykatat e shkallëve më të ulta, kërkohet që ky unifikim të ketë pavarësi nga iniciativat për çështjet konkrete, gjykimi unifikues të bëhet nga një organ i pavarur nga trupa gjyqësore që gjykon çështjen individuale dhe rregullimet juridike për gjykimin unifikues duhet të bëhen me kushtetutë dhe ligje. Mendoj se këto janë konstatime dhe rekomandime të vlefshme që i japin më tepër perparësi funksionit unifikues të pavarur sesa funksionit kasacional të Gjykatës së Lartë. Sepse, kolegji që ka gjykuar çështjen konkrete dhe e propozon atë si shkas për unifikim merr pjesë në vendimmarrjen e Kolegjeve te Bashkuara, që vendosin unifikimin. Ndërsa gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në mënyrë të veçantë dhomat penale dhe civile janë të "familjarizuara" prej shumë vitesh me praktikat ndryshuese të vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë, një praktikë e tillë mendoj se nuk mundet dhe nuk duhet të ndodhë me gjykatat administrative, pasi qëllimi kryesor i krijimit të tyre ka qenë dhe është gjykimi i specializuar dhe pavarësimi i plotë nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor. Përndryshe nuk ka progres, por ka regres në dhënien e drejtësisë administrative.[19]

---

18. Florjan Kalaja, *Mbi Gjykimin Unifikues*, gazeta 'Panorama' e datës 27 dhjetor 2016, fq.18

19. Vasil Bendo, *Plotesimi i Gjykimit Administrativ*, revista 'Avokatia', Nr. 15, Korrik 2015, fq. 45-47

Sistemet e pavarësimit të drejtësisë administrative

Në Evropën e sotme demokratike janë ravijëzuar apo themeluar dy sisteme të diskutueshme të pavarësimit të drejtësisë administrative nga sistemi i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Çështja shtrohet në pavarësimin e plotë, ose në pavarësimin e ndërvarur të saj.

Sistemi i pavarësimit të plotë. Shtete të zhvilluara të Evropës perëndimore me përvoja të gjata të drejtësisë administrative në aspektin e demokratizimit të gjykimit publik, si Franca, Italia, Hollanda, Greqia, Gjermania etj., drejtësinë administrative e kanë të organizuar mbi bazën e një shkëputjeje të plotë nga trishkallëshi i gjyqësorit të juridiksionit të zakonshëm. Në këto vende, dhënia e drejtësisë administrative jo vetëm është e ndarë dhe e pavarur nga juridiksioni i zakonshëm në shkallë të parë dhe të dytë, por funksionon *Këshilli i Shtetit* si organ i shkallës superiore të gjykimit administrativ,[20] si organ kushtetues dyfunksionesh me kompetenca këshilluese të qeverisë për aktet që prekin interesa publike dhe gjykues të akteve të ekzekutivit në shkallë të tretë. Ndonëse kam komente te mirëstudiuara për seicilin prej vendeve të përmendura, nuk dua të zgjatem me argumente për arësyet përse ky sistem duhet të jetë i atashueshëm për vendin tonë, sepse ndoshta mund të quhen të parakohshme pasi sapo ka kaluar një ligj kushtetues, që nuk e parashikon këtë institucion dhe/ose institut të së drejtës administrative.

Mirëpo, drejtësia administrative në vendin tonë duhet të pavarësohet plotësisht nga juridiksioni i sistemit gjyqësor të zakonshëm. Aktualisht nuk kemi një sistem frytdhënës dhe plotësisht të pavarur. Tashmë, prej afërsisht katër vitesh, praktika e gjykimit administrativ tre shkallësh ka provuar plotësisht se, drejtësia administrative nuk është e shkëputur nga sistemi i juridiksionit të zakonshëm. Problemi qëndron te Gjykata e Lartë ku mpleksen konfliktet e interesave ndërmjet tre kolegjeve të asaj Gjykate. Dhe kjo nuk është pak, sepse sjell pështjellim në orientimin dhe unifikimin gjyqësor administrativ të dy shkallëve më të ulta të drejtësisë administrative, sepse këto janë të ndikuara gjyqësisht nga shkalla superiore. Dhënia e drejtësisë administrative dhe unifikimi gjyqësor nga Gjykata e Lartë lë shumë për të dëshiruar dhe kjo gjendje nuk mund të vazhdojë

20. Sokol Sadushi, *Gjykata Administrative dhe kontrolli ligjor mbi administratën, Një vështrim krahasues mbi drejtësinë administrative*, Tirane 2014, fq.33-82 Shih gjykimin administrativ në Francë dhe modelin gjerman të gjykatave administrative

gjatë. Përndryshe ka pasoja të padëshirueshme, që vështirë se mund të rregullohen në vazhdimësinë e pavarësimit të plotë të sistemit të gjykimit administrativ.

Sistemi i ndërvarësisë gjyqësore. Ndërsa në vendet e zhvilluara të Evropës perëndimore është vendosur një ekuilibër ndërmjet gjyqësorit administrativ dhe atij të zakonshëm, ndonëse jo plotësisht i konsoliduar për shkak të veçantive, ngaqë shtete të tjera më pak të zhvilluara nga ato të sipërpërmendura dhe që i përkasin Evropës lindore, si Rumania, Bullgaria, etj., kanë një sistem të ndërvarur të drejtësisë administrative. Në këto vende, gjykimi në shkallë të parë dhe të dytë të konflikteve administrative përfshihet me seksione të specializuara brenda gjykatave të këtyre shkallëve të juridiksionit të zakonshem, kurse në shkallë të tretë përsëri miksohet me gjykimin e juridiksionit të zakonshëm. Po paraqes një analizë të shkurtër për gjykimin në shkallë të tretë të sistemit të Rumanisë dhe Bullgarisë.

Në Republikën e Rumanisë funksionon Gjykata e Lartë e Kasacionit dhe e Drejtësisë me të paktën 4 departamente (kolegje) dhe një bashkim departamentesh (kolegjet e bashkuara), si dhe një panel me 9 gjyqtarë. Njëri prej departamenteve më të rëndësishme është Departamenti i Konflikteve Administrative dhe Fiskale i ndarë nga departamenti tregtar, civil dhe penal.[21] Megjithë qëllimin pozitiv të ligjvënësit që ky departament të jetë i pozicionuar si i pavarur dhe i specializuar për gjykimin në shkallë të tretë të konflikteve administrative dhe fiskale në mënyrë kasacionale, veprimtaria e tij dobësohet në vendimmarrjen unifikuese, sepse vendimi merret nga bashkimi i departamenteve, pra, nga shumica e gjyqtarëve të departamenteve të tjera dhe të paspecializuara, përfshirë edhe departamentin në fjalë. Në të dyja shkallët e gjykatave të zakonshme më të ulta funksionojnë seksione të specializuara për gjykimin e çështjeve civile, penale, administrative etj., siç ka qenë e organizuar në vendin tonë deri në miratimin e ligjit dhe fillimin e funksionimit të gjykatave administrative në nëntorin e vitit 2013.[22]

21. Raporti Evropian i Drejtësisë Administrative për Republikën e Rumanisë, 2007, website www.scj.ro

22. Ligji Nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"; Ligji Nr. 151/2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8588, datë 15.03.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë"; Dekreti i Presidentit të Republikës Nr.8349, datë 14.10.2013

Në Republikën e Bullgarisë, funksionojnë dy gjykata të larta, Gjykata Supreme e Kasacionit dhe Gjykata Supreme Administrative. Të dyja këto gjykata të larta ushtrojnë njëlloj dhe pavarësisht nga njëra - tjetra dy funksione kushtetuese gjyqësore: 1. Rishikimi gjyqësor (gjykimi) në shkallë të tretë të vendimeve të gjykatave më të ulta; 2. Zbatimi i njëllojtë i ligjit (unifikimi) nga të gjithë gjykatat, sipas sistemit të tyre tre shkallësh.[23] Pra, unifikimi i praktikave gjyqësore ndërmjet dy sistemeve janë krejtësisht të ndara, të pa influencuara dhe të specializuara. Çështjet ndërlidhen në gjykatat e apelit, gjykatat rajonale dhe gjykatat e rretheve, në të cilat gjykimi administrativ është i përfshirë ne gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nëpërmjet seksioneve të specializuara, por mendoj se ndikimi i seksioneve të tjera nuk është problematik sepse, siç thashë, unifikimi i praktikave gjyqësore bëhet nga një gjykatë e lartë administrative e veçantë dhe e pavarur.

Në grupin e sistemit të ndërvarësisë gjyqësore bën pjesë edhe sistemi gjyqësor administrativ i vendit tonë i sapothemeluar, por me një përparësi, gjykatat administrative të Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit në Tiranë janë krejtësisht të ndara dhe të pavarura nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, veçse gjykimi dhe unifikimi në shkallë të tretë krijon probleme dhe konfuzion për gjykatat e shkallëve më të ulta. Nëse ky sistem do të vazhdojë kështu, me këtë reformë administrative të pamjaftueshme, i destinuar është që të dështojë dhe do të shkojë në dëm të publikut shqiptar. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, miksuar dhe bashkëvepruar me të dy kolegjet e tjera të asaj Gjykate, nuk garanton paanshmërinë dhe profesionalitetin e kërkuar në gjykimin kasacional dhe rishikues në shkallë të tretë të konflikteve administrative dhe mendoj se duhet të rishikohet.

Rireformimi i drejtësisë administrative është një çështje që kërkon vëmëndjen maksimale të politikës pushtet - krijuese parlamentare shqiptare dhe jo të anashkalohet apo të mos preket fare, siç ndodhi me ndryshimet e fundit kushtetuese në korrik 2016,[24] në kuadrin e reformës në drejtësi. Gjykimi në shkallë të tretë i konflikteve administrative mund të ketë dy qellime pozitive në përputhje me orientimet evropiane:

---

23. Organizimi i Drejtësise Administrative në Republikën e Bullgarisë, Kushtetuta e vitit 1991 me ndryshimet deri në vitin 2007, marrë nga faqja zyrtare "website" e Asamblese Kombetare te Bullgarisë

24. Ligji Nr. 76/2016, datë 22.07.2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8417, date 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë"

- Pavarësimi i plotë i gjykimit administrativ nga sistemi i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në shkallë të tretë
- Unifikimi gjyqësor i pavarur i drejtësisë administrative nga unifikimi i juridiksionit të zakonshëm, në shkallë të dytë apo të tretë.

Propozime reformative

Jam munduar dhe menduar shumë gjatë që të gjej një zgjidhje "hibride", të paktën më të mirën e mundshme dhe të ndryshme nga aktualiteti i sotëm ligjor dhe organizativ i sistemit të drejtësisë administrative. Përpara më shtrohen disa variant - propozime, që besoj se vëmendësojnë politikën ligjbërese në vendin tonë për pavarësimin e plotë të drejtësisë administrative. Por, natyrisht kam preferencën dhe mendimin tim për variantin më të mirë dhe të mundshëm për aplikim.

Së pari, të vazhdojmë me një sistem konfliktual interesi ndërgjyqësor që nuk ka dhënë efektivitetin e dëshiruar dhe është i ndërvarur nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, siç është realiteti i sotëm. Kjo është një zgjidhje ligjore dhe organizative jo e kënaqshme, sepse duke vazhduar të mbajmë në funksionin më të lartë gjyqësor të drejtësisë administrative një kolegj të inkorporuar në Gjykatën e Lartë, do të kemi vazhdimisht ndërthurje dhe konfliktualitete ndërgjyqësore. Padyshim, zgjidhje e gabuar është që kemi bërë dhe vazhdojmë të bëjmë për sa kemi në fuqi këtë sistem tashmë të dështuar. Pavarësimi dy shkallësh i arritur deri tani sjell mpleksje në shkallën superiore të gjykimit me Kolegjin Administrativ, çka anasjelltas përsëri sjell mpleksje në gjykimin administrativ dy shkallësh nëpërmjet vendimeve unifikuese të ndryshueshme, të paqëndrueshme dhe konfliktuale me kolegjet e tjera të asaj Gjykate.[25]

Së dyti, të krijohet *Këshilli i Shtetit* me kompetenca gjyqësore krejtësisht të pavarura për konfliktet shtet - privat në shkallë të tretë, duke iu përqasur së tepërmi organizimit të vendeve të zhvilluara evropiane. Natyrisht, kjo është zgjidhje ideale por ndoshta e papërtypur ende nga politika ligjbërëse shqiptare, ndoshta e painteresuar. Megjithatë, kur ekspertët ndërkombëtarë hedhin idenë e krijimit të një gjykate të dytë të lartë në vendin tonë, Gjykatës së Lartë Administrative krahas Gjykatës së

25. Sokol Sadushi, *Gjykata Administrative dhe kontrolli ligjor mbi administratën, Një veshtrim krahasues mbi drejtësinë administrative*, Tiranë 2014, Praktika unifikuese në çështjet administrative – zgjidhje e problemit apo vetë problemi?, faqe 353-375

Lartë aktuale,[26] do të thotë se ne paskemi kapacitete juridiko -ekonomike që të mbajmë dy gjykata të larta në një *vend të vogël*, ose që organizmat ndërkombëtarë janë *të vegjël* në asistimin e tyre këtu për reformën në drejtësi.

Së treti, të krijohet një gjykatë e dytë e lartë, pra Gjykata e Lartë Administrative, siç ka qenë një Projekt paraprak dhe mbase jo i mirëstudiuar i Misionit asistues EURALIUS dhe i atij atij OBDAT, propozuar politikës ligjbërëse shqiptare dhe publikut të specializuar, i dërguar edhe Komisionit të Venecias për konsultim. Sipas nenit 135/2 të këtij Projekti kushtetues: "*Gjykimi administrativ organizohet në dy shkallë dhe përfshin Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë dhe Gjykatën e Lartë Administrative*".[27] Më duhet të theksoj se, varianti i gjykimit administrativ dy shkallësh pranohet haptazi si nga nderkombëtarët propozues, po ashtu nga Kushtetuta jonë aktuale, sikurse edhe nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Personalisht kam qënë kundër këtij varianti për disa arësye që nuk janë objekt i këtij artikulli, por në mungesë të iniciativës për krijimin e Këshillit të Shtetit, ndoshta do të ishte një zgjidhje e pëlqyeshme dhe e përkohshme, që do të konsolidohej me reformat e ardhëshme në drejtesinë administrative.

Së katërti dhe *kryesori*, në pamundësi të krijimit të *Këshillit të Shtetit* si një propozim i parakohshëm për reformimin e plotë të drejtësisë administrative, mund të krijohet një sistem gjyqësor administrativ dy shkallësh me gjykata administrative të shkallës së parë, me numër dhe shtrirje territoriale të njëjtë me gjykatat e juridiksionit të zakonshëm (ndoshta në numër edhe më të madh per t'iu afruar publikut), si edhe gjykata e apelit administrativ që merr funksionin e dhënies së vendimit përfundimtar në shkallë të dytë dhe unifikimin e praktikës gjyqësore administrative. Në këtë mënyrë shkurtohet dhe shpejtohet koha e gjykimit të konflikteve administrative, që është një nga kërkesat themelore të Bashkimit Evropian, si edhe pavarësohet plotësisht gjykimi unifikues. Ky variant shmang krijimin e *Këshillit të Shtetit*, duke e lënë atë për një kohë të mëvonshme, shmang krijimin e Gjykatës së Lartë Administrative dhe shuan Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë që ka konflikte

26. Version i Integruar i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, EURALIUS Nentor 2015, me Projekt - amendamentet kushtetuese dërguar Komisionit të Venecias dhe konsultimi publik më datë 13.11.2015
27. Po aty, për nenet 135-142

shumëplaneshe interesash me dy kolegjet e tjera të asaj gjykate në gjykimin administrativ tri shkallësh.

Konkluzione

Nisur nga fakti që prej fillimit të viteve ’90 jemi udhëhequr nga faktorë dhe nga aktorë ndërkombëtarët për reformat tona themelore, zgjidhja më e mirë e tani për tanishme dhe e përkohshme e rireformimit të drejtësisë administrative mendoj se do të ishte që **sistemi i gjykimit administrativ mund të jetë dy shkallësh dhe i organizuar në proporcionalitet me sistemin e juridiksionit të zakonshëm.**

Për vendosjen e këtij sistemi mendoj se ka dy variante propozim-ligjbërëse dhe organizative, që kërkojnë ndërhyrje ligjore dhe vendimmarrje politike.

Varianti i parë mund të konsiderohet zgjidhje emergjente:

- Gjykatat administrative të shkallës së parë të jenë me një numër të njëjtë, ose më të madh, se sa gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.
- Të ketë disa gjykata administrative te apelit, të jenë të organizuara mbi baza territoriale dhe me një numër më të kufizuar nga gjykatat e zakonshme të apelit. Këto gjykata të jenë përfundimtare në gjykimin administrativ dhe së bashku me kolegje të bashkuara të unifikojnë praktikën gjyqësore.

Varianti i dytë mund të jetë më tepër frytdhënës, por sidoqoftë i perkohshëm:

- Të suprimohet Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, si një organizëm gjyqësor konfliktual në shkallën e tretë të gjykimit administrativ.
- Gjykata e Lartë të ndahet nga gjykimi administrativ i deritanishëm dhe t’i përkasë vetëm gjykimit kasacional dhe unifikues civil, penal etj.
- Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, mund të riorganizohet me disa kolegje të specializuara, në përputhje me natyrën dhe grupimin e konflikteve administrative që gjykon në shkallë të dytë.
- Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, krahas të qënit unike si deri tani për gjykimin në shkalle të dytë, të marrë edhe funksionet dhe kompetencat si një “Gjykatë e Lartë” që merr vendime përfundimtare dhe vendos unifikimin e praktikave gjyqësore administrative.

Të dyja variantet janë të pranueshme, por natyrisht jam për

variantin e dytë, si ndarje përfundimtare e gjyqësorit të zakonshëm nga gjyqësori administrativ. Këto konkluzion –propozime vërtet japin një zgjidhje tranzitore, por krijojnë mundësinë e një pavarësimi të plotë të drejtësisë administrative nga sistemi aktual tre shkallësh i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, deri në një zgjidhje përfundimtare që do të kërkojë ndërhyrje sërishmi në Kushtetutë, në disa ligje organike dhe kode.

Literatura:

Akte normative

- Ligji për Dispozitat Kryesore Kushtetuese, Nr. 7491, datë 29.04.1991
- Ligji kushtetues për shtesën e kreut "Organizimi i Drejtësisë dhe Gjykata Kushtetuese", Nr. 7561, datë 29.04.1992
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin Nr. 8417, datë 21.10.1998, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 28, faqe 1073
- Ligji Nr. 76/2016, datë 22.07.2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë"
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, 1994
- Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, 1996
- Ligji organik për Gjykatën e Kasacionit, Nr. 8362, datë 01.07.1998
- Ligji organik për Gjykatën e Lartë, Nr. 8588, datë 15.03.2000 për suprimimin e Kolegjit Administrativ në Gjykatën e Kasacionit

Ligji organik Nr. 49/2012 për Gjykatat Administrative, rikrijimin dhe kompetencat e Kolegjit Administrativ në Gjykatën e Lartë

Ligji Nr.151/2013 për ndryshimet në ligjin organik të Gjykatës së Lartë

Dekreti i Presidentit të Republikës Nr.8349, datë 14.10.2013

Doktrinë

- Sokol Sadushi, *Gjykata Administrative dhe kontrolli ligjor mbi administratën, Një vështrim krahasues mbi drejtësinë administrative*, Tiranë 2014
- Vasil Bendo, *Plotësimi i Gjykimit Administrativ*, revista 'Avokatia,

Nr.15, Korrik 2015

- Florjan Kalaja, *Mbi Gjykimin Unifikues*, Gazeta 'Panorama', datë 27 dhjetor 2016

- Raporti Evropian i Drejtësisë Administrative për Republikën e Rumanisë 2007, website www.scj.ro

- Organizimi i Drejtësisë Administrative në Republikën e Bullgarisë, Kushtetuta e vitit 1991 me ndryshimet deri në vitin 2007, faqja zyrtare "website" e Asamblesë Kombëtare të Bullgarisë

- Versioni i Integruar i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, EURALIUS Nëntor 2015, me Projekt amendamentet kushtetuese dërguar Komisionit të Venecias dhe konsultimit publik profesional, datë 13.11.2015

Jurisprudencë

- Vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, 2013 – 2015, ndryshimi i vendimeve unifikuese administrative, website www. Gjykataelartë.gov.al

PËR NJË NDËRHYRJE NORMATIVE TË NXITUAR DHE JO TË MIRËMENDUAR

Av. Përparim KALO
Av. Aigest MILO
Studio ligjore 'Kalo & Associates',
Tiranë

Hyrje

Mbrojtja dhe respektimi i të drejtave themelore të njeriut përbën një prej detyrave më thelbësore të shtetit të së drejtes dhe elementin përcaktues të dallimit midis totalitarizmit dhe demokracisë.

Kushtetuta jonë, padyshim, promovon vlera demokratike të gjithë pranuara nga vendet Evropiane perëndimore dhe demokracitë përparimtare. Në të janë sanksionuar parimet e demokracisë kushtetuese, si: ndarja e pushteteve, liria e veprimtarisë ekonomike dhe e drejta e pronës private, të drejtat e njeriut dhe dinjiteti njerëzor etj. Siç parashikohet shprehimisht në nenin 15/2 të saj, Kushtetuta, më tej, ngarkon organet e pushtetit publik (përfshirë Parlamentin), që në përmbushje të detyrave të tyre të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Ndërsa kufizimin e mundshëm të këtyre të drejtave, Kushtetuta e zgjidh në parim, kur bën fjalë për kufizim që mund të vendoset vetëm me ligj (pra, jo nëpërmjet aktesh nënligjore, vendime organesh administrativë etj.),[1] për interes publik, ose për të mbrojtur interesat e të tjerëve,[2] të jetë në përpjesëtim të drdejtë me gjëndjen që ka bërë të nevojshme atë (pra, në përputhje me parimin e proporcionalitetit në ndërhyrje[3]). Gjithashtu, në paragrafin 2 të nenit 17 parashikohet që kufizimet "*nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të*

1. Shih vendimin nr.20, datë 11.07.2006 të Gjykatës Kushtetuese
2. Shih vendimin nr.30, datë 01.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese
3. Shih vendimin nr.16, datë 11.11. 2004 të Gjykatës Kushtetuese

drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejlkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut".

Parë nga ky këndvështrim, çdo ligj apo akt nënligjor, si edhe çdo akt administrativ i organeve publike, që prodhon efekte në kundërshtim me përmbajtjen e dispozitave kushtetuese, më konkretisht në mospajtim me parimet e mësipërme, nuk mund të mbetet në fuqi, pa iu bërë ndryshimet apo rregullimet mdoshta të pjesëshme, por sidoqoftë të domosdoshme. Sepse rregullat për vendimmarrje nuk mund të interpretohen si norma të izoluara, por në harmoni me konceptin e shtetit të së drejtës.

Më poshtë do të ndalemi te teksti normativ i ligjit 19/2016 "Për masat shtesë të sigurisë publike", që për mendimin tonë i përball disa subjekte private me ngarkesa të pajustifikueshme, me kosto që nuk mund të injorohen dhe që bien ndesh me lirinë e tyre ekonomike, si edhe me mbrojtjen e të dhënave personale.

Përmbajtja e Ligjit 19/2016

Më 28 dhjetor 2016 hyri në fuqi ligji 19/2016, "*Për masat shtesë të sigurisë publike*"[4] miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë më datë 22.9.2016, duke lënë pas zhvillimin e debateve të ashpra parlamentare dhe reagimin e opinionit publik[5] çka detyroi Presidentin e Republikës së asokohe ta kthente për rishqyrtim projektligjin në Parlament, që – sipas Tij - vinte në kundërshtim me "*Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe jurisprudencën përkatëse të detyrueshme në Republikën e Shqipërisë*".[6]

Ligji parashikon se subjektet private dhe publike, pra "*subjektet që kanë selinë e mjediset e punës dhe ushtrojnë veprimtari tregtare në vende të ekzpozuara ndaj rrezikut të shtuar për sigurinë", "subjektet që ushtrojnë aktivitet tregtar nga ora 23:00 – 06:00*" apo "*subjektet që kanë aktivitet ekonomik, xhiroja vjetore e të cilave është mbi 10 milionë lekë*"[7] duhet të marrin masa shtesë të sigurisë publike, që përfshijnë jo vetëm vendosjen e kamerave CCTV me rreze infra të kuqe dhe me rezolucion të lartë, por shkojnë deri

4. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 181, datë 28 shtator 2016
5. Shih Opinionin [negativ] të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nt. 1118/1, datë 11.11.2015
6. Shih Dekretin e Presidentit të Republikës, nr. 9501, datë 4.4.2016
7. Neni 4 i ligjot 19/2016, "Për masat shtesë të sigurisë publike"

tek detyrimi për nënshkrimin e një kontrate sigurie me subjekte që ushtrojnë veprimtari në fushën e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike (pra, me policë privatë!).[8]

Mirëpo, ky detyrim formulohet në bazë të analizës së vlerësimit të rrezikut që bën Policia e Shtetit, duke u mbështetur në kritere *a priori* shumë të përgjithshme, diskrecionale dhe të paverifikueshme nga të interesuarit, siç janë: "*lloji i veprimtarisë*" (!), "*ekspozimi i mjediseve të subjektit ndaj elementeve kriminale*", "*largësia e vendit ku ushtrohet veprimtaria nga njësia policore apo qendrat e banuara*" etj.[9]

Arsyeja përse një ligj i hyrë në fuqi më shumë se një vit më parë përbën interes analize edhe aktualisht për opinionin e gjerë, është sepse tashmë ka përfunduar edhe periudha një vjeçare e "faljes" së parashikuar nga neni 19 i ligjit për aplikimin e sanksioneve të konsiderueshme administrative (të cilat shkojnë deri në 100 mijë lekë), dhe subjektet apo sipërmarrjet po përballen tashmë edhe me efektet negative që po prodhon ligji në fjalë.

Veçoria e ligjit shqiptar është se, ndryshe nga legjislacionet e tjera që në këtë fushë kryesisht disiplinojnë dhe rregullojnë (madje, me rregulla mjaft strikte) vendosjen në mënyrë vullnetare të sistemeve private të kontrollit dhe survejimit, ligji shqiptar jo vetëm që e gjeneralizon vendosjen e tyre në kundërshtim me parimet kushtetuese të mbrojtes së privatësisë dhe lirisë së qytetarëve, por ua dikton marrjen e masave shtesë të sigurisë publike subjekteve private, duke cenuar rënde lirinë e tyre ekonomike, sepse masat kanë të atilla kosto ekonomike që nuk mund të shpërfillen. Ndërkohë që ligji ia transferon në mënyrë të paarsyeshme sektorit privat detyrat funksionale të Shtetit në lidhje me rendin dhe sigurinë publike.

Në konflikt me parime ndërkombëtare të gjithëpranuara

Gjatë shtjellimit të konceptit të shtetit të së drejtës, vazhdimisht është vënë dukje apo theksuar se, ndryshe nga shteti totalitar, ai është i kufizuar nga e drejta që vetë e ka krijuar, ose e ka pranuar edhe nëpëpmjet miratimit dhe ratifikimit të traktateve apo konventave ndërkombëtare. Por, nga analiza e tekstit normativ në fjalë dhe nga mënyra e funksionimit të vet, sëbashku me atë të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij,[10] na rezulton se ligji 19/2016

8. Neni 8 i ligjit 19/2016
9. Neni 7 i i ligjit 19/2016
10. Në zbatim të dispozitave të Ligjit 19/2016 janë nxjerrë aktualisht edhe aktet nënligjore

përbën një akt normativ problematik dhe të papërputhshëm me kuadrin kushtetues kombëtar, si edhe me marrëveshje ndërkombëtare ku Shqipëria është Shtet Palë.

Po kështu mund të shprehemi edhe për aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit "Për masat shtesë të sigurisë publike", veçanërisht nëse i referohemi Udhëzimit nr. 134, datë 10.3.2017, te Ministrit të Punëve të Brendshme, "*Për përcaktimin e nivelit të masave shtesë të sigurisë dhe llojin e masave që duhet të marrin subjektet në varësi të aktivitetit apo vlerësimit të rrezikut, si dhe procedurat e njoftimit të tyre*". Me këtë Udhëzim janë tejkaluar parashikimet e ligjit në lidhje me përcaktimet që i lihen në kompetencë Ministrit, në kundërshtim me nenin 118 të Kushtetutës.

Më konkretisht, duke vijuar me analizën e cenueshmërisë kushtetuese të ligjit, na rezulton se norma në fjalë është në konflikt me disa parime, çka do ta shtjellojmë më poshtë.

Parimi i mbrojtes së të dhënave personale dhe jetës private, i sanksionuar nga neni 35 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,[11] gjen burimin e tij në Preambulën e vetë Kushtetutës ku garantohet mbrojtja e dinjitetit dhe personalitetit njerëzor, dhe me herët në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut ku në nenin 12 të saj parashikohet, se: "*Askush nuk mund të jetë objekt i ndërhyrjes arbitrare në jetën e tij private dhe*

---

vijuese, të cilat plotësojnë përmbajtjen e tij:

- Udhëzim nr. 134, datë 10.3.2017, i Ministrit të Punëve të Brendshme, "Për përcaktimin e nivelit të masave shtesë të sigurisë dhe llojin e masave që duhet të marrin subjektet në varësi të aktivitetit apo vlerësimit të rrezikut, si dhe procedurat e njoftimit të tyre"
- Udhëzim nr. 46, datë 28.3.2017, i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, "Për përcaktimin e nivelit të sigurisë për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemeve të sigurisë, në zbatim të ligjit 19/2016, "Për masat shtesë të sigurisë publike"
- Udhëzim nr. 223, datë 11.4.2017, i Ministrit të Punëve të Brendshme, "Për ngritjen, përbërjen, kompetencat dhe procedurat e funksionimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, për sanksionet mbi moszbatimin e masave shtesë të sigurisë publike"
- Udhëzim nr. 224, datë 11.4.2017, i Ministrit të Punëve të Brendshme, "Për rregullat për kryerjen e inspektimeve nga Policia e Shtetit, për monitorimin e përmbushjes së masave shtesë të sigurisë publike"
- Udhëzim i përbashkët nr. 1181, datë 30.10.2017, i Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, "Për ngritjen dhe funksionimin e Regjistrit elektronik të subjekteve që marrin masa shtesë të sigurisë publike"

11. Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj

familjare, në banesën ose leterkëmbimin e tij, as objekt cenimesh të nderit dhe reputacionit të tij". Në të njëjtën linjë është edhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në nenin 8/1 të së cilës përcaktohet (në kuptimin pozitiv) si detyrim për Shtetin, se: "Çdo person ka të drejtë që t'i respektohet jeta e tij private dhe familjare, vendbanimi dhe korrespondenca e tij".

Parimi i Mbrojtjes se Jetës Private është shtjelluar nga ana e Gjykatës Kushtetuese, sipas së cilës: "*E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare përbën edhe sot një nga sfidat e shteteve të lira e demokratike, veçanërisht të demokracive të reja. Garantimi i kësaj të drejte themelore është edhe një reflektim ndaj përvojës negative të regjimeve totalitare e diktatoriale, tendenca e të cilëve ka qenë ndërhyrja ekstreme edhe në çështjet apo vendimet intime personale apo familjare. [...] se e drejta për respektimin e jetës private në thelbin e saj duhet t'i sigurojë individit një hapësirë, brenda së cilës, ai do të mund të zhvillonte dhe plotësonte në mënyrë të pavarur personalitetin e tij. Sigurisht, që këtu, përfshihet edhe zhvillimi apo ruajtja në një masë të caktuar e marrëdhënieve me njerëzit e tjerë. Pra, respektimi i jetës private kërkon në parim mosndërhyrjen në vendimet që merr vetë individi rreth mënyrës së bërjes së jetës së tij*."[12]

E drejta e jetës private dhe e mbrojtjes së të dhënave personale përbën një të drejtë themelore të njeriut dhe cenimi apo kufizimi i saj mund të bëhet vetëm me ligj, duke respektuar parimin e proporcionalitetit dhe domosdoshmërisë së ndërhyrjes. Në bazë të nenit 17 të Kushtetutës (parimi i bilancimit të të drejtave), "*kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe, në asnjë rast, nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në KEDNJ*".

Nga ana tjetër KEDNJ në nenin 8/2 të saj, sipas interpretimit të bërë nga jurisprudenca e GJEDNJ lejon kufizime të të drejtës së jetës private dhe familjare, vetëm nëse ato bëhen me ligj, të kenë për qëllim mbrojtjen e disa të drejtave të tjera themelore dhe të jenë të nevojshme në një shoqëri demokratike.[13]

---

12. Shih: Vendim i GJK, nr.16, datë.11.11.2004; në të njëjtin sens, Vendim GJK, nr. 52, datë 1.12.2011

13. Shih vendimet e GJEDNJ për çështjet: *Sunday Times v. the United Kingdom* (Application no. 6538/74), Judgment, 26 April 1979, para. 49; *Malone v. the United*

GJEDNJ, ka specifikuar më tej se, parashikimi në ligj i kufizimeve të parimit të të drejtës private kërkon që ligji në fjalë të jetë i aksesushëm, të jetë i parashikueshëm në detyrimet që përmban dhe të jetë në përputhje me shtetin e të drejtës, veçanërisht përsa i përket ndarjes së pushteteve (të atij legjislativ me atë ekzekutiv).[14]

Në rastin konkret, Ligji 19/2016 nuk përmbush kriteret e kërkuara nga Kushtetuta dhe KEDNJ, për të kufizuar ligjërisht të drejtën për garantimin e një jete private.

Ndërhyrja në të drejtën për jetë private dhe familjare përmes masave të parashikuara në nenin 8 të Ligjit nuk është e justifikueshme, e domosdoshme dhe proporcionale. Nuk rezulton të jetë bërë asnjë studim paraprak apo të ekzistojë ndonjë tregues se marrja e masave në fjalë do të sjellë si efekt atë të "*zbulimit dhe parandalimit te dhe goditjen e çdo veprimtarie kriminale, në mbrojtje të pronës, jetës dhe garantimin e sigurisë publike*".

Nga ana tjetër, e qartë është për këdo që vendosja e një regjimi survejimi në masë, në ambiente private (banimi apo pune) dhe publike, siç është ai qe vendoset në ekzekutim të Ligjit 19/2016 përbën një cenim të hapur edhe të menjëhershëm të jetës private dhe familjare të individëve, duke u kthyer në një pengesë të pa justifikueshme në jetën familjare dhe personale të qytetarëve shqiptarë.

Ligji 19/2016 nuk përmbush, gjithashtu, edhe kriteret e parashikuar nga KEDNJ, pasi nuk plotësohen në këtë aspekt as kriteri i parashikueshmërisë së detyrimit, as ai i ndarjes së pushteteve. Siç doli në pah nga analiza që iu bë ligjit në fjalë në pjesën e parë të këtij shkrimi, rezulton se është e vështirë për këdo të kuptojë se cilët do të jenë subjektet e ligjit nga përmbajtja e tij.

Ligji në fjalë parashikon disa kategori shumë të përgjithshme subjektesh, të cilat mund të jenë të detyruara, por përcaktimin më konkret të tyre ia delegon Policisë së Shtetit, që nëpërmjet disa kritereve shumë gjenerike dhe diskrecionale (për shembull, lloji i aktivitetit të zhvilluar dhe

Kingdom, para. 66; Kruslin, para. 27; Kopp, Judgment, 25 March 1998, para. 55; *Amann*, para. 50; *Leander v. Sëeden* (Application no. 9248/81), Judgment, 26 March 1987, para. 50; *Rotaru v. Romania*, para. 52; *Foxley v. the United Kingdom* (Application no. 33274/96), Judgment, 20 June 2000, para. 34; Ëeber and Saravia v. Germany, para. 84; *Liberty and Others*, para. 59

14. Shih vendimet e GJEDNJ për çështjet: *Rotaru v. Romania*, para. 54; *Leander v. Sweden*, para. 52-53

distanca e objektit ku ushtrohet veprimtaria nga njësia policore), *de facto* bën përcaktimin e subjekteve dhe ambienteve që detyrohen të marrin masa shtesë të sigurisë publike.

Ligji në fjalë nuk përmbush as kriterin e ndarjes së pushteteve, pasi i delegohet Policisë së Shtetit, që është një ndër përfaqësuese e Ekzekutivit, e cila bën përcaktimin *de facto* të subjekteve të detyruara, duke marrë kompetenca që duhet të ishin të ligjvënësit.

Problematike është, gjithashtu, edhe dispozita e nenit 13 të Ligjit, ku i jepet e drejta Policisë nëpërmjet një kërkese të thjeshtë, duke anashkaluar organet kushtetuese të përcaktuara për hetimet (për shembull, të marrë pamje filmike), ndërkohë që Kodi i Procedurës Penale përcakton qartë se diçka e tillë mund të realizohet veç përmes autorizimit të gjykatës. Në këtë aspekt është evidente mundësia e keqpërdorimit të pamjeve filmike dhe e të dhënave personale, e shfrytëzimit për qëllime që nuk kanë lidhje me sigurinë apo mundësia e keqpërdorimit të tyre nga ana e strukturave policore si mjet kërcënimi, diskreditimi publik, ose për shantazh.

Në këtë vështrim Ligji 19/2016 mendojmë se nuk jep asnjë garanci të mjaftueshme lidhur me ruajtjen e privatësisë së qytetarëve, dhe është në kundërshtim me nenin 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 8 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Parimi i lirisë ekonomike dhe i të drejtës së pronës. Në bazë të nenit 11/1 të Kushtetutes, "*Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike*». Në paragrafin e tretë të nenit në fjalë parashikohet, se: "*Kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike, mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike*" (siç njihen ndryshe parimet e rezervës ligjore dhe proporcionalitetit në ndërhyrjet që mund të kufizojnë të drejtën e lirisë ekonomike).

Në thelb të parimit të proporcionalitetit qëndron ekuilibrimi i drejtë i interesave, vlerësimi objektiv i tyre, si edhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre. Jurisprudenca kushtetuese, veçanërisht për sa u takon mjeteve të përdorura është shprehur se, ligjvënësi duhet të zbatojë mjete të tilla ligjore, të cilat duhet të jenë efektive, domethënë, të zgjedhura në mënyrë të atillë që të jenë të përshtatshme për realizimin e synimeve që ndiqen. Përdorimi i këtyre mjeteve duhet të jetë i domosdoshëm, gjë që do të thotë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera. Domosdoshmëria ka të bëjë, gjithashtu,

edhe me përdorimin e mjeteve më pak të dëmshme për subjektet që u cenohen të drejtat dhe liritë.[15]

Në rastin konkret, ligjvënësi duke mos respektuar parimin e proporcionalitetit (neni 17 i Kushtetutës) ka cënuar parimin e lirisë ekonomike dhe të drejtën e pronës. Norma ligjore në fjalë, pra, Ligji 19/2016 nuk siguron një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet masës së përdorur, masave shtese të sigurisë publike dhe qëllimeve që kërkohen të arrihen. Për rrjedhojë, mbi tregtarët rëndon një barrë disproporcionale.

Imponimi i kësaj barre te disa subjekte që ushtrojnë veprimtari ekonomike, të perzgjedhura ne baze kriteresh diskrecionale nga ana e Policise se Shtetit, duke mos patur si efekt te provueshëm atë të sigurisë publike, pasi siç u tha me sipër, nuk ka një vlerësim objektiv të rrezikut që i kanoset sigurisë që të ketë çuar në marrjen e këtyre masave të kushtueshme në ngarkim të opertatorëve ekonomikë, nuk arrin të bëjë bilancimin e duhur të interesave në lojë. Për rrjedhojë, përmbajtja e dispozitave të Ligjit 19/2016 është shprehje e dukshme e ndërhyrjes joproporcionale nga ana e shtetit në pasurinë dhe lirinë e veprimtarisë ekonomike të subjekteve ndaj të cilave ai zbatohet, duke cenuar në mënyrë të paarsyeshme të drejtën e veprimtarisë ekonomike.

Në këtë aspekt, jo mirë i arsyetuar rezulton vendimi i Gjykatës Kushtetuese, nr. 60, datë 31.7.2017, nëpërmjet të cilit kjo Gjykatë rrëzoi kërkesën e ankueses për shfuqizimin e Ligjit 19/2016 mbi bazën esencialisht të cenimit të parimit të lirisë ekonomike. Në vlerësimin tonë, Gjykata Kushtetuese nuk është shprehur në lidhje me kushtetueshmërinë e ligjit në aspektin e respektimit ose jo të parimit të lirisë ekonomike, por e anashkalon këtë, duke u fshehur pas një përgjigje formaliste se kerkesa e ankueses nuk është mjaftueshmërisht e argumentuar.

Megjithatë, ky vendim nuk cenon mundësinë e ripropozimit të një ankimi nga një subjekt tjetër në lidhje me këtë aspekt (cenimi i lirisë ekonomike), por edhe të antikushtetueshmërisë së ligjit 19/2016, duke e argumentuar në mënyrë të ndryshme dhe më gjerësisht kërkesën, qët t'i jepet Gjykatës liria e nevojshme për t'u shprehur.

Parimi i barazisë dhe mos diskriminimit përpara ligjit. Ligji 19/2016 cenon, ndër të tjera, edhe parimin e barazisë së individëve përpara

15. Shih: Vendimi nr. 33, datë 8.06.2016

ligjit,[16] që në konceptin primar kërkon që të trajtohen në mënyrë të njëjtë situata të njëjta, dhe në mënyrë të ndryshme situata të ndryshme.

Ligji 19/2016, duke e lënë në dorë të Policisë së Shtetit përcaktimin e subjekteve që detyrohen të marrin masa shtesë të sigurisë publike, mbi bazën e kritereve jo objektive, të pa verifikueshme *a priori* nga të interesuarit, siç janë largesia nga zyra e policisë apo lloji i aktivitetit të ushtruar, përbën një rrezik të mjaftueshëm dhe konkret diskriminimi dhe pabarazie ndërmjet subjekteve që do të duhet të ndërmarrin masa shtesë të sigurisë publike me kosto jo të shpërfillshme për mbarëvajtjen e veprimtarisë ekonomike dhe subjekteve që për arsye diskrecionale të policisë nuk do të duhet të bartin të tilla kosto, duke sjellë kështu si rezultat një diskriminim ndërmjet subjektesh që ushtrojnë aktivitet të njëjtë, por ndodhen bie fjala në zona të ndryshme dhe konkurrencë të çrregullt në treg, çka e bën ligjin në fjalë edhe faktor disekuilibri të tregut të brendshëm.

Parimi i sigurisë juridike. Ligji në shqyrtim të këtyre rradhëve cenon ndërkohë edhe parimin e sigurisë juridike, sepse formulimi i dispozitave të neneve 4/1, 2 dhe 7 te tij nuk plotëson kërkesën për qartësi dhe siguri. Ligji lë në diskrecionin e organeve të policisë të vlerësojnë nëse një aktivitet i caktuar do të konsiderohet apo jo aktivitet që përbën rrezik të shtuar për sigurinë publike dhe, për rrjedhojë, do të duhet të ndërmarrë masat e caktuara me kostot dhe detyrimet përkatëse. Rregullimet ligjore krijojnë një mjedis pasigurie për ushtrimin e lirë të veprimtarisë ekonomike të subjekteve që janë potencialisht objekt i ligjit, të cilat mund tëmbeten të frikësuara për pasojat e të gjitha veprimeve të tyre, pa e pasur të qartë (duke qene se ligji nuk parashikon kritere rigoroze) nëse do të jene subjekte të ligjit apo jo.

Parimi i procesit të rregullt ligjor. Në bazë të nenit 42/1 të Kushtetutës: "*liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor*". Ky parim është sanksionuar tashmë se i përket jo vetëm procesit gjyqësor, por edhe aktivitetit administrativ, për t'u respektuar nga çdo organ i pushtetit publik.

Sipas Vendimit nr. 29/2013 të Gjykatës Kushtetuese: "*e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor, e parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por edhe në atë me karakter disiplinor administrativ [...] çdo organ i pushtetit publik, gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues e ligjor, është i detyruar të*

16. Neni 18 i Kushtetutës

respektojë standardet e gjithëpranuara demokratike, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë".

Një aspekt të rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor administrativ përbën fakti që subjekti i një aktiviteti administrativ të ketë mundesinë të dëgjohet dhe të japë mendimin e vet në lidhje me aktivitetin administrativ që ndërmeret kunder tij.

Në Ligjin 19/2016 e gjithë procedura e vlerësimit të rezikut të shtuar për sigurinë publike, që do të çojë me pas në marrjen e një akti administrativ për t'i imponuar subjektit marrjen e masave shtesë të sigurisë publike, zhvillohet pa dijeninë dhe pa mundësinë e dëgjimit të subjektit të interesuar, i cili nuk ka mundësi të kontrollojë ligjshmërinë dhe veprimtarinë administrative që po ndërmerret kundrejt tij.

Mospasja e kësaj mundësie për subjektin e interesuar, që ai të dëgjohet nga ana e organit administrativ në lidhje me aktivitetin që po ndërmerret kundrejt tij, si edhe mangësia e çfarëdolloj instrumenti të parashikuar nga ligji kundrejt imponimit për marrjen e masave shtesë të sigurisë publike, tek e fundit përbën shkelje të të drejtës së individit për një proces të rregullt ligjor administrativ, çka e bën Ligjin 19/2016 antikushtetues edhe në këtë aspekt.

Konkluzion

Përfundimisht, nga analiza e mësipërme vlerësojmë se, Ligji 19/2016 "Për masat shtesë të sigurisë publike" përbën një ndërhyrje normative të nxituar dhe jo të mirëmenduar, që për hir të së vërtetës është formuluar nën shtysën e disa momenteve dramatike të kronikës së zezë të vendit tone. Por ky fakt nuk e justifikon mbajtjen në fuqi të një korpusi normativ, që është i huaj dhe në kundërshtim me parimet kushtetuese dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare, që rregullojnë funksionimin e shtetit të së drejtës dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit.

Ndërkohë që në Shqipëri ka patur raste të ndërhyrjes normative nga ana e Kuvendit për korrigjimin e aspekteve problematike të ligjeve të ndryshme, prandaj mendojmë se një ndërhyrje e tillë mund të zbatohet edhe në rastin e ligjit 19/2016, për të mënjanuar problematikat që u përpoqëm t'i evidenconim shkurtimisht këtu. Kjo do të ishte e këshillueshme për të shmangur një fluks të parashikuar të procedurave administrative e gjyqësore nga subjektet që preken prej ligjit në fjalë.

Literatura:

Akte normative

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
- Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut
- Kodi i Procedurave Administrative
- Kodi i Procedurës Penale
- Ligji nr. 19/2016 "Për masat shtesë të sigurisë publike", botuar në 'Fletore Zyrtare', nr.

181, datë 28 shtator 2016

- Dekreti i Presidentit të Republikës, nr. 9501, datë 4.4 2016
- Udhëzimi nr. 134, datë 10.3.2017, i Ministrit të Punëve të Brendshme "Për përcaktimin e nivelit të masave shtesë të sigurisë dhe llojin e masave që duhet të marrin subjektet në varësi të aktivitetit apo vlerësimit të rrezikut, si dhe procedurat e njoftimit të tyre"
- Udhëzimi nr. 46, datë 28.3.2017, i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Për përcaktimin e nivelit të sigurisë për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemeve të sigurisë, në zbatim të ligjit 19/2016, "Për masat shtesë të sigurisë publike"
- Udhëzimi nr. 223, datë 11.4.2017, i Ministrit të Punëve të Brendshme "Për ngritjen, përbërjen, kompetencat dhe procedurat e funksionimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, për sanksionet mbi moszbatimin e masave shtesë të sigurisë publike"
- Udhëzimi nr. 224, datë 11.4.2017, i Ministrit të Punëve të Brendshme "Për rregullat për kryerjen e inspektimeve nga Policia e Shtetit, për monitorimin e përmbushjes së masave shtesë të sigurisë publike"
- Udhëzim i përbashkët nr. 1181, datë 30.10.2017, i Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale "Për ngritjen dhe funksionimin e Regjistrit elektronik të subjekteve që marrin masa shtesë të sigurisë publike"

Jurisprudencë

- Vendime të Gykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë: nr. 16, datë.11.11. 2004; nr. 52, datë 1.12.2011; nr. 33, datë 8.6.2016; nr. 20, datë 11.7.2006; nr. 1.12. 2005

- Vendimet e GJEDNJ për çështjet: *Sunday Times v. the United Kingdom* (Application no. 6538/74), Judgment, 26 April 1979; *Malone v. the United Kingdom*; *Kruslin*, Kopp, Judgment, 25 March 1998; *Amann*; *Leander v. Sëeden* (Application no. 9248/81), Judgment, 26 March 1987; *Rotaru v. Romania*; *Foxley v. the United Kingdom* (Application no. 33274/96), Judgment, 20 June 2000; Ëeber and Saravia v. Germany; *Liberty and Others*

ANALIZË E STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE DHE E PRAKTIKËS VENDASE PËR ZBATIMIN E MASËS SË ARRESTIT NË BURG

Av. Erida SKËNDAJ
Drejtore Ekzekutive
e Komitetit Shqiptar të Helsinkit,
Tiranë

Hyrje

E drejta e lirisë nënkupton vetëm mbrojtjen nga kufizimi i lirisë fizike. Nuk është e lehtë të përcaktosh kuptimin e termit *kufizim lirie*, por në përgjithësi këtë do të kuptojmë detyrimin për të qëndruar në një hapësirë të kufizuar gjatë një periudhe kohe të konsiderueshme.[1]

Në çdo shtet të botës, njerëzit arrestohen dhe ndalohen me dyshimin se kanë kryer një vepër penale. Shpesh, këtë individë mbahen të kufizuar nga liria me javë, muaj apo edhe me vite para se një gjykatë kompetente të shprehet me vendim për çështjen e tyre në themel. Kushtet në të cilat këta individë mbahen janë shpesh më të këqijat në sistemin e brendshëm penitenciar. Statusi i tyre ligjor është i rrezikuar pasi ata janë të dyshuar, por nuk janë deklaruar fajtor dhe ata janë nën një presión jashtëzakonisht të madh, për shkak të dëmeve që pësojnë në aspektin ekonomik apo ndarjes nga familja dhe komuniteti.[2]

Standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut kërkojnë që çdo kufizim i lirisë duhet të jetë përjashtim, objektivisht i justifikuar dhe për një kohëzgjatje jo më shumë se sa është absolutisht i domosdoshëm. Standardet ndërkombëtare inkurajojnë shprehimisht mospërdorimin e masave shtrënguese

1. *Zbatimi i të drejtave të njeriut në praktikë*, Manual trajnimi për të drejtat ndërkombëtare të njeriut, Fondacioni SLYNN, Londër (UK) Janar 2016, fq. 184 - 185
2. *Të drejtat e njeriut dhe paraburgimi*, Manual për standartet ndërkombëtare të Paraburgimit (Nju Jork dhe Gjenevë), 1994

të kufizimit të lirisë gjatë hetimit dhe gjykimit, deri në dhënien e vendimit. Në rastet përjashtimore, kur kufizimi i lirisë vlerësohet si i domosdoshëm, ai duhet të garantojë respektimin e të drejtave dhe garancive me natyrë procedurale, të parashikuara në aktet ndërkombëtare që janë të detyrueshme për t'u zbatuar në vendin tonë, si edhe në legjislacionin e brendshëm.

Përkundrejt standardeve ndërkombëtare përdorimi i zgjeruar i arrestit në burg në vendin tonë evideton një njohje jo të mirë të tyre nga aktorët e sistemit të drejtësisë penale, në mënyrë të veçantë nga prokuroria dhe gjykata. Megjithatë, roli i gjykatave ngelet themelor jo vetëm për korigjimin e veprimeve proceduriale të kryera nga prokuroria dhe policia, por sidomos për garantimin e lirive dhe të të drejtave themelore, si edhe të parimeve të shtetit të së drejtës.

Në këto rradhë do të përpiqemi të analizojmë aktet më të rëndësishme ndërkombëtare që njohin dhe promovojnë të drejtën për liri dhe siguri, jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, legjislacionin tonë të brendshëm në këtë fushë, si edhe gjetjet që kanë rezultuar nga monitorimi i fundit i Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) sa i takon praktikës gjyqësore për caktimin e masave të sigurimit, në dy prej gjykatave më të mëdha të vendit (gjykatat e rretheve gjyqësore Tiranë dhe Durrës).

Duke qenë se format e kufizimit të lirisë sipas standardeve ndërkombëtare dhe legjislacionit tonë janë nga më të ndryshmet, fokusi kryesor i këtij artikulli është analizimi i standardeve dhe praktikës tonë gjyqësore për caktimin e masës së sigurimit personal "arrest në burg". Kjo për arsye se format e kufizimit të lirisë janë të ndryshme dhe në varësi të tyre ndryshojnë edhe kriteret dhe garancitë procedurale për personat ndaj të cilave jepen. *Arresti në burg* vlerësohet se është masa më e ashpër e sigurimit personal, që kufizon në mënyrë të ndjeshme lirinë e individit, ajo mund te cenojë drejtpërdrejtë liritë dhe të drejtat e tjera themelore të tij dhe mund të çojë deri në trajtim ç'njerëzor dhe degradues.

Cilat janë standartet bazë të së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut për të drejtën për liri dhe siguri?

E drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut përcakton se, të gjithë personat duhet të mbrohen nga kufizimi i paligjshëm i lirisë, dhe kufizimi i saj mund të ndodhë vetëm në rrethana kohore të pjesëshme dhe të përcaktuara.

E drejta për liri dhe siguri, si edhe të drejtat e personave të ndaluar dhe të arrestuar, në pritje të një vendimi gjyqësor, parashikohen në një sërë aktesh ndërkombëtare, si: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Pakti Ndërkombëtar për të drejtat Civile dhe Politike, Rregullat Mínimum Standarde për Trajtimin e të Burgosurve, Rregullat Mínimum Standarde mbi Administrimin e Drejtësisë për të Miturit (*Rregullat Beijing*), Konventa Evropiane për të Drejtat të Njeriut dhe Liritë Themelore, Grupimi i Rregullave për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga çdo Formë e Ndalimit dhe e Burgimit etj.

E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut u akordon personave të dyshuar/akuzuar për vepra penale një mbrojtje të veçantë ku, ndër të tjera, ata duhet të gëzojnë të drejtën për një proces të rregullt, të prezumohen të pafajshëm, të mbrohen nga tortura, trajtimi apo dënimi mizor, ç'njerëzor apo degradues, të kenë mbrojtje të barabartë nga ligji, si edhe të gëzojnë gjithashtu të drejtën për liri nga ndalimi apo arrestimi arbitrar.

Sipas nenit 3 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, kushdo gëzon të drejtën e jetës, lirisë dhe sigurisë personale. Sikurse vërehet në formulimin e këtij neni të një prej akteve më të rëndësishme ndërkombëtare, e drejta për liri dhe siguri parashikohet në të njëjtën klauzolë me të drejtën e jetës. Pa patur liri është e vështirë të gëzohen dhe ushtrohen të drejtat dhe liritë e tjera të njeriut.

Liria dhe siguria personale garantohet nga neni 5 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) dhe nga neni 9 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP). Neni 5 i KEDNJ është formuluar në mënyrë më të hollësishme se sa neni 9 i KNDCP-së. [3]

Sipas nenit 5 të KEDNj, çdokush ka të drejtën e lirisë dhe të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në këtë nen dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj. Ndër të tjera, kufizimi i lirisë parashikohet kur personi është arrestuar dhe paraburgosur për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent, kur ka arsye të besueshme për të dyshuar se ai ka kryer një vepër penale, ose kur ka motive të arsyeshme për të besuar se është e nevojshme që të pengohet të kryejë një vepër penale, ose të largohet pas kryerjes së saj.

Sipas Komitetit të të Drejtave të Njeriut, kufizimi i lirisë me arrestim duhet të përmbushë kushtet e ligjshmërisë, arsyetueshmërisë

3. *Zbatimi i të drejtave të njeriut në praktikë*, Manual trajnimi për të drejtat ndërkombëtare të njeriut, Fondacioni SLYNN, Londër (UK) Janar 2016

dhe domosdoshmërisë. Arrestimi duhet të konsiderohet si përjashtim i të drejtës së lirisë.[4]

Si është analizuar në vendimmarrjen e GJEDNj e drejta për liri dhe siguri dhe në mënyrë të veçantë për aplikimet e shqyrtuara pranë kësaj Gjykate lidhur me arrestin në burg?

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNj) ka patur një praktikë të gjerë sa i takon rasteve të shqyrtuara ndaj Shteteve të ndryshme Anëtar të Këshillit të Evropës, lidhur me cenimin e nenit 5 të Konventës. Në vendimet e saj, Gjykata ka vendosur nëse kufizimi i lirisë plotëson kërkesat apo standardet minimale që parashikon Konventa, pavarësisht se si kuptohet apo përcaktohet kjo çështje nga e drejta e brendshme.

Sipas jurisprudencës së GjEDNj,[5] qëllimi kryesor i nenit 5 të KEDNJ është të parandalojë heqjen arbitrare dhe të pajustifikuar të lirisë. Për të përmbushur këtë qëllim, neni 5 përcakton se heqja e lirisë duhet të jetë e ligjshme si nga ana substanciale, ashtu edhe nga ajo proceduale.[6]

GjEDNj ka vendosur që një person i ndaluar për shkak se dyshohet të ketë kryer një vepër penale, menjëherë[7] dhe në mënyrë të shpejtë[8] duhet të dërgohet para një autoriteti gjyqësor. Qëllimi dhe hapësira interpretative e zbatimit të nocionit *menjëherë* është shumë e kufizuar.

GjEDNj ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme prezumimin në favor të lirimit[9] dhe ka qartësuar se, shteti ka barrën për të provuar që një masë më pak shtrënguese se sa ndalimi nuk do t'i shërbente qëllimit përkatës.[10] Vendimi për ndalimin duhet të arsyetohet në mënyrë të mjaftueshme dhe nuk duhet të përdoren fjalë të standardizuara apo

4. *Zbatimi i të drejtave të njeriut në praktikë*, Manual trajnimi për të drejtat ndërkombëtare të njeriut, Fondacioni SLYNN, Londër (UK) Janar 2016, fq 195, paragrafi 46
5. Çështja *Mckay k. Mbretërisë së Bashkuar*
6. *Zbatimi i të drejtave të njeriut në praktikë*, Manual trajnimi për të drejtat ndërkombëtare të njeriut, Fondacioni SLYNN, Londër (UK) Janar 2016, fq. 189, paragrafi 26
7. Çështja *Rehbock k. Sllovenisë*, Aplikimi. 29462/95, 28 Nëntor 2000, paragrafi 84
8. Kohëzgjatja e ndalimit të pranueshëm paraprak nuk është përkufizuar nga GJEDNj, megjithatë, në çështjen *Brogan dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, Aplikimet. 11209/84; 11234/84; 11266/84; 11386/85, 29 November 1988 Gjykata vlerësoi se, periudha e ndalimit paraprak që varion nga 4 deri në 6 ditë është në shkelje të nenit 5, paragrafi 3, të Konventës
9. Çështja *Michalko k. Sllovakisë*, Aplikimi 35377/05, 21 Dhjetor 2010, paragrafi 145
10. Çështja *Ilijkov k. Bullgarisë*, Aplikimi 33977/96, 26 Korrik 2001, paragrafi 85

steriotipizuara.[11] Argumentet *pro* dhe *kundër* arrestit në burg nuk duhet të jenë të përgjithshme dhe abstrakte.[12] Gjykata duhet të angazhohet në arsyetimin e arrestit në burg dhe refuzimin e kërkesës për lirim.[13]

GjEDNj ka nënvizuar shkaqet e ligjshme për të cilat mund të urdhërohet *arresti në burg*, të cilat janë: (1) rreziku që i dyshuari mund të mos marrë pjesë në procesin gjyqësor;[14] (2) rreziku që i dyshuari mund të prishë provën ose të frikësojë dëshmitarët;[15] (3) rreziku se i dyshuari mund të kryejë vepra të tjera penale;[16] (4) rreziku se lirimi mund të cenojë rendin publik;[17] ose (5) nevoja për të mbrojtur sigurinë e një personi nën hetim në raste përjashtimore.[18] Vetëm fakti i dyshimit se është kryer një vepër penale nuk është shkak i mjaftueshëm për të vendosur arrestin me burg, pavarësisht se sa e rëndë është vepra penale apo sa të forta janë provat kundër të dyshuarit.[19] *Arresti në burg*, bazuar në nevojën për të ruajtur rendin publik nga ç'rregullimi i shkaktuar nga vepra penale[20] mund të jetë legjitim vetëm nëse rendi publik vazhdon të jetë i kërcënuar.

Lidhur me respektimin e afateve të ndalimit apo arrestimit, GJEDNj është shprehur në vendimin e çështjes *Bozano kundër Francës,*[21] se jo çdo parregullsi për procedurën ligjore të ndjekur në kufizimin e lirisë sjell paligjshmëri. Ato duhet të jenë parregullsi të rënda dhe të qarta (është fjala për respektimin e afateve). Për shembull, gabimet administrative të kryera në procedurën për ndjekjen e afateve të kufizimit të lirisë nuk sjellin në çdo rast cenim të nenit 5 të Konventës dhe as nuk do të konsiderohen shkelje vonesat "minimale".

Në rastin e arrestimit/ndalimit personi ka të drejtë të kërkojë praninë e avokatit mbrojtës. E drejta e lirisë e humbet kuptimin e saj nëse personi i arrestuar/ndaluar nuk ka të drejtë të kërkojë menjëherë praninë

---

11. Çështja *Yagci dhe Sargin k. Turqisë*, Aplikimet 16419/90, 16426/90, 8 Qershor 1995, paragrafi 52
12. Çështja *Smirnova k. Rusisë*, Aplikimi 46133/99, 48183/99, 24 Korrik 2003, paragrafi 63
13. Çështja *Buzadj k. Moldavisë*, Aplikimi 23755/07, 16 Dhjetor 2014, paragrafi 3
14. Çështja *Smirnova k. Rusisë*, Aplikimi 46133/99, 48183/99, 24 Korrik 2003, paragrafi 59
15. Ibid
16. Çështja *Muller k. Francës*, Aplikimi 21802/93, 17 Mars 1997, paragrafi 44
17. Çështja *I.A. k. Francës*, Aplikimi 28213/95, 23 Shtator 1988, paragrafi 104
18. Ibid, paragrafi 108
19. Çështja *Tomasi k. Francës*, Aplikimi 12850/87, 27 Gusht 1992, paragrafi 102
20. Çështja *I.A. k. Francës*, Aplikimi 28213/95, 23 Shtator 1988, paragrafi 104
21. Çështja *Bozano k. Francës*, Aplikimi 9990/82, Vendimi i dt. 2 Dhjetor 1987

e një avokati mbrojtës. Sipas teorisë që të drejtat e njeriut duhet të jenë *praktike dhe efektive*, e drejta për të patur një avokat mbrojtës sa më shpejt të jetë e mundur është parashikuar si pjesë e të drejtës për liri dhe siguri, ashtu edhe si pjesë e të drejtës për një proces të rregullt ligjor.[22] E drejta për të pasar avokat mbrojtjës, sipas nenit 5 të KEDNj përfshin të drejtën që bisedat avokat - klient të jenë konfidenciale.[23]

Ekzistojnë një tërësi parimesh që garantojnë mbrojtjen nga kufizimi arbitrar i lirisë. Këto parime janë përcaktuar në mënyrë të përmbledhur nga GJEDNj në çështjen *James, Ëells dhe Lee k. Mbretërisë së Bashkuar:*[24]

a) Gjykata do të konstatojë shkelje të nenit 5, kur edhe pse formalisht ekziston shkaku i ligjshëm i heqjes së lirisë, autoritetet e brendshme kanë zbatuar në keqbesim jo mirë një masë që lejon kufizimin e lirisë.

b) Gjykata duhet të shqyrtojë rastin përtej shkakut të paraqitur nga autoriteti për kufizimin e lirisë, dhe e gjykon të paligjshëm arrestimin ose ndalimin nëse rezulton se heqja e lirisë është kryer për një shkak tjetër të paligjshëm.

c) Gjykata do të konstatojë shkelje të nenit 5, kur megjithëse ekziston shkaku i ligjshëm për kufizimin e lirisë, ky shkak nuk përputhet me kushtet dhe vendin në të cilin është kryer heqja e lirisë.

d) Gjykata do të konstatojë shkelje të nenit 5, nëse nuk është respektuar parimi i proporcionalitetit ndërmjet shkakut të arrestimit/ndalimit dhe nivelit të kufizimit të lirisë.

Si rregullohet e drejta për liri dhe siguri në legjislacionin tonë të brendshëm?

Përmbajtja e nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut reflektohet me disa ngjashmëri në nenet 27 dhe 28 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Sipas nenit 28, liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastet e nevojshme, ndër të tjera, kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale, ose largimin e tij pas kryerjes së saj. Ndërkohë që neni

22. Çështja *John Murray k. Mbretërisë së Bashkuar*
23. Çështja *Modarca k. Moldavisë*
24. *Zbatimi i të drejtave të njeriut në praktikë*, Manual trajnimi për të drejtat ndërkombëtare të njeriut, Fondacioni SLYNN, Londër (UK) Janar 2016, paragrafi. 31, fq. 191

28 i Kushtetutës sanksionon të drejtat dhe garancitë me natyrë procedurale ndaj personit të cilit i hiqet liria, si: e drejta e njoftimit në një gjuhë të kuptueshme të shkaqeve të masës, akuzën që i bëhet, e drejta për të mos bërë deklarata, e drejta për të komunikuar me avokatin, e drejta e ankimit ndaj vendimit gjyqësor që kufizon lirinë, e drejta për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm etj.

Kodi i Procedurës Penale të RSH parashikon masat e sigurimit, kushtet, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre. Masat e sigurimit ndahen në masa të sigurimit personal dhe masa të sigurimit pasuror. Masat e sigurimit personal ndahen në masa shtrënguese dhe masa ndaluese. Neni 232 i Kodit të Procedurës Penale përcakton llojet e masave shtrënguese, ku masa e arrestit në shtëpi dhe masa e arrestit në burg zbatohen kur aplikimi i masave më të lehta nuk është i justifikuar.

Në nenin 228 të Kodit të Procedurës Penale parashikohen kushtet për caktimin e masave të sigurimit personal. Sipas pikës 1 të këtij neni, askush nuk mund t'u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të personit nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova.

Çfarë duhet kuptuar me termin *dyshim i arsyeshëm*?

Duhet të krijohet bindja se provat të bëjnë të dyshosh që është kryer apo është duke u kryer një vepër penale. Natyrshit, kjo bindje apo dyshim i arsyeshëm krijohet kur personi ndalohet, ose arrestohet në flagrancë, por kjo bindje duhet të jetë e atillë që të vlerësohet nga gjyqtari. Në të dyja rastet respektohet parimi i prezumimit të pafajësisë. Dyshimi i arsyeshëm sipas GjEDNj kërkon fakte, ose informacione, që do të bindin një vëzhgues objektiv se personi në fjalë mund të ketë kryer vepër penale.[25] Fakti që një individ ka precedentë penal nuk konsiderohet i mjaftueshëm për të krijuar dyshime të arsyeshme. Dyshimi i arsyeshëm mund të bazohet edhe në informacione anonime. Megjithatë, GjEDNj ka vlerësuar se informacionet e një informatori anonim, të pakonfirmuara nga prova apo informacione të tjera, të pamjaftueshme janë për të krijuar dyshimin e arsyeshëm.[26]

Në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë[27]

25. Çështja *Fax, Campbell dhe Hartley k. Mbretërisë së Bashkuar*
26. *Zbatimi i të drejtave të njeriut në praktikë*, Manual trajnimi për të drejtat ndërkombëtare të njeriut, Fondacioni SLYNN, Londër (UK) Janar 2016, fq 196, paragrafi 49/2
27. Shih vendimin Nr. 00-2017-323 i Vendimit (59), dt. 19.04.2017

është analizuar se, në kuptim të nenit 228/1 të Kodit të Procedurës Penale, dyshimi i arsyeshëm duhet të mbështetet në prova dhe të mos jetë i supozuar. Kolegji i Gjykatës së Lartë (Kolegji) vëren se, dyshimi i arsyeshëm presupozon ekzistencën e fakteve, ose informatave, të cilat mund të plotësojnë bazën objektive që personi në fjalë mund të ketë kryer veprën e dyshuar. Çështja nëse dyshimi mund të konsiderohet si i arsyeshëm varet nga lloji i veprës penale që dyshohet, rrethanat e atribuimit të faktit penal, si edhe nga të gjitha rrethanat e tjera të çështjes. Kolegji vlerëson, se bëhet fjalë për ato "të dhëna provuese" që prokurori duhet të grumbullojë gjatë zhvillimit të hetimeve paraprake, të cilat formohen në gjendjen që janë aktet. Pra, që bazohen në materialin provues të grumbulluar deri në atë çast të caktuar, dhe që ky mund të ndryshojë, duke evoluar apo involuar në bazë të pretendimeve dhe të dhënave të sjella nga prokuroria dhe nga mbrojtja.

Kodi i Procedurës Penale të RSH parashikon vendosjen e disa masave paraprake të kufizimit të lirisë, përkatësisht "*arresti në flagrancë*" dhe "*ndalimi i të dyshuarit për një krim*". Këto masa paraprake kanë kohëzgjatje të kufizuar në kohë dhe duhet të ndjekin respektimin e disa kritereve strikte, si edhe të të drejtave dhe garancive procedurale ndaj personave që zbatohen, deri sa gjykata të vendosë vleftësimin ose jo të masës së sigurimit personal të kërkuar nga prokuroria. Ndalimi nuk lidhet me flagrancën, por me dyshimin për kryerjen e një krimi dhe rrezikun e ikjes. Kërkesa e prokurorit për vlerësimin e arrestit në flagrancë apo të ndalimit, si masë e ligjshme, dhe për caktimin e masës së sigurimit që vlerësohet e përshtatshme, duhet të jetë e argumentuar.

Në kuadër të reformës në Sistemin e Drejtësisë, ndryshimet e fundit në Kodin e Procedurës Penale përcaktojnë disa garanci më specifike për respektimin e të drejtave procedurale, që gëzon i ndaluari ose i arrestuari. Lidhur me këto garanci, risi përbën neni 34/b i këtij Kodi, për njohjen e të ndaluarit me të drejtat e tij nëpërmjet "*letrës së të drejtave*" në formë të shkruar, e cila duhet t'i jepet personit të ndaluar kundrejt nënshkrimit. Ky parashikim është në harmoni me kërkesën e nenit 4 të Direktivës së Bashkimit Evropian për të drejtën e informimit.

Gjithashtu, me ndryshimet në këtë Kod, vendimi gjyqësor për caktimin e masës së sigurisë bëhet i pavlefshëm nëse nuk përmban të gjitha elementet e parashikuara në nenin 245 të tij. Një element i ri që është bërë i detyrueshëm në përmbajtjen e këtij vendimi është *parashtrimi i fakteve* se përse nuk merren parasysh pretendimet e parashtruara nga mbrojtja, si edhe

arsyetimi i papërshtatshmërisë së masave të tjera të sigurimit kur caktohet "*arresti në shtëpi*", "*arresti në burg*" dhe "*shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik*".

Si paraqitet praktika jonë gjyqësore për caktimin e masës së sigurimit personal (shtrënguese) "*arrest në burg*"?

Legjislacioni ynë procedural penal është hartuar në mënyrë të atillë që inkurajon përdorimin fleksibël të masave alternative të sigurimit personal, gjë që do t'i shërbente parandalimit të krimeve dhe edukimit më të mirë të të akuzuarve. Megjithëse në ligj masa të tilla janë parashikuar, në praktikën gjyqësore të monitoruar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) këto masa nuk konceptohen në mënyrë të drejtë dhe zbatimi i tyre është relativisht i kufizuar në raport me masën e arrestit në burg, e cila në vend që të jetë masë përjashtimore ajo përbën një nga masat që ka gjetur zbatim të gjerë.

Në fokus të monitorimit të KShH ishte vlerësimi i një numri të konsiderueshëm seancash dhe vendimesh gjyqësore, për të arritur në disa përfundime lidhur me bazueshmërinë ligjore të ndalimeve, arrestimeve dhe caktimit të masave të sigurimit personal nga gjykatat e rretheve gjyqësore të Tiranës dhe Durrësit. Ky monitorim nuk ka qënë i lehtë dhe ishte i pari i këtij lloji që realizohet në vendin tonë. Monitorimi mori shkas nga gjendja shqetësuese e mbipopullimit në sektorët apo institucionet e paraburgimit.

Monitorimi i KShH-së u përqëndrua në rreth 400 seanca gjyqësore gjatë periudhës Shkurt – Prill 2017, si edhe në studimin e 1817 dosjeve dhe vendimeve gjyqësore të dhëna gjatë vitit 2015 për vleftësimin e ndalimit/arrestimit dhe caktimin e masës së sigurimit personal. Monitorimi dhe studimi kishte si objektiv vlerësimin e veprimtarisë së policisë, prokurorisë dhe gjykatës lidhur me interpretimin dhe zbatimin e normave të Kodit të Procedurës Penale për caktimin e masave të sigurimit personal dhe, në mënyrë të veçantë, të masës shtrënguese "*arrest në burg*", duke patur në fokus respektimin e të drejtave dhe lirive të personave të ndaluar dhe të arrestuar.

Me miratimin e ligjit nr. 98/2014, datë 31.7.2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal" u vu re një ashpërsim i politikës penale për disa vepra penale dhe kriminalizim i formave të reja të veprimtarive të paligjshme. Kjo është arsyeja pse monitorimi alternon të dhënat cilësore dhe sasiore të rezultuara nga dosjet/vendimet e vitit 2015 me ato të seancave

gjyqësore të vitit 2017, për të evidentuar ndër të tjera se si ka ndikuar ashpërsimi i politikës penale në rritjen e masës së sigurimit personal "*arrest në burg*".

Më 2015-ën, një vit pas ndryshimeve në Kodin Penal, të dhënat e studimit evidentuan rritje të numrit të ndalimeve/ arrestimeve nga policia dhe prokuroria, për personat e dyshuar për vepra me rrezikshmëri jo të lartë shoqërore, të parashikuara në nenin 137 të Kodit Penal "Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike" dhe nenin 291 "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt" (vepra të kriminalizuara ose të ashpërsuara në masën e dënimit me ndryshimet që pësoi Kodi Penal në vitin 2014). Për një numër të konsiderueshëm të këtyre shtetasve që ndaloheshin/arrestoheshin në flagrancë për këto vepra, prokuroria kërkonte dhe gjykata vendoste masën "*arrest në burg*". Përveç këtyre veprave, arresti në burg aplikohet në masë të konsiderueshme për "Dhunën në familje", parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, për veprat penale për vjedhjen e pasurisë, të parashikuara nga nenet 134, 135, 136, 137 të Kodit Penal, si edhe për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", "Trafikimi i narkotikëve", vepra këto të parashikuara nga neni 283 dhe neni 283/a i Kodit Penal.

Pavarësisht se në metodologjinë e monitorimit janë marrë si referencë kampionë të ndryshëm (vendime e dosje për vitin 2015 dhe seanca gjyqësore për vitin 2017), si edhe pavarësisht nga fakti që periudhat e këtyre kampioneve janë të ndryshme dhe me diferencë prej gati më shumë se një vit, problematika që ka rezultuar në tërësi nga monitorimi ka qenë pothuajse e njëjtë. Edhe në aspektin statistikor, të dhënat cilësore janë përafërsisht të njëjta. Konkluzioni i parë përgjithësues për këtë monitorim është se u vërejt një përdorim tepër i lartë i masës së sigurimit "*Arrest në burg*". Kërkesat e prokurorisë për caktimin e kësaj mase zënë një numër të konsiderueshëm në raport me masat e tjera dhe, po kështu, zbatimi i kësaj mase nga gjykata është sërisht tepër i lartë.

Monitorimi ka konstatuar, gjithashtu, raste të caktimit të masës së sigurimit, duke i dhënë përparësi kryesisht maksimumit të dënimit që parashikon dispozita përkatëse e Kodit Penal, pa vlerësuar në kompleks edhe rrethanat, kushtet në të cilat është kryer vepra, pasojat që kanë ndodhur etj. Veç kësaj, në disa raste është zbatuar masa e arrestit në burg edhe kur ndalimi/ arrestimi bëhet për vepra penale më pak të rënda, kur mund të justifikohej edhe një mase më e lehtë. K.Pr.Penale parashikon që çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për

veprën penale konkrete. *Arresti në burg* mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit.

Problem tjetër i përgjithshëm që u vërejt nga monitorimi ka të bëjë me mungesën e efektshmërisë së mbrojtjes ligjore me avokat në seancat për caktimin e masave të sigurimit, sidomos kur avokatët janë të caktuar kryesisht. Është vërejtur një diferencë në cilësinë e mbrojtjes, e cila ka qënë më e mirë kur avokatët janë zgjedhur privatisht. Kur mbrojtja është caktuar kryesisht, cilësia ka qënë më e dobët. Ka patur një numër të konsiderueshëm personash që në procesin e vleftësimit të masës së sigurimit janë mbrojtur me avokat kryesisht. Në mënyrë të tërthortë, kjo e dhënë evidenton faktin, se një pjesë e konsiderueshme e këtyre personave vijnë nga shtresa të varfëra ekonomike që nuk kanë mundësi të kenë avokat privat.

Në kampionet e monitoruara për vitin 2015 u vërejt, se 56.5% e personave ndaj të cilëve caktohet masa e sigurimit mbrohen me avokat privat dhe 40.2% mbrohen me avokat të caktuar kryesisht. Tërheq vëmëndje gjithashtu fakti, se një shumicë jo e vogël avokatësh marrin pjesë në seancat gjyqesore me të njëjtët prokurorë dhe gjyqtarë. Natyrisht, ky fakt nuk të jep të drejtën të paragjykosh, por një e dhënë e tillë ka vend të diskutohet.

Nga seancat e monitoruara për vitin 2017 rezulton, se rreth 57.8% e personave janë përfaqësuar me avokat të zgjedhur, ndërkohë që vijon të ketë një numër të lartë personash të përfaqësuar me avokat të caktuar kryesisht, përkatësisht 39%. Vërehet në mënyrë të tërthortë se ka një monopolizim të avokatëve që caktohen kryesisht në këto seanca, të cilët kanë qenë pothuaj të njëjtët, në total rreth 6 avokatë. Në rreth gjysmën e çështjeve të studiuara (51.8%), mbrojtja ka pretenduar se nuk ishte njohur me materialet e prokurorisë. Në 72% të rasteve, avokati mbrojtës nuk ka paraqitur prova për të mbrojtur të drejtat/interesat e personit të ndaluar/arrestuar në këto seanca. Veçanërisht kur mbrojtësit janë caktuar kryesisht, shpesh ka rezultuar se nuk është studiuar dosja apo çështja më parë nga ana e tyre, nuk është realizuar asnjë takim apo bisedë me personin nën hetim për të hartuar së bashku me të strategjinë e mbrojtjes. Kjo vjen, përveç të tjerash, edhe për arsye praktike, pasi mbrojtësit e caktuar kryesisht nga ana e gjykatës nuk kanë patur mundësi objektive të flasin me vetë personin e ndaluar/arrestuar apo me familjarët e tyre. Këto të dhëna evidentojnë në përgjithësi një mbrojtje jo aktive, jo efektive dhe shpesh herë edhe formale.

Gjithashtu, në praktikën gjyqësore është vërejtur mungesë

konsistence në kërkimin nga prokuroria dhe vendimmarrjen e gjykatës rreth masave të sigurisë për vepra të ngjëjta, ose kur autorët e dyshuar kanë patur profil të ngjashëm dhe rrezikshmëri të ulët.

Trajtimi i të miturve kërkon një vëmëndje dhe vlerësim të veçantë, duke patur në konsideratë nevojat e tyre sociale dhe edukative, të cilat nuk mund të plotësohen efektivisht në kushtet e kufizimit të lirisë. K.Pr.P në fuqi gjatë kohës së studimit parashikon se, kur i pandehuri është i mitur gjykata mban parasysh kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukative konkrete. Caktimi i masës së sigurisë "*arrest në burg*" për kategorinë e të miturve dhe të rinjve nën 21 vjeç mund të ishte më i reduktuar, pavarësisht se në disa raste veprat e kryera prej tyre nuk konsiderohen të lehta. Kryesisht të miturit dhe të rinjtë e kësaj moshe, ndaj të cilëve është caktuar *arrest në burg* akuzohen për vepra penale kundër pasurisë, shitjen e narkotikëve apo armëmbajtje pa leje. Ndër rastet e studiuara është caktimi i masës së sigurisë "*arrest në burg*" për të miturin 15 vjeçar për veprën penale "vjedhje" të një vlerë shumë të vogël (kryesisht ushqime dhe pije). Ndërkohë, të dhënat për dosjet/vendimet dhe seaancat e monitoruara evidentojnë, se ka patur raste kur mund të shmangej caktimi i masës "*arrest në burg*" dhe të zbatoheshin alternativat më të lehta të kësaj mase, veçanërisht kur autorët e akuzuar të veprave penale kanë qënë të mitur, gra, të moshuar, ose të sëmurë.

Vlen të përmëndet që në raste shumë të rralla është përdorur *garancia pasurore* në përputhje me ligjin. Zbatimi i kësaj mase apo masave të tjera të sigurimit mund të ndikonte pozitivisht jo vetëm te vetë individi i akuzuar, por do t'i shërbente qoftë edhe në një masë të kufizuar shpopullimit të institucioneve të burgimit dhe paraburgimit. Kjo nuk do të thotë që për të justifikuar uljen e mbipopullimit, gjykatat të mos zbatojë masën e arrestit kur kjo do të ishte e domosdoshme. Megjithatë, referimi në statistikat zyrtare të mbipopullimit është një nga treguesit që gjykata mund ta marrë në konsideratë sa herë që është e lëkundur për domosodoshmërinë apo jo të masës "*arrest në burg*". Vendimet e studiuara nuk evidentojnë referim të gjykatës në këto statistika/të dhëna.

Në mjaft raste rezulton se kërkesa për masat e sigurimit bazohet kryesisht në provat e mbledhura nga policia gjyqësore dhe se prokuroria nuk ka kryer hetim apo përpunim të akteve të policisë. Në kushte të tilla vështirësohet shqyrtimi gjyqësor, sepse del nevoja e kërkesës së provave të tjera, por ajo që tërheq vëmëndjen është fakti se shpesh mbrojtësi nuk ka një rol proaktiv dhe nuk paraqet prova në këto seanca, por kufizohet

duke i kërkuar gjykatës masë më të lehtë sigurimi nga ajo e parashtruar nga prokurori. Deri në një farë mase, kjo praktikë e ndjekur mund të ketë ndikuar ne cenimin e parimit të barazisë së armëve juridike.

Ka patur edhe raste kur gjykata nuk ka patur një rol proaktiv në konstatimin e shkeljes së të drejtave procedurale dhe lirive të të ndaluarit/arrestuarit nga policía apo nga prokuroria. Rrjedhimisht, provat e siguruara nga prokuroria gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nuk kanë respektuar në mënyrë të plotë kërkesat e ligjshmërisë. Janë vërejtur, gjithashtu, parregullsi në veprime procedurale, si "*kontrolli i banesës*" apo "*kontrolli personal*". Jo vetëm prokurori duhet të jetë më rigoroz në mbikëqyrjen dhe respektimin e kërkesave të K.Pr.P për të gjitha veprimet procedurale që kryhen ndaj personave të dyshuar, të ndaluar apo të arrestuar, por edhe gjykata duhet të jetë më kërkuese ndaj fakteve, të analizojë dhe verifikojë në seancë ligjshmërinë e provave të sjella, pa anashkaluar këtu edhe rolin e mbrojtjes në favor të të të ndaluarit/arrestuarit.

Vlen të përmëndet se, në disa vendime të gjykatës mungon jo vetëm arsyetimi formalo-ligjor, por edhe konsekuenca në ato raste kur vepra e kryer mund të jetë e njëjta, madje edhe rrethanat apo kushtet e kryerjes së saj kanë qënë gjithashtu të njëjta. Në disa raste, gjykata nuk ka marrë në analizë as në mënyrë të përmbledhur provat mbi të cilat mbështeten faktet e referuara në vendimin gjyqësor, duke u mjaftuar me citimin e provave të prokurorisë, por pa bërë referime të fakteve mbi të cilat hedhin dritë këto prova. Shumica e vendimeve të monitoruara janë tepër të shkurtra dhe nuk kanë një arsyetim të mjaftueshëm për të gjithë kushtet dhe kriteret ligjore që ekzistojnë për të caktuar këtë ose atë masë sigurie. Linja argumentuese në këto vendime përkon më së shumti me kërkimet/argumentet e prokurorisë. Shpesh është vërejtur se, linja argumentuese në këto vendime nuk është e thellë dhe nuk ka një balancim në arsyetim mes kërkesave dhe pretendimeve të prokurorisë dhe atyre të mbrojtjes.

Nga monitorimi rezultoi, gjithashtu, se në shumicën dërrmuese të rasteve gjykatat kanë zbatuar kërkesën ligjore që brenda 3 ditëve të merrnin në pyetje personat ndaj të cilëve ishte marrë masa e sigurimit "*Arrest në burg*", ose "*Arrest në shtëpi*". Sipas K.Pr.Penale, çdo dy muaj nga zbatimi i vendimit të arrestit prokurori informon me shkrim gjykatën, që ka caktuar masën mbi hetimet e kryera dhe nevojat e sigurimit. Monitorimi i KShH evidentoi se, në 99.4% të rasteve ky informacion me shkrim nuk është i pranishëm në dosje, ndërkohë që vetëm në 0.6% raste informacioni është

i pranishëm në dosje. Me ndryshimet e reja të K.Pr.P është parashikuar se, kur prokurori nuk informon në afatin e përcaktuar, gjykata verifikon nevojat e sigurimit me kërkesë të të pandehurit ose kryesisht. Gjykata, pasi dëgjon palët, vendos vazhdimin, zëvendësimin, ose revokimin e masës së sigurimit.

Përfundime

1. Standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut kërkojnë që çdo kufizim i lirisë duhet të jetë përjashtim, objektivisht i justifikuar dhe për një kohëzgjatje jo më shumë se sa është absolutisht i domosdoshëm. Standardet ndërkombëtare inkurajojnë shprehimisht mospërdorimin e masave shtrënguese të kufizimit të lirisë gjatë hetimit dhe gjykimit, deri në dhënien e vendimit.

2. Përkundrejt standardeve ndërkombëtare përdorimi i zgjeruar i *arrestit në burg* te ne evideton njohje jo të mirë të tyre nga aktorët e Sistemit të Drejtësisë Penale, në mënyrë të veçantë nga prokuroria dhe gjykata. Monitorimi i kryer nga KShH i 400 seancave gjyqësore dhe studimi i 1800 vendimeve gjyqësore për masat e sigurimit personal në gjykatat e rretheve gjyqësore Tiranë dhe Durrës nxori në pah përdorimin tepër të lartë të masës së sigurimit "*Arrest në burg*". Në këtë trend të gjykatës vlerësohet se ka ndikuar edhe ashpërsimi i politikës penale për vepra që nuk kanë rrezikshmëri të lartë shoqërore.

3. *Arresti në burg* zbatohet në përqindje të lartë edhe kur të ndaluarit akuzohen për vepra penale që nuk paraqesin rrezikshmëri të theksuar shoqërore, ndaj të ndaluarve të mitur, ndaj të rinjve të moshës 18-21 vjeç dhe ndaj grave.

4. Ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale, mund të ndikojnë pozitivisht edhe për kuptimin dhe zbatimin më të drejtë të masave të sigurimit personal dhe, në mënyrë të veçantë, të *arrestit në burg*. Kuptimi dhe zbatimi i drejtë i ligjit nga të gjithë aktorët e Sistemit të Drejtësisë Penale do të reflektojë edhe në respektimin më të mirë të të drejtave që ligji u garanton personave të ndaluar/arrestuar dhe atyre ndaj të cilëve caktohet një masë sigurimi personal.

5. Monitorimi i KShH, me gjithë nevojën për t'u përmirësuar e pasuruar më tej mund të të shërbejë në drejtim të ndërgjegjësimit më të mirë dhe rritjes së kapaciteteve profesionale të punonjësve të policisë, të prokurorëve si dhe të avokatëve mbrojtës.

Literatura:

Akte normative
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë
- Kodi Penal i Republikës së Shgqipërisë

Doktrinë
- *Zbatimi i të drejtave të njeriut në praktikë*, Manual trajnimi për të drejtat ndërkombëtare të njeriut, Fondacioni SLYNN, Londër (UK) Janar 2016
- *Të drejtat e njeriut dhe paraburgimi,* Manual për standartet ndërkombëtare të Paraburgimit Nju Jork dhe Gjenevë 1994

Jurisprudencë
- Vendime të GjEDNj për çështjet: Mckay k. Mbretërisë së Bashkuar; Rehbock k. Sllovenisë; Brogan dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar; Michalko k. Sllovakisë; Ilijkov k. Bullgarisë; Yagci dhe Sargin k. Turqisë; Smirnova k. Rusisë; Buzadj k. Moldavisë; Muller k. Francës; I.A. k. Francës; Tomasi k. Francës; Bozano k. Francës; Modarca k. Moldavisë; Fax, Campbell dhe Hartley k. Mbretërisë së Bashkuar
- Vendimi i Gjykatës së Lartë të RSh, Nr. 00-2017-323 i Vendimit (59), dt. 19.04.2017

PËRDORIMI ME EFEKTIVITET I EKSPERTIMEVE PËR ZBULIMIN E TË VËRTETËS NË PROCESIN PENAL

Av. Prof. asoc. Dr. Fatmir TARTALE
Dekan i Fakultetit të Shkencave Shoqërore
në Albanian University,
Tiranë

Hyrje

Ekspertimi, si një nga provat që meren gjatë procedimit penal, përcaktohet nga organi i procedimit me anën e shtrimit para ekspertit të pyetjeve që duhet të zgjidhën mbi bazën e njohurive të tij të posaçme. Zgjidhja e këtyre pyetjeve realizohet nëpërmjet paraqitjes së materialit përkatës nga ana e prokurorit, ose e gjykatës, studimi i të cilit i krijon mundësi ekspertit për të arritur në përfundimet përkatëse rreth një fakti, ose rrethane të caktuar. Gjatë procedimit penal, për zbulimin dhe vërtetimin e fakteve të rëndësishme në një çështje penale, policia gjyqësore, prokurori dhe gjykata thërrasin, kur u Iind nevoja, specialistë të fushave të ndryshrne të shkencës, të teknikës dhe të kulturës, për të kërkuar mendimin e tyre të kualifikuar. Objekt i ekspertimit mund të jetë: vendi ku ka ndodhur vepra penale; sendi mbi të cilin autori ka vepruar gjatë kryerjes së veprës penale; gjurmë të gjetura në këtë send apo mjet të kryerjes së veprës penale; gjurmë në geniet e gjalla (njerëz apo kafshë, shpendë etj., ndaj të cilave ka vepruar autori i veprës penale), që mund të jenë: gjurmë gjaku, pështymë, spermë, qime floku, lëkurë e pjesëve të ndryshme të trupit të autorit. Ose te autori i veprës penale - gjumët që kanë mbetur nga viktimat apo nga personat ndaj të cilëve është kryer vepra penare, por që vërtetojnë praninë e autorit në veprën e kryer penale, e cila po hetohet

nga organet e hetimit paraprak apo po gjykohet nga gjykata. Duke parë larminë e jetës së njeriut, ekspertimet janë të shumëllojshme, sikurse edhe nevojat e organeve të procedimit janë gjithashtu të shumëllojshme, disa prej të cilave do të trajtohen në këtë punim, sepse ato gjejnë përdorim në procedimin penal shqiptar apo edhe në atë të shteteve të tjera evropiane e me gjere.

Siç dihet, vepra penale mund të prekë marrëdhënie shoqërore nga me të ndryshmet në fusha të çfarëdoshme të jetës. Kjo kushtëzon mundësinë që ekspertimi të gjejë zbatim në çdo fushë të teknikës, të shkencës ose të kulturës. Praktika e procesit të të provuarit tregon se si paraqiten ekspertimet nga fusha e kriminalistikës, traseologjisë, toksikologjisë, mjekësisë ligjore, psikiatrisë, kimisë, biologjisë, kontabilitetit; transportit rrugor, hekurudhor, ajror, detar; ndërtimit, zjarrit, arkitekturës, arkeologjisë, si edhe një shumëllojshmëri ekspertimesh, të cilat ndikohen nga zhvillimi dinamik i jetës dhe i veprave penale, që kryhen nga autorët e tyre. Këto ekspertime kanë veçoritë e veta, por në pamundësi për t'u ndalur këtu në përmbajtjen e tërë llojeve të ekspertimit, ndoshta do të ishte mirë të shohim mundësinë konkrete për zbulimin e provave, nëpërmjet disa llojeve të ekspertimeve, siç janë: ekspertimi traseologjik, ai i materialeve ngjitëse, ekspertimi mjeko-ligjor, ai i lëkurës së kokës së njeriut, ekzaminimi i ADN-së, ekspertimi odorologjik, si edhe identifikimi i personit në bazë të zërit.

Ekspertimi traseologjik

Mbledhja e provave me anën e ekspertimeve traseologjike, domethënë, e ekspertimeve ku objekt ekzaminimi janë gjurmët e duarve, të këmbeve, të dhëmbëve, të materialeve ngjitëse, të arrmëve të ndryshme, të mjeteve të transportit, të çelësave të automjeteve etj., synon në: a) identifikimin e personit (apo sendi) që ka lënë gjurmën; b) kur një gjë e tillë nuk është e.mundur, vërtetimin e saktë të këtyre ose atyre cilësive (veçorive) të atij personi (apo sendi); c) vërtetimin e shkaqeve dhe të kushteve në të cilat u krijuan gjurmët dhe, duke u nisur nga këto, njohjen e disa hollësive lidhur me ngjarjen që është duke u hetuar; d) zbulimin dhe fiksimin e vetë gjurmëve në rastet kur kjo nuk është e mundur të bëhet pa një analizë laboratorike.

Mbi rëndësinë që merr ekspertimi traseologjik për të gjitha këto

drejtime, mund të sjellim shernbuj nga praktika në lidhje me vjedhjet e makinave, një veper pcnale kjo që sot ndeshet shpesh. Kështu, për shembull, gjatë këqyrjes së një aitomjeti të markës 'Benz' në datën 26.05.2004, të vjedhur në Tiranë, i cili ishte lënë në qytetin e Lezhës, u konstatua se gjatë realizimit të vjedhjes, në derën e anës së shoferit ishin lënë gjurmë të mjeteve dhe të pëllëmbës së dorës së majtë. Sipas rregullave procedurale, këto gjurmë u fiksuan dhe u bashkuan me çështjen. Një rast tjetër, në datën 27.01.2005 ishte vjedhur pranë lokalit "Tajvani" në Tiranë ishte vjedhur gjithashtu një makinë tip 'Benz' 300D, me të cilën u kapën në flagrancë A.P dhe P.LL. Nga ekspertimi daktiloskopik që iu bënë gjurmëve të lëna në makinë doli se autori i vjedhjeve doli që ishte P.LL. Në lidhje me këto çështje organi i procedimit caktoi ekspertimin traseologjik dhe daktiloskopik. me ndihmën e të cilave u vendos së pari që të verifikohej hamendësimi, nëse të dyja vjedhjet qenë kryer me të njëjtat mjete dhe nëse në të dyja makinat ishin lënë të njëjtat gjurmë. Për këtë qëllim, para ekspertit u shtrua pyetja: të dyja vjedhjet qenë kryer me të njëjtat mjete? Eksperti shfaqi mendimin se gjurmët qenë lënë nga i njëjti mjet si në portën e makinës, ashtu edhe në bravën e çelësit të saj. Ndërsa me ndihmën e ekspertimit daktiloskopik organi i procedimit verifikoi nëse gjurmët e gishtave ishin lënë prej personave të ndaluar si të dyshimtë në kryerjen e këtyre veprave penale. Eksperti dha raportin, sipas të cilit, gjurmët e gishtave ishin lënë nga P. LL. Të dhënat e mendimeve të ekspertëve, të pavarura nga njëra-tjetra, lejuan planifikimin e drejtë të hetimeve paraprake dhe, në të njëjtën kohë, shërbyen si hallka të rëndësishme në tërësinë e provave të mbledhura në çështje, duke argumentuar në mënyrë të plotë fajësinë e P. LL.-së dhe të bashkëpunëtoreve të tij në kryerjen e vjedhjeve.[1]

Ekspertimi i materialeve ngjitëse

Në kushtet e sotme, institucionet e ekspertimit ligjor kanë vënë forcat për zgjerimin e mundësive të ekspertimit, mbi bazën e integrimit të njohurive speciale, të tërheqjes në praktikë të objekteve të reja, të ekspertimit kriminalistik të materialeve, lëndëve dhe të produkteve me ngjitës. Vitet e fundit i është kushtuar vëmendje e veçantë përpunimit të bazave teorike dhe metodologjike të shurnëllojshmërisë së ekspertimit kriminalistik të materialeve, substancave dhe produkteve të materialeve

1. Arkivi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dosje e vitit 2005

ngjitëse, që dalin gjithnjë e më shumë në cilësinë e provave materiale gjatë hetimeve të veprave të ndryshme penale: në ato kundër personit, në vrasjet, në vjedhjet e pasurisë me dhunë, në vjedhje bankash me përdorimin e eksplozivit, në shkeljet e rregullave të sigurimit teknik; në vjedhje të mjeteve të transportit, në aktet terroriste etj. Ky lloj ekspertimi është i kushtëzuar me përhapjen e gjerë dhe përdorimin e materialeve ngjitëse në të gjitha degët e ekonomisë, si edhe në përdorimin e gjerë familjar.

Industria kimike prodhon shumë materiale ngjitëse, që e dallon secilin produkt nga vetitë e veçanta. Sasia e ngjitësve të llojeve të ndryshme sa vjen e rritet. Kështu, materialet ngjitëse përdoren në prodhimin dhe remontin e transportit automobilistik, në industrinë e përpunimit të drurit dhe në atë të lehtë, në ndërtim, në tregti, në sistemin postar, në mjekësi, në administratë etj. Gjithashtu përdoren për ngjitjen e materialeve të ndryshme, si shirita të filmave, shirita magnetikë etj. Ndërkohë përdoren për paketimin e mallrave industriale dhe të ushqimeve, për pakot postare, në reklama etj. Nga përhapja dhe shumëllojshmëria e materialeve ngjitëse përcaktohet mundësi më e madhe e gjurmëve të tyre, e shtresëzimeve, e mikrogjunnëve të veçanta në vendin e ngjarjes, në trupin (veshjen) e të pandehurit apo të të dëmtuarit dhe në elemente të ndryshme të mjedisit të krimit. Objektet e ekspertimit mund të jenë: gjurmë, shtresëzime të materialeve ngjitëse të llojeve të ndryshme të objekteve mbartëse; gjurmë dhe shtresëzime të ngjitësve në objektet që janë mjete të krimit; grimca (thërrmija) të materialeve ngjitëse që janë zbuluar në vendin e ngjarjes; vëllime të përcaktuara të ngjitësve; madhësi të veçanta të komponenteve të materialeve ngjitëse (tretës, plastifikues etj.); materiale të forta të përcaktuara në formën e kokrrizave, të rrathëve, të pllakave, të shtresës së hollë (ose të shiritit), të fijeve etj; shirita (filma) viskozë.

Objekte të këtij ekspertimi mund të jenë edhe mjetet e transportit, elementet e konstruksioneve të ndërtesave dhe të pajisjeve, objekte të tjera, që nga përmasat e mëdha nuk mund të merren dhe të bashkëngjiten me çështjen në cilësinë e provave materiale, por fotografohen e filmohen, dhe më pas çdo gjë fiksohet në procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes, ose të faktit të fiksuar në këto objekte që ka lidhje me veprën penale të kryer. Vetitë e bashkimeve me ngjitës varen nga shumë rrethana, siç rnund të jenë: përgatitja e sipërfaqes së objekteve që ngjiten, numri i shtresave ngjitëse në secilën sipërfaqe të ngjitur, mënyrat e shtrimit të ngjitësve, shndërrimi i lëndës ngjitëse në shtresë etj. Vetitë e bashkimeve (vendit ku ngjiten) u

nënshtrohen ndryshimeve në varësi nga koha dhe kushtet kur është kryer ai, kohës së gjatë të veprimit të faktorëve të ndryshëm, si ngarkesat, uljet dhe ngritjet e temperaturave, kushtet klimaterike etj. Në bazë të metodave të studimit të materialeve të lëndëve dhe produkteve ngjitëse për zbulimin e gjurmëve në to përdoren metodika kimike, spektrale, lumineshente, mikroskopike, kromatografike, si edhe metoda të tjera të studimit të ngjitësve. Eksperienca e fituar e kryerjes së ekspertimeve kriminalistike thekson mundësinë parimore të përdorimit të fakteve, që formojnë vetitë (cilësitë) e materialeve ngjitëse dhe të bashkimeve të ngjitjeve, në drejtirn të zgjidhjes së detyrave që i janë ngarkuar ekspertit, kur ekzaminon materiale të tilla ngjitëse apo objekte ku ato janë ngjitur dhe përdorur nga autorët e veprave penale.

Lokalizimi i objekteve të zbuluara gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes me gjurmët - shtresa të ngjitësve, të lejon të sqarosh mekanizmin e formimit të këtyre gjurmëve, vendosjen, drejtimin dhe veprimin reciprok të tyre. Shtresëzimet e materialeve ngjitëse në veshjet e mjeteve të përdorura për thyerje dhe të sendeve të tjera mund të dëshmojnë për metodën e përdorur nga autorët e këtyre veprave penale, për mjetet e krimit dhe mënyrat e përdorimit të tyre.Llojet e materialeve ngjitëse që janë përdorur, sasia e shtresave, vazhdimësia e tyre, rregullsia, radha, mënyrat dhe teknologjia e vënies së ngjitësit, e përputhjes së tyre me standardet etj. sjellin një informacion të rëndësishëm, dëshmues të një fakti ,që mund të ketë rëndësi për zbulimin e së vërtetës në një procedim penal. Me mjaft rëndësi është edhe konstatimi i faktit të ringjitjes së malirave të paketuara industriale, ushqimore, famaceutike, të pakove postare, gjithashtu edhe konstatimi i burimit të prejardhjes së materialeve ngjitëse. Gjurmët - shtresëza të materialeve ngjitëse mund të kenë rëndësi të madhe, në zgjidhjen e ekspertimeve komplekse të një çështjeje penale, në lidhje me faktet e bashkëpunimit të objekteve që janë paraqitur nga prokurori ose gjykata për ekzaminim. Me anën e ngjitësve bashkohn me njëri-tjetrin objekte të tjera, objekte zbukuruese, materiale fibrore dhe produkte të tyre (plastmas, gomë, xham, metale, aliazhe dhe produktet e tyre), materiale ndërtimi etj. Ngjitësit janë komponente përbërëse të një sërë materialesh, lëndësh dhe produktesh (të ngjyrave ngjitëse, të lëkurës artificiale, të materialeve me push artificial).

Sot ky lloj ekspertimi zgjidh një rreth të madh çështjesh, ndër të tjera: Materiali i paraqitur për ekzaminim, a është material ngjitës? Në

objektet mbartëse a ka pjesëza ose gjurmë - shtresë të lëndës ngjitëse? Për ngjitje a është përdorur një apo disa ngjitës? Cila është natyra, pamja dhe emërtimi i materialit ngjitës? Cili është mekanizmi i formimit të gjurmëve - shtresa të lëndës ngjitëse? Materialet e krahasuara ngjitëse a kanë një grup të përbashkët përkatësie? A janë të nevojshme? A është përdorur ngjitësi i paraqitur për studim në përgatitjen e sendit? Objektet e krahasuara a kanë të njëjtin burim të prejardhjes nga teknologjia e përgatitjes së materialit ngjitës, të bashkimit ngjitës etj.? Objektet e krahasuara a i përkasin të njëjtës parti të produktit të uzinës prodhuese konkrete? Me mënyrë të fabrikuar apo artizanale a është hedhur ngjitësi në objekt? Në vartësi nga rrethanat e çështjes penale, para ekspertëve a mund të parashtrohen edhe pyetje të tjera si për shembull, a i janë nënshtruar hapjes dhe ngjitjes së përsëritur pakot postare apo pako të tjera? Çfarë ndryshimesh kanë ndodhur në materialet ngjitëse, që janë të kushtëzuara nga kushtet, nga paketimi, dërgimi dhe dorëzimi i sendit të paketuar? etj.

Në çdo rast, në hetimin paraprak, nevojitet të merren masa për zbulimin dhe ekzaminimin e materialeve ngjitëse, që i përkasin çështjes. Mbi bazën e analizën së situatës në vendin e ngjarjes, e marrjes parasysh të veçorive të materialeve ngjitëse dhe kushteve të përdorimit të tyre, prokurori ose gjykata mund të marrë vendim për ekspertimin e objekteve bartëse, ku mund të zbulohen gjurmë - shtresëzime të ngjitësit. Natyrisht, këtu bëjnë përjashtim rastet kur sendi bartës i gjurmës së ngjitësit nuk mund të veçohet nga vendi i ngjarjes dhe kur ka rrezik të humbasë mikroobjekti, ose të ndodhin ndryshime gjatë transportit të tij, së bashku rne objektin bartës. Pavarësisht nga përjashtimet e sipërme, për ekzaminim merren thërrmija apo pjesëza të objekteve me shtresëzimet e lëndës Për ta realizuar këtë duhet të merren masa që garantojnë ruajtjen e pamjes fillestare dhe gjendjen e objekteve. Pjesëzat e marra paketohen dhe i vihen në dispozicion ekspertit, që t'i ekzaminojë, dhe ai përdor metodat traseologjike të ekzaminitnit, për të konstatuar nëse pjesëzat i përkasin një të tëre apo jo. Kushti kryesor i kryerjes së ekspertimit është paraqitja e mostrave për studimin krahasues, gjithashtu edhe paraqitja e të gjitha materialeve të çështjes, që përmbajnë të dhëna, të cilat mund ta ndihmojnë ekspertin në zgjedhjen e mjeteve, për t›i zbërthyer pyetjet që i ka vënë përpara prokurori apo gjykata.

Rezultati i ekspertimit varet edhe nga zgjedhja që u bën organi i hetimit paraprak materialeve, të cilat i përkasin prejardhjes së objekteve që

i nënshtrohen ekspertimit. Rëndësinë e këtij ekspertimi, mund ta ilustrojmë me një shembull nga praktika. Kështu, në datë 10.10.2002 në Durrës pranë lokalit "Torra" ndodhi një konfrontim me armë. Ekspertët shkuan në lokal, ku në cilësinë e provës morën dy shishe birre të mbetura në tryezë dhe katër gjurrmë papilare (me anën e gjurmëkopjuesit transparent). Këto gjurmë u emërtuan: «A», «B», «C», «D». Më vonë, në afërsi të shkollës së muzikës u gjet një makinë tip 'Fiesta', në pjesën e brendshme të xhamit të së cilës (nga krahu i shoferit) u gjet një gjurmë gishti, që u mor me gjurrmëkopjues. Kjo gjurrmë u emërtua "E". Veprimet u kryen nga eksperti i Durrësit, i cili bëri mbylljen e gjurrmë-kopjuesve dhe shënimet e duhura në çdonjërin prej tyre.Vendimi i ekspertimit, bashkëngjitur dhe me pesë gjurmëkopjuesit u dorëzuan në Institutin e Policise Shkencore pranë Ministrisë së Brendshme. Shefi përkatës, në datën 03.10.2002 ngarkoi një ekspert dhe ia dorëzoi laborantit, që i fotografoi të pesë gjurmëkopjuesit menjëherë. Eksperti, duke kryer ekspertimin daktiloskopik nr. 2855, datë 07.10.2002, arriti në konkluzionin se të pesë gjurrmët e sjella për ekspertim qenë të vlefshme për identifikim[2]. Më 08.10.2002 akti i ekspertimit dhe pesë gjurmëkopjuesit u tërhoqën nga drejtuesi i laboratorit kriminalistik të Drejtorisë së Policisë së Qarkut të Durrësit. Eksperti i këtij laboratori e krahasoi gjurmëkopjuesin "E" me atë që ndodhej në laboratorin kriminalistik të Durrësit (sipas tyre, e kishin marrë dy herë atë gjurmë dhe e kishin emërtuar "E l") dhe vuri re se gjurrma nuk ishte e njëjtë me atë të ekzaminuar, të quajtur "E". (Këtë gjurrnë, "E", dhe dy nga gjurmët e tjera: "A" e "C", i kishin marrë nga dy herë, pasi cilësia nuk ishte e mirë, madje gjurmën e dytë "E" e kishin emërtuar "E l". Por, në procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes nuk ishte shënuar se këto gjurrmë qenë rnarrë dy herë.[3] Nga tërësia e rrethanave të ngjarjes u ngritën dyshime, se gjurma qe ndërruar, duke u hapur nga eksperti kriminalist IPSh-së në Tiranë dhe duke vendosur gjurmë tjetër në vend të saj. Ndaj ekspertit filloi procedimi penal nën akuzën e veprave penale: shpërdorim detyre dhe kryerje e veprimeve që pengojnë zbulimin e së vërtetës, të parashikuara si vepra penale.[4] Sipas kërkesës së mbrojtësit të ekspertit të akuzuar nga ana e organit procedues u vendos kryerja e ekspertimit teknik dhe grafik të gjashtë gjurnnëkopjuesve, nga ana e një grupi ekspertësh (tre prej një zyrë private ekspertimi, një nga Shoqata e

2. Nga Arkivi i Institutit të Policisë Shkencore, Tiranë 2002
3. Arkivi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, viti 2002
4. Shih nenet 248 dhe 301 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2017

Shkencave Ligjore dhe dy ekspertë të Institutit të Policisë Shkencore pranë Ministrisë së Brendshme). Ekspertëve iu shtruan për zgjidhje dy pyetje: a) Shkrimi dhe nënshkrimi në gjurmëkopjuesit e emërtuar "A", "B", "C", "D", "E"dhe "E l" a ëslitë kryer nga njëjti person? b) Në gjashtë gjurmëkopjuesit objekt ekspertimi, a vërehen ndërhyrje në pjesët e prera të gjurmëkopjuesit (hapje dhe rimbylljet të gjurmëkopjuesit) dhe në nënshkrimin e vendosur në pjesët e tyre anësore?

Ekspertët, me aktin e ekspertimit nr. 3372, datë 10.11.2002 arritën në konkluzionin se tekstet (shkrimet) në gjashtë gjurrmëkopjuesit ("A", "B", "C", "D", "E" edhe "El") - objekte të këtij ekspertimi qenë shkruar nga e njëjta dorë; nënshkrimet (firmat) në ato gjashtë gjurrmëkopjues duhet të qenë shkruar nga e njëjta dorë dhe te të gjashtë gjurmëkopjuesit objekt ekspertimi nuk u konstatuan gjurrmë të ndërhyrjes në pjesët e prera (hapje dhe rimbyllje të gjurmëkopiuesve), as te nënshkrimet e vendosura në pjesët e tyre anësore.Kryerja e këtij ekspertimi solli fakte, që tregonin se eksperti i akuzuar, nuk kishte kryer asnjë veprim të kundërligjshëm, dhe kështu ra poshtë çdo dyshim për akuzat e ngritura ndaj tij. Për rrjedhojë, procedimi penal u pushua.[5]

Një ekspertim i tillë është me shumë rëndësi, pasi zbulon fakte që kanë vlerë provuese për veprën penale të kryer dhe për autorin, ose kur nuk ekzistojnë fakte të tilla sqarohet pafajësia e personit të vënë nën akuzë.

Ekspertimi mjeko-ligjor

Mundësia e mbledhjes së provave me anë të ekspertimit mjeko-ligjor është e shumëllojshme. Ky ekspertim kryhet në hetimin e veprave penale kundër jetës e shëndetit të personit, si edhe të provave materiale e biologjike. Me ndihmën e këtij ekspertimi, organi i procedimit ka mundësi të sigurojë të dhëna mbi kohën kur ka ndodhur një vdekje, të tregojë se në çfarë pozicioni i janë shkaktuar plagët të dëmtuarit, nëse kufoma është lëvizur ose jo pas vdekjes, të japë të dhëna mbi karakterin dhe mënyrën e shkaktimit të plagëve dhe shkaqeve të vdekjes. Ekspertimi mjeko-ligjor lejon të verifikohen shpjegimet e ndryshme që jepen nga ana e të pandehurit, nga i dëmtuari dhe dëshmitarët rreth zhvillimit të ngjarjes që është duke u hetuar; të përcaktohet shkalla e rrezikshmërisë së plagëve të shkaktuara etj

5. Vendimi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për pushimin e procedimit penal nr. 1988, Tiranë 2000

Në shumë raste bëhet e nevojshme kryerja e ekspertimeve mjeko-ligjore të karakterit biologjik. Kjo ndodh kur duhet përcaktuar lënda organike nga e cila është formuar një njollë, lloji i flokëve, grupi i gjakut, gjinia etj. Me ndihmën e ekspertimit mjeko-ligjor mund të sqarohen rrethana që i përkasin anës objektive; mund të grumbullohen të dhëna mbi karakterin e ngjarjes, mbi zhvillimin e saj etj. Le të marrim një rast nga praktika. I mituri B.C., tek rrinte në një lokal provokohet nga dikush, më i madh në moshë dhe fizikisht më i fortë (në këtë rast, viktima). Për të mos e vazhduar grindjen, B.C. del nga lokali, por provokuesi e ndjek, e fyen dhe e godet. I mituri, duke qenë nën goditjet e viktimës dhe i tronditur shumë edhe nga fyerjet drejtuar familjarëve të tij, nxjerr një thikë që kishte me vete dhe e godet një herë në trup. Personi (viktima) vdes. Nga ekspertimi mjeko-ligjor i caktuar rezultoi se të dy kishin dëmtime në trup, ndërsa viktima kishte dhe një goditje me thikë në bark. Mbi bazën e konkluzioneve të ekspertirnit doli që vdekja e viktimës kishte ardhur si rezultat i goditjes me thikë në bark nga ana e të miturit B.C. Nga provat e tjera të mbledhura gjatë hetimit paraprak u sqaruan elementet e anës objektive, si edhe elementet e anës subjektive. I mituri u gjykua dhe u dënua për veprën penale të vrasjes, të kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike, të parashikuar në nenin 82 të Kodit tonë Penal.[6]

Ekspertimi i lëkurës së kokës së njeriut

Në vendin e kryerjes së vrasjes, të përdhunimit, të krimeve që lidhen me shkaktimin e dëmtimeve trupore, të ngjarjeve të transportit rrugor etj., përveç gjurmëve tradicionale, shpesh mbeten dhe gjurrmë të lëkurës së kokës së njeriut, të ballit, të hundës, të buzëve, të mjekrës, të faqeve dhe të llapave të veshëve. Ato mund të ndodhen në mbeturinat e duhanit, në pecetat, në dorezën e telefonit, në xhamat e dritareve, në derën e hyrjes etj.

Këto gjurrmë të zbuluara mund të përdoren gjatë hetimit të krimeve në rolin e burimit të provave. Gjatë hetimit paraprak, oficerët e policisë gjyqësore dhe prokurorët (kur ata marrin pjesë në këqyrje), rrallë i kushtojnë kujdes zbulimit, fiksimit dhe marrjes së këtyre gjurrmëve, ekspertimi i të cilave lejon të konstatohen rrethana të rëndësishme në procesin e të provuarit.

Ekspertimi i gjurrmëve të mbulesës së lëkurës së kokës së njeriut, është një nga llojet e ndryshme të ekspertimit traseologjik. Ai lejon të konstatohet mekanizmi i krijimit të këtyre gjurmëve dhe karakteri i veprimeve të autorit

6. Nga Arkivi i i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, viti 1994

të veprës penale, numri i personave pjesëmarrës, seksi i këtyre personave, mosha dhe veçoritë e pamjes së jashtme të tyre, duke realizuar identifikimin e autorit, sipas gjurmëve të ballit, të hundës, të buzëve, të mjekrës, të faqeve dhe të Ilapave të veshëve.

Zbulimi i këtyre gjurmëve është i lehtë jo vetëm per ekspertin, por edhe për oficerin e policisë gjyqësore, sepse per zbulimin e tyre zbatohen po ato mjete që përdoren për zbulimin e gjurmëve të duarve. Meqenëse këto gjurmë kanë qëndrueshmëri të pakët ndaj veprimeve mekanike, sigurisht që duhet të tregohet kujdes gjatë këqyrjes. Objektet që i mbajnë këto gjurme duhet te dërgohen sa më shpejt për ekspertim. Ekspertit mund t'i bëhen disa pyetje, përgjigjet e të cilave ai duhet t'ia japë organit procedues: A ka gjurrnë të lëkurës së kokës së njeriut në objektin e paraqitur? Në qoftë se po, konkretisht nga cila pjesë e lëkurës së kokës janë lënë ato? Si rezultat i cilave veprime janë formuar këto gjurmë? Cili është mekanizmi i formimit të këtyre gjurrnëve? Pyetja e fundit është e domosdoshme për përcaktimin në të ardhmen te kushteve të marrjes se kampionëve për krahasim, që korespondojnë me gjurmët eksperimentale të lëkurës së kokës. Duke supozuar daljen në çështje të persona që verifikohen, atëhere bëhen pyetje plotësuese, si: A është e vlefshme kjo gjurmë për identifikimin njeriut? Gjurmët a janë lënë nga një person apo nga persona ndryshëm?

Në rastin kur në momentin e caktimit të ekspertimit për te evidentuar personin që verifikohet, e domosdoshme është të merren gjurmë eksperimentale të asaj pjese të lëkurës së kokës së tij, që është pasqyruar në gjurmë. Në rastin kur është evidentuar se në cilat pjesë të lëkurës është lënë gjurme, atëherë, lind problemi që të merren mostra për krahasim. Dhe, për arritur në konkluzione të drejta kryhet ekspertimi kryesor dhe ai plotësues. Pas kryerjes së ekspertimit vlerësues kryhet ekspertimi që do sqarojë nëse gjurma e ballit, e hundës, e buzëve është lënë nga personi i dyshuar në objektin ku është konstatuar. Eksperti duhet të sqarojë edhe seksin e autorit të veprës penale, nëse është mashkull apo femër; duhet të dallojë moshën e tij dhe shenjat e pamjes se jashtme. Veçoria e këtij ekspertimi dhe të dhënat e përfituara nga kryerja e tij shërbejnë për të individualizuar dhe saktësuar autorin e veprës penale; për të ngritur versione të drejta për zhvillimin dinamik të hetimit; për të arritur sa më shpejt në zbulimin dhe kapjen e autorit që ka kryer veprën penale.

Ekzaminimi i ADN-së

Ekzaminimi i ADN-së përbën një provë që për nga rëndësia është e njëjtë me gjurmët daktiloskopike. Ky lloj ekspertimi shërben për identifikimin e autorit të kryerjes së veprës penale, ose për përjashtimin e tij nga akuza, në bazë të gjurmës gjenetikem sipas të ashtuquajturave metoda të ADN-së (A=acidi, D=dezoxi, N=nuklein). ADN-ja ndodhet në çdo qelizë njerëzore, të kafshës, të bimës. Çdo qelizë e organizimit ka një kod. Metoda e përcaktimit të kodit gjenetik u aplikuan fillimisht në Angli, nga biologu Alec Jeffery i Universitetit te Losterit, me 1985. Ai vertetoi që testi i AND-së bazohet në faktin se asnjë qenie njerëzore nuk ka trashegimi të njëjtë gjenetike.[7]Ai ariti ne keto konkluzione, te cilat u zhvilluan më tej, duke u perfeksionuar dhe duke u përhapur në të gjithë botën, si edhe duke u vënë në shërbim të hetimit paraprak dhe në gjykimin e veprave penale Sot kanë gjetur zbatim të gjerë dhe përdoren me efektivitet në shumë vende të botës (Evropë, ShBA, por edhe në Shqipëri etj.) për zbulimin, hetimin dhe gjykimin e veprave penale të vrasjeve, të marrëdhënieve seksuale me dhunë, të akteve terroriste, vjedhjeve me armë, kur gjatë kryerjes së veprës penale, autorët janë përleshur me viktimat dhe kanë lënë gjurmë të tyre (gjak, sekrecione të ndryshme) në vendin e krimit. Në Shqiperi, analizat e AND-së për çështje penale kanë filluar të aplikohen që prej vititi1995 dhe të kryheshin në Policinë Shkencore të Romës. Ndersa, që prej vitit 2009, ato kryhen në Policinë tonë Shkencore.[8]

ADN-ja ndodhet në gjak, në spermë, në sekrecionct vagjinale, në pështymë, në qimet e flokut, në grimca të muskujve dhe indeve organike që mbeten nga autorët e veprave penale, qofshin këto edhe të thara e të mbetura në objekte të ndryshme, madje për disa vjet. Duke u zbuluar ADN-ja, plotësisht e mundur është që të përcaktohet dhe të identifikohet personi që e ka atë. Kjo realizohet duke e krahasuar me modelin e nxjerë nga personi i dyshuar. Me anë të aparaturave bashkëkohore, analizohet përputhja apo mospërputhja e saj për një kohë të shkurtër. Eksperti i caktuar me autorizim të organit procedues në hetimin paraprak apo nga gjykata në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale,[9] mund të marrë gjak apo të bëjë

7. V. Latifi, *Kriminalistika*, Prishtinë 2014, fq. 41
8. L. Veliqoti, *Kriminalistika*, Tiranë 2015, fq. 141
9. Nenet 151, 184, 198 dhe 199 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2017

ndërhyrje të tjera trupore edhe pa vullnetin e personit (nëse nuk ka rrezik për jetën). Kur kemi njerëz të vdekur, veprimet kryhen në konformitet me kërkimet e Kodit të Procedurës Penale,[10] gjithmonë kur është e nevojshme për konstatimin e fakteve që kanë rëndësi për çeshtjen.

Ekspertimi odorologjik

Lindja e llojeve të reja të ekspertimeve ligjore, si një kërkesë e praktikës e zgjeron rrethin e provave materiale dhe forcon depërtimin e të dhënave bashkëkohore, të shkencave natyrore dhe teknike në procedimin gjyqësor penal. Në këto metoda bën pjesë edhe odorologjia."*Cilësia më e rëndësishme e erës për odorologjinë kriminalistike është individualiteti i saj. Qysh në fundin e shekullit të kaluar, Hans Gros ka bërë me dije mundësinë e shfrytëzimit të qenve në hetime, duke theksuar se në këtë mënyrë zbulohet dhe përcillet më shpejt krimineli…*".[11] Futja e ekspertimit ligjor odorologjik në procedimin penal jep ndihmesë në hetimin e veprave penale me rrezikshmëri të madhe, si ato për vrasje, marrëdhënie seksuale me dhunë, vjedhje etj. Ky lloj ekspertimi mund të përdoret me efektivitet për identifikimin odorologjik të autorit të veprës penale, në bazë të gjurmëve të erës që ka lënë në vendin e ngjarjes. Gjithashtu, ky lloj ekspertimi përdoret shpesh edhe për një arsye të rëndësishme, se autorët e veprave penale me rrezikshmëri të madhe sa vjen dhe po kualifikohen, kështu që ata po lënë gjithnjë e më pak gjurmë tradicionale në vendin e krimit.

Ky lloj identifikimi është aplikuar ne vendin tone qe prej vititi 1950,[12] nëpërmjet përdorimit të qenit të stërvitur në këtë drejtim, për zbulimin e autorëve të veprave penale, në bazë të gjurmëve të erës, të lëna në objekte të ndryshme në vendin e ngjarjes. Natyrisht, për konservimin e erës që kanë lënë autorët shërbejnë dhe laboratorë të posaçëm, që konservojnë erërat e mbledhura në vendin e ngjarjes, të cilat më pas përdoren për zbulimin dhe kapjen e autorëve të veprave penale. Shkalla e përpikmërisë së konkluzioneve të këtij ekspertimi është e barabartë me shkallën e rezultateve të llojeve më të përhapura të ekspertimeve ligjore, siç janë ekspertimet grafike apo

10. Shih nenin 200 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2017
11. V. Latifi, *Kriminalistika*, Prishtinë 2014, fq. 117
12. A. Sanxhaku, O. Marko, Trajtimi, përgatitja dhe përdorimi i qenve të shërbimit, Tiranë 1984, fq. 5

daktiloskopike etj. Në Hungari është krijuar Banka Shtetërore Qëndrore e Erërave nga vendet e krimeve të pazbuluara, si edhe bankat e erës të retheve dhe qarqeve. Në një vit në Hungari, me përdorimin e kësaj metode zbulohen deri në 1000 krime.[13]

Përdorimi i këtij ekspertimi ka dhënë rezultate në Evropë, si në Francë, Gjermani, Hungari dhe Rusi, gjithashtu edhe në ShBA etj, duke zbuluar kështu autorët e shumë krimeve të kryera. Në bazën e këtij ekspertimi qëndrojnë arritjet e shkencave mbi erërat. Nga shkencat fiziologjike, biologjike dhe kimike është vendosur që era e njeriut ka individualitet dhe qëndrueshmëri relative. Gjurmët e erës janë komponente materiale që nuk duken, si ato të teshave, sendeve, aparateve te ndryshme telefonike fikse apo portable, të sediljeve të makinave, të karikeve, mjeteve të kryerjes së krimit, orëve, portofolëve, stilolapsave, llullave dhe çdo objekti të prekur nga autori që ka kryer veprën, të cilat kanë në sipërfaqe një informacion ere, të burimit të erës (së njeriut) dhe që janë bartësit e saj (objekte të identifikimit të odorologjisë). Sipas informacionit të erës realizohet identifikimi odorologjik i njeriut si burim i erës, me ndihrnën e detektorëve biologjikë - analizatorit të nuhatjes të qenit të stërvitur në këtë drejtim.

Është e rëndësishme të theksojmë se individualiteti i erës është i kushtëzuar; është rezultat i shumë funksioneve të organizmit, që realizohen nga sistemet e djersitjes, të gjendrave, endokrine dhe nga sisteme të tjera të veçanta të organizmit. Transmetimi i informacionit të erës së vet nga njeriu është një proces i pashmangshëm dhe i pandërprerë. Odorologjia përdoret edhe për kërkimin dhe zbulimin e drogave të fshehura në objekte të ndryshme dhe te eksplozivëve, nëpërmjet qenit të përdorur për këtë qëllim apo edhe kafshëve të tjera të stërvitura posaçërisht. Duke iu referuar kërkimeve në dispozitat ligjore,[14] që bëjnë fjalë për këqyrjen, nuk ka ndonjë, kufizim për zbulimin dhe marrjen e gjurmëve të zbuluara nga organi procedues. Në zbatim të nenit 178 të K.Pr.P., ligjvënësi nuk ka parashikuar ndonjë kufizim (veç atij në paragrafin e dytë), kur është i nevojshëm zhvillimi i kërkimeve, ose marrja e të dhënave dhe e vlerësimeve që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, shkencore dhe kulturore. Pra, në këto raste nuk ka asnjë pengesë, që të caktohet edhe ekspertimi ligjor odorologjik. Në këtë ekspertim, eksperti do të sqarojë disa çështje, si ato që po i rendisim më tej: nëse era në atë objekt bartës

13. I. Kliver, Socialistiçeskaja zakonost, Nr. 10, 1097
14. Shih nenin 198/1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2017

të erës (veshje, letër, armë dhe mjete të tjera të krimit etj.) i përket personit që dyshohet apo jo; nëse, duke gjykuar në bazë të erës, njollat e gjakut në vendin e krimit, flokët, djersa etj. i përkasin personit që dyshohet apo jo; nëse ruhen gjurmët e erës së këmbëve apo të duarve nga personi apo nga persona (kur janë disa) që dyshohen; cili nga të dyshuarit ka lënë erën në mjetet e thyerjes, në sipërfagen e thyer, në drynin e thyer; kujt nga të dyshuarit i përket era në letër, në zarf, në dokument, në aparate të ndryshme apo paisje të përdorura, në sediljen e makinës, timonin e makines, stilolapsin, portofolin etj.; nëse era në atë veshje është e personit të dyshuar apo jo; në cilën nga të gjitha teshat e paraqitura ka mbetur era e personit që paraqitet si i dyshuar.

Natyrisht, për kryerjen e këtij ekspertimi kërkohen specialistë të kualifikuar në këtë drejtim, për zbulimin, më tej, për fiksimin në procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes, siç veprohet dhe për mikrogjurmët e tjera sot, të cilat nuk shihen nga askush. Këto mikrogjurmë merren me një garzë të pastër dhe mbyllen në një kuti të posaçme, mbi të cilën vihet një shënimin konkret për ditën, datën, vendin, orën dhe objektin ku është marrë; për paketimin etj., që janë rregulla të caktuara procedurale për pasqyrimin e këtyre veprimeve në akte procedurale, për t'iu dhënë rëndësia e duhur si provë materiale në procesin e të provuarit, që zhvillon organi i procedimit në hetimin paraprak dhe, më tej, në shqyrtimin gjyqësor. Zbatimi i këtij ekspertimi dhe shfrytëzimi i konkluzioneve të tij nuk do të thotë që, organi i procedimit të mbështetet vetëm në ato konkluzione, për të akuzuar dhe dërguar për gjykim një person që dyshohet si autor i një vepre penale. Konkluzione të tilla mund të shikohen si prova indirekte dhe si bazë për veprimet e mëvonshme procedurale të organit të procedimit, në procesin e të provurarit, për të vërtetuar më pas, që në atë vepër penale ka marrë pjesë edhe një person, ndaj të cilit kanë filluar hetimet. Kjo do të shihet në raport me të gjitha provat e mbledhura gjatë hetimit paraprak, në mënyrë që organi i procedimit të arrijë në konkluzione përfundimtare në lidhje me autorin e dyshuar për kryerjen e një vepre penale të caktuar. Zbatimi i këtij ekspertimi do të ndihmojë në efektivitetin e luftës kundër kriminalitetit.

Identifikimi i personit në bazë të zërit

Studimi, krahasimi dhe individualizimi i zërit të njeriut jo vetem nepermjet shqisese se degjimit vjen prej me shume se 100 vjtesh. Edhe ky lloj ekzaminimi është një ekspertim që ndeshet në praktikë dhe është i mundur të realizohet, veçanërisht në hetimin e disa lloje veprash penale, siç janë

kanosje serioze për vrasje, njoftime per vënie bombe, telefonata me fjalë të pahijshme, mesazhe kërcënuese apo shantazhuese të lëna në sekretaritë telefonike, në vjedhje me dhunë, me arrmë; në marrëdhënie seksuale me dhunë, në rrëmbim ose mbajtja peng personi/personash, në akte terroriste, në të cilat jo rrallë mbetet zëri i incizuar i personit të dyshuar (sidomos, në shiritat magnetikë, në mjetet e sotme të komunikimit, me anën e të cilave transmetohet ose regjistrohct zëri, siç janë: sekretaritë telefonike, telefonat celularë apo mjete të tjera që njëkohësisht regjistrojnë figurën dhe zërin e personit qe ka kryer vepren penale, pa perjashtuar edhe zërat e përftuar nga përgjimi i kryer,[15] i cili autorizohet me vendim te oprganit kompetent te procedimit penal). Gjithashtu, ky ekzaminim mund të realizohet edhe me mjete filmimi, pra, me kamera të llojeve të shumta që ndodhen në objekte të ndryshme private apo publike, në banesa apo zyra, në banka apo jnstitucione që i mbajnë në punë në mënyrë të përhershme, të cilat aktualisht shfrytëzohen në te shumten e rasteve nga organet e procedimit penal, për faktin se ka përhapje të gjerë të përdorimit të tyre. Inçizimet e zërave të autorëve të dyshuar për kryerjen e një vepre penale, me këto lloj aparatesh mund të shfrytëzohen nga ekspertët e caktuar nga organi i procedimit, për t'i pasur si objekt ekspertimi. Autorët, që gjatë kryerjes së veprës penale komunikojnë nëpërmjet mjeteve të komunikimit, ose direkt me njëri-tjetrin apo me të afërmit, ose me policinë kur duan të bisedojnë apo kur paraqesin kërkesa në biseda me ta për të bërë marrëveshje rreth lirimit të ndonjë personi apo evitimit të një akti terrorist, zërin e tyre e lënë të regjistruar në mjetet e komunikimit të bashkë-biseduesve të vet, veç atyre që regjistrojnë në mënyrë automatike e të pavarur nga bashkëhiseduesit.

Në këto raste, eksperteve u vihen në dispozicion këto incizime dhe identifikimi është rezultat i një ekspertimi me pajisje kompjuterike, ku analizohet zëri nëpërmjet analizatorëve akustikë që e transkriptojnë zërin në diagram, shenjat e të cilit regjistrohen në ordinator. Duke qenë se, *zëri është i veçantë për çdo person*, pikerisht per këtë ai përbën një *pasaporte akustike*, e cila mund të shfrytëzohet me sukses, duke e krahasuar zërin e panjohur të regjistruar gjatë kryerjes së veprës, me zërin e personave të dyshimtë, gjithashin te regjistruar, siç shprehet një studiues.[16] "*Zëri nuk*

15. Në referim të kërkimeve të neneve 221 - 226 të Kodit të Procedurës Penale të R.Sh., Tiranë 2017

16. L. Veliqoti, *Identifikimi i personit në bazë të zërit*, Tiranë 1998, fq. 106

humbet, nuk vidhet, nuk imitohet", - shprehet një tjetër.[17] Pra, ka mundësi ekzaminimi dhe shërben në identifikimin e autorit të dyshuar për kryerjen c një vepre penale. Duke qenë një ekzaminim dhe identifikim i saktë, që na çon drejt zbulimit të autorit dhe që nëpërmjet këtij ekzaminimi përcaktohet: mosha, seksi, niveli kulturor e arsimor, gjendja emocionale e autorëve në momentin e kryerjes së veprës penale, numri i tyre, lëvizjet që kanë bërë në vendin e ngjarjes, objektet që kanë prekur, spostuar, rrëzuar apo thyer, të cilat na shërbejnë për të kryer ekzaminime të tjera, si ai traseologjik, daktiloskopik, odorologjik, biologjik, të ADN-së etj. për identinfikimin e autorit/autorëve, ky lloj ekspertimi, pra, identifikimi nëpërmjet zërit ka gjetur përdorim në praktikën e organeve të hetimit paraprak dhe të gjykimit.

Rastet e zbatimit, të marrjes dhe të ekzaminimit të kësaj prove në zbulimin e veprave penale të ndodhura janë të shumta dhe kanë dhënë efektivitet në luflën kundër kriminalitetit. Ekspertët e caktuar nga organi i procedimit në kryerjen e këtij ekspertimi, këtë e kryejnë sipas parashikimeve ligjore,[18] duke i analizuar veç e veç diagramet e prodhuara pas analizës së zërit të administruar si provë dhe zërit të personit të dyshuar. Fizikani Lorenc G. Kresta, mbas shumë studimesh dhe eksperimentesh konkludoi, se saktesia e identifikimit të personit nëpërmjet zërit të jetë 99,65%.[19] Në rast perputhjeje personi i dyshuar identifikohet, ndërsa në rast mospërputhjeje ai shfajësohet për akuzën e ngritur ndaj tij.

Këtë mund ta ilustrojmë me rastin e parë të njohur në kriminalistikë për identifikimin e autorit të një vrasjeje nëpërmjet ekspertimit të zërit. Kjo ndodhi në San Pol të ShBA-ve. Më 22 maj 1970, në mbrëmje, një grua telefonoi në zyrat e Policisë së qytetit dhe kërkoi t'i dërgonin një makinë, mbasi po i lindte e motra shtatzënë dhe në shtëpi nuk kishin asnjë autormjet transporti. Pas pak, polici mbërriti në adresën e dhënë dhe sa po trokiste në portën e shtëpisë u godit në shpinë, nga një predhë arme zjari. Nisën hetimet e çështjes. Gjatë hetimit u provua, se asnjëra nga banoret e asaj shtëpie nuk ishte duke lindur dhe asnjë prej tyre nuk kishte telefonuar në polici për nevojën e një automjeti. Pra, telefonata kishte pasur qëllim që ta fuste policinë në kurth. Menjëherë filloi puna dhe u regjistrua zëri i secilit prej të dyshuarve. Nga krahasimi i vokogrameve të përfituara, zëri i trembëdhjetë u identifikua si zëri i autores së thirrjes telefonike. Sipas

17. S. Begeja, *Kriminalistika*, Vëllimi I, Tiuranë 2001, fq, 72
18. Shih nenet 149, 151, 179, 294, 300, 303, 314, 366 të K. Pr. P., Tiranë 2017
19. R.I.P.C., Nr. 189, viti 1965

ekzaminimit të bërë dhe përfundimit të dhënë, gruaja u arrestua, dhe ky arrestim u realizua me anën e zërit. Por, pavarësisht nga rezultati i zbulimit të autorit të vrasjes së policit, kjo provë nuk mund të shërbente e vetme për gjykatën, por i duhej hetimit paraprak, për të ngritur versione dhe akuzuën për bashkëpunim në vrasje. Më pas, gruaja tregoi bashkëpunëtorët dhe motivin e vrasjes. Gjatë shqyrtimit të çështjes në gjyq, krahas provave të tjera, u pranua edhe identifikimi në lidhje me autorin.[20]

Për identifikimin e autorit të krimit, për të drejtuar hetimet paraprake drejt gjetjes së provave të tjera, që të vërtetohet akuza e ngritur ndaj autorit të dyshuar, mund të përdoret edhe kjo provë shkencore e marrë gjatë hetimit paraprak. Nga ana tjetër, gjykata, në dhënien e vendimit, e shqyrton edhe atë në raport me provat e tjera, për të dhënë një vendirn të drejtë e të bazuar. Edhe në Shqipëri, duke iu referuar praktikës së organeve të procedimit, kanë filluar identifikimet në bazë të zërit kanë filluar të praktikohen. Për herë të parë, identifikimi i zërit të disa të akuzuarve nëpërmjet ekzaminimit të zërit të fiksuar në përgjimet telefonike mes tyre, te ne u realizua në vitin 2007 nga Qëndra Shkencore e Mbrojtjes së Individit "The experts", në një gjykim që zhvillohej nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë,[21] për trafikim narkotikësh nga një grup i strukturuar kriminal. Pas këtij identifikimi, kjo Qëndër ka kryer edhe disa identifikime të tjera në bazë të zërit të autorëve të vënë nën procedim penal, në zbatim të kërkesave të gjykatave shqiptare.

Konkluzione

Kryerja e këtyre ekspertimeve ka dhënë rezultate herë pozitive dhe herë negative, por gjithsesi u kanë shërbyer dhe i sherben edhe sot dhënies se drejtësisë nga gjykatat. Përdorimi i këtyre ekespertimeve dhe të tjera të këtij lloji, për vetë efektivitetin që japin në luftën kundër kriminalitetit, sidomos kundër atij të organizuar, trafiqeve të ndryshme të armëve, kultivimit, transportit dhe tregtimit të lëndëve narkotike të kategorive të ndryshme, kundër terorizmit siç është dhe çështja penale kundër një grupi autorësh që se fundmi këtë vit po hetohet, mund të thuhet se është bërë një domosdoshmëri. Për vertetimin e kryerjes së veprave penale nga autorët

20. E. Myftari, *Identifikimi i personit me anë të zërit*, revista 'Tribunë Juridike' Nr. 52, Tiranë 2005
21. Nga Arkivi i Gjykatës së Krimeve të Rënda, Tiranë 2007

e tyre, kjo domosdoshmëri vjen edhe si rezultat i përdorimit të gjërë të rregjistrimeve të zërit apo figurës me mjetet e sotme moderne të përdorimit privat dhe publik, dhe këto të fundit me leje të organeve kompetente që ua jep këtë drejtë ligji, duke respektuar të drejtat kushtetuese të qytetarëve te parashikuara në Kreun e II ("Liritë dhe të drejtat vetiake") të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ato të parashikuara në Kreun III ("Mjetet e kërkimit të proves") të Kodit tonë të Procedurës Penale. Kjo, në hetimin paraprak dhe më pas në gjykimin e autorëve të veprave të ndryshme penale nga gjykatat, veçanërisht nga ato të Krimeve të Renda. Gjykatat, si organe që japin drejtësi, nuk mund të mos mbajnë në qëndër të vëmëndjes së tyre analizën e të gjitha provave të shqyrtuara, si edhe faktet e përftuara nga ekspertimet dhe të verifikuara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Literatura:

Akte normative
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë

Doktrinë
- S. Begeja, *Kriminalistika*, Tiranë 2001
- V. Latifi, *Kriminalistika*, Prishtinë 2014
- L. Veliqoti, *Kriminalistika*, Tiranë 2015
- L. Veliqoti, *Identifikimi i personit në bazë të zërit*, Tiranë 1998
- A. Sanxhaku, O. Marko, *Trajtimi, përgatitja dhe përdorimi i qenve të shërbimit*, Tiranë 1984
- E. Myftari, *Identifikimi i personit nëpërmjet zërit*, revista 'Tribunë juridike' Nr. 52/2005
- I. Kliver, 'Socialistiçeskaja zakonost', Nr. 10/1987
- R.I.P.C., Nr. 189/1065

Jurisprudencë
- Çështje e nxjerrë nga Arkivi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, viti 2005

- Çështje e nxjerrë nga Arkivi i Gjykatës së Krimeve të Rënda, Tiranë 2007
- Çështje e nxjerrë nga Arkivi i Gjykatë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë 2002
- Çështje e nxjerrë nga Arkivi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë 1994
- Çështje e nxjerrë nga Arkivi i Prokurorisë së Rrethit gjyqësor Tiranë
- Çështje e nxjerrë nga Arkivi i Institutit të Policisë Shkencore, Tiranë 2002

SFIDAT E BIOTEKNOLOGJISË NË FUSHËN JURIDIKE, IMPAKTI NË SHOQËRINË SHQIPTARE

Prof. Asoc. Dr. Hemion BRAHO
Prof. Asoc. Dr. Juelda LAMÇE
Pedagogë në Universitetin Evropian, Tiranë

Hyrje

Përdorimi i teknologjive riproduktive e ka origjinën në fillimet e shekullit me aplikimin e parë te kafshët, në mënyrë që të "prodhohej" për qëllime komerciale. Më pas, këto metoda janë aplikuar për njerëzit, sidomos për çiftet jo fertile, të cilat nuk mund të kishin fëmijë me anë të marrëdhënieve seksuale normale. Bëhet fjalë për inseminimin artificial, për t'u siguruar që një marrëdhënie seksuale, me ndihmën e teknologjisë, mund të bëhet fertile dhe kështu të arrihet lindja e fëmijës së dëshiruar.

Ishte viti 1968 kur Edwards, mjek anglez, ushtronte eksperimentet e tij në Universitetin e Cambridge. Ndryshimi i vërtetë i bioteknologjisë së aplikuar në riprodhim është kryer në vitin 1978, kur Edwards dhe Steptoe realizuan për herë të parë fekondimin e një ovuli (vezë) human jashtë trupit të një femre, duke e bashkuar me një spermatozoid në epruvet. Kështu iu dha një shtysë prodhimit në masë të embrioneve të njeriut, të cilët transferoheshin në mitrën e një gruaje (nëna, ose një tjetër grua që jep me "qira" mitrën e saj). Pra, merr fund parimi juridik - natyror "*mater semper certa*" (*nëna është gjithmonë e sigurt*).[1]

1. Jonas, H., *The Imperative of Responsibility: In Search of an Ethics for the Technological Age*, Chicago Univ. Press., 1985, fq.. 5-20

Llojet e fekondimit

Në varësi të formave të ndryshme të fekondimt dallohen:

- *Inseminimi artificial*, kur kemi të bejmë me fekondimin e semenëve mashkullorë drejtpërpërdrejt në trupin e gruas.

- *IVF (in vitro fertilisation),* që është një teknikë e riprodhimit mjekësor të asistuar, e cila konsiston në përftimin e fekondimit të vezës jashtë trupit të femrës me pasojë formimin e embrionit dhe transferimin e mëvonshëm në mitër të këtij të fundit.

- *ICSI (intracytoplasmic spermatozoid injection),* mikroinjeksioni ose vendosja e spermatozoidit brenda citoplazmës së qelizës vezë. Kjo është teknika më e suksesshme dhe më e shpeshtë e mikromanipulimit dhe aplikohet në rastet me dëmtim të rëndë të spermatozoideve.

- *Ektogjeneza* është një teknikë e ardhshme, që do të zëvendësonte artificialisht organizmin e nënës gjatë procesit të fekondimit dhe të zhvillimit embrional.

Në lidhje me IVF duhet të bëjmë dallimin midis fekondimit homolog dhe fekondimit heterolog: në rastin e parë, elementet organike (vezë dhe spermë) i përkasin gjenetikisht atyre që duhet të jenë prindërit natyrorë të fëmijës; në rastin e dytë, nëse ka një dhurues të jashtëm nga çifti. Në të dy rastet, procesi mjekësor mbetet i njëjtë. Inseminimi heterolog mund të realizohet si nga figura mashkullore, si nga ajo femërore Në rastin e parë, burri është dhurues i spermatozoideve dhe nuk i përket çiftit. Rasti i dytë është ai i mëmësisë surrogative. Duke specifikuar më tej: kur një çift dëshiron fëmijë është steril (steril të dy, ose një nga të dy) duhet të përgatitet të pranojë që një grua tjetër të rrisë në barkun e saj embrionin e fekonduar në vitro, të çiftit, duke u përftuar kështu "*qiraja e mitrës*". Nëse gruaja, përveç mitrës ofron të gjithë kapacitetin e saj riprodhues (duke rënë dakord që të fekondohet me spermën e burrit të çiftit), atëherë përftohet një "*surrogim i mëmësisë*". Në të dyja rastet, çifti ka kryer një marrëveshje me një grua për të realizuar një shtatzëni, ose për të mbartur embrionin nga çifti, në mënyrë që të lindë më pas fëmijën dhe të heqë dorë nga çdo pretendim mbi atë.[2]

2. Bompiani A., *Le tecnologie di fecondazione assistita: una rassegna critica*, Vita e Pensiero, Milano, 2006

Problematikat që shtrohen për zgjidhje

Në nivel Global, Evropa ka numrin më të lartë të trajtimit të teknikave të riprodhimit të asistuar.[3] Sipas studimeve më të fundit mbi zbatimin e teknikave të riprodhimit të asistuar në Evropë, rezulton se shumica e vendeve parashikojnë një lloj mbështetje financiare nga ana e shtetit në trajtimin e teknikave të riprodhimit të asistuar. Vetëm gjysma e këtyre vendeve lejojnë zbatimin e praktikave nga gratë *single* dhe vetëm pak vende lejojnë aksesin në këto teknika të grave lesbike.[4]

Problematikat që parashtrohen për zgjidhje shtrihen në spektër të gjerë, që prekin jo vetëm çështje etike, por edhe teknikalitete nga pikëpamja e së drejtës civile. Kështu, për shembull:

- Mund të disponohet statusi familjar (nënë-bijë)? Cilat janë të drejtat e fëmijës në nivel personal dhe familjar?
- Ekziston e drejta për të pasur femijë? Ekziston detyrimi i shtetit për të ofruar këtë shërbim? Ekziston detyrimi i privatit për dorëzim?
- Ka shfrytëzim të femrës dhe shkelje të dinjitetit të gruas?
- Ekziston e drejta e anonimitetit e personit dhurues i materialit gjenetik?
- A cënohet familja "tradicionale"?
- Marrëdhëniet që lindin midis subjekteve të përfshira në proceset e riprodhimit mjekësor të asistuar dhe mëmësinë surrogative, mund të rregullohen edhe nëpërmjet autonomisë kontraktore? Në këtë rast, cili do të ishte objekti i kontratës (fëmijë, trupi i femrës, shërbimi)? Shkaku, a do të mund të cilësohej si i ligjshëm? A duhet të ketë shpërblim (marrëdhënie juridike pasurore apo jo pasurore)? Sipas një rryme doktrinare *po shfaqen forma të reja të pronësisë, të sofistikuara, sepse sot po posedohen qëniet njerëzore, ato po disponohen përpara se të lindin, nëpërmjet një shfrytëzimi të qënies njerëzore të pandeshur më parë.*[5]
- Si duhet përcaktuar atësia dhe sidomos amësia?

Argumente pro:

- Kontrata është e ekzekutueshme, sepse realizohet për interesin

3. Präg P., Mills M., *Assisted reproductive technology in Europe. Usage and regulation in the context of cross-border reproductive care*, in 'Family and Society Ëorking Paper' 43/2015, fq. 3
4. Po aty, fq. 18
5. Cardia C., *La famiglia e il diritto*, in Iustitia, 2014, pp. 279-280.

e fëmijës, dhe gruaja mund të tërhiqet nga detyrimi kontraktual deri në momentin e zënies, por jo më vonë.

- Nuk ka shfrytëzim, sepse femra vendos përpara shtatëzanisë të marë apo jo përsipër detyrimin.
- Pagesa nuk fyen dinjitetin e femrës, sepse paguhet disponibiliteti për inseminim, jo fëmija.
- Familja tradicionale nuk cënohet, sepse qëllimi mbetet gjithnjë krijimi i familjes.
- Nuk ka shfrytëzim nga grupe ekonomike (klinikat), sepse ofrohet një shërbim në funksion të dëshirës (së drejtës) për të patur pasardhës.
- Kjo veprimtari që lidhet me riprodhimin artificial duhet mbrojtur nga e drejta e privatësisë (neni 8 ECHR), si në rastin e së drejtës per abort.
- Personi apo çifti "porositës" ka të drejtë të përcaktojë sjelljet e subjektit të detyruar (nëna surrogate) gjatë shtatëzanise, duke përfshirë detyrimin për abort.

Argumente kundër:

- E drejta e privatësisë nuk përfshin të drejtën për të patur pasardhës.
- Ka kundërshtim midis praktikës mjekësore në fjalë dhe birësimit.
- Legjislacioni mbi abortin bie në kundërshtim me të drejtën për të patur fëmijë.
- Interesi i fëmijës është të ketë një figurë prindërore të vetme.
- *De facto* është një adoptim kundrejt pagesës, kështu që veprimi juridik mund të konsiderohet si i pavlefshëm.
- Fëmijët duhet të kenë vetëm një "*status filiationis*" (statusi i fëmijës); prindër natyralë; sidoqoft nuk mind t'i mohoet mundësia për t'i njohur apo identifikuar prindërit natyral.
- Shkelet dinjiteti i gruas, sepse mund të konsiderohet si formë e re prostitucioni (shitblerje e trupit).
- "Objekti" (subjekti) i paligjshëm (fëmija).
- Nga pikëpamja civilistike "*pacta sunt servanda*" (marrëveshjet duhen respektuar) bie në kundërshtim me "*pacta quae causam turpem habent non sunt servanda*" (marrëveshjet që kanë një shkak të turpshëm, nuk duhen respektuar).

• Kjo veprimtari mund të lidhet me veprën penale të braktisjes së të miturit.[6]

Praktika gjyqësore: vendime të Gj.E.D.Nj. dhe të vendeve të veçanta

Në nivel evropian, Traktati i Lisbonës ka shtruar për debat çështjen e impaktit të vendimeve të GjEDNj në legjislacionin mbi riprodhimin e asistuar në shtetet evropiane. Në mënyrë specifike, dy rrymat e mendimit mund sinitetizohen si më poshtë:[7]

a) *Interesi për t'iu nënshtruar riprodhimit të asistuar përbën një të drejtë sipas kuptimit të përcaktuar nga KEDNJ dhe, në këtë rast, të gjitha shtetet duhet ta njohin dhe ta mbrojnë (...);*

b) *Interesi për t'iu nënshtruar riprodhimit të asistuar nuk konsiderohet një e drejtë sipas*

KEDNJ. Por nëse njihet nga secili shtet, atëherë do të gjejë zbatim KEDNj.

Vlerësimi i Gjykatës së Strasburgut mbi këtë çështje është fokusuar në tre drejtime kryesore:[8]

1. Përcaktimi i momentit kur embrioni fiton dinjitetin e personit.
2. Vlerësimi në lidhje me legjitimimin e kufizimeve të vendosura nga ligjvënësi në lidhje me fekondimin heterolog.
3. Vlerësimi në lidhje me legjitimimin e kufizimeve të vendosura nga ligjvënësi në lidhje me diagnostikimin përpara implantimit, me qëllim parandalimin e sëmundjeve gjenetike.

Në çështjen *S.H. dhe të Tjerë kundër Austrisë,* Gj.E.D.Nj. konkludon, se: *kjo fushë ku ligji duket se evoluon vazhdimisht dhe është subjekt i një zhvillimi dinamik të shkencës dhe ligjit, duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit*

6. D'Agostino F., Palazzani L., *Bioetica. Nozioni fondamentali*, La Scuola, Brescia 2007, fq. 82-89
7. Catania E., L'impatto della CEDU nella legislazione sulla Procreazione Medicalmente Assistita negli Stati Europei, në Diritto& Diritti 2017, online file:///C:/Users/jlamce/Downloads/limpatto-della-cedu-nella-legislazione-sulla-procreazione-medicalmente-assistita-negli-stati-europei.pdf
8. Shih Lanzafame A., *La fecondazione medicalmente assistita tra bilanciamento di valori e consenso europeo*, në http://www.leggioggi.it/wp-content/uploads/2014/04/Lanzafame-La-fecondazione-medicalmente-assistita.pdf

nga shtetet kontraktuese.[9] Nëpërmjet këtij vendimi, Gjykata e Strasburgut vendosi t'u lejojë shteteve autonomi në përcaktimin e legjislacionit dhe politikës përkatëse në këktë fushë.

Gj.E.D.Nj. ka konstatuar gjithashtu se ligji italian nr. 40/2004,[10], i cili *ndalon një çift që është fertile (pjellor), por që janë bartës të një sëmundje gjenetike që të kenë akses në diagnostikimin përpara implantimit të embrioneve, është në kundërshtim me K.E.D.Nj.*[11] Po kështu, edhe Gjykata Kushtetuese italiane ka deklaruar antikushtetuetshmërinë e nenit 14/2, të ligjit 40/2004 që rregullon fekondimin e asistuar në pjesën që parashikon se, vetëm "*një implant unik dhe të përbashkët, por jo më shumë se tre*" embrione.[12] Nga ana tjetër, vendimi nr. 162/2014 i Gjykatës Kushtetuese italiane eliminon ndalimin që ndodhej në ligj ndaj fekondimit heterolog, ndërkohë që vendimi nr. 96/2015 i saj eliminon ndalimin në ligj për diagnostikimin embrional dhe pamundësinë e seleksionimit të embrioneve në rast sëmundje.

Në një tjetër, vendimi të Gj.E.D.Nj. datë 27 Qershor 2015 (çështja *Paradiso dhe Campanelli kundër Italisë*) vihet theksi në dy probleme serioze: a) në lidhje me statusin juridik të subjektit të lindur nëpërmjet

---

9. Vendimi i Gj.E.D.Nj. datë 3 nëntor 2011, Aplikimi nr. 57813/00. Shih Roagna I., *Mbrojtja e së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare sipas Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut*, në 'Doracakët për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës', Strasbourg 2012, fq. 50-51, në të cilin sqarohet se: *Gjykata i ka mirëpritur argumentet e interesit publik që Austria i ka marrë parasysh për vendimin rreth ndalimit të dhurimit të spermës apo vezëve për IVF, mbrojtjen e femrave, meqë dhurimi i vezëve mund të shpie në zhvillime problematike siç është shfrytëzimi dhe poshtërimi i femrave, në veçanti i atyre që gjinden në situata ekonomike të pafavorshme; ato që kanë të bëjnë me amësinë e ndarë, meqë IVF mund të shpije në krijimin e marrëdhënieve të pazakonta ku rrethanat sociale devijojnë nga ato biologjike, përkatësisht, ndarja e amësisë në një aspekt biologjik dhe në një aspekt të "mbajtjes së fëmijës" dhe ndoshta edhe një aspekt social; mirëqenia e fëmijëve dhe nevoja për parandalimin e riprodhimit selektiv*

10. Ligji nr. 40, datë 19 shkurt 2004, "Norma në fushën e riprodhimit mjeksor të asistuar". Gjykata Kushtetuese Italiane me vendimin nr. 151, datë 1 prill 2009 deklaroi të paligjshme një pjesë të rëndësishme të ligjit Italian 40/2008, në http://www.associazionelucacoscioni.it/campagna/fecondazione-assistita-0 . Po kështu edhe në vendimin nr. 162 datë 9 prill 2014 kjo Gjykatë u shpreh për paligjshmërinë e fekondimit heterolog, në http:// www.biodiritto.org/index.php/item/505-casonato-eterologa

11. Shih komentet në http:// www.ilfattoquotidiano.it/2013/02/11/procreazione-assistita-corte-di-strasburgo-boccia-ricorso-dellitalia/495952/ .

12. Shih vendimin nr. 151/2009 të Gjykatës Kushtetuese Italiane

mëmësisë surrogative; b) në parimin e interesit më të lartë të fëmijës.[13]

Në SHBA, vendime të rëndësishmë në këtë drejtim janë: *Baby M* (1988); *Johnson vs. Clavert* (1993) "*intended mother*"; *In re marriage of Buzzanca* (1998) "parent responsibility"; *Elisa B. vs. Emily B* (2005) "homosexual couple"; *A. and Sh. Raftopol* (2011) "new way to born".

Situata në Shqipëri

Në kuadrin e detyrimeve që rrjedhin jo vetëm nga KEDNj, por edhe nga Konventa e të Drejtave të Njeriut dhe Biomjekësisë, e njohur ndryshe edhe si Konventa e Oviedo-s (1997), qëllimi i së cilës ishte të përcaktonte instrumentat që do të garantonin një standard minimal mbrojtjeje në aplikimin e mjekësisë dhe biologjisë, Shqipëria ka ende shumë punë për të bërë. Në Shqipëri nuk kemi një legjislacion të mirëfilltë dhe gjithëpërfshiës mbi këto argumente.[14] Për riprodhimin artificial, Ligji nr. 8876 "Për shëndetin riprodhues", i miratuar në vitin 2002 (i ndryshuar) përbëhet nga vetëm 12 nene. Ai plotësohet pjesërisht nga Ligji nr.10454, datë 21.7.2011 "Për transplantimin e indeve, të qelizave dhe të organeve në Republikën e Shqipërisë", i cili parashikon shprehimisht te neni 3, se: *ky ligji gjen zbatim edhe për qelizat riprodhuese (vezët, sperma)"*. Nga teknikat riprodhuese të sipërpërmëndura rregullohen "*inseminimi artificial*" dhe "*fekondimi in vitro*". Neni 30 parashikon që: "*Riprodhimi mjekësor i asistuar ka për qëllim t'i përgjigjet kërkesës së një individi, ose të një çifti për të pasur fëmijë. Ai synon të trajtojë një, ose disa shfaqje mjekësore*

13. Perrini F., *La lunga vicenda relativa al caso Paradiso e Campanelli: la grande Camera assolve l'italia per avere disposto l'allontanamento del minore nato da un contratto di maternità surrogata*, 'Osservatorio l'Italia e la CEDU' n.1/2017, fq. 130

14. Sipas mjekëve ekspertë (Demaliaj E.,), *Ligji shqiptar për teknikat e riprodhimit është i paplotë dhe shpeshherë kjo lë hapësirë për abuzime (...) qendrat duhet të jenë të detyruara të raportojnë rastet. Diskutimi,nëse duhet të lejohet donacioni apo jo I materialit gjenetik si femeror apo mashkullor ,është një diskutim tjetër dhe në të duhet të përfshihen shumë grupe interesi. Përvec kësaj do të duhej, që terapia hormonale, që aplikohet për të arritur një shtatëzani nëpërmjet procedurave të prokreacionit të asistuar , të futet në skemën e rimbursimit, me qëllim uljen e kostove dhe për të ndihmuar sa më shumë çiftet e reja në realizmin e ëndërrës së tyre . (...) Mundësia për të arritur një shtatëzani nëpërmjet procedurës IVf mbetet në 30 % .Shumë i rëndësishëm është laboratori biologjik, cilësia e tij dhe profesionalizmi i ekipit të mjekëve që kryejnë këto metoda.* Shih artikullin me titull: *Fajin e ka mashkulli apo femra?* në http:// www.lgsh-group.org/infertiliteti-bashkeshortor-ne-shqiperi, parë në datë16.10.2016

të infertilitetit, që bëjnë që një çift të mos arrijë një shtatzëni në rrugë natyrore". Gjithashtu, fakti që flitet për një çift e lë ligjin pa përcaktimet e nevojshme, domethënë, a duhet të jetë çifti i martuar apo jo, a duhet të jetë ai heteroseksual? Në nenin 34 ku rregullohet inseminimi artificial sanksionohet që: "*Me insiminim artificial kuptohet përfitimi i semeneve nga donatori dhe injektimi i tyre te gruaja. Kjo kryhet kur: a) bashkëshorti i saj rezulton infertil; b) dhuruesi nuk është bashkëshorti i gruas*". Në këtë mënyrë, në vendin tonë është lejuar inseminimi heterolog, pra, kur babai gjenetik i fëmijës nuk është bashkeshorti i gruas, por një tjetër individ jashtë çiftit. Çfarë do të ndodhë nesër, nëse femijët do të kërkojnë babain e tyre biologjik? A ruhen këto të dhëna biologjike?[15] Legjislacioni shiptar mbi këtë çështje garanton ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave.[16] Përveç kësaj, vendimi Nr. 630 i Këshillit të Ministrave, datë 15.07.2015 parashikon mënyrën e funksionimit, përbërjen dhe organizimin e Komitetit Kombëtar të Etikës, duke e vendosur këtë Komitet nën varësinë e Ministrisë së Shëndetësisë, si autoritet përgjegjës kombëtar, rregullator për çështje të caktuara të bioetikës mjekësore dhe mbrojtjen e të drejtave, sigurinë dhe mirëqenien e personit gjatë studimit klinik, që lejohet të kryhet mbi të. Megjithatë, nëqoftë se ligji ka rregulluar *insiminimin artificial heterolog*, ai duhet të kishte rregulluar edhe *mëmësinë surrogative,* që kështu mbetet e lirë, sepse duke mos u ndaluar, ajo lejohet!

15. Për më gjerë, shih Lamçe J., & Çuni E., *The right of children to knoë their origin in adopting and medically assisted reproduction*, in 'Mediterranean Journal of Social Sciences' (MJSS), Vol. 4, No. 6, July 2013, Romë, fq.. 605-610.

16. Sipas nenit 33 të Ligjit nr.10454, datë 21.7.2011 "Për transplantimin e indeve, të qelizave dhe të organeve në Republikën e Shqipërisë" mbi ruajtjen e konfidencialitetit: *1. Strukturat shëndetësore, që kryejnë veprimtari në fushën e transplantit, duhet të sigurojnë ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave, në mënyrë që të mos identifikohen, si dhuruesi ashtu dhe përfituesi, sipas kërkesave të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë". 2. Për ruajtjen e konfidencialitetit, institucionet përkatëse duhet të marrin masat për: a) ruajtjen e sistemit të të dhënave, si dhe ruajtjen nga çdo shtesë, heqje apo modifikim i paautorizuar i të dhënave në dosjen e dhuruesit apo nga zhvendosja dhe transferimi i të dhënave; b) hartimin e procedurave për të zgjidhur mospërputhjen e të dhënave dhe nxjerrjen e paautorizuar të tyre për të garantuar gjurmimin e dhurimeve; c) të garantuar që identiteti i përfituesit të mos i bëhet i njohur dhuruesit apo familjes së tij/saj dhe anasjelltas kryesisht në rastin e dhurimit të qelizave riprodhuese; ç) garantimin e të dhënave të dhuruesve gjatë gjithë procesit të gjurmimit. 3. Përjashtim bëjnë rastet kur të dhënat bëhen të njohura me pëlqimin e dhuruesit, përfituesit ose një përfaqësuesi ligjor, por gjithnjë pa cenuar a nonimatin e palës tjetër*

Tjetër kritikë i përket faktit që në këto 12 nene nuk parashikohet asgjë për praktikën publicitare, e cila zhvillohet lirisht në vendin tonë, gjë që nuk lejohet në pjesën më të madhe të legjislacioneve evropiane. Gjithashtu, këto nene nuk hyjnë në detaje të rregullimit të kësaj praktike, duke u kufizuar në një rregullim të përgjithshëm, madje edhe pak kontradiktor. Nuk parashikohet asgjë për *numrin e embrioneve* që mund të krijohen me këto teknika dhe *si ruhen apo përdoren embrionet* që "ngelen" pasi gruaja mbetet shtatzënë.[17]

Pikë tjetër e debatuar në doktrinë janë format e kontrollit të ushtruara mbi këtë praktikë mjekësore dhe materialet gjenetike të përdorura, pasi mund të kemi në të ardhmen problematika të ndryshme, nga të cilat, më paradoksalet mund të jenë ato të një motre dhe një vëllai që takohen e krijojnë *lidhje (incest),* pa ditur që janë të tillë nga pikëpamja biologjike. Në Shqipëri ky rrezik shmanget nga parashikimi në nenin 3 i Ligjit nr.10454, datë 21.7.2011 "Për transplantimin e indeve, të qelizave dhe të organeve në Republikën e Shqipërisë", i cili parashikon shprehimisht se: "2. *Ky ligj zbatohet për të gjitha transplantimet që kryhen: (...) b) midis individëve që kanë lidhje gjaku (gjyshi, gjyshja, prindi, fëmija, tezja, daja, xhaxhai, halla, nipi, mbesa), me përjashtim të qelizave riprodhuese".*[18]

Sipas nenit 33 të Ligjit 8897/2002, të ndryshuar: "*Teknikat e riprodhimit përdoren vetëm në rastet kur: a) metoda të tjera të trajtimit kundër infertilitetit të burrit ose të gruas nuk janë produktive ose të përshtatshme dhe nuk garantojnë rezultatin e dëshiruar; b) parandalojnë transmetimin te fëmija të sëmundjeve gjenetike, si dhe të sëmundjeve të tjera që do të rezultonin në një vdekje të parakohshme, në prapambetje mendore të tij dhe invaliditet të rëndë; c) konsiderohen si një alternativë për lindje natyrore*". Me këtë nen i hapet rruga eugjenetikës. Por ka kontradikta midis këtij Ligji, Kodit të Familjes dhe Ligjit "Për ndërprerjen e shtatzënisë", i ndryshuar.

Teknikat e riprodhimit të asistuar aplikohen prej disa vitesh në spitalet private në Shqipëri (për shembull, prej pesë vitesh në spitalin

17. Neni 38 i këtij Ligji parashikon, se: "*Embrioni human ndalohet të përdoret për çfarëdolloj qëllimi tjetër komercial ose industrial dhe eksperimental*"

18. Kuptimi i qelizave riprodhuese përcaktohet në nenin 4, pika 13, të ligjit nr.10454, datë 21.7.2011 "Për transplantimin e indeve, të qelizave dhe të organeve në Republikën e Shqipërisë", sipas të cilit: ""*Qeliza riprodhuese" janë të gjitha indet dhe qelizat e synuara për t'u përdorur për qëllim të riprodhimit me teknika ndihmëse."*

Hygeia).[19]

Problem tjetër është edhe ai i regjistrimit të fëmijës së lindur në një vend që lejon mëmësinë surrogative në regjistratat e gjendjes civile të një vendi që e ndalon atë (*turizmi riprodhues*).

Duke iu referuar bazës ligjore dhe dokumenteve strategjike të Ministrisë së Shëndetësisë në Shqipëri deri në vitin 2015 rezultonte, se: *shërbimet shëndetesore publike të nivelit tretësor duhej të ofronin trajtim të specializuar për infertilitetin dhe Teknikat e Fekondimit in Vitro.*[20] Në Objektivin 4 të Dokumentit Strategjik "Për shëndetin riprodhues" 2009-2015 parashikohej që të përmirësohej dhe përforcohej zbatimi praktik i legjislacionit mbi infertilitetin, në mënyrë specifike:

- *Rishikimi dhe përforcimi i akteve ligjore për riprodhimin e asistuar në vend.*
- *Zhvillimi standardeve kombëtare për menaxhimin e infertilitetit, përfshirë teknologjitë e riprodhimit të asistuar.*
- *Vendosja e një sistemi kombëtar ndihme mjekësore për të asistuar çiftet infertile me nivel jo të mire social ekonomik, që ata të marrin trajtimin e duhur me një kosto të reduktuar.*[21]
- *Përcaktimi i udhëzimeve mbi çështjet kritike, ligjore dhe etike.*

Ndërkohë që Dokumenti Strategjik dhe Plani i Veprimit për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues 2017-2021, aktualisht evidenton problematikat kryesore në këtë fushë[22] dhe synon: *vendosjen e sistemit të mbledhjes së*

---

19. Shih artikullin me temë: Inferitiliteti dhe programi i fekondimit In Vitro, në https://www.pressreader.com/albania/living0970/20170301/285409171327764, datë 1 mars 2017.

20. Dokumenti Strategjik "Për shëndetin riprodhues" 2009-2015

21. Mbi arsyet e lënies pezull të Projektit për ofrimin e shërbimit të fekondimit in vitro pranë spitalit publik "Koço Glozheni ", shih artikullin e Canameti D., me temë në: https://shendeti.com.al/deshtimi-i-projektit-in-vitro-prej-tre-vjetesh-projekti-qendron-pezull/ , datë 17 janar 2017

22. *Mosnjohja e terapive të fundit apo teknikave të riprodhimit të asistuar bashkëshortor nga ana e personelit mjekësor. Sistemi i referimit lidhur me trajtimin e infertilitetit nuk është evidentuar qartë. Mungon një database i rasteve me infertilitet bashkëshortor primar apo sekondar, që bën që rastet të mos raportohen dhe terapia e marrë të mos evidentohet. Nuk evidentohen rastet që i janë nënshtruar teknikave të riprodhimit të asistuar. Mungojnë vlerësime, studime mbi pengesat në aksesimin e kujdesit dhe trajtimeve të infertilitetit, si dhe raportimi i komplikacioneve të hasura në këtë rrugë. Të gjitha qendrat e trajtimit të infertilitetit nuk janë të certifikuara sipas standardeve ndërkombëtare, gjë që sjell pasiguri për cilësinë e trajtimit të çifteve në këto qendra, si dhe mungesë kontrolli të*

të dhënave mbi regjistrimin dhe raportimin e shkaqeve të infertilitetit si dhe ofrimin e trajtimit të specializuar për infertilitetin dhe teknikave të riprodhimit të asistuar në shërbimet shëndetësore publike të nivelit terciar.[23] Objektivi specifik 3 i tij synon: *Përmirësimin dhe zbatimin e legjislacionit mbi shëndetin riprodhues lidhur me çështjet e infertilititetit, nëpërmjet:*

1. Zhvillimit të rregulloreve dhe standardeve kombëtare për menaxhimin e infertilitetit, përfshirë teknologjitë e riprodhimit të asistuar.

2. Pakësimin e pabarazive në akses për trajtim të sigurt dhe efektiv të infertilitetit. Rishkimin e kostos për trajtimin e çifteve infertile me probleme social-ekonomike.

3. Përcaktimin e udhëzimeve, rregulloreve, mbi çështjet kritike, ligjore dhe etike që lidhen me cilësinë e kujdesit në shërbimet publike dhe private, që ofrojnë teknologjitë e riprodhimit të asistuar.

Problemet që lidhen me *birësimin surrogativ*

Birësimi surrogativ nënkupton mundësinë e birësimit të një të mituri të lindur nëpërmjet teknikave të riprodhimit të asistuar. Neni 261 i K.F. shqiptar parashikon, se: *Për birësimin surrogativ, të parashikuar në ligjin nr.8876, datë 4.4.2002 ""Për shëndetin riprodhues" të ndryshuar, zbatohen të njëjtat kritere dhe procedura për birësimin, sipas këtij Kodi dhe legjislacionit përkatës"".* Për sa kohë që Kodi i Familjes parashikon dy mundësi të birësimit të të miturve - atë për fëmijët e braktisur dhe atë për fëmijët që jepet pëlqimi nga prindërit biologjikë (çka realizohet në çdo rast vetëm nëpërmjet një vendimi gjyqësor), atëherë rruga ligjore për ta birësuar një fëmijë të lindur nëpërmjet këtyre teknikave do të ishte

---

aftësive dhe performancës së tyre. Nuk ka protokolle të unifikuara për të gjitha klinikat për trajtimin konservativ të infertilitetit bashkëshortor, si dhe nuk ka kritere të qarta për rastet e çifteve që u duhen nënshtruar teknikave të riprodhimit të asistuar. Çertifikimi i laboratorëve, kryerja e plotë e të gjitha ekzaminimeve laboratorike hormonale apo gjenetike, si dhe monitorimi i cilësisë së punës së tyre nuk bëhet në të gjithë vendin. Mungon një qendër terciare publike për infertilitetin bashkëshortor që kryen mjekim konservativ, apo trajtim me metodat e riprodhimit të asistuar. Ka mangësi në ligjshmërinë tonë për shëndetin seksual dhe riprodhues, teknikat e riprodhimit të asistuar, etj. Nevojitet rishikimi i legjislacionit tonë dhe ballafaqimi me legjislacionin europian

23. Ministria e Shëndetësisë, Dokumenti Strategjik dhe Plani i Veprimit për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues 2017-2021, miratuar me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë Nr.529, datë 1.12.2016, fq. 79

ajo e pëlqimit të prindërve biologjikë. Por, si do të regjistrohet fëmija në momentin e lindjes? Cila është baza ligjore që do të shërbejë për këtë qëllim? A e parashikon Ligji shqiptar "Për gjendjen Cvile" një situatë të tillë? Si do të balancohen interesat e ruajtjes së privatësisë dhe fshehjes së identitetit të prindërve biologjikë nga njëra anë, dhe ai i fëmijës (tashmë madhor) për të njohur origjinën nga ana tjetër?[24]

Problemet ligjore që lindin nga teknikat e riprodhimit të asistuar lidhen pikërisht me mangësitë në legjislacion për zbatimin e këtyre teknikave.[25] Sipas nenit 43 të Ligjit nr. 8876, datë 04.04.2002 "Për Shëndetin Riprodhues", i ndryshuar: *Ministri i Shëndetësisë detyrohet që të nxjerrë akte të veçanta për të përcaktuar specifikimet lidhur me: a) inseminimin artificial; b) teknikat e riprodhimit të asistuar; c) adoptimin surrogativ*, të cilat ende nuk i japin zgjidhje problematikës.

Sipas një studimi të vitit 2009 në Shqipëri, *çështjet etike si manipulimi spermes, vezëve dhe embrionit, adoptimit surrogativ duhen rishikuar nëpërmjet mekanizmave efektiv rregullues.*[26]

Pretendimet e LGBT. Në ligjin "Për shëndetin riprodhues" nuk ka një dispozitë ligjore që garanton të drejtën e çifteve me të njëjtën gjini të kenë fëmijë nëpërmjet teknikave të riprodhimit mjekësor të asistuar. Sipas përfaqësueses së Aleancës kundër diskriminimit LGBT, në nenin 17 të këtij ligji thuhet, se: *"Çdo individ ka të drejtën të mbrojë aftësitë e tij riprodhuese, duke u ankuar kundër veprimeve, vendimeve, dëmeve të*

---

24. *The right of children to knoë their origin in adopting and medically assisted reproduction*, 'Mediterranean Journal of Social Sciences' (MJSS), Vol. 4, No. 6, July 2013, Romë, Italy, fq.. 605-610

25. Juristi Çumani I., Drejtor i Institutit Kombëtar të Integrimit të Jetimë) shprehet gjithashtu, se: *Nga pikëpamja ligjore nuk ekziston asnjë mundësi që një fëmijë i lindur nga një nënë, të bëhet më pas fëmijë i dy prndërve të tjerë, përveçse me procedurrën e birësimit.* Ai thekson se ekziston rreziku që të shkelen të drejtat e fëmijëve pasi "fëmija trajtohet si plaçkë". Shih artikullin me temë: *Dua të bëhem nënë po më duhet një zëvendësuese* në http:// www.shekulli.com.al/p.php?id=207183, parë në datë 15.08.2016

26. Analizë e situatës në sektorin e shëndetit riprodhues, në http://www.shendetesia.gov.al/files/userfiles/Baza_Ligjore/Dokumenta_strategjike/ANALIZA_SITUATES_E_RIPUNUAR_mars_09.pdf . Sipas këtij studimi, *teknikat e fekondimit të asistuar ofrohen në sektorin privat nga disa klinika, por ato luhaten në cilësi dhe kosto. Përqindja e infertilitetit në këto shërbime është e paqartë, sepse ato nuk kanë asnjë detyrim ligjor për të raportuar. Këto shërbime nuk kontrollohen rregullisht për cilësinë e ofruar, dhe monitorimi dhe rregullimi i papërshtatshëm ligjor i këtyre shërbimeve mund të çojë në keqpërdorimin e këtyre teknologjive.*

të tretëve, kur cënohen të drejtat që lidhen me shëndetin riprodhues", ka nevojë për interpretime të mëtejshme lidhur me ndërhyrjet mjekësore që përfshijnë personat interseks.[27]

Konsiderata konkluzive të rregullimit normativ të teknikave të riprodhimit të asistuar në Shqipëri

Nga sa më sipër, si edhe duke iu referuar parashikimeve të Strategjisë së Këshillit të Evropës 2016-2021, sipas së cilës: *duhet të ndërmerren masa në interesin më të lartë të fëmijës në kontekstin e formave të reja të familjes dhe bioetikës, veçanërisht përsa i përket surrogacisë dhe riprodhimit njerëzor me ndihmën e dhuruesve, vëmendje e veçantë i duhet kushtuar procesit të vlerësimit të interest më të lartë të fëmijës, duke analizuar se si vendet anëtare kanë krijuar ligjet, rregulloret dhe procedurat, të cilat garantojnë se interesi më i lartë i fëmijës është konsideratë parësore në vendimet që lidhen me heqjen/humbjen e përgjegjësisë prindërore, lënien e fëmijës për rritje dhe edukim si dhe ribashkimin familjar.*[28]

Përsa i përket Ligjit 8876/2002, të ndryshuar, problemet në interpretimin e tij janë të shumta. Kështu, për shembull:

1. Lidhur me debatin nëse aksesi në këto teknika në Shqipëri lejohet si për çiftet e martuara apo edhe për ato që bashkëjetojnë.Sipas një raporti të Shoqatës Amerikane për Mjekësinë Riprodhuese të vitit 2010, sipas legjislacionit shqiptar, martesa përbën *condition sine qua non* për zbatimin e teknikave të riprodhimit të asistuar.[29]

2. Lidhur me nevojën për plotësim të kuadrit normativ në fushë, jemi të mendimit se marrëdhëniet që lindin nga zbatimi i teknikave të riprodhimit të asistuar, pikërisht për kompleksitetin etiko-ligjor që mbartin, duhen rregulluar me një ligj të posaçëm. (i tillë është psh. rregulli i pranuar në të gjitha vendet evropiane sipas të cilit bashkëshorti i cili jep pëlqimin për zbatimin e teknikave të riprodhimit të asistuar nuk mund të përdorë më pas institutin e kundërshtimit të atësisë; i njëjti parashikim duhet të vlejë edhe për gruan).

---

27. *Raporti "Hije". Fusha e kujdesit shëndetësor – Rasti i Shqipërisë*, QSHPZH Tiranë, 2016, fq. 50-51.
28. Council of Europe Strategy for the Rights of the Child (2016-2021), Council of Europe, March 2016, p. 19.
29. Shih International Federation of Fertility Societies. Surveillance 2010, fq. 26

3. Lidhur me birësimin surrogativ, procedura e përcaktimit të amësisë dhe atësisë së fëmijës duhet të kalojë nëpërmjet një vendimi gjyqësor, ashtu sikundër veprohet edhe për birësimin e të miturit (me pëlqim të prindërve biologjikë). Në këtë sens shprehet edhe neni 261 i K.F., sipas të cilit, edhe për birësimin surrogativ (…) zbatohen të njëjtat kritere dhe procedura për birësimin, sipas këtij Kodi dhe legjislacionit përkatës.

4. Në lidhje me problematikën se si do të përcaktohet përkatësia dhe ushtrimi i përgjegjësisë prindërore, kriteri i vlerësimit duhet të jetë ai i pranuar nga nga të gjitha vendet evropiane, pra "*qëllimi për të qënë prind*".

5. Lidhur me pyetjen nëse *kontrata e surrogacisë* cënon të drejtat themelore të njeriut, jemi të mendimit se ato cënohen, pasi statusi i fëmijës nuk mund të negociohet me një kontratë mes privatësh.

6. Edhe pse qëllimi i ligjit është t'u vijë në ndihmë personave/çifteve që nuk mund të kenë fëmijë në rrugë natyrore, *interesi më i lartë i fëmijës* është parimi udhërrëfyes në hartimin e një kuadri normativ të plotë në lidhje me realizimin e të gjithë procedurave teknike si dhe rregullimin e raportit të përgjegjësisë prindërore.

7. Objektivi 4 i *Planit të veprimit për infertilitetin për periudhën 2010-2015, i cili duhet të ishte përmbushur brenda vitit 2015 - të përmirësohet dhe përforcohet zbatimi praktik i legjislacionit mbi infertilitetin* - nuk ka gjetur ende zbatim! Prandaj rekomandohet ndërmarrja e masave për plotësimin e objektivave strategjikë të synuar prej kohësh.

Literatura:

Alkte normative

- *Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut*
- Konventa e të Drejtave të Njeriut dhe Biomjekësisë (Komvemnta e Oviedos), 1997
- Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë
- Ligji nr. 40, datë 19 Shkurt 2004 "Norma në fushën e riprodhimit mjekor të riprodhuar"
- Ligji nr. 10454, datë 21.07. 2011 "Për transplantimin e indeve, të qelizave dhe organeve në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji nr. 8876, datë 04.04.2002 "Për shëndetin riprodhues"

- Vendimi nr. 630, datë 15.07.2015 i Këshillit të Ministrave të R.Sh.

Doktrinë

- Jonas, H., *The Imperative of Responsibility: In Search of an Ethics for the Technological Age*, Chicago Univ. Press., 1985

- Bompiani A., *Le tecnologie di fecondazione assistita: una rassegna critica*, Vita e Pensiero, Milano, 2006

- Präg P., Mills M., *Assisted reproductive technology in Europe. Usage and regulation in the context of cross-border reproductive care*, in 'Family and Society Ëorking Paper' 43/2015

- Cardia C., *La famiglia e il diritto*, në 'Iustitia', 2014

- D'Agostino F., Palazzani L., *Bioetica. Nozioni fondamentali*, La Scuola, Brescia 2007

- Catania E., L'impatto della CEDU nella legislazione sulla Procreazione Medicalmente Assistita negli Stati Europei, në 'Diritto&Diritti' 2017, online file:///C:/Users/jlamce/Downloads/limpatto-della-cedu-nella-legislazione-sulla-procreazione-medicalmente-assistita-negli-stati-europei.pdf

- Lanzafame A., *La fecondazione medicalmente assistita tra bilanciamento di valori e consenso europeo*, në http://www.leggioggi.it/wp-content/uploads/2014/04/Lanzafame-La-fecondazione-medicalmente-assistita.pdf

- Doracakët e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut

- Perrini F., *La lunga vicenda relativa al caso Paradiso e Campanelli: la grande Camera assolve l'italia per avere disposto l'allontanamento del minore nato da un contratto di maternità surrogata*, 'Osservatorio l'Italia e la CEDU' n.1/2017

- Lamçe J., & Çuni E., *The right of children to knoë their origin in adopting and medically assisted reproduction*, in 'Mediterranean Journal of Social Sciences' (MJSS), Vol. 4, No. 6, July 2013, Romë

- *Inferitiliteti dhe programi i fekondimit In Vitro*, në https:// www.pressreader.com/albania/living0970/20170301/285409171327764, datë 1 mars 2017.

- Dokumenti Strategjik "Për shëndetin riprodhues" 2009-2015

- Canameti D., me temë në: https://shendeti.com.al/deshtimi-i-projektit-in-vitro-prej-tre-vjetesh-projekti-qendron-pezull/ , datë 17 janar 2017

- Dokumenti Strategjik dhe Plani i Veprimit për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues 2017-2021, miratuar me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë Nr.529, datë 1.12.2016

- *The right of children to knoë their origin in adopting and medically assisted reproduction*, 'Mediterranean Journal of Social Sciences' (MJSS), Vol. 4, No. 6, July 2013, Romë, Italy

- Çumani I., *Dua të bëhem nënë, por më duhet një zëvendësuese* në http:// www.shekulli.com.al/p.php?id=207183, parë më 15.08.2016

- *Raporti "Hije". Fusha e kujdesit shëndetësor – Rasti i Shqipërisë*, QSHPZH, Tiranë 2016

- Council of Europe Strategy for the Rights of the Child (2016-2021), Council of Europe, March 2016

- *International Federation of Fertility Societies*, Surveillance 2010

Jurisprudencë

- Vendimi i GjEDNj, datë 3 Nëntor 2011, Aplikimi nr. 5781300

- Vendimer e GjEDNj për çështjet *Paradiso dhe Campanelli vs. Italisë*; *S.H. dhe të Tjerë vs. Ausrtrisë*

- Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Italisë me nr. 151, datë 1 Prill 2009 dhe nr. 162, datë 9 Prill 2014

- Vendime të Gjykatave në ShBA për çështjet: *Boby M.* (1998); *Johnson vs. Clavert* (1993); Elisa B. vs. Wmily B. (2005); *A. and Sh. Raftopol* (2011)

POHIMI DHE HESHTJA SI MJET PROVE NË GJYKIM

Ina HOXHAJ[1]
Gjyqtare pranë Gjykatës
së Rrethit Gjyqësor,
Pogradec

Hyrje

Qëllimi i këtij punimi është të trajtojë disa çështje që lidhen me një mjet të provës në procesin gjyqësor civil, pohimin gjyqësor. Përgjatë rradhëve të mëposhtëme do të trajtohet pohimi gjyqësor dhe vlera provuese e tij në procesin gjyqësor civil; parimi i moskontestimit (*ficta confesio*), kuptimi dhe vlera provuese e moskontestimit në mënyrë të shprehur të fakteve nga palët, ose e thënë ndryshe, vlera provuese e heshtjes së palëve në proces; do të analizohet se cilat janë subjektet e legjitimuara për të bërë pohim gjyqësor; do të trajtohet çështja nëse mund të revokohet pohimi gjyqësor; faza procedurale deri kur mund të bëhet pohimi gjyqësor si dhe deri kur mund të realizohet heqja dorë nga pohimi gjyqësor; po ashtu do të trajtohet çështja e pohimit gjyqësor të personit juridik dhe të përfaqësuesit të palës; do të trajtohet natyra juridike e pohimit si akt vullneti për disponimin e së drejtës, nëse mund të bëhet pohim gjyqësor për të drejtat të cilat nuk mund të disponohen apo nga të cilat për shkak të ligjit apo natyrës juridike të tyre nuk mund të hiqet dorë etj..

Nëpërmjet këtij punimi kam vlerësuar të rëndësishme të trajtoj nga pikëpamja shkencore çështje dhe problematika në lidhje me këtë mjet të provës, të cilat i kam konstatuar në praktikën gjyqësore, qoftë në punën

1. Aktualisht dhe përkohësisht e komanduar si Ndihmësmagjistrate pranë Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë

e përditshme të gjyqtarit, apo qoftë edhe në punën si ndihmësmagjistrat pranë Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Nga ana tjetër, në vëmëndje të lexuesit sjell se Kodi i Procedurës Civile (në vijim KPC) ka mangësi në rregullimin e pohimit gjyqësor. Aktualisht, edhe me ndryshimet e KPC me Ligjin nr. 38/2017 "*Për Disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin Nr. 8116, Datë 29.3.1996, "Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar", ka vetëm 9 dispozita që rregullojnë pohimin gjyqësor dhe jashtëgjyqësor, konkretisht nenet 186, 214, 267/2, 281, 282, 283, 284, 285 dhe 465 të KPC, të cilat përcaktojnë vlerën provuese të pohimit gjyqësor, mënyrën dhe procedurën se si artikulohet pohimi gjyqësor dhe fazën se deri kur mund të bëhet pohimi gjyqësor dhe jashtëgjyqësor. Ndërkohë që ka shumë çështje të tjera të lartpërmendura, që lidhen me pohimin gjyqësor, të cilat kërkojnë përgjigje dhe zgjidhje ligjore.

Në aspektin metodologjik është përdorur vështrimi historik, po ashtu analiza dhe vështrimi krahasues me modelet ligjore të Republikës së Francës dhe Republikës së Italisë, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e KPC në fuqi dhe e ndryshimeve të fundit me Ligjin nr. 38/2017 në lidhje me pohimin gjyqësor.

Pohimi si mjet prove dhe kuptimi i tij

KPC në nenin 214 ka parashikuar, se: "*Pohimet e bëra në gjykatë prej palëve apo prej përfaqësuesve të tyre, çmohen nga gjykata pa nënvleftësuar provat e tjera dhe rrethanat e çështjes*". Nisur nga kjo dispozitë, mund të thuhet se ligji procedural nuk jep një përkufizim se çfarë është pohimi gjyqësor, por thjesht e rendit atë si një nga mjetet e provës në procesin civil. Megjithatë ligji procedural civil, përtej përcaktimit të përgjithshëm të nenit 309 të KPC, parashikon edhe në këtë normë *lex specialis* statusin e kësaj prove. Duke qenë se ligji parashikon që pohimi gjyqësor vlerësohet nga gjykata pa nënvleftësuar provat e tjera dhe rrethanat e çështjes, konkludohet se ligji procedural civil e rendit pohimin gjyqësor apo jashtëgjyqësor në provat e zakonshme, që do të thotë se pohimi nuk ka vlerë të paracaktuar, porse vlera e pohimit përcaktohet dhe i nënshtrohet vlerësimit të lirë të gjykatës.

Në doktrinën juridike, pohimi në procesin gjyqësor civil është përkufizuar si deklarata me anë të të cilës pala pranon si të vërteta faktet që janë të disfavorshme për të dhe të favorshme për palën tjetër. Objekt i

pohimit janë faktet juridike, ato që në thelb përbëjnë *thema probandum* gjatë shqyrtimit gjyqësor, të cilat themelojnë objektin e mosmarrëveshjes në kuptim të nenit 5 të KPC, të kontestueshme dhe relevante për zgjidhjen e çështjes.[2] Nuk mund të përbëjnë objekt pohimi gjyqësor: opinionet, gjykimet, vlerësimet[3] dhe as kualifikimet juridike.[4] Vlerësimet juridike janë në pushtetin ekskluziv të gjykatës, sipas parimit se gjykata e di dhe e njeh ligjin (*iura novit curia*), të sanksionuar në nenin 16 të KPC apo në nenin 17 të Ligjit Nr. 49/2012 për gjykimin administrativ.

Pohimet (nga doktrina dhe nga ligji, pas ndryshimeve në KPC të vitit 2017) ndahen në pohime jashtëgjyqësore dhe në pohime gjyqësore. Kjo ndarje merr si kriter faktin se ku formësohet apo ku është formësuar pohimi gjyqësor. Pohimet jashtëgjyqësore formësohen jashtë procesit gjyqësor dhe mund të bëhen në mënyrë verbale apo mund të fiksohen në shkresa. Barrën e provës për pohimin jashtëgjyqësor, e ka pala në dobi të së cilës ai është bërë,[5] sipas parimit të sanksionuar në nenin 12 të KPC, se pala që pretendon një të drejtë ka detyrimin që në përputhje me ligjin të provojë faktet mbi të cilat bazon pretendimet e tij. Në varësi të burimit apo mënyrës se si artikulohet pohimi jashtëgjyqësor, ai mund të provohet në proces nëpërmjet mjeteve të tjera provuese të parashikuara nga KPC si: shkresat, dëshmia indirekte (*de relato ex parte actoris)*[6] etj. Sakaq, në lidhje me të do të zbatohen rregullat për pranueshmërinë dhe formimin e mjetit provues, ku pohimi është fiksuar. Pohimi jashtëgjyqësor merr vlerë relative provuese dhe gjykata e vlerëson lirisht një pohim të tillë duke e bashkuar në tërësinë e të gjitha provave dhe rrethanave të tjera të çështjes.

Ndërsa pohimi gjyqësor formohet para gjykatës. Pohimi gjyqësor mund të jetë i rastit ose i nxitur. Pohim i nxitur është ai që bëhet nëpërmjet pyetjeve të bëra në mënyrë zyrtare nga gjykata për një qëllim të tillë (neni 281 i KPC). Është i rastit pohimi që del përgjatë shpjegimeve të palëve

2. Vendim nr. 19165, dt. 29 shtator 2005, i Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë

3. Vendim nr. 16260, dt. 3 gusht 2005; Vendim nr. 11266, dt. 30 korrik 2002 të Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë

4. Vendim nr. 11881, dt. 6 gusht 2003, i Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë

5. Alessandro Simoni, Sokol Sadushi, Sokol Çomo, *Vështrim i krahasuar mbi procedure civile*, Shkolla e Magjistraturës, Tiranë 2006, faqe 254

6. Dëshmia indirekte, de relato *ex parte actoris* lidhet me informacione apo të dhëna, për të cilat dëshmitari ka marrë dijeni prej njërës palë të procesit

në seancë përgatitore apo gjyqësore, nëpërmjet veprimeve dhe akteve procedurale të kryera prej palëve gjatë procesit (nenet 182 dhe 282 të KPC). Pohimi gjyqësor i nxitur del gjatë pyetjes të organizuar qëllimisht për të nxjerrë pohimin nën një procedurë formale solemne gjyqësore (neni 283 i KPC).

Në çdo rast, pohimi gjyqësor formal duhet të jetë një deklaratë e shprehur (*eksplicite*) dhe univoke, të cilën pala deklaruese e bën në mënyrë verbale, ose në çdo akt procedural të nënshkruar prej saj (neni 282 i KPC). Asnjëherë pohimi eksplicit nuk mund të deduktohet nga veprimet konkludente të palëve apo të dalë në mënyrë të nënkuptuar nga deklaratat e palëve. Në një situatë të tillë, këto të fundit (veprimet konkludente apo deklaratat implicite) do të konsiderohen si indicie dhe të vlerësohen dhe çmohen lirisht nga gjykata.[7]

Instrumenti nëpërmjet të cilit nxitet zyrtarisht pohimi është ndërpyetja e palëve. Ky është një instrument shumë i rëndësishëm për procedimin provues, pasi palët janë burimi kryesor i informacionit rreth fakteve objekt kontesti. Ato zakonisht dinë më së miri gjendjen faktike me anë të së cilës mbështesin pretendimet e tyre.[8] Në këtë kuptim, palët janë i vetmi burim që mund të japë informacione më të sakta rreth çështjes në aspektin cilësor dhe sasior. Për këtë qëllim gjykata merr vendim të ndërmjetëm ku cakton pyetjet që do i drejtohen palëve, mënyrën dhe afatet e realizimit të saj (neni 283/2 i KPC). Pyetjet realizohen nga pala tjetër dhe bëhen për fakte ose rrethana në mënyrë që të pohohen apo kundërshtohen pretendimet e palëve (neni 283/1 i KPC). Nuk mund të bëhen pyetje mbi fakte të ndryshme nga ato të formuluara në vendimin e gjykatës, përveç kur palët bien dakord dhe gjykata çmon se ato janë të dobishme për procesin gjyqësor.[9]

Pohimi gjyqësor formal në përmbajtje të tij përbëhet nga dy elementë me natyrë objektive dhe subjektive. *Elementi objektiv* nënkupton se deklarata që bën pala, duhet t'i referohet faktit të disfavorshëm, i cili është relevant për zgjidhjen e çështjes dhe ndikon pjesërisht ose tërësisht në një zgjidhje të disfavorshme të çështjes për palën që e pohon. Ndërsa *elementi subjektiv*

7. Vendim nr. 6301, dt. 26 Maj 1992, i Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë

8. Faik Brestovci, *E drejta procedurale civile*, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë 2006, faqe 269

9. Ina Hoxhaj, *Roli i gjykatës në procesin e të provuarit gjatë gjykimit në shkallë të parë*, Shkolla e Magjistraturës, Viti 2014, faqe 112-113

nënkupton se deklarata duhet të jetë shprehje e vullnetit të plotë të palës, e cila pranon dhe njeh vërtetësinë e faktit të disfavorshëm (*animus confitendi).* Elementi *animus* nuk kërkon domosdoshmërisht që pala që pranon faktin e disfavorshëm të jetë e ndërgjegjshme, për pasojat juridike procedurale që do të sjellë pohimi në procesin e të provuarit. Pra, nuk është e nevojshme që pohimi të jetë bërë me qëllimin për të avantazhuar palën tjetër në proces.[10] Efektet e pohimit rrjedhin *ex legge* dhe mjafton që pala deklaruese të ketë pasur qëllimin dhe vullnetin për të njohur vërtetësinë e faktit, objektivisht të disfavorshëm për të.[11]

Vlera provuese e pohimit gjyqësor në gjykimin civil

Duke iu kthyer edhe një herë parashikimit ligjor të nenit 214 të KPC, mund të thuhet se pohimi gjyqësor formal dhe joformal, i nxitur apo i rastit, gjyqësor apo jashtëgjyqësor, përbën një mjet prove që i nënshtrohet vlerërimit të lirë nga gjykata sipas parimit të përgjithshëm se asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar, sikurse edhe as që mund të përjashtohet *a priori* nga arsyetimi i vendimit të gjykatës.[12] Në bazë të këtij parimi, gjykata formon bindjen e saj të brendshme mbi të vërtetën në lidhje me një çështje gjyqësore, pas vlerësimit të të gjitha provave në tërësinë e tyre (nenet 29/2 dhe 309/2 të KPC[13]).

Përjashtimisht, nuk i nënshtrohen vlerësimit të lirë të gjykatës provat

10. Vendim nr. 16127, dt. 15 nëntor 2002; Vendim nr. 1723, dt. 5 mars 1990, i Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë

11. Vendim nr. 8923, dt. 11 tetor 1996, i Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë

12. Vendim nr. 34, dt. 19 Shkurt 2009, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

13. Në fakt neni 309 i Kodit të Procedurës Civile, sikurse dispozita homologe në Kodin e Procedurës Civile të Republikës Federale të Gjermanisë ka një problem në mënyrën se si rregullon procesin e vlerësimit të provave nga ana e gjykatës. Kësaj norme i mungon një togfjalësh "*përveç rastit kur ligji parashikon ndryshe.*", megjithëse nuk është vënë re as nga praktika gjyqësore dhe as nga doktrina e së drejtës së procedurës civile. Neni 309 i Kodit të Procedurës Civile rregullon vetëm vlerësimin nga ana e gjykatës së provave të zakonshme dhe nuk rregullon mënyrën se si gjykata vlerëson provat ligjore, pikërisht ato të cilat nuk i nënshtrohen vlerësimit të lirë të gjykatës, por vlera provuese e tyre është paracaktuar nga ligji. Shiko mënyrën se si është formuluar neni 116 i Kodit të Procedurës Civile i Republikës së Italisë. Ky ndryshim sigurisht që do të plotësonte nenin 309 të Kodit të Procedurës Civile dhe do të dallonte qartë vlerësimin e provës ligjore dhe të zakonshme nga ana e gjykatës

ligjore (me fuqi të plotë provuese) dhe gjykata është e detyruar ta konsiderojë si të provuar faktin e kontestuar, në qoftë se për të flasin lloje të caktuara të mjeteve provuese.[14] Vlerën provuese të provës në këtë rast e paracakton ligji (*in abstracto*) dhe gjykata nuk ka liri vlerësimi të saj, por e merr si të mirqënë faktin e pasqyruar në të. Sakaq, mund të thuhet se, prova legale, me fuqi të plotë provuese, e çliron palën e detyrurar me barrën e provës, në paraqitjen e provave të tjera për vërtetimin e fakteve të vëna në themel të pretendimit apo prapsimit të saj.

Në doktrinën juridike shqiptare, është pranuar se nuk nevojitet prova për faktet e pranuara njëzëri nga të dyja palët ose të parashtruara nga një palë, por të pranuara nga pala tjetër.[15] Ndërkohë që KPC nuk e parashikon në mënyrë të shprehur, si parim të përgjithshëm, përjashtimin nga barra e provës së fakteve që nuk kundërshtohen, ose siç njihen në doktrinën italiane[16] ***faktet paqësore***. Madje, sikurse u theksua më sipër, neni 214 i KPC duket se i jep vlerë relative provuese dhe jo fuqi të plotë provuese pohimit gjyqësor.

Çështja e parë që natyrshëm shtrohet për diskutim, është se si duhet t'a vlerësojë gjykata pohimin gjyqësor në procesin e të provuarit, si provë me vlerë relative apo si çlirim nga barra e provës, me të njëjtën vlerë si prova me fuqi të plotë provuese.

Në një vështrim krahasues me modelet ligjore që kanë shërbyer si bazë për hartimin e KPC të Republikës së Shqipërisë në fuqi, mund të thuhet që pohimi gjyqësor ka vlerën e provës me fuqi të plotë provuese. Kështu, neni 1356/2 i Kodit Civil të Republikës së Francës ka parashikuar, se: "*Pohimi gjyqësor përbën provë të plotë kundrejt atij që e ka bërë*". Ndërsa neni 2733 i Kodit Civil të Republikës së Italisë ka parashikuar, se: "*Pohimi gjyqësor përbën provë të plotë kundrejt atij që e ka bërë, nëse nuk lidhet me të drejta që nuk mund të disponohen*". Njëlloj e rregullonte vlerën provuese të pohimit gjyqësor edhe Kodi Civil i vitit 1929 i Mbretnisë së Shqipërisë, i cili kishte zgjedhur të merrte si model pikërisht ligjet civile të këtyre vendeve. Të tre këto kode civile për nga pikëpamja e teknikës legjislative rregullonin aspektin material të së drejtës së provave, ndrësa aspekti procedural i tyre rregullohej nga ligji procedural civil.

---

14. Faik Brestovci, *E drejta Procedurale Civile I*, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë 2006, faqe 248
15. Alban Brati, *Procedura Civile*, Botimet 'Dudaj', Tiranë 2008, fq. 279
16. Salvo Leuzzi, *I mezzi di prova nel processo civile. Formazione, acquisizione, integrazione.*, 'Giuffre' Editore, Milano 2013, faqe 78

Po ashtu, nëse i referohemi Ligjit Kosovar për Procedurat Kontestimore (në vijim LPK, simotra e KPC), në nenin 321.2 të tij parashikohet, se: "*Nuk ka nevojë të provohen faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor*". Pra, edhe L.P.K në mënyrë eksplicite ka përjashtuar nga barra e provës palën mbi të cilën ka detyrimin të provojë faktet të cilat pala kundërshtare i ka pohuar gjatë procesit gjyqësor.

Në vijim të këtij arsyetimi vlen të theksohet se, *ratio* e përjashtimit nga barra e provës të fakteve paqësore konsiston në atë që objekti i të provuarit (*thema probandi*) në procesin civil janë faktet që përbëjnë objektin e mosmarrëveshjes, të vendosura në themel të pretendimeve apo prapësimeve të palëve. Pra, objekt prove në procesin civil janë vetëm faktet e kontestuara dhe jo faktet e pranuara njëzëri. Prezumimi se faktet e pranuara[17] janë të vërteta (për këtë arsye nuk kanë nevojë të provohen) bazohen në filozofinë e thjeshtë njerëzore se: *"Askush nuk mund të pranojë një fakt të disfavorshëm për të, në qoftë se ky fakt nuk është i vërtetë.*"[18]. Sakaq, natyrshëm do të thonim se pohimi gjyqësor është provë me të njëjtën vlerë si prova legale, me fuqi të plotë provuese, e cila e çliron palën nga barra për të sjellë prova të tjera që vërtetojnë pretendimin apo prapsimin e saj.

Por, nëse i rikthehemi edhe njëherë parashikimit të nenit 214 të KPC, pohimet e bëra në gjykatë prej palëve apo prej përfaqësuesve të tyre, nga gjykata çmohen lirisht dhe nuk kanë fuqinë e provës së plotë. Në vlerësimin tim, ky parashikim ligjor vjen në kundërshtim me frymën e KPC dhe me natyrën akuzatore të procesit civil apo parimit bazë që frymëzon filozofinë e tij: parimi i disponibilitetit maksimal të padisë dhe të të drejtave. Dhe nuk duhet të harrohet që natyra akuzatore dhe parimi i disponibilitetit të të drejtave rredh nga neni 11 i Kushtetutës, apo nga filozofia kushtetuese individualiste dhe liberaliste të qarkullimit civil. Arsyeja e kësaj kundërshtie lidhet me faktin se në hartimin e KPC, nuk është ndjekur në mënyrë koherente një model unik ligjor si në pjesën e parimeve të përgjithshme ashtu edhe në pjesën e dispozitave të posaçme që përcaktojnë regjimin juridik të provave.

Paraprakisht vlen të theksohet se sisteme të ndryshme të së drejtës

---

17. Në çdo rast bëhet fjalë për faktet e pranuara në gjykatë, pra në kuadër të një pohimi gjyqësor. Pohimet jashtëgjyqësore nuk mund të shërbejnë si bazë e vetme për konstatimin e një fakti apo një të drejte. Gjykata e çmon një pohim të tillë në tërësi me të gjitha provat dhe rrethanat e tjera të çështjes, sipas rregullave të përgjithshme të çmuarjes së provave

18. Cfr.C.FURNO, *Confessione (dir.proc.civile)*, in Enc. Dir. VIII, Milano 1961, faqe 879

procedurale civile ndjekin kritere të ndryshme në gjetjen e së vërtetës gjyqësore, duke pasur parasysh se kush e ka iniciativën në mbledhjen e provave mbi të cilat gjykata bazon vendimin meritor në lidhje me çështjen konkrete. Ka ligje procedurale që synojnë standardin material të provueshmërisë, duke përcaktuar si garante për arritjen e këtij standardi gjykatën dhe e barazojnë nevojën e garantimit të këtij standardi me nevojën për ruajtjen e rendit publik. Nga ana tjetër ka ligje procedurale që procesin e njohin si domen dhe interes të palëve dhe që gjykatën e aktivizojnë vetëm për të ruajtur procesin e rregullt. Këto ligje procedurale si produkt përfundimtar të procesit, synojnë atë që quhet "*e vërteta procedurale*". Sipas këtyre kritereve, ekzistojnë dy sisteme të së drejtës procedurale, sistemi inkuizitor dhe sistemi akuzator.

Në sistemin akuzator iniciativa për kërkimin dhe paraqitjen e provës i përket eksluzivisht palëve. Sipas këtij sistemi, ato kanë barrën e paraqitjes së fakteve, të cilat gjykata i ve në themel të vendimit të saj si dhe barrën e tregimit të provave që vërtetojnë këto fakte. Ndërkohë që, gjykata ka detyrimin të individualizojë normën juridike që i përgjigjet fakteve të konstatuara gjatë procedimit të çështjes. Në këtë sistem, e vërteta gjyqësore është një e vërtetë relative, është më shumë një bindje e gjyqtarit mbi të vërtetën, që vjen si rezultat i debatit gjyqësor kontradiktor. Pohimi i palës kundërshtare, në këtë sistem, e çliron palën e detyruar për të provuar faktet nga barra e provës dhe faktet e pranuara nuk përbëjnë objekt prove. E vërteta gjyqësore është ajo që "*ofrohet*" nga palët në proces, sipas vlerësimit që ato i bëjnë interesave të tyre ngushtësisht private. Nëse palët nuk kanë kontestime në lidhje me disa fakte, nuk ka mosmarrëveshje për tu zgjidhur nga gjykata dhe për gjykatën faktet e pranuara nga palët duhet të konsiderohen si të vërteta.

Ndërsa në sistemin procedural inkuizitor, gjykata ka një rol përcaktues, determinant në kërkimin dhe marrjen e provës si dhe gjetjen e së vërtetës. Këtu gjyqtari është *dominus litis* dhe nga ai varet se cilat fakte do të konstatohen dhe cilat mjete provuese do të përdoren[19]. Pohimi i fakteve në këtë sistem ka vetëm vlerën e indicies.[20] Ky sistem ka si bazë gjetjen e së vërtetës objektive, absolute, tej asaj që sjellin dhe pohojnë palët në proces si dhe drejtësinë efikase sepse synon që drejtësia t'i jepet atij që i takon.

Gjatë periudhës së Mbretnisë Shqiptare (1928-1939), me Shtojcën e

19. Faik Brestovci, *Procedura Civile I*, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë 2006, faqe 34
20. Po aty

Dytë të Kodit të Procedurës Civile (1929), ishte vendosur një sistem procedural akuzator, ku parimet bazë ishin disponibiliteti i palëve dhe roli pasiv i gjykatës. E njëjta filozofi sistemi frymëzonte edhe Kodin Civil, konkretisht pjesën e rregullimeve materiale të asaj që përbënte të drejtën e provave. Në lidhje me pohimin gjyqësor, ky ligji procedural i kohës në nenin 100/1 parashikonte se: "*Ndërgjyqësi që pretendon një fakt duhet t'a provojë, përveç kur ana kundërshtare e pranon*". Kështu, objekt prove në gjykimin civil sipas këtij ligji ishin vetëm faktet e kontestuara.

Gjatë viteve 1958-1990, e drejta procedurale civile pësoi ndryshime rrënjësore. Kodet e Procedurës Civile, përkatësisht ai i vitit 1958 dhe ai i vitit 1981, ngjizën një sistem procedural me tipare të sistemit inkuizitor, që për standard provues sanksiononte të vërtetën materiale duke ia ngarkuar si detyrë hetimin gjyqësor të fakteve edhe gjykatës kryesisht dhe në mënyrë komplementare. Në nenin 173 të Kodit të Procedurës Civile të vitit 1958, parashikohej se: "*Pohimet e bëra në gjykatë prej palëve, ose prej përfaqësuesve të tyre, çmohen nga gjykata, duke u marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes.*". Procesi gjyqësor civil, u bë akoma më shumë inkuizitorial nga Kodi i Procedurës Civile i vitit 1981, ku gjykata mundej të procedonte me gjykimin edhe në mungesë të interesit apo vullnetit të palëve.

Ndërkohë që pas viteve '90, me Ligjin nr. 8116, dt. 22.03.1996 u miratua Kodi i Procedurës Civile në fuqi, i cili reformoi krejt sistemin procedural të mëparshëm, nga një sistem të pastër inkuizitor në një sistem me tipare mbizotëruese akuzatore, duke iu rikthyer traditës së vendosur gjatë periudhës së Mbretnisë Shqiptare. Në pjesën e parimeve të përgjithshme, ai pati si model Kodin e Procedurës Civile Franceze (me parashikime thuajse identike), ku parimet bazë të procesit civil ishin parimi i disponibilitetit maksimal i të drejtave nga palët dhe rolit pasiv të gjykatës në të drejtat materiale dhe disponimin procedural të tyre.

Ndërkohë që rregullimi ligjor përsa i përket pohimit gjyqësor dhe vlerës provuese të tij, konkretisht neni 214, nuk u harmonizua dhe nuk u bazua tek modelet ligjore perëndimore, por ngeli i pandryshuar sikur ishte formuluar në kodet e mëparshme të sistemit inkuizitor, i cili pohimit gjyqësor i atribuonte vlerë relative provuese.

Mungesa e harmonizimit sipas një modeli të vetëm të unifikuar, në konceptimin e të gjitha dispozitave të Kodit ka sjellë kundërshti dhe përplasje midis tyre. Kështu, në nenin 259 të KPC është parashikuar se: "*Shkresa e thjeshtë e nënshkruar nga personi që e ka lëshuar, përbën provë të*

plotë se deklarimet që përmban janë të atij që e ka nënshkruar, në rast se personi kundër të cilit paraqitet shkresa pranon se është nënshkruar prej tij.". Po ashtu, në nenin 267 të KPC është parashikuar se: "*Personi ndaj të cilit paraqitet shkresa private është i detyruar të deklarojë menjëherë se e pranon ose jo origjinalitetin e nënshkrimit, ndryshe shkresa konsiderohet si e pranuar*".

Pra, duket se KPC në këto dispozita të posaçme, ndryshe nga parashikimi i përgjithshëm i nenit 214, i jep pohimit vlerën e provës së plotë në lidhje me nënshkrimin e shkresës, si mekanizmi nëpërmjet të cilit një shkresë e thjeshtë me fuqi relative provuese shndërrohet në provë me fuqi të plotë provuese. Në këtë linjë arsyetimi, mund të thuhet, se neni 214 i KPC është rudiment i kodeve të mëparshme, jokoherent me frymën dhe parimet e përgjithshme të KPC në fuqi, të cilat kanë synuar të vendosin një sistem kryesisht akuzator, ku pohimi nuk ka vlerën e provës, por e shkarkon palën e detyruar nga barra e provës.

Vlen të përmendet se në Komisionin e Ekspertëve që u caktua nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim hartimin e ndryshimeve të KPC në përputhje me analizën e sistemit të drejtësisë në Shqipëri[21] në kuadër të reformës në drejtësi, u propozua një ndryshim i nenit 214 të KPC nën këtë frymë ligjore, por nuk u pranua. Propozimi për ndryshimin e nenit 214 të Kodit të Procedurës Civile ishte formuluar si më poshtë:

"*Pohimi gjyqësor përbën provë të plotë kundrejt atij që e ka bërë, nëse nuk lidhet me të drejta që nuk mund të disponohen.*

Pohimet jashtëgjyqësore të palëve apo prej përfaqësuesve të tyre, çmohen nga gjykata pa nënvleftësuar provat e tjera dhe rrethanat e çështjes.".[22]

Kjo mënyrë e formulimit të këtij propozimi për ndryshim është frymëzuar edhe nga ligjet procedurale civile të Francës dhe Italisë apo edhe Kosovës. Sa më sipër, megjithëse në vitin 2017 dhe në vitet para tij ky shans është humbur, ndryshimi i nenit 214 të KPC, sipas modeleve ligjore të sistemeve procedurale akuzatore, nga të cilat është frymëzuar një pjesë e

21. Shiko në web: http://www.reformanedrejtesi.al/analiza-e-sistemit-te-drejtesise-ne-shqiperi-2015

22.https://www.academia.edu/31108874/Propozim_p%C3%ABr_reform%C3%ABn_n%C3%AB_Kodin_e_Procedur%C3%ABs_Civile

mirë e dispozitave të KPC në fuqi, do të ngelet si objektiv për ndryshimet ligjore në të ardhmen. Kjo çështje do të duhet të gjejë vëmëndjen e duhur nga ana e ligjvënësit, i cili do të duhet të unifikojë në mënyrë koherente të gjitha institutet e procesit të të provuarit, sipas parimeve të përgjithshme të procesit gjyqësor civil me natyrë akuzatore, sipas parimit të disponibilitetit dhe parimit të gjykatës pasive.

Parimi i barrës së kontestimit (*onus contestatio*) Vlera provuese e heshtjes së palëve në gjykimin civil (*ficta confesio*)

Në procesin e të provuarit, përveç parimit të barrës së provës (*onus probandi*) dhe parimit të barrës së paraqitjes së fakteve (*onus proferendi)*, flitet edhe për parimin e barrës së kontestimit (*onus contestatio*). Ky trend i së drejtës procedurale civile moderne synon që të thjeshtësojë zgjidhjen e konflikteve gjyqësore duke rritur efektivitetin e prodhimit të së vërtetës procedurale në secilën prej fazave të procesit. Jo pak shtete e kanë pranuar këtë mënyrë të të provuarit në ligj, duke e formalizuar në kodet e procedurave civile edhe mekanizmin se si arrihet të përfitohet një fakt i provuar sipas kësaj mënyre. Nga ana tjetër shumë shtete, përfshirë edhe Shqipërinë, nuk e kanë formalizuar në ligjin procedural këtë mekanizëm të të provuarit, por në to ka gjurmë të këtij mekanizmi dhe se gjykatat në praktikën gjyqësore po aplikojnë mënyra të provimit të fakteve të cilat janë *thema probandum*.

Parimi i barrës së kontestimit (*onus contestatio*) do të thotë se pala që nuk është pozicionuar asnjëherë proceduralisht ndaj pretendimeve të palës kundërshtare, merr përsipër riskun që këto fakte të konsiderohen prej gjykatës të pakontestueshme. Pra, mungesa e kontestimit së disa fakteve të vëna në themel të prapsimeve të një pale, nga pala tjetër, pavarësisht se nuk përbën provë në vetvete, merr vlerë si argument prove në varësi me provat e tjera dhe shërben si mjet për tu çliruar nga barra e provës ndaj një fakti juridik të pretenduar. Vetë natyra kontradiktore e procesit gjyqësor civil, krijon në thelb detyrimin e palës që i kundrejtohet një fakt, të marrë e të paraqesë qëndrimin e tij rreth atij fakti nëpërmjet prapsimit apo mbrojtjes, me pasojën ligjore procedurale që, kur nuk e bën një gjë të tillë do të thotë se fakti bëhet i pranuar dhe gjykata mund ta vendosë si të tillë në themel të vendimit të saj.

Në KPC janë parashikuar disa raste kur heshtja e palës apo sjellja

inaktive e saj në kuadër të barrës së kontestimit merr vlerë provuese. Më konkretisht përmendim nenet 259, 267/2 dhe 277 të KPC, ku pasoja procedurale ligjore kur pala të cilës i kundrejtohet një shkresë private nuk prapson apo kur nuk paraqitet personalisht kur gjykata ka vendosur të marrë pohimin gjyqësor formal të saj, sipas nenit 182 dhe 285 të KPC, është që shkresa e cila i kundrejtohet kësaj pale shndërrohet në provë me fuqi të plotë provuese apo që gjykata mund t'i marrë si të pranuara faktet për të cilat pala është pyetur dhe nuk është përgjigjur. E njëjta pasojë ligjore procedurale është edhe në lidhje me situatën e parashikuar në nenin 120 të KPC, i cili ka sanksionuar institutin e heqjes dorë heshtazi nga prapsimi procedural i pavlefshmërisë së akteve procedurale.[23]

Në vijim të kësaj analize, vlen për t'u trajtuar dallimi midis fakteve paqësore dhe fakteve për të cilat pala kundërshtare hesht. Faktet paqësore janë faktet të cilat në mënyrë eksplicite pranohen nga pala kundër së cilës ato paraqiten në procesin gjyqësor. Pranimi është eksplicit kur ai rezulton nga deklarata e drejtpërdrejt e palës lidhur me vërtetësinë e fakteve që janë të disfavorshme për të. Ndërsa faktet për të cilat pala kundërshtare hesht, janë ato të cilat as nuk kundërshtohen por as nuk pranohen nga pala tjetër.

Dallimi midis fakteve paqësore dhe fakteve për të cilat pala kundërshtare hesht ka vlera të rëndësishme praktike. Të parat nuk duhet të provohen. Të dytat nuk e shkarkojnë *ipso facto* palën e detyruar nga barra e provës. Heshtja e palës kundërshtare në këtë rast mund t'i shërbejë gjykatës si indicie apo si argument prove (*ficta confesio*) për vërtetësinë e faktit lidhur edhe me provat apo rrethanat e tjera të çështjes.[24]

Nga mënyra se si procesi gjyqësor civil shqiptar është hartuar, e sidomos pas ndryshimeve të KPC që hynë në fuqi me datë 05.11.2017, momenti kryesor për të konkluduar lidhur me *onus contestatio* apo me përmbushjen e barrës së kontestimit, për palën e paditur është deklarata e mbrojtjes. Më tej për palën paditëse do të jetë përgjigja me shkrim pas njoftimit të deklaratës së mbrojtjes apo seanca e parë përgatitore apo gjyqësore nëse nuk ka një përgjigje me shkrim rreth prapsimeve. Më tej, nëse ndryshon shkaku ligjor apo objekti i padisë, atëhere momenti procedural kur

23. Edhe kjo dispozitë është ndryshuar nga Ligji Nr. 38/2017, i cili ka hyrë në fuqi më datë 05.11.2017

24. Shiko Vendimin nr. 294, datë 04.07.1995, të Dhomës Civile të Kasacionit të Republikës së Francës, ku ndër të tjera thuhej, se: "*Nuk shkarkohet nga barra e provës, pala së cilës I bie kjo barrë, për shkak të heshtjes së palës kundërshtare.*"

duhet të kontestohen faktet e servirura rishtazi për gjykim do të jetë seanca më e parë, apo kur ndryshimet bëhen dhe pranohen menjëherë, aty për aty do të duhet që pala kundërshtare të realizojë kontestimet eventuale. Përndryshe, gjykata, nga moskontestimi i palës kundërshtare të fakteve që janë sjellë për gjykim, mundet të konkludojë mbi ekzistencën e atyre fakteve.

Nga kjo kuptohet se *onus contestatio* apo edhe *ficta confesio* do të veprojnë si mekanizma procedural për të konkluduar mbi ekzistencën e fakteve vetëm kur gjykimi zhvillohet në prezencë të palëve. Duke qenë se sistemi procedural civil i gjykimit në mungesë i Shqipërisë hyn në modelet ligjore ku mungesa e palës paditëse apo palës së paditur nuk ka relevancë mbi procesin e të provuarit,[25] atëhere konkludohet se edhe *onus contestiatio* edhe *ficta confesio* nuk mundet të veprojë dhe përjashtohet apriori në të gjitha rastet kur gjykimi civil zhvillohet në mungesë të njërës prej palëve.[26] Kjo zgjidhje rrjedh nga fakti që në modelet ligjore simotra të Shqipërisë, ligji procedural civil gjykimin në mungesë e njeh si sjellje të një inaktiviteti të plotë procedural, nga e cila nuk mundet të deduktohet asnjë argument prove.

Vlerësoj se KPC do të duhet të kishte patjetër një rregullim ligjor mbi mënyrën se si gjykata vlerëson rast pas rasti faktet paqësore, veprimin e mekanizmit procedural *onus contestatio* dhe *ficta confesio*. Parashikimi ligjor do të bënte të mundur që të respektohej nevoja për garantimin e parimit të sigurisë juridike. Edhe për këtë ometim të ligjit procedural civil ka pasur një propozim konkret në Komisionin e Ekspertëve që draftuan ndryshimet e KPC, por që nuk është miratuar e më tej dhe nuk është bërë ligj. Ky propozim kërkonte ndryshimin e nenit 309 të KPC, duke parashikuar se:

"*Vendimi mbështetet vetëm në të dhëna që ndodhen në aktet dhe që janë shqyrtuar në seancë gjyqësore. Gjithashtu gjykata mundet të vlerësojë në raport me provat e tjera edhe faktet e pakundërshtuara shprehimisht nga pala prezent në gjykim.*

Gjykata çmon provat e marra gjatë gjykimit të çështjes, sipas bindjes së saj të brendshme, të formuar nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në tërësinë e tyre, përveç kur ligji parashikon ndryshe.

Gjykata mundet të vlerësojë si argument prove sjelljet refuzuese të palës, që nuk përgjigjet në procedurën e pohimit gjyqësor të vendosur nga

25. Florjan Kalaja, *Gjykimi në mungesë në procesin civil*, Shtëpia Botuese 'Fan Noli', Tiranë 2014

26. Shiko për më tepër nenin 115 të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Italisë, ndryshuar në vitin 2009

gjykata, nuk pranon të sjellë provën e kërkuar nga pala tjetër, nuk pranon të kryhen kqyrjet e vendosura nga gjykata, apo përgjigjet e palëve dhe sjelljet e tyre përgjatë gjykimit.".[27]

Natyra juridike e pohimit gjyqësor Afati procedural i paraqitjes së pohimit dhe parevokueshmëria e tij

Sikurse u trajtua më sipër, pohimi gjyqësor është një akt vullneti, i realizuar nën një procedurë formale, para organit gjyqësor dhe efektet e tij procedural dhe substancial nuk varen nga deklaruesi, por rrjedhin *ex legge.*[28] Duke qënë se pohimi merr vlerë provuese, në disfavor të palës që e bën, mund të thuhet se ky akt vullneti përfshihet në kategorinë e akteve të disponimit të së drejtës. Sakaq, pohim gjyqësor mund të bëhet vetëm për faktet në lidhje me të drejtat që mund të disponohen dhe nga të cilat mund të hiqet dorë, për shkak të ligjit apo natyrës juridike të tyre. Në këtë linjë arsyetimi sjellim në vëmendje nenin 2733 të Kodit Civil Italian, i cili parashikon se: "*Pohimi përbën provë të plotë kundrejt atij që e ka bërë, për sa kohë nuk lidhet me të drejta që nuk mund të disponohen*".

Duke qënë një akt disponimi të së drejtës, pohimi mund të bëhet në çdo fazë të gjykimit, në shkallë të parë dhe gjatë gjykimit në apel. Në fakt nën këtë logjikë juridike u frymëzuan edhe ndryshimet e KPC me Ligjin nr. 38/2017, në lidhje me momentin procedural se deri kur mund të bëhet pohimi i palës. Kështu neni 186 i KPC (i ndryshuar me Ligjin nr. 38/2017) ka parashikuar, se:

"*1. Pas urdhrit të gjyqtarit të vetëm për caktimin e seancës gjyqësore, sipas nenit 158/c, të këtij Kodi, nuk mund të kërkohen prova të reja dhe të pretendohen fakte të reja, përveçse kur: a) pala e interesuar provon se, pa fajin e saj, nuk ishte në gjendje të paraqiste këto fakte dhe/ose prova të reja më parë; b) pala e interesuar provon se nuk mund të ishte në dijeni të fakteve dhe/ose provave të reja; c) ekziston një interes publik për pranimin e provave të reja. 2.* ***Kjo dispozitë nuk zbatohet për marrjen e pohimit gjyqësor ose***

27. https://www.academia.edu/31108874/Propozim_p%C3%ABr_reform%C3%ABn_n%C3%AB_Kodin_e_Procedur%C3%ABs_Civile
28. Vendim nr. 11745, dt. 1 Gusht 2003; Vendim nr. 12803, dt. 27 Shtator 2000, i Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë

jashtëgjyqësor."[29]

Po ashtu, në nenin 465 të KPC (i ndryshuar me Ligjin nr. 38/2017) ka parashikuar, se:

"*...Gjykata e apelit mund të pranojë për shqyrtim fakte dhe prova të reja, nëse: a) pala e interesuar provon se, pa fajin e saj, gjatë shqyrtimit të çështjes para gjykatës së shkallës së parë nuk ishte në gjendje të paraqiste këto fakte dhe/ose prova të reja; b) pala e interesuar i ka kërkuar, por gjykata e shkallës së parë, në kundërshtim me ligjin, nuk i ka marrë këto fakte dhe/ose prova, të cilat kanë rëndësi për çështjen; c) pala e interesuar provon se nuk mund të ishte në dijeni të fakteve dhe/ose provave të reja gjatë gjykimit në shkallën e parë. 6.* ***Kjo dispozitë nuk zbatohet për marrjen e pohimit gjyqësor ose jashtëgjyqësor.***"[30]

Një çështje tjetër që mund të haset në praktikën gjyqësore është nëse mund të revokohet pohimi gjyqësor dhe si do e vlerësojë gjykata situatën kur pala e mohon faktin të cilin e ka pohuar në fillim. KPC nuk ka një parashikim ligjor që të përcaktojë nëse mund të hiqet apo jo dorë nga pohimi gjyqësor, nëse pala mund t'a revokojë atë dhe deri në çfarë momenti procedural.

Nëse bëhet një vështrim krahasues me modele të tjera ligjore, mundet të gjenden rregullime të ndryshme në lidhje me këtë çështje. Kështu, LPK në nenin 321/3 parashikon se: *"Gjykata ka të drejtë të vlerësojë, duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, se a do ta merr si të pohuar apo si të kontestuar faktin të cilin pala njëherë e ka pohuar e pastaj tërësisht apo pjesërisht e ka kontestuar, apo e ka kufizuar pohimin duke shtuar fakte tjera".* Sipas, LPK mohimi i një fakti të pohuar i nënshtrohet vlerësimit të lirë diskrecional të gjyqtarit, sipas rregullave të çmuarjes së lirë të provave.

Nga ana tjetër, një parashikim të ndryshëm e ka Kodi Civil Italian, i cili në nenin 2732 të tij, parashikon se: *"Pohimi nuk mund të revokohet nëse nuk provohet se është bërë si pasojë e gabimit në fakt ose si pasojë e dhunës."*[31]

Po ashtu, në nenin 1356/3 të Kodit Civil Francez, parashikohet se: "*Pohimi gjyqësor nuk mund të revokohet, me përjashtim të rastit kur provohet se ai është bërë për shkak të një gabimi në fakt. Ai nuk mund të revokohet për shkak të një lajthimi mbi të drejtën."*[32]

---

29. Theksim i autorit
30. Idem
31. Përkthim i autorit
32. Përkthim i autorit

Ratio, e këtyre modeleve ligjore lidhen me natyrën e pohimit gjyqësor, i cili është një akt vullneti, formal, efektet e të cilit rrjedhin *ex legge*. Po ashtu në doktrinën juridike italiane[33] është mbajtur qëndrimi se nëse do të lejohej revokueshmëria e pohimit gjyqësor formal, në çdo fazë dhe shkallë të procesit, kjo do të krijonte një anomali që do të vinte ndesh me sistemin e rënies në dekadencë të të drejtave dhe kërkimeve gjatë procesit.

Sa më sipër, në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje, vlerësoj se pohimi gjyqësor formal përbën një akt vullneti disponimi të së drejtës, formal, solemn, i artikuluar nën kushtet e vullnetit të plotë dhe ndërgjegjies më të lartë të deklaruesit, i cili para se të pranojë një fakt, është i vetëdijshëm për pasojat që mund t'i vijnë nga pohimi i bërë para autoritetit gjyqësor. Pohimi gjyqësor sjell pasoja juridike si në marrëdhënien juridike-procedurale ashtu edhe në marrëdhënien juridike-materiale objekt gjykimi. Duke u përcaktuar si heqje dorë nga e drejta, pohimi gjyqësor nuk mund të revokohet përveçse nëse provohet se është bërë nën rrethanat e veseve të vullnetit. Vetë procedura e parashikuar në nenin 283 të KPC është një procedurë tepër formale, pikërisht për të sjellë në vëmendje të palëve rëndësinë e pohimit dhe për t'i bërë të përgjegjshëm për veprimet që kryhen.[34]

Konkluzione

Pohimi është një nga provat tipike që KPC rregullon në mënyrë eksplicite. Megjithatë, më shumë se sa provë, pohimi është një mekanizëm se si ligji civil parashikon se pala që ka barrën e provës për të provuar një fakt mundet të çlirohet nga ajo nëse pala tjetër pretendon faktin që i kundrejtohet atij. Pra pohimi gjyqësor duket se është një mënyrë ligjore se si çlirohet pala nga barra e provës.

Përveç se në mënyrë eksplicite, KPC e rregullon në një mënyrë kontradiktore pohimin gjyqësor. P.sh. neni 267 paragrafi i dytë i KPC parashikon se, pohimi apo mungesa e tij përballë një shkrese të thjeshtë, arrin të shndërrojë shkresën e thjeshtë njëlloj si shkresë zyrtare, e cila merr fuqi të plotë provuese. Nga ana tjetër, neni 214 i KPC parashikon se në çdo rast pohimi gjyqësor është prove e zakonshme dhe vlera e saj përcaktohet

33. Salvo Leuzzi, *I mezzi di prova nel processo civile. Formazione, acquisizione, integrazione*., 'Giuffre' Editore, Milano 2013, faqe 319
34. Ina Hoxhaj, *Roli i gjykatës në procesin e të provuarit gjatë gjykimit në shkallë të parë*, Shkolla e Magjistraturës, Viti 2014, faqe 112

nga vlerësimi i lirë i gjykatës në raport me provat e tjera. Po ashtu, logjika e nenit 214 të KPC nuk është koherente me logjikën e nenit 186 dhe 465 të KPC, ndryshimit më të fundit të ligjit procedural nga ligjvënësi mbi pohimin gjyqësor dhe jashtëgjyqësor.

Duke pasur parasysh parimin e disponibilitetit maksimal të padisë dhe të të drejtave civile, vlerësoj se në KPC nuk ka vend për mënyrën se si është formuluar neni 214 të KPC. Në çdo rast, kur e drejta mundet të jetë objekt disponimi nga pala që do të bëjë pohimin, pohimi gjyqësor duhet të ketë vlerë ligjore provuese, që do të thotë se përbën provë të plotë. Ndërkohë pohimi jashtëgjyqësor i një fakti, për shkak të mosformësimit të tij para gjykatës dhe për shkak se në këto kushte duhet të konfirmohet nga gjykata, duhet të përbëjë prove të zakonshme. Kjo do të thotë se, ndërsa pohimi gjyqësor, i rastit apo i nxitur, nuk i nënshtrohet vlerësimit të lirë të gjykatës sepse vlerën provuese atij ia jep ligji, pohimi jashtëgjyqësor i nënshtrohet vlerësimit të lire të gjykatës, që do të thotë se gjykata e vlerëson atë sipas mënyrës që përcakton neni 309 i Kodit të Procedurës Civile.

Pohimi gjyqësor apo jashtëgjyqësor, tej vlerës procedurale, përbën një disponim mbi të drejtën materiale të palës që e bën. Ndaj nuk mundet të ketë pengesa të vlerës provuese sikurse neni 214 i KPC parashikon. Kjo do të thotë se gjykata nuk mundet të investohet për të zgjidhur çështjet ku palët nuk kanë konflikt, por ka juridiksion eksluziv për të zgjidhur vetëm konfliktet ndërmjet palëve. Si rrjedhojë vlerësoj se neni 214 i KPC duhet të ndryshohet. E nëse ndryshimi nuk vjen me ligj, atëhere gjykatat duhet të bëjnë të mundur që neni 214 i KPC, nga gjykatat për llogari të zgjidhjes së çështjeve gjyqësore, të interpretohet në mënyrë pajtuese me parimet e përgjithshme të procesit gjyqësor civil, sikurse të ishte formuluar në këtë formë: "*Pohimi gjyqësor përbën provë të plotë kundrejt atij që e ka bërë, nëse nuk lidhet me të drejta që nuk mund të disponohen. Pohimet jashtëgjyqësore të palëve apo prej përfaqësuesve të tyre, çmohen nga gjykata pa nënvleftësuar provat e tjera dhe rrethanat e çështjes.*"

Gjithashtu vlerësoj se ligji procedural civil duhet të njohë pa ekuivoke parimin e barrës së kontestimit (*onus contestatio*) dhe vlerën provuese të mungesës së kontestimit të fakteve (*ficta conffesio*), krahas fakteve paqësore të pakontestuara nga palët në proces. Një regjim i tillë juridik do të forconte rregullat e zhvillimit të gjykimit kontradiktor në procesin civil.

Vlerësoj se propozimi mbi ndryshimin e nenit 309 të KPC ka qenë i drejtë dhe duhet të jetë përsëri pjesë e axhendës së ligjvënësit. Kështu duhet

të parashikohet një paragraf që të rregullojë konkluzionin e gjykatës për faktet e pakontestuara, duke parashikuar se faktet e pakotestuara nga pala të cilës i kundrejtohen, kur pala ka qenë prezent në gjykim, duhet të lejohen të përdoren nga gjykata në vlerësimin e saj. Ligji duhet të jetë i qartë se, në dobi të realizimit të gjykimit sipas parimit të kontradiktoritetit, pala ka detyrimin të komentojë dhe të kundërshtojë çdo fakt të pretenduar nga pala kundërshtare (*onus contestatio*). Për rrjedhojë, nëse një fakt i pretenduar nuk kontestohet nga pala tjetër, atëhere gjykata, duke mbajtur parasysh këtë sjellje të palës së cilës i kundrejtohet, gjithmonë kur ajo është prezente në gjykim, mundet ta konsiderojë të pranuar dhe të provuar. Gjithashtu vlerësoj se duhet të rregullohet me ligj, si një dispozitë e përgjithshme *lex generalis* për mënyrën se si gjykata vlerëson sjelljet procedurale të palëve gjatë gjykimit, për të deduktuar sakaq argumentet e provës nga ato. Rregulla të tilla ligji procedural i ka në nenin 267 paragrafi i dytë, në nenin 295 paragrafi i dytë, në nenin 214 të KPC. Nën këtë frymë dhe logjikë neni 309 i KPC duhet të ndryshohet si më poshtë:

"*Vendimi mbështetet vetëm në të dhëna që ndodhen në aktet dhe që janë shqyrtuar në seancë gjyqësore. Gjithashtu gjykata mundet të vlerësojë në raport me provat e tjera edhe faktet e pakundërshtuara shprehimisht nga pala prezent në gjykim. Gjykata çmon provat e marra gjatë gjykimit të çështjes, sipas bindjes së saj të brendshme, të formuar nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në tërësinë e tyre, përveç kur ligji parashikon ndryshe. Gjykata mundet të vlerësojë si argument prove sjelljet refuzuese të palës, që nuk përgjigjet në procedurën e pohimit gjyqësor të vendosur nga gjykata, nuk pranon të sjellë provën e kërkuar nga pala tjetër, nuk pranon të kryhen kqyrjet e vendosura nga gjykata, apo përgjigjet e palëve dhe sjelljet e tyre përgjatë gjykimit.*".

Nëse këto ndryshime nuk vijnë me ligj, vlerësoj se duhet të vijnë patjetër nëpërmjet jurisprudencës dhe praktikës gjyqësore. Prandaj, në çdo rast, duhet të jenë gjykatat që duhet ta reformojnë mënyrën se si KPC zbatohet në zgjidhjen e konflikteve gjyqësore dhe në sallat e gjykimit.

Literatura:

Akte normative

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar
- Kodi Civil i Republikës së Francës
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
- Kodi Civil i Mbretnisë Shqiptare (viti 1928)
- Shtojca e Dytë e Kodit të Procedurës Civile
- Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Gjermanisë
- Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Italisë
- Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Francës
- Ligji nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"
- Kodi i Procedurës Civile i vitit 1958;
- Kodi i Procedurës Civile i vitit 1981
- Ligji nr. 38/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Civile".
- Ligji i Republikës së Kosovës për Procedurat Kontestimore

Doktrinë

- Prof. Dr. Faik Brestovci, *E Drejta Procedurale Civile I*, Prishtinë 2006
- Florjan Kalaja, *Gjykimi në mungesë në procesin civil*, Shtëpia Botuese 'Fan Noli', Tiranë 2014
- Michelle Taruffo, *Commentario Cendon*, VI, Torino 1991
- Alessandro Simoni, Sokol Sadushi, Sokol Çomo, *Vështrim i krahasuar mbi procedurën civile*", Shkolla e Magjistraturës, Tiranë 2006
- Faik Brestovci, *E drejta procedurale civile*, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë 2006
- Ina Hoxhaj, *Roli i gjykatës në procesin e të provuarit gjatë gjykimit në shkallë të parë*, Shkolla e Magjistraturës, Viti 2014
- Alban Brati, *Procedura Civile*, Botimet 'Dudaj', Tiranë 2008
- Salvo Leuzzi, *I mezzi di prova nel processo civile. Formazione, acquisizione, integrazione*", 'Giuffre Editore', Milano 2013

- Cfr.C.FURNO, *Confessione (dir.proc.civile)*, in Enc. Dir. VIII, Milano 1961

Jurisprudencë

- Vendime Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të R. Sh.: Nr. 12, datë 14.09.2007; Nr. 3, datë 08.07.2013; Nr.3, datë 27.08.2002;

- Vendimi nr. 34, datë 19.02.2009 i Koegjit Civil të Gjykatës së Lartë të R. Sh.

- Vendimi Nr. 80-127, datë 20.01.1981 i Këshillit Kushtetues të Republikës së Francës

- Vendimi Nr. 294, datë 04.07.1995 i Dhomës Civile të Kasacionit të Republikës së Francës

- Vendimi Nr. 15, dt. 21.12.2006 i Asamblesë Plenare të Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë

- Vendime të Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë: nr. 3188, datë 14 Shkurt 2006; nr. 28711; datë 3 Dhjetor 2008; nr. 19165, datë 29 Shtator 2005; nr. 16260, datë 3 Gusht 2005; nr. 11266, datë 3 Korrik 2002; nr. 11881, datë 6 Gusht 2003; nr. 6301, datë 26 Maj 1992; 16127, datë 15 Nëntor 2002; nr. 1723, datë 5 Mars 1990; nr. 8923, datë 11 Nëntor 1996; Nr. 11745, datë 1 Gusht 2003; nr. 12803, datë 27 Shtator 2000

Të tjera:

https://www.academia.edu/31108874/Propozim_p%C3%ABr_reform%C3%ABn_n%C3%AB_Kodin_e_Procedur%C3%ABs_Civile

http://www.reformanedrejtesi.al/analiza-e-sistemit-te-drejtesise-ne-shqiperi-2015

http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Vendime_Unifikuese_39_1.php

MBI AGJENCITË E ADMINISTRIMIT KOLEKTIV PËR TË DREJTËN E AUTORIT

Av. Dr. Oltion SPIRO
Lektor në Universitetin e Tiranës,
Studio Ligjore 'Loloçi & Associates',
Tiranë

Hyrje

Si në shumë fusha të së drejtës, edhe e drejta e autorit është ndodhur para sfidës së përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Përpjekjet kanë qenë të vazhdueshme, megjithatë nuk duhet të fshehim problematikat që prekin këtë fushë, për të cilat ende nuk po gjendet trajtimi dhe vëmendja e duhur. Dhe në këtë kuadër, administrimi i të drejtave të autorit prej agjencive kolektive ka njohur gjatë këtyre viteve më shumë rënie se sa ngritje.

Administrimi kolektiv është trajtuar në Ligjin e 9380/2005 (tashmë i shfuqizuar), i cili përafrohej me Direktivën 2004/48/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 29 prill 2004, në lidhje me zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale. Ligji në fjalë, krahasimisht me ligjin e mëparshëm të vitit 1992, që rregullonte fushën e të drejtës së autorit në Shqipëri para vitit 2005, ka qenë një hap përpara i pamohueshëm në rregullimin e marrëdhënieve të të gjithë aktorëve të të drejtës së autorit. Ligji 9380/2005 solli në kuadër të përmirësimeve të mëtejshme të kornizës ligjore të të drejtës së autorit disa risi për sa i përket agjencive të administrimit kolektiv (më poshtë në ktë trajtim, referohen si "AAK"), si për shembull, përcaktimin e formës së tyre ligjore,[1] të mënyrës së liçencimit[2] dhe të rregullave bazë të funksionimit të tyre.[3] Ligji

1. Neni 108 i Ligjit 9380/2005
2. Neni 109 i Ligji 9380/2005
3. Neni 110 i Ligji 9380/2005

9380/2005 ndiqte parimin e parashikuar nga Direktiva 2004/48/KE, sipas të cilit AAK-të kanë po ato të drejta të mbrojnë veprën nga shkeljet e mundshme, siç i gëzon vetë autori.[4]

Mirëpo zbatimi i këtij ky ligj rezultoi jo fort i kënaqshëm. Së pari, AAK-të hasën në shumë vështirësi gjatë përmbushjes së misionit të tyre të mbledhjes së shumave në favor të autorëve; së dyti, ato kanë vuajtur nga një mungesë transparence e dëmshme në mënyrën e shpërndarjes së shumave në favor të autorëve. E gjithë kjo amulli ka prodhuar konflikte institucionale mes disa AAK-ve dhe organit të mbikqyrjes (Zyra Shqiptare e të Drejtave të Autorit – sot njihet si DDA).[5] Praktika ka folur qartë për një dështim të veprimtarisë së tyre dhe të nevojës për një rimëkëmbje që kalon gjithashtu edhe te një rishikim i dispozitave ligjore.

Në këtë kuadër, ligji 35/2016 "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera e lidhur me to" (Ligji 35/2016), i cili përveçse përafron edhe më tej legjislacionin tonë me atë të BE-së[6] sjell disa risi konkrete, si edhe saktësime më të mëdha dhe të nevojshme, që krijojnë një bazë më të shëndoshë për aktivitetin e AAK-ve. Kështu, ligji 35/2016 është më shterues në përshkrimin e krijimit të AAK-ve[7], të drejtat dhe detyrimet e AAK-ve[8], kriteret e miratimit të tarifave[9] dhe mbikëqyrjes së aktivitetit të tyre,[10] si edhe të mbikëqyrjes së përdoruesve të të drejtave.[11] Ligji, nën impulsin e Direktivës 2006/115/KE[12] dhe të praktikës evropiane tashmë të konsoliduar duke rimarrë parimin e shpërblimit të drejtë, i cili lind në favor të autorit pasi është riprodhuar vepra e tij në mënyrë të ligjshme, por pa pëlqimin vetjak. Janë pikërisht AAK-të që kanë detyrimin që të mbledhin këto shuma dhe t'ua shpërndajnë autorëve. Shpërblimi i drejtë është një mekanizëm që nuk duhet neglizhuar

4. Neni 4 i Direktivës 2004/48/KE
5. Bëhet fjalë për agjencinë "Albautor"
6. Përafrim me direktivat 2001/29/KE "Mbi harmonizimin e disa aspekteve të të drejtës së autorit dhe të të drejtave të lidhura me të në shoqërinë e informacionit", si edhe me Direktivën 2006/115/KE
7. Sipas dispozitave të nenit 133 të ligjit për të drejtat e autorit
8. Neni 127 e vijues i ligjit 35/2016
9. Nenet 127, 142, 150 dhe 151 të igjit 35/2016
10. Nenet 134, 153 dhe 157 të ligjit 35/2016
11. Neni 152 i ligjit për të drejtat e autorit
12. Direktiva 2006/115/KE e Parlamentit dhe e Këshillit në lidhje me të drejtën e qirasë dhe të drejtën e huadhënies, si edhe mbi disa të drejta që lidhen me të drejtën e autorit në fushën e pronësisë intelektuale, flet për të drejtën e shpërblimit të drejtë

pasi në tregjet evropiane përfaqëson të ardhura mjaft të konsiderueshme për industrinë artistike.[13] Shpërblimi i drejtë i parashikuar në nenin 31 të ligjit 35/2016 do të vilet nga shitja e materialeve teknike të tilla që mundësojnë kopjimin (riprodhimin) e veprës. Këto materiale do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Lista e materialeve, për nga natyra dhe llojet e materialeve do të bazohet në ekspertizat e huaja. Kryesisht, në të do të bëjnë pjesë materialet e fotokopjeve, CD-të, DVD-të bosh, materialet e printimit e kështu me radhë. Risia e Ligjit, dhe që i jep një rëndësi më të madhe rolit të AAK-ve, është se autorët nuk mund të heqin dorë nga të drejtat për shpërblim të drejtë.[14] Rrjedhimisht, edhe administrimi kolektiv i këtyre të drejtave për shpërblim të drejtë do të jetë i detyrueshëm: nëse autori nuk mund të heqë dorë, atëherë edhe AAK-ja ka detyrimin që t'i mbledhë ato.[15]

Roli i AAK-ve është parësor në fushën e artit. Ato mund të kontribuojnë në ekonominë e vendit dhe në zhvillimin e artit. Parimi themelor i administrimit të të drejtave të autorit është që autorët gëzojnë të drejtën për të mbrojtur vetë të drejtat e tyre, si mishërim i idesë se e drejta e autorit është një e drejtë që lidhet ngushtësisht me personin e autorit. E drejta ekskluzive e autorëve për të shfrytëzuar veprat e tyre është element thelbësor i të drejtës së autorit. Kjo e drejtë u takon tërësisht autorëve dhe nëse ata janë në gjendje, mund ta ushtrojnë këtë të drejtë personalisht, dhe për këtë gëzojnë mbrojtjen e ligjit dhe të autoriteteve kompetente. Kjo për vetë faktin se kemi të bëjmë me një të drejtë pronësore që i takon autorit dhe kësisoj ai është titullar i shfrytëzimit të saj dhe i përfitimit të fryteve që burojnë prej këtij shfrytëzimi.

Megjithatë, mundësia e vështirë praktike për të bërë një gjë të tillë në shoqërinë e informacionit, praktikisht e bën këtë parim vështirësisht të zbatueshëm. Në këtë kuptim rritet rëndësia e agjencive të administrimit kolektiv, si organizime që kanë mundësi më të mëdha të mbrojnë dhe të mbrojnë të drejtën e autorit.[16] Zhvillimi teknologjik ka treguar qartë se, për shkak të

13. Ky lloj shpërblimi parashikohet në nenin 31 të ligjit për të drejtat e autorit dhe përbën një nga risitë më të mëdha të tij. Shpërblimi i drejtë përfaqëson një përqindje të çmimit të shitjes së suporteve bosh të CD-ve, DVD-ve apo USB-ve, për të kompensuar humbjet që pësON autori nga përhapja e veprës së tij në mënyrë private, pa dijeninë e tij. Rasti më konkret është ai i kopjimi te CD-ve apo të këngëve nga një USB në tjetrën, çka sjell një fitim të humbur për autorin, që kompensohet nga shpërblimi i drejtë
14. Pika 7 e nenit 31 të Ligjit 35/2016
15. Neni 131 i Ligjit 35/2016
16. Xavier Linant de Bellefonds, *Droit d'auteur et droits voisins*, 'Dalloz'. Botimi II, 2004, fq. 393

vështirësisë së kontrollit që ushtron autori mbi veprën e tij, e arsyeshme është parë që autorët të bashkohen dhe të bëjnë të mundur një mbrojtje më efektive të të drejtave të tyre. Një parim i tillë nuk vlen vetëm për autorët, por edhe për personat që kanë të drejta të lidhura me të drejtën e autorit, siç janë producentët, artistët ekzekutues apo interpretues.

Me hyrjen në skenë të teknologjive digjitale dhe shpërndarjes së veprave nëpërmjet internetit, shumë autorë dhe përfaqësues të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale ("OBPI" ose "WIPO") ngritën shqetësimin që lidhej me mbijetesën e formës aktuale të AAK-ve apo nevojës për të ndryshuar në mënyrë rrënjësore organizimin e tyre.[17] Në maj të vitit 1997, OBPI-ja organizoi Forumin Ndërkombëtar mbi Sfidën e Teknologjisë Digjitale mbi administrimin e të drejtave të autorit. Pjesëmarrësit diskutuan rreth debatit nëse parimet ekzistuese të menaxhimit duhet të mbeteshin në fuqi apo nëse ato kishin dalë jashtë loje me ardhjen e internetit. Përgjigja gati unanime e ekspertëve ishte se parimet e parashikuara në ligjet dhe traktatet ndërkombëtare për të drejtën e autorit kanë një qasje neutrale ndaj zhvillimeve teknologjike, që do të thotë se këto parime vlejnë dhe kanë vokacion të jenë të vlefshme, pavarësisht zhvillimeve tekonologjike që mund të influencojnë mbi vepër. Kështu, sipas ekspertëve, është e nevojshme një përmirësim i rregullave aktualë në mënyrë që t›i përgjigjen më mirë realiteteve të reja.[18]

Përhapja masive e veprës në të gjithë globën në saj të internetit përforcon akoma më shumë idenë se pa bashkim, nuk ka fuqi dhe kësisoj nuk ka respektim global të të drejtave të autorit. Autori duhet të kontrollojë veprat e tij, të negociojë me përdoruesit, të mbledhë të ardhurat që vijnë prej përdorimit dhe njëkohësisht të marrë përsipër dhe rolin e ndëshkuesit nëse ndonjë përdorues nuk përmbush detyrimin e tij. E gjitha kjo vështirësohet nëse analizën tonë e vendosim në vende me vështirësi në zbatimin e ligjit, siç është Shqipëria apo nëse vendi i përdoruesit është shumë larg nga vendi i autorit.

Pra, kuptohet se arsyeja përse të drejtat pasurore të autorit apo të personave që gëzojnë të drejta të lidhura me të drejtën e autorit nuk mund të zbatohen gjithmonë individualisht është se veprat, në ditët e sotme përdoren

17. Lucie Guibault, Stef van Gompel, *Collective Management in the European Union, in Colelctive Management of Copyright and Related Rights*, Third Edition, Aspen Publishers, UK 2015

18. Mihaly Ficsor, "*Collective Management of Copyright and Related Rights*", botimi i OBPI-së, Gjenevë 2002

nga shumë përdrorues që gjendet në vende të ndryshme dhe njëkohësisht[19]. Të vetmuar, autorët mund të mos kenë kapacitetet për të mbikqyrur, filluar negociata dhe mbledhur paratë që burojnë prej përdorimit të veprës së tyre.

Këtu hyjnë në lojë agjencitë e administrimit kolektiv të të drejtave.

Kuptimi i administrimit kolektiv të të drejtave

Për herë të parë AAK-të janë krijuar me ligjin nr. 7564, datë 19.5.1992 ”Për të drejtën e autorit”, ligji i parë modern në këtë fushë. Ky ligj kishte marrë parimin e përgjithshëm sipas të cilit, ”*autorët i mbrojnë vetë të drejtat e tyre*”,[20] me përjashtimin e kuptueshëm kur ”*të drejtat nuk mund të ushtrohen vetë nga autorët*”, të cilët në këtë rast ”*kanë të drejtë që të themelojnë agjenci për mbrojtjen e të drejtave*”.[21] Në ndryshim nga çfarë parashikohet sot, AAK-të themeloheshin në gjykatë, ndërkohë që ministria e ngarkuar për çështjet e Kulturës mbikëqyrte veprimtarinë e tyre. Ligji gjithashtu tentonte që t›u jepte autorëve kompetenca të forta në përcaktimin e të drejtave të tyre në gjirin e agjencive. Kështu, «*autorëve, të drejtat e të cilëve administrohen nga agjencitë, u jepet informacion i rregullt, i plotë dhe i hollësishëm për veprimtarinë e agjencisë së tyre, me qëllim që të ushtrojnë të drejtat e tyre*”.[22] Gjithashtu, ”*pa autorizimin e autorëve, të drejtat e të cilëve administrohen drejtpërdrejt, ose nëpërmjet përfaqësuesve të tyre, asnjë honorar i mbledhur nga agjencitë e autorëve nuk mund të përdoret për qëllime të tjera, përveç qëllimeve që kanë të bëjnë me mbulimin e kostos aktuale të administrimit të të drejtave në fjalë dhe shpërndarjes së pjesës së honorareve që mbeten pas zbritjes së kostos së sipërpërmendur*”.[23]

Praktika e AAK-ve gjatë periudhës së zbatimit të igjit nr. 7564 ka qenë nën pritshmëritë. Vetëm një agjenci është krijuar gjatë kësaj periudhe, agjencia ’Albautor’, e krijuar nga autorët e veprave të ndryshme, kryesisht ato muzikore.

Ligji nr. 7564 nuk sqaronte natyrën juridike të AAK-ve. Kjo pikë mjaft e rëndësishme, e cila qendron në themel të çdo analize të mëtejshme që bëhet mbi lidhjen që krijohet midis anëtarëve të agjencisë dhe vetë agjencisë,

19. Po aty, fq. 19
20. Neni 41 i ligjit 7564
21. Po aty
22. Neni 47 i ligjit 7564
23. Po aty

u parashikua në ligjin 9380/2005, sipas të cilit, AAK-të do të jenë organizata jofitimprurëse. Në këtë kuptim, ligji 9380/2005 ishte në harmoni me direktivat përkatëse evropiane të cilat lënë një mundësi zgjedhjeje për shtetet për sa i përket formës juridike që ato mund t'u japin AAK-ve. Ato janë të organizuara sipas modelit të organizatës jofitimprurëse dhe liçencohen, duke filluar me hyrjen në fuqi të ligjit 9380/2005 nga ministria përgjegjëse për Kulturën. Në këto kushte, AAK-të do të rregullohen si nga legjislacioni në fuqi për të drejtën e autorit, ashtu edhe nga ligji për organizatat jofitimprurëse, për sa i përket organizimit të tyre. Të njëjtin parim e gjejmë dhe në ligjin për të drejtat e autorit.[24]

Me hyrjen në fuqi të ligjit 35/2016, tashmë ka një kuadër më të qartë të mënyrës së krijimit të tyre dhe të rolit që ato do të luajnë në administrimin e të drejtave të autorit. Administrimi kolektiv është një mënyrë suplementare[25] e administrimit të të drejtave nga autorët dhe titullarët e të drejtave të autorit. Në parim, si e drejtë pronësore, e drejta e autorit duhet të administrohet nga vetë autori ose titullarët.[26] Por zhvillimi teknologjik, kurorëzuar me digjitalizimin ka bërë që veprat të njohin një përhapje në publik masive dhe të shpejtë.[27] Ndërkombëtarizimi i repertoreve muzikore, shpërndarja e veprave nëpërmjet kanaleve të ndryshme jo tradicionale si për shembull *YouTube*, ose platforma të rrjeteve sociale si *Facebook* e kështu me radhë, ka bërë që autori ose titullarët të mos jenë në gjendje që të përballojnë veçmas administrimin e të drejtave të tyre, për shkak se bëhet gati e pamundur dhe kthehet në një përpjekje shumë të kushtueshme.

Në këtë kuptim, autorët apo titullarët e të drejtave mblidhen për të krijuar një AAK, e cila do të mbrojë interesat e tyre, interesa të cilat konsistojnë në dhënien e autorizimit për përdorimin e objektit të të drejtës së autorit, mbledhjen e shpërblimeve për përdorim të objektit të mbrojtjes, shpërndarjen e shpërbimeve të mbledhura, kontrollin e përdorimit të objektit të mbrojtjes si dhe nisjen dhe mbarëvajtjen e procedurave të mbrojtjes në rastet e shkaljes të të drejtave të autorit.[28] Kështu, AAK-të janë ndërmjetësit më të mirë ndërmjet autorëve apo titullarëve të të drejtave dhe përdoruesve të të drejtave.[29] AAK-

24. Shkronja a) e pikës 2 të nenit 133 të ligjit për të drejtat e autorit
25. Michel Vivant, Jean-Michel Bruguière, *Droit d'auteur*, 'Dalloz', 2009, fq. 579
26. Këtë parim parashikon neni 127 i ligjit 35/2016
27. Michel Vivant, Jean-Michel Bruguière, *Droit d'auteur*, 'Dalloz', 2009, fq. 579
28. Neni 128 i ligjit 35/2016
29. Michel Vivant, Jean-Michel Bruguière, *Droit d'auteur*, 'Dalloz', 2009, fq. 582

të krijohen nga një grup autorët ose titullarësh të të drejtave, në funksion të interesave të titullarëve të të drejtave, të parashikuar në nenin 130 të ligjit 35/2016. Krijimi i tyre do të bëhet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas formës së organizatës jofitimprurëse. Ato pajisen me statutin e tyre ku do të parashikojnë me imtësi funksionimin e tyre.[30] Por më e rëndësishmja është se, ato duhet të liçencohen nga ministria përgjegjëse për të drejtën autorit, liçencë e vlefshme për 3 vjet dhe e rinovueshme.[31] Liçencimi është një moment i rëndësishëm pasi autoriteti publik duhet të dijë nëse AAK-të kanë mundësitë dhe logjistikën e nevojshme që të kryejnë punën e tyre plotësisht dhe në respekt të të drejtave të autorit. Administrimi i këtyre të drejtave është shumë i rëndësishëm për t'ju lënë në dorë individëve që nuk kanë asnjë kontroll ose mbikëqyrje nga organet publike ose private mbikëqyrëse. Prandaj, disa autorë kanë shprehur idenë se lindja e AAK-ve është një "lindje e kontrolluar",[32] për shkak të misionit specifik që kanë. AAK-të veprojnë nëpërmjet mekanizmit juridik të përfaqësimit, sipas parashikimeve të nenit 64 të Kodit Civil. Detyrat e saj janë përcaktuar në Ligj, ashtu siç mund të përcaktohen detyra të tjera, me anë të kontratës ndërmjet autorëve dhe AAK-së. Në çdo rast, ashtu siç e parashikon dhe vetë kuptimi i përfaqësimit, AAK nuk mund të kryejë veprime juridike në emër të autorit, nëse ky i fundit nuk e ka lejuar shprehimisht.[33] Kjo do të thotë se kompetencat e AAK ushtrohen për ato të drejta dhe vepra që ka autorizuar autori. Misioni i tij duhet të interpretohet në mënyrë strikte: kompetenca për të hyrë në transaksione të ndryshme nuk përfshin atë të zgjidhjes së konfliktit,[34] ashtu sikundër e drejta për të kryer një shitje nuk përfshin atë të huadhënies, nëse kjo nuk është e specifikuar në kontratën e përfaqësimit.[35]

Duke patur parasysh se qëllimi i tyre është edhe mbledhja e sa më shumë anëtarëve, ato i ngjajnë më shumë formës së shoqatës. Megjithatë, ka

30. Neni 133 i ligjit 35/2016
31. Neni 134 i ligjit 35/2016
32. Christophe Caron, *Droit d'auteur et droits voisins*, 'Litec LexisNexis', botimi III, 2013, fq. 443
33. Neni 67 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë
34. Përfaqësimi në proceset gjyqësorë në emër të autorit, parashikohet ne nenin 137 të ligjit 35/2016, për aq sa është dhënë kjo kompetencë nga autori. Një AAK në këtë rast do të ketë të njëjtin trajtim si autori (shih : D. Bainbridge, *Intellectual Property*, ninth edition, UK 2012, fq. 118)
35. François Collart Dutilleul, Philippe Delebecque, *Contrats civils et commerciaux*, 'Dalloz', Botimi IX, Paris 2011, fq. 555

disa dallime fort thelbësore ndërmjet OJF-ve dhe AAK-ve. Kryesorja ndër to dhe që mjafton për të treguar mospërputhjen, çka mund të krijojë probleme në regjistrimin e tyre është se anëtarët e AAK-së shpërndajnë fitime, ndërkohë që anëtarët e një shoqate nuk duhet të shpërndajnë fitime, pasi është e ndaluar nga Ligji 8878/2001 "Për organizatat jofitimprurëse". Nga ana tjetër, AAK-të nuk janë shoqëri tregtare, pasi qëllimi i tyre është administrimi dhe jo nxjerrja e fitimit. Në këtë kontekst, AAK-të janë grupime *sui generis*, të cilave anëtarët e tyre u kanë dhënë mandatin[36] brenda kuadrit të përcaktuar në nenin 128 të ligjit 35/2016.

Më tej, AAK-ve u shtohen anëtarë të tjerë në mënyrë të vullnetshme. Të mos harrojmë parimin: administrimi i të drejtave bëhet në mënyrë individuale, me përjashtim të rasteve kur autorët ose titullarët e të drejtave pranojnë të hyjnë vullnetarisht në AAK dhe, rrjedhimisht. të bëhen anëtarë të saj. Veprimi juridik me anë të të cilit AAK-të bëhen anëtarë është kontrata.[37] Paraprakisht AAK duhet të informojë autorin ose titullarin e të drejtave për tërësinë e detyrave dhe funksioneve të saj, të shtjelluara në mënyrë shteruese në nenin 137 të ligjit për të drejtën e autorit.

Administrimi kolektiv i të drejtave përfshin katër shtylla kryesore. Ligji 35/2016 nuk thotë nëse për secilën shtyllë duhet të ketë një dhe vetëm një AAK. Nëse po, do të ishte nje dispozitë që do të binte potencialisht ndesh me parimin e konkurrencës së lirë. Megjithatë, është e qartë se në kushtet e Shqipërisë, edhe pse krijimi i agencive mund të mos kufizohet, është më e volitshme që agjencitë të jenë në një numër të tillë që të sigurojnë efektshmërinë e të drejtës së autorit, si në mbledhjen e tarifës, ashtu dhe në shpërndarjen e fitimeve mes autorëve. Katër shtyllat parashikohen në nenin 130 të Ligjit për të drejtën e autorit dhe janë: (i) administrimi kolektiv i të drejtave të autorit, (ii) administrimi kolektiv i të drejtave të interpretuesve/ekzekutuesve; administrimi kolektiv i të drejtave të prodhuesve të fonogramit si dhe (iv) administrimi kolektiv i producentëve të filmave. Neni 130 i ligjit parashikon një sërë të drejtash për çdo agjenci kolektive. Këto të drejta nuk janë shteruese, çka u lejon anëtarëve të AAK-së që të parashikojnë të drejta të tjera administrimi.

Së fundi, risia e ligjit 35/2016 është parashikimi i një administrimi kolektiv të detyrueshëm për ato fusha ku është publikisht e ditur se autorët ose

36. Christophe Caron, *Droit d'auteur et droits voisins*, 'Litec LexisNexis', botimi III, 2013, fq. 442
37. Neni 132 i ligjit 35/2016

titullarët e kanë shumë të vështirë që të administrojnë të drejtat e tyre si për shembull: transmetimet dhe ritransmetimet për autorët, e drejta për shpërblim për komunikimin publik të veprës fonogram si dhe e drejta për shpërblim për riprodhimin e kopjeve private dhe përdorimit personal për autorët dhe titullarët e tjerë të të drejtave.[38]

Risia e dytë është parashikimi i sportelit unik në lidhje me mbledhjen e shpërblimeve. Kështu, nisur nga një praktikë e huaj dhe e promovuar edhe nga Direktiva përkatëse, AAK-të pranojnë, nëpërmjet një marrëveshjeje me shkrim, të caktojnë njërën prej tyre si sporteli në të cilin do t'i "*transferohet funksioni i mbledhjes së tarifave për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave*".[39] Nëse palët nuk bien dakord, KKDA që do ta caktojë, duke iu referuar disa kritereve objektive.[40] Këto kritere objektive mund të ndihmojnë palët që, në brenda harkut kohor prej 30 ditësh, të përcakojnë atë AAK që mund ta kryejë më mirë këtë funksion.

Veprimtaria e agjencive të administrimit kolektiv

Përgjithësisht praktika e AAK-ve në Shqipëri ka lënë për të dëshiruar. Praktika e tyre e punës ka qenë e paqartë, bilancet e tyre nuk janë bërë asnjëherë të njohura, ndërveprimi me autorët që presupozohen se janë dhe anëtarë të tyre ka qënë i pakët. Gjithashtu, ato kanë krijuar një emër negativ në publik për shkak të ndërhyrjeve të tyre në disa çështje gjyqësore të cilat kanë treguar se ato nuk kanë interes të mbrojnë të drejta por nëpërmjet këtyre procedurave të fitojnë të drejta që nuk u takojnë. Dy shembuj do të sjellim në këtë trajtim. E para është çështja gjyqësore që rezultoi në Vendimin e Gjykatës së Lartë nr. 1426, datë 21.12.2010 dhe çështja tjetër ilustrohet nëpërmjet Vendimit të datës 23.12.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Një veprimtari abuzive ndaj përdoruesve të veprave. Çështja e parë e rëndësishme në lidhje me veprimtarinë e AAK-ve ishte ajo që vinte përballë agjencinë 'Albautor' dhe operatorët celularë 'Vodafone'

38. Neni 131 i ligjit 35/2016. Në lidhje me mënyrën e shpërblimit, Ligji bën një ndarje artificiale ndërmjet riprodhimeve të veprave nëpërmjet pajisjeve regjistruese, kasetave, videokasetave dhe pajisjeve të fotokopjimit, për të cilat tarifa është përcaktuar sipas pikës 1 të nenit 139 të Ligjit 35/2016 dhe fushave të tjera ku, me sa duket, shpërblimi do të bëhet në bazë marrëveshjeje mes AAK-ve dhe autorëve
39. Neni 138 i ligjit 35/2016
40. Po aty

dhe 'AMC'[41] ("Operatori" apo "Operatorët"). Agjencia Albautor pretendonte pagesën nga ana e operatorit celular, të tarifave të ofrimit të shërbimit të ringtoneve të instaluar në celular, pra jo të ringtoneve të shkarkuar pasi përdoruesi fundor ka blerë celularin. Albautor pretendonte se operatori, me anë të aktivizimit të kartës SIM (kartë që i përkiste këtij të fundit, ajo bën të mundur dhe dëgjimin e zileve të instaluara në celular). Meqënëse këto ringtone kanë autorë dhe meqënëse, sipas pretendimeve të Albautor, kjo e fundit pretendonte se mbulonte të drejtat e të gjithë autorëve në botë, Operatori, kishte shkelur të drejtat e autorit, për të cilat Albautor kishte tagër t'i mbronte. Gjykata e Lartë në vendimin e saj numër 1426, datë 21.12.2010, e hedh poshtë këtë pretendim, duke saktësuar dhe rolin e Albautor dhe të Operatorëve, ashtu si dhe atë të përdoruesve fundorë, pra të agjencive të administrimit të të drejtave si dhe të operatorëve celularë dhe të konsumatorëve.

Sipas Gjykatës së Lartë, në thelb të këtij kërkimi është pretendimi dhe arsyetimi i 'Albautor', se pala e paditur ka përdorur pronësi artistike, më konkretisht vepra muzikore dhe audiovizive, të cilat gjenden në vetë aparatet telefonikë lëvizës (mobile), të instaluara nga prodhuesit e këtyre aparateve, si funksion sinjalizues për thirrje telefonike (ringtone), në formën e melodive apo sinjaleve zanore të thjeshta. Këtë përdorim pala e paditur, 'Vodafone Albania' sh.a., e ka realizuar nëpërmjet dhënies në përdorim të kartës SIM me numrin përkatës telefonik, si edhe përcjelljes së sinjalit për thirrje telefonike tek mbajtësi i aparatit telefonik me kartë SIM dhe numër telefoni të dhënë nga kjo palë abonentëve të saj.

Pra, ky përdorim i pronësisë artistike është realizuar nga 'Vodafone Albania' përmes dërgimit të sinjaleve të thirrjeve telefonike në aparatet telefonikë (celularë), gjatë realizimit të komunikimit mes klientëve të saj. Duke dërguar sinjalin për komunikimet e thirrjet telefonike në aparatet telefonikë (celularë) të klientëve të saj, pala e paditur bën të mundur që të shfaqen, të bëhen të dëgjueshme në publik veprat artistike që gjenden në vetë aparatin telefonik, në formën e sinjaleve të thjeshta apo melodive të ndryshme (ringtone), të para-instaluara nga prodhuesi i këtyre aparateve telefonikë celularë.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë pranoi rekursin e 'Vodafone Albania' dhe rrëzoi pretendimet e Albautor, duke thënë se aktivizimi i muzikës nëpërmjet thirrjes telefonike nuk mund të asimilohet me një përcjellje të

41. Në fakt bëhet fjalë për dy çështje me objekt të njëjtë

veprës në publik, të iniciuar nga Vodafone, akoma më tepër kur bëhet fjalë për zile të para-instaluara , pra, që gjenden në celular, të cilat operatori nuk i ofron.

Vendimi ishte mjaft i qartë dhe nxori në pah odisenë juridike për një çështje mjaft periferike dhe e ngritur abuzivisht nga agencia kolektive, e cila harroi punën e saj të përditishme për t'u fokusuar në një çështje që ishte kryekëput e pabazuar në ligj dhe në prova.

Mungesa e mbrojtjes së autorëve nga veprimet e palëve të treta. Në çështjen *Trebicka kundër Vodafone*, të shqyrtuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë dhë pranë Gjykatës së Apelit, doli në pah dhe njëherë ngatërresa e roleve që ka secili aktor i të drejtës së autorit. Autorët në këtë rast pretendonin se Vodafone ka shkelur të drejtën e tyre të autorit pasi nuk u ka marrë autorizimin për përdorimin e ringtoneve të këngëve të tyre. Ndërkohë që Operatori Celular ngrinte pretendimin se ringtonet janë prodhuar nga një shoqëri e teknologjisë së informacionit, janë ofruar prej saj dhe në bazë të një kontrate të lidhur me autorët. Bazuar në Ligjin për tregtinë elektronike operatorët e telefonisë celulare kryejnë funksionin e ndërmjetësit të ofrimit të shërbimit për sa i përket shërbimeve të zileve ringtone. Një përkufizim i qartë i përgjegjësisë së ndërmjetësit teknik jepet në Ligjin 10,128 Për tregtinë elektronike (Ligji Për Tregtinë Elektronike) dhe direktivën e BE-së mbi tregtinë elektronike të vitit 2000 (përshtatje e të cilës është dhe ligji ynë për tregtinë elektronike). Sipas ligjit për Tregtinë Elektronike, "*ndërmjetësi i shërbimit është çdo person fizik ose juridik, i cili mundëson transmetimin e mesazheve apo të dokumenteve të ofruesit të shërbimit të shoqërisë* **së informacionit tek të tretët** *apo që çon mesazhe a informacione nga marrësit e shërbimit dhe të mallrave nga të tretët te ofruesi i shërbimit të shoqërisë së informacionit*".[42] Sipas përkufizimit, ndërmjetësit përjashtohen nga përgjegjësia civile nëse nuk kanë qenë efektivisht në dijeni të karakterit të paligjshëm të informacionit të përcjellë.

Për të ilustruar këtë pohim, po rimarrim pjesën arsyetuese të Vendimit të Gjykatës së Lartë nr. 1426, datë 21.12.2010,[43] të përmendur më sipër:

"Dërgimi dhe përcjellja e sinjalit për thirrje telefonike apo komunikim çfarëdo nga ana e operatorit telefonik të lëvizshëm (qoftë edhe të palëvizshëm), sikurse është edhe e paditura "Vodafone Albania" sha, nuk është një veprim që përbën në vetvete shfaqje në publik të fonogramit që

42. Neni 3 pika d) e ligjit Për Tregtinë Elektronike
43. I konsultueshëm në faqen e Gjykatës së Lartë: www.gjykataelarte.gov.al

gjendet në aparatin telefonik. E paditura thjesht dërgon një sinjal për të njoftuar abonentin se ka një thirrje telefonike dhe përmes sistemit të saj mundëson që më pas ai të komunikojë pa kabëll me thirrësin.

Nga ana tjetër, përdoruesi i telefonit të lëvizshëm, nëse e ka zgjedhur, e shfrytëzon fonogramin që gjendet i instaluar në telefon privatisht, vetëm me qëllimin që t'i mundësohet pikërisht atij, jo publikut, se ka një thirrje telefonike. Përdoruesit të telefonit, fonogrami sinjalizues (ringtone-zilja) nuk i shërben për ndonjë qëllim tjetër, madje as edhe nuk ka përfitim tjetër të natyrës tregtare, ekonomike e financiare nga bërja të dëgjueshme për të të këtij sinjalizuesi zanor (zile) telefonik. Veç kësaj, vetë karakteristikat dhe destinacioni i aparatit telefonik të lëvizshëm, nuk janë që të shërbejnë për shfaqje publike të melodive dhe video-ve.

Edhe nëse do të mendohej për një çast se përdoruesi i telefonit do ta shfrytëzonte për një qëllim të tillë, edhe nëse karakteristikat e pajisjes do ta mundësonin një gjë të tillë, kjo do të përbënte një shkelje të së drejtës së autorit nga vetë mbajtësi i aparatit që shërben për thirrjet telefonike të lëvizshme. Nuk mund të mbajë përgjegjësi ofruesi i shërbimit telefonik të lëvizshëm për këtë shkelje të supozuar nga ana e abonentit të tij telefonik. Veç kësaj, e rëndësishme është të mbahet parasysh që kjo shkelje mund të konsumohet në mënyrë të pavarur nga operatori i telefonisë së lëvizshme, pra edhe pa marrë ndonjë sinjal për thirrje telefonike. Operatori vetëm dërgon sinjal për thirrje telefonike, ky është qëllimi i tij.

Kolegji Civil çmon edhe të evidentojë se, për vetë natyrën e veprimtarisë, operatori i shërbimit telefonik të lëvizshëm nuk ka asnjë interes e përfitim tregtar e ekonomik. Ai as mund ta nxitë, as mund ta shtrëngojë dhe as mund ta detyrojë apo kufizojë, nga pikëpamja e vullnetit dhe e teknologjisë, abonentin e tij që të përdorë sinjalin e thirrjes telefonike si mundësi për të shfaqur në publik një fonogram. Pra, edhe nëse do të pranohej abuzimi me të drejtën e autorit si shfaqje publike, ai duhet t'i ngarkohej atij që kërkon dhe përpiqet të përdorë qoftë edhe një pajisje të tillë si aparati telefonik celular, për qëllime të një shfaqje publike të fonogrameve që mbarten në atë aparat."

Në këtë kuptim, operatori celular ka qenë jashtë çdo lloj përgjegjësie të karakterit civil pasi ai jo vetëm ka respektuar detyrimet kontraktuale por nuk ka vepruar në asnjë çast, gjatë ekzekutimit të kontratës, në tejkalim të detyrimeve të saj kontraktore. Vendimi i Gjykatës së Apelit rrëzoi pretendimin e agjencisë kolektive, duke pranuar argumentet e Operatorit Celular. Edhe

nëpërmjet këtij rasti, kuptojmë qartë se aktiviteti i agjencive kolektive ka qenë abuziv dhe kundërproduktiv. Ndryshimet ligjore rrjedhimisht kanë rezultuar mëse të domosdoshme. Por, a do të ndiqen nga faktet?

Nevoja e rithemelimit të AAK-vë në ndikimin e shoqërisë së informacionit

Ashtu siç dhe integrimi në BE është një proces i vazhdueshëm, edhe procesi i përafrimit me legjislacionin e BE-së njeh dhe do të kalojë nëpërmjet një procesi përditësues të legjislacionit tonë. Vlen këtu të theksojmë se Ligji 35/2016 ka arritur të përfshijë edhe aspektet e Direktivës 2014/26/EU, miratuar në shkurt 2014, në lidhje me administrimin dhe liçencimin multiterritorial të të drejtave mbi veprat muzikore për përdorimet në linjë (*online*).[44] Fatmirësisht, me miratimin e ligjit 35/2016, këto çështje mund të konsiderohen globalisht të përafruara me parashikimet e asaj Direktive direktivë me miratimin e Ligjit 35/2016.

E kuptuam pra, se dy shqetësimet më të mëdha që lidhen me AAK-të janë transparenca dhe mbikëqyrja e aktivitetit të tyre, si kundërpeshë e një autonomie të sanksionuar dhe të ripohuar nga direktivat në favore të AKK-ve. Ligji aktual, përpiqet të sjellë maksimumin në këto dy elementë të rëndësishëm, gjithmonë duke patur si pikë referimi direktivat e BE-së që rregullojnë këtë fushë.

Autonomia në kryerjen e veprimtarive të AAK-ve. Autonomia në përmbushjen e veprimtarive të AAK-ve vërehet në (i) formën juridike që ato kanë dhe (ii) në mënyrën e përcaktimit dhe të menaxhimit të të ardhurave që sigurojnë prej vjeljes së shumave nga përdoruesit e të drejtave të autorit.

Për sa i përket formës juridike, Direktiva 2014/26/EU parashikon që AAK-të duhet të kontrollohen, ose të zotërohen nga anëtarët e tyre (autorët, artistët, producentët, sipas kategorive të caktuara…) dhe duhet të mbështeten në formën e organizatave jofitimprurëse.

Ligji 35/2016 i parashikon të dyja këto kritere.[45] Ideja e përgjithshme është se AAK-ja nuk duhet të jetë një shoqëri tregtare, pra, nuk duhet të ketë si motiv sigurimin e fitimit. Direktiva 2014/26/EU e lë këtë pikë të hapur për t'u vendosur nga vetë shtetet, në funksion të organizimit të AAK-

44. http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32014L0026 (FZ e BE-së L84 datë 20.3.2014)
45. Neni 133 i igjit 35/2016

vë ekzistuese në secilin shtet.[46]. Në Shqipëri ato kanë formën e organizatave jofitimprurëse, por për shkak të misionit të tyre, që është të mbledhin shumat në favor të autorëve dhe t'ua shpërndajë atyre, ato do të kenë një natyrë juridike *sui generis*. Ligji përcakton se AAK-të do t'i nënshtrohen ligji për organizatat jofitimprurëse për sa i përket regjistrimit të tyre, ndërkohë që në të njëjtën linjë Direktiva thotë se ato nuk duhet të kenë veprimtari fitimprurëse. AAK-të duhet të kenë një status të veçantë dhe ndoshta të mos i nënshtrohen ligjit për OJF-të, pasi ky ligj ndalon dhe fitimin në favor të anëtarëve, gjë që bie në kundërshtim me vetë misionin e AAK-ve. Në këtë pikë, është e nevojshme një përafrim më i plotë me direktivën dhe një sqarim i statusit të AAK-ve, qoftë dhe me ndërhyrje ligjore. Megjithatë vlen të bëjmë një koment në lidhje me natyrën sui generis të AAK-ve. Regjistrimi i tyre rregullohet nga ligji 8788/2001 "Për organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar.[47] Edhe nga leximi i ligjit për të drejtat e autorit na rezulton se, edhe mënyra e organizimit dhe e funksionimit të AAK-ve duhet të bazohet në ligjin 8788/2001. Kështu, AAK duhet të ketë statutin e saj në përputhje me legjislacionin e organizatave jofitimprurëse.[48] Kjo do të thotë se, veprimtaria e përditshme dhe organet duhet të bazohen në përcaktimet e këtij ligji. Nga pikëpamja formale, AAK-të janë subjekte juridike të ngjashme, për të mos thënë identike me organizatat jofitimprurëse. Ndërkohë, një nga misionet e AAK-ve është që të mbledhin shumat nga kontratat që do të lidhin me përdoruesin e veprave artistike dhet t'ua rishpërndarjnë autorëve ato, në raport me shfrytëzimin që i është bërë çdo vepre. Në këtë kuptim, misioni i tyre qëndron tërësisht në një pozicion diametralisht të kundërt me misionin e organizatave jofitimprurëse. Shpërndarja e fitimeve është misioni kryesor i shoqërive tregtare. Megjithatë, AAK-të prapë nuk mund të konsiderohen në sytë e ligjit tonë si shoqëri tregtare, edhe pse ato kryejnë veprimtari tregtare, sepse autorizimi që japin nëpërmjet lidhjes së kontratave përbën një akt tregtar. Megjithatë, nëse qëllimi i shoqërive tregtare është të krijojnë fitime për shoqërinë, rrjedhimisht për aksionerët, që në rastin konkret aksionerë mund të konsiderojme autorët, AAK-të nuk krijojnë fitim: nëpërmjet

46. Pika 14 e Direktivës: "*This Directive does not require collective management organizations to adopt a specific legal form. In practice, those organizations operate in various legal forms such as associations, cooperatives or limited liability companies, which are controlled or owned by holders of copyright and related rights or by entities representing such rightsholders*."
47. Neni 133 i ligjit 35/2016
48. Po aty

kontratave që lidhin me përdoruesin, ato sigurojnë shpërblimin e autorëve. Të ardhurat nuk konsiderohen të jenë të AAK-së,[49] por të autorëve, të cilët përfitojnë nga një punë ekzistuese dhe jo nga një veprim të krijuar nga AAK. Por edhe këtu, debati doktrinar është ende i hapur.

Organi më i lartë i AAK-së është asambleja e anëtarëve, i cili duhet të mblidhet në mënyrë të rregullt, por në çdo rast jo më pak se një herë në vit. Kjo asamble do të vendos mbi çështjet kryesore të AAK-së si për shembull mbi statutin apo ndryshimet e tjera ligjore, mbi shperndarjen e të ardhurave për shkak të shfrytëzimit të të drejtave, mbi aktivitetin financiar, si dhe mbi organet drejtuese.[50] Edhe këtu kemi një përafrim me direktivën 2014/26/EU.[51] Detyrimi që përcakton Ligji për mbledhjen e asamblesë në mënyrë të rregullt është një pasojë direkte e parashikimeve të konsideratës 22 të Direktivës 2014/26/EU, sipas të cilës anëtarët duhet të kenë të drejta të plota që shprehen kryesisht duke qenë të pranishëm në proceset vendimmarrëse të agjencisë.[52]

Së dyti, për sa i përket administrimit të të ardhurave, duhet thënë në radhë të parë se pasi autori autorizon një AAK të administrojë të drejtat e tij pasurore, AAK ka të drejtën të hyjë në marrëdhënie kontraktore me çdo përdorues (person juridik, person fizik, individ apo grupim individësh) që t'i autorizojë të përdorin një vepër të caktuar. Në mënyrë periodike, AAK-ja mbledh shpërblimet për përdorimin e të drejtës së autorit dhe i menaxhon dhe i shpërndan ato, pasi të ketë hequr një fond të caktuar prej tyre, që do të shërbejë vetëm për mirëmbajtjen e agjencisë. Pra, pika e nisjes do të jetë gjithmonë autorizimi i autorit.

Ligji 35/2016 sjell një risi për sa i përket mbledhjes së shumave nga shpërblimi i drejtë.[53] Neni 139 i ligjit për të drejtën e autorit thotë se, për shpërblimet e mbledhura sipas nenit 31, nen që flet për përdorimin e veprave në kuadër të përjashtimeve, ose kufizimeve të të drejtës së autorit, kryesisht për përdorim vetjak, autorët marrin 40%, interpretuesit dhe/ose ekzekutuesit

49. Edhe pse një pjesë e të ardhurave qendrojnë brenda AAK-së për qëllime administrimi, ato nuk konsiderohen si të ardhura për shoqërinë, në kuptimin tregtar të fjalës
50. Neni 133 i ligjit për të drejtat e autorit
51. Neni 8 i Direktivës
52. Lucie Guibault, Stef van Gompel, *Collective Management in the European Union, in Collective Management of Copyright and Related Rights*, Third Edition, 'Aspen Publishers', UK 2015
53. Neni 139 i ligjit

30% dhe prodhuesit e fonogrameve ose prodhuesit e filmit 30%.

Kjo pikë, nga direktivat e BE-së, është lënë në pëlqim të shteteve dhe në këtë kuadër,[54] Ligji 35/2016 sanksionon krijimin e AAK-ve të reja që do të administrojnë dhe do të mbledhin në mënyrë të detyruar, pra, pa autorizimin e autorit, shumat që vijnë nga shpërblimi i drejtë. Në këtë kuptim, ligji 35/2016 rrit autonominë e disa AAK-ve, gjë që duhet të sjellë në mënyrë të pashmangshme rritjen e nivelit të transparencës dhe të mbikqyrjes mbi to.

Transparenca e veprimtarisë së AAK-ve. Për sa i përket liçencimit të AAK-ve Ligji 9380/2005 ka patur mangësi në lidhje me transparencën e procedurave. Ligji 35/2016, duke u udhëhequr nga parimi i transparencës parashikuar në dy direktiva,[55] parashikon procedura, në mos më të qarta, më të shtjelluara, në të cilat shpjegohen të gjitha hapat që duhet të ndjekin organet përkatëse për të mbërritur në dhënien e liçencës[56] **në favor të AAK-ve. Procesi i dhënies së liçencës do t'i bindet procedurave të parashikuar në Ligjin për lejet dhe liçencat në Republikën e Shqipërisë**.[57] Zbatimi i këtij ligji ka si pasojë kryesore publicitetin e procedurës së liçencimit, pasi liçencat që merren nëpërmjet këtij ligji, bëhen nëpërmjet procedurave që synojnë transparencën.

Në lidhje me detyrimet që ka AAK ndaj anëtarëve të saj, në ligj reflektohet një përmirësim i dukshëm. Në nenin 133 të ligjit, parashikohet forma e themelolimit të AAK-ve dhe kuadri rregullator i tyre. Meqënëse AAK-të do të regjistrohen sipas procedurës së regjistrimit të OJF-ve dhe duke patur parasysh që në to do të marrin pjesë jo vetëm anëtarët themelues, por edhe çdo anëtar tjetër që kërkon të jetë pjesë e AAK-së, ato do t'i ngjasojnë më shumë formës juridike të shoqatës. Duke qenë kështu, ligji parashikon mbledhjen e asamblesë së përgjithshme të paktën një herë në vit ku do të miratohet statuti dhe ndryshimet përkatëse, rregullat e përzgjedhjes së drejtuesve, mbikëqyrja e tyre dhe rregullat e administrimit financiar. Roli i anëtarëve nuk duhet të jetë pasiv dhe ligji jep disa garanci drejt këtij qendrimi.[58] Gjithashtu, ndryshimi i statutit duhet të miratohet dhe nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit,[59] pranë Ministrisë së Kulturës. Edhe kjo

54. Neni 13 i Direktivës
55. Direktiva 2014/26/BE dhe Direktiva 2001/29/KE
56. Liçencat jepen nga ministri përgjegjës për Kulturën
57. Pika 2 e nenit 134 të ligjit 35/2016
58. Pika 2.iii e nenit 133 të ligjit 35/2016
59. Ish Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit, e cila tashmë do të jetë në organigramën e Ministrisë së Kulturës

pikë përbën një garanci më shumë transparence, edhe pse ndërhyrja e një organi shtetëror në rishikimin e statutit mund të duket abuzive. Shpërblimi që do të marrin AAK-të prej përdoruesve të të drejtave janë objekt i një përcaktimi të qartë nga përdoruesit, se ku dhe në ç'masë do të përdorën. Këtë informacion ato duhet t'ua komunikojnë AAK-ve paraprakisht, ose të paktën 15 ditë pas përdorimit. Megjithatë, AAK dhe përdoruesit mund të bien dakord për një afat tjetër.[60] Së fundi, AAK duhet të parashikojë rregulla të qartë të shpërndarjes së shpërblimeve në favor të anëtarëve të saj (rregulla këto që do të votohen nga asambleja e përgjithshme dhe më tej), si edhe rregullat dhe fitimet që do të dalin nga vjelja e shpërblimit do të publikohen dhe do të jenë në dispozicion të anëtarëve në çdo kohë.[61] Këto parime nuk përmbushen dot vetëm duke u parashikuar në ligj. Duhet të ketë një vullnet të qartë dhe pa ekuivok të rolit të secilit: AAK është një person juridik i mandatuar nga anëtarët që janë realisht pronarët e të drejtave.

Dispozitat ligjore të sipërcituara janë hartuar që të rritet besueshmëria e AAK-ve pranë publikut, ashtu si edhe në gjirin e anëtarëve të saj. Në këtë kuptim ka qenë i nevojshëm përafrimi me Direktivën e sipërcituar, në mënyrë të veçantë për pikat që lidhen me transparencën dhe komunikimin e informacionit që kanë AAK-të.[62] Në këtë kategori përfshihet informacioni që AAK-të duhet t›u japin titullarëve të të drejtave mbi mënyrën sesi t'i administrojnë këto të drejta,[63] informacionin që duhet të japin AAK në favor të shoqërive që ato përfaqësojnë në Shqipëri.[64] Kjo pikë është mjaft e rëndësishme dhe mund të eliminojë abuzime të hasura më parë në praktikën e AAK-ve, që vepronin në emër të autorëve (kryesisht të huaj), pa patur mandatin e tyre. Së fundi, një rëndësi parësore ka dhe publiciteti i informacionit të AAK-ve, pra, bërja publike e informacioneve bazë të AAK-së, si për shembull: statutin, kontratat e liçencave, emrin e personave që administrojnë pjesën ekzekutive të AAK-ve, politikat e përgjithshme të shpërndarjes së fitimeve[65] etj. Këto pika janë të një rëndësie madhore, siç e thamë, për rritjen e besueshmërisë së AAK-ve.

Mbikëqyrja e veprimtarisë së AAK-ve. Me ligjin 9380/2005

60. Neni 150 i ligjit 35/2016
61. Neni 151 i ligjit për të drejtat e autorit
62. Kapitulli 5 i Direktivës
63. Neni 18 i Direktivës
64. Neni 19 i Direktivës
65. Neni 21 i Direktivës

mbikëqyrja e AAK-ve lidhej vetëm me detyrimin për informim që kishin ato ndaj Zyrës Shqiptare të të Drejtave të Autorit. Në rast se nuk merrej informacioni i kërkuar, ZSHDA (tashmë DDA) kishte të drejtën të kërkonte pezullimin e e liçenc**ës nga ministri përgjegjës për K**ulturën.

Ligji 35/2016, duke rimarrë procedurën më sipër e shtjellon atë dhe njëkohësisht rrit kontrollin e DDA-së, duke parashikuar për shembull, kontrolle të posaçme vjetore të detyrueshme.[66]

Megjithatë, edhe në këtë pikë, përpjekjet për përafrimin e legjislacionit nuk do të mungojnë. Për shembull, direktiva 2014/26/EU parashikon krijimin e një organi mbikëqyrjeje brenda vetë AAK-së.[67] Ndër të tjera, ky organ do të kishte mundësinë e kontrollit dhe të raportimit të vërejtjeve pranë Asamblesë së përgjithshme të AAK-së. Meqënëse direktiva lë hapësirë në organizimin e këtij organi të ri, mund të mendohej për shembullin që ky organ të përbëhej nga profesionistë jo anëtarë të AAK-së, bie fjala, gjyqtarë apo juristë me integritet të pacenuar.

Mbikëqyrja e AAK-ve kërkohet gjithashtu dhe nga gjykatat. Në këtë prizëm, më shumë sesa përafrim me tekstin e direktivave kërkohet prej gjykatave tona edhe një përafrim me praktikën e gjykatave evropiane, Gjykatës së Drejtësisë *in primis*. Ato, si gardiane të lirive dhe të të drejtave të njeriut duhet të luajnë edhe në këtë fushë rolin e tyre shumë të rëndësishëm në rregullimin e marrëdhënieve midis AAK-ve nga njëra anë dhe anëtarëve e përdoruesve nga ana tjetër. Kjo për faktin se, AAK-të administrojnë të drejtat e autorit, të cilat përbëjnë një monopol në vetevete, rrjedhimisht AAK-të mund të jenë në një pozitë monopol dhe të kenë një pozitë dominuese në tregun artistik.

Kështu, për sa i përket abuzimit me pozitën dominuese në treg, Gjykata e Drejtësisë ka shprehur idenë se, së pari AAK-të hyjnë në përkufizimin e "ndërmarrjeve", për qëllimet e zbatimit të nenit 102 të Traktatit të BE-së, në lidhje me konkurrencën.[68] Së dyti, angazhimet e panevojshme dhe të tepërta që AAK-ja i kërkon autorit rrjedhimisht shkelin lirinë e tij në ushtrimin e të drejtës së autorit mund të përbëjnë një abuzim me pozitën dominuese. Konkretisht, Gjykata e Drejtësisë është shprehur se përbën abuzim me pozitën dominuese fakti që u imponohet autorëve një

66. Shkronja f) e pikës 2 të nenit 157 të ligjit për të drejtat e autorit
67. Neni 9 i Direktivës
68. Vendimi i Komisionit Evropian, më 8 tetor 2002 (COMP/C2/38.014 – IFPI "Simulcasting")

cedim global dhe të përgjithshëm të të drejtave që shkonte përtej periudhës së anëtarësisë së autorit në AAK.[69] Kjo do të thotë, se është e rëndësishme të kontrollohet angazhimi që kërkon AAK-ja nga autori, pasi edhe po të lexojmë tekstet e direktivave do të shikojmë se autori ka të drejtë të autorizojë një AAK që të administrojë të drejtat e tij, kategorinë e këtyre të drejtave, territorin dhe afatin.[70] Autori pra, në përcaktimin e të drejtave që do të menaxhohen është i lirë, dhe është pikërisht kjo liri që duhet ruajtur duke rritur mbikqyrjen mbi AAK-të. Megjithatë, në jurisprudencën e fundit të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë vihet re një pranim i monopolit shtetëror të AAK-ve, pasi "*një përdorues i një vepre artistike që zgjedh një AAK të caktuar në një vend tjetër të BE-së, do të krijonte, në stadin aktual të të drejtës së BE-së, probleme të rëndësishme kontrolli në lidhje me përdorimin e të drejtave"*.[71] Monopoli shtetëror mund të krijojë një pozitë dominuese, gjë që edhe në jurisprudencën e re, Gjykata Evropiane e Drejtësisë e pranon si rrezik potencial.[72] Megjithatë, ajo shprehet, se: "*nëse një AAK përdor tarifa për shërbimet që ofron më të larta se nga ato të zbatuara në vendet e tjera anëtare, dhe nëse vlerësimi i tarifave bëhet në bazë të një krahasimi homogjen, është pikërisht kjo diferencë, që nëse rezulton e ndjeshme, shkel konkurrencën"*.[73]

Së fundi, ashtu si edhe Autoriteti i Konkurrencës (të cilin nuk e përmendëm, por është organi që mund të thirret të trajtojë çështje që lidhen me AAK-të), gjykatat duhet të kontrollojnë dhe situatën monopol që ato mund të krijojnë në raport me përdoruesit e të drejtave. Përdoruesit e të drejtave lidhin marrëveshje me AAK-të për përdorimin e veprave dhe, në bazë të këtij përdorimi, ata duhet të paguajnë një tarifë periodike në favor të AAK-ve. Pikërisht, menyra e përcaktimit të tarifave mund të përbëjë problem, në rast se ato janë më të larta, ose të përcaktuara në mënyrë abuzive nga AAK-të. Kontrolli në këtë rast do të jetë i dyfishtë: së pari, nga Këshilli Kombëtar i të Drejtës së Autorit, organ i ri i krijuar me ligjin 35/2016, i cili miraton edhe

69. Gjykata e Drejtësisë, më 25 tetor 1979, in Christophe Caron, *Droit d'auteur*, 'Litec LexisNexis', botimi III, fq. 452
70. Shih gjithashtu vendimin e Komisionit Evropian, datë 6.8.2008 (COMP/C2/37.219 Daft Punk k. SACEM
71. Vendimi i CJUE për çështjen *OSA vs. Republika çeke*, 27.4.2014 (eur.lex.europa.eu/legal-content/)
72. Po aty
73. Po aty

metodologjinë e tarifave,[74] që AAK duhet t›i dorëzojë në bazë të kritereve që janë përcaktuar më qartë në ligjin për të drejtat e autorit;[75] së dyti, nga gjykatat, të cilat mund të njohin çështje të tilla, duke zbatuar jo vetëm ligjin për të drejtat e autorit, por edhe kriteret e përgjithshme të nenit 608 të Kodit Civil, me qëllim përcaktimin e fajit, dëmit dhe lidhjes shkakësore mes tyre. Natyrisht, këtu duhet përmendur sërish dhe roli i Autoritetit të Konkurrencës, që në një të ardhme mund të jetë i detyruar të shqyrtojë çështje të tilla.

Konkluzion

AAK-të janë një hallkë shumë e rëndësishme e zbatimit efektiv të të drejtës së autorit. Autori dhe titullarët e tjerë të të drejtave përballen gjithmonë e më shumë me vështirësinë e administrimit dhe kontrollit të qarkullimit të pronës së tyre. Përdoruesit e të drejtave të autorit kanë sot më shumë mjete teknike në dispozicion, krahasimisht me vite më parë, për të vënë në qarkullim veprat, pa patur domosdoshmërisht autorizimin e titullarëve të të drejtave. Kjo situatë joligjore është pasojë direkte e zhvillimit teknologjik. Për t'i bërë ballë kësaj situate, prania e AAK-ve mund të rezultojë e domosdoshme, sepse si një strukturë e organizuar dhe me përkrahje shtetërore në veprimtarinë e vet, ato mund të lidhë kontratat e liçencës dhe/ose përdorimit me përdoruesit, në emër të autorëve, pasi të ketë marrë autorizimin e tyre për të vepruar.

Roli i rëndësishëm i AAK-ve kërkon nga njëra anë dhënien e mundësive në favor të tyre për të vepruar, çka nënkupton lidhjen e kontratave me përdoruesit, përcaktimin e klauzolave të kontrollit të qarkullimit të veprës, të shpërblimeve në favor të autorit dhe ndihmën e vazhdueshme nga

74. Neni 156 i ligjit për të drejtat e autorit

75. Neni 142 i ligjit për të drejtat e autorit parashikon një metodologji mjaft të shtjelluar: *do të kihet parasysh burimi i vlerës e tarifës vendoset me anë të një marrëveshjeje të lidhur me AAK-së dhe përdoruesve, të cilët mund të grupohen në shoqata. Nëse marrëveshja nuk arrihet, është KKDA që do t'i përcaktojë ato. Deri sa të përcaktohen tarifat e reja, AAK mund të veprojë nëpërmjet përcaktimit të tarifave provizore, jo më larta se 60% e projekt-tarifave për t'u miratuar. Palët kanë drejtë që t'i kundërshtojnë ato në gjykata. Në këtë situatë, nëse gjykata parashikon një tarifë më të ulët se 60% të projekt-tarifave, AAK është e detyruar që të kthejë diferencën përdoruesve. Metodologjia përfshin: të ardhurat që mund të sigurohen nga tregtimi i veprës; numri i publikut që i vihen në dispozicion veprat; nëse të ardhurat nuk reflektojnë natyrën e përdorimit të veprave, do të merren për bazë kostot; rëndësia e përdorimit të veprës; krahasueshmëria me tarifat nga AAK-të homologe të huaja. Për çdo tarifë, ardhurave: subvencione, abonime dhe sponsorizime*

ana e organeve shtetërore. Nga ana tjetër, kjo fuqi kontraktore që do të kenë AAK-të kërkon edhe një balancë, që lidhet me kontrollin e veprimtarisë, me transparencën dhe mbikëqyrjen e tyre. Këto mjete kontrolli duhet të jenë në duart e vetë anëtarëve të AAK-ve, por gjithashtu dhe të organeve shtetërore, pranë të cilave ato liçencohen.

Ky mekanizëm balancimi i pushtetit me përgjegjësinë qendron në themel të Direktivës 2014/26/BE dhe të ligjit 35/2016 që e ka përshtatur atë në Shqipëri.

Literatura:

Akte normative

- Direktiva 2014/26/BE e Parlamentit Europian dhe Keshillit datë 26.2.2014 "Për menaxhimin kolektiv të së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të dhe liçencimin multiterritorial i të drejtave në veprat muzikore për përdorim në internet në tregun e brendshëm, FZ e BE-së L84 datë 20.3.2014
- Direktiva 2001/29/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 29.4.2001 "Mbi harmonizimin e disa aspekteve të të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të në shoqërinë e informacionit", FZ e BE-s*ë L167 datë 22.6.2001*
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë
- Ligji 35/2016 "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to"
- Ligji nr. 8788, datë 7.5.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar
- Ligji 10128, datë 11.5.2009 "Për tregtinë elektronike", i ndryshuar

Doktrinë

- Xavier Linant de Bellefonds, *Droit d'auteur et droits voisins*, Dalloz. Botimi II, 2004
- Mihaly Ficsor, *Collective Management of Copyright and Related Rights*, botimi i OBPI-së, Gjenevë 2002
- Michel Vivant, Jean-Michel Bruguière, *Droit d'auteur*, 'Dalloz', 2009

- Christophe Caron, *Droit d'auteur et droits voisins*, 'Litec LexisNexis', botimi III, 2013

- François Collart Dutilleul, Philippe Delebecque, *Contrats civils et commerciaux*, 'Dalloz', botimi IX, Paris 2011

- *The Collective Management of Rights in Europe*, Korrik 2006, European Affairs, http://www.europarl.europa.eu/meetdocs/2004_2009/documents/dv/study-collective-management-rights-/study-collective-management-rights-en.pdf;

- Lucie Guibault, Stef van Gompel, *Collective Management in the European Union*, in 'Colelctive Management of Copyright and Related Rights', Third Edition, Aspen Publishers, UK 2015 - https://www.ivir.nl/publicaties/download/CMCR_5.pdf

- David Bainbrigde, *Intelektual Property,* 'Pearson', 9th edition, London 2012

- Anne - Laure Sterin, *Guide pratique du droit d'auteur*, 'Maxima' Paris 2007

Jurisprudencë

- Vendimi i Gjykatës së Drejtësisë së BE-së, *OSA vs. Republika çeke*, 27.4.2014

- Vendimi i Komisionit Evropian, më 8 tetor 2002 (COMP/C2/38.014 – IFPI "Simulcasting")

- Vendimi i Komisionit Evropian, më datë 6.8.2008 (COMp/C2/37.219, *Daft Punk vs. SACEM*

- Vendimi nr. 1426, datë 21.12.2010 i Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë

- Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 23.12.2013

KUPTIMI DHE PËRDORIMI I *AMICUS CURIAE*

Alket JAUPI
Ekspert në Institucionin
e Avokatit të Popullit,
Tiranë

Hyrje

Aplikimi i përdorimit të *Amicus Curiae* dhe trendi në rritje i lejimit të ndërhyrjeve të këtij instituti proceduraL, sot përballet me pikëpamje të debatueshme mbi origjinën historike dhe kuptimin e tij.

Kjo ndodh kur numri i ndërhyrjeve *Amicus Curiae*, si edhe kur numri i opinioneve të paraqitura prej tyre, të njohura ndryshe si "*Amicus*", me kalimin e kohës është rritur në mënyrë graduale dhe të qëndrueshme.

Aktualisht kjo lloj pjesëmarrje procedurale ka gjetur përhapje në nivel të gjykatave kombëtare, por edhe të gjykatave ndërkombëtare, për çështje që lidhen më të drejtat e njeriut. Për më tepër, zhvillimi i konceptit dhe aplikimit të ndërhyrjes Së "*Amicus Curiae*" ka prirjen të mos ngelet në kuadër të përkufizimeve klasike të tij, por të ketë një natyrë dinamike dhe të shfaqet edhe në procedurat e zhvilluara nga institucione të ndryshme, nga gjykatat.

Në ditët e sotme ndërhyrja e "*Amicus Curiae*" pranohet nga shumica e gjykatave ndërkombëtare. Megjithëse, procedura për ndërhyrje me këtë cilësi është e ndryshme në secilën prej këtyre gjykatave, instrumenti i pjesëmarrjes "*Amicus Curiae*" pranohet si i tillë nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Gjykata Inter-Amerikane e të Drejtave të Njeriut, nga mekanizmi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në Organizatën Botërore të Tregtisë, nga Gjykata Ndërkombëtare e Krimeve dhe nga Arbitrazhi i Traktatit Ndërkombëtar të Investimeve.[1]

1. Levine, '*Amicus Curiae in International Investment Arbitration: The implications*

Individët dhe organizatat joqeveritare të të drejtave të njeriut, në Evropë dhe në kontinentin Amerikan, konceptin e "*Amicus Curiae*" e kanë shfrytëzuar si një mekanizëm për pjesëmarrje dhe formësim të gjykimit të të drejtave të njeriut para Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Gjykatës Inter-Amerikane të të Drejtave të Njeriut. Edhe në kontinentin Afrikan kjo praktikë po zhvillohet me të njëjtin trend.

Megjithëse kjo procedurë do ende të "zërë rrënjë", ajo po shfaqet gjithnjë e më shumë në procedurat ndërkombëtare të arbitrazhit, si ato të Organizatës Botërorë të Tregtisë (WTO), Marrëveshjes së Lirë të Tregtisë Amerikano - Veriore (NAFTA) dhe Qendrës Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimit (ICSID). Mbi këtë bazë po parashikohet që paraqitja e opinioneve *amicus curiae* do të bëhet një praktikë universale në të ardhmen.[2]

Qëllimi i këtij punimi është paraqitja e nocionit të këtij instrumenti ndërhyrës dhe e kuptimit të ndërhyrjes efektive të subjekteve të interesuara në rolin e "Amicus Curiae", si palë të treta, pranë gjykatave kombëtare dhe ndërkombëtare, pjesë e gjykimeve të shumëanshme të çështjeve gjyqësore strategjike mbi të drejtat e njeriut.

Me këtë qasje vjen edhe analiza se, ku ndodhet aktualisht aplikimi i kësaj ndërhyrjeje në kontekstin e Shqipërisë dhe se si mundet që kjo ndërhyrje të shërbejë si një instrument i vlefshëm për respektimin dhe realizimin efektiv të të drejtave të njeriut.

Ky kontekst merr një rëndësi të madhe sidomos në kuadër të zbatimit të Reformës në Drejtësi, e cila përfaqëson një reformë jetike për vendin, për shkak të një sërë problematikave që rëndojnë mbi këtë sistem dhe, në fund të fundit, mbi procesin e dhënies së drejtësisë.

Kuptimi i termit *Amicus Curiae*

Kuptimi klasik gjendet në termin latin *Amicus Curiae*, që do të thotë: *mik i gjykatës*. Në përdorim të përgjithshëm, termi përdoret si *Amicus*.

---

of an increase in third-Party participation, 29 'Berkley Journal of International Law' (2011), fq. 200-208

2. Gomez K.F., *Rethinking the role of amicus in International Investment Arbitration: How to draw the Line Favorably for the Public Interest Litigation* (2012), 'Fordham International Law Journal', fq. 510

Megjithatë ka qëndrime të ndryshme lidhur me origjinën e këtij termi. Një prej këtyre qëndrimeve mbron argumentin se, *Amicus Curiae* e ka origjinën nga fjala e vjetër romane *consilium* dhe është zhvilluar me kohë në kuadër të sistemeve ligjore në kuptimin e një *miku të gjykatës*.

Në praktikën e lashtë romake gjykatat lejoheshin të caktonin palë të treta në rolin e këshilltarëve të pavarur, të cilët mund të sillnin informacion ligjor, ose faktues, mbi çështje pak të njohura. Besohet që kjo praktikë të jetë futur në sistemin *Common Law* gjatë shekullit e XiV.[3]

Përkundër të parit, një qëndrim tjetër parashtron argumentin se, ky term e ka origjinën nga tradita juridike e *Common Law* dhe është krijuar për të kapërcyer vështirësi të zbatimit të parimit të kontradiktorialitetit, përmes plotësimit të provave dhe fakteve nga *Amicus Curiae*. Pavarësisht qëndrimeve të ndryshme, pikëpamja e përgjithshme është që origjina e këtij termi vjen nga e drejta romake.

Opinioni i shkurtër i subjektit që luan rolin e *Amicus Curiae* njihej në të Drejtën Romake dhe ka luajtur një rol të rëndësishëm gjithashtu në sistemin dhe traditën ligjore Angleze dhe atë Amerikane. Përdorimi i tij ka luajtur një rol të rëndësishëm në sistemin e së drejtës zakonore angleze që në shekullin e XV, si edhe ka njohur zhvillim të mëtejshëm në sistemin ligjor të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Duke u zhvilluar dhe evoluar kohë pas kohe, kjo lloj ndërhyrjeje është prezente tashmë natyrshëm që prej viteve '90 të shekullit të kaluar pranë gjykatave ndërkombëtare.

Megjithëse procedurat *Amicus* nuk përmbahen tradicionalisht në sistemet e vendeve të së Drejtës Civile, në këto vende gjykatat po lejojnë gjithnjë e më shumë ndërhyrje të tilla.

Sot mund të gjenden përkufizime të ndyshme për *Amicus Curiae*.

Mellinkoff's Dictionary of American Legal Usage përcakton se ky mik i gjykatës është: "*Dikush jo palë në çështje gjyqësore, por që zakonisht favorizon një prej palëve dhe që lejohet t'i bëjë një argumentim gjykatës*".

Një përkufizim tjetër në vazhdim përcakton, se: "*Amicus Curiae është ai, që si një vrojtues, mund të informojë gjykatën kur një gjykatës është në dyshim, apo në gabim, për një çështje ligjore. Ai dëgjohet vetëm me leje dhe në ndihmë të gjykatës, mbi një çështje që i është parashtruar gjykatës...(praktika është), që të lejojë një avokat, apo një person tjetër, që të paraqitet si një mik i gjykatës në një çështje, për të vepruar si një*

3. Gao HS, *Amicus Curiae in WTO Dispute Settlement: Theory and Practice* (2006), fq. 51

këshillues i gjykatës dhe për të bërë sugjerime …".[4]

Në vazhdim mund të përmendim përcaktimin, sipas të cilit, subjekti që ndërhyn me këtë cilësi është: "*Person me interesa ose opinione të forta mbi objektin e një padie…që faktikisht sugjeron një arsyetim në përputhje me pikëpamjet e veta. Një "Amicus Curiae" informon gjykatën mbi pikat e diskutueshme të ligjit, mbledh ose organizon informacionin apo ndërgjegjëson mbi disa aspekte të çështjes që, në të kundërt, gjykatës mund t'i shpëtonin…*".[5]

Një tjetër përkufizim është, ai sipas të cilit: "*Një "Amicus Curiae" mund të përshkruhet si një person apo entitet, që ka për qëllim të kontribojë në procedurat ligjore, por pa u bërë "palë", në këto procedura*".[6]

Ndonëse e "eksploruar" më herët në vende të tjera, kjo ndërhyrje është një koncept dhe praktikë e re për vendin tonë, për çka mund të thuhet që mbetet ende në fillesat e saj.

Ajo është qëllimuar të jetë një metodë ku një palë e tretë, pa interes të drejtëpërdrejtë në një çështje mund të citojë në interes të drejtësisë rastet që gjykata mund t'i anashkalonte.[7]

Ndërhyrja *Amicus Curiae* është parashtrimi i një eseje në një gjykatë, e quajtur ndryshe "*Opinion i shkurtër Amicus*", i cili u jep gjyqtarëve një informacion të ri, ose një perspektivë të ndryshme nga ajo që palët i kanë prezantuar gjyqtarit.[8]

Këto opinione të shkruara, që kanë të bëjnë me çështje ligjore të rëndësishme në gjykim dhe çështje të informacionit dokumentues, mund të paraqiten nga palë të treta me pëlqimin e gjykatës dhe pas konsultimit me palët.

Parashtrimi i një ndërhyrjeje të tillë nuk niset nga interesi i ngushtë i çështjes, por nga një interes shumë më i gjerë se sa ai që paraqitet në çështjen konkrete.

---

4. *Quasi –Party In the Guise of Amicus Curiae*, 'Cumberland Law Rewiew', Volume 7, 293 (1976-1977), fq. 294 (http://heionline.org).
5. http://legal-dictionary.thefreedictionary.com/amicus+curiae
6. L Bartholomeuszs, *The amicus curiae before international courts and tribunals* (2005), 'Non-State Actors and International Law', 209, fq. 273
7. Wayne W. Schmidt, *History, Purpose and Philisophy of Amicus Advocacy: The AELE Amices Brief Program,* fq. 1, http://www.aele.org/history.html
8. http://www.rbs2.com/amicus.htm

Mënyra e përdorimit

Për të patur një ndikim maksimal në ecurinë e procesit në gjykatë, një ndërhyrje e *Amicus Curiae* duhet të paraqitet në shkallën e parë të gjykimit, por kjo gjë nuk përjashton ndërhyrjen në shkallë më të larta të gjykimit.

Paraqitja e një ndërhyrje e *Amicus Curiae* përfaqëson një proces me dy faza:

- Së pari, sigurimi i lejes nga gjykata për të paraqitur një ndërhyrje të tillë, e cila jepet zakonisht.
- Së dyti, paraqitja e ndërhyrjes e Amicus Curiae, pas marrjes së lejes.[9]

Proceduralisht, një ndërhyrje e tillë kuptohet si një përmbledhje e shkruar e argumenteve që sjell në proces ndërhyrësi *Amicus Curiae* dhe jo si një parashtrim verbal para gjykatës i kësaj përmbledhjeje.

Ndërhyrësi *Amicus Curiae* nuk mund të ketë cilësinë klasike të një palë të tret*ë, ndërhyrëse në proces, por sidoqoftë ndikon në përfundimi*n e procesit gjyqësor dhe vendimmarrjen respektive, që në fakt mund të kthehet në një "precedent" për çështje të tjera gjyqësore në të ardhmen.

Opinioni i *Amicus* duhet të paraqitet në gjykatë gjatë kohës që palët paraqesin pretendimet e tyre. Kjo përmbledhje kërkon një studim të gjerë ligjor, si edhe një formulim të kujdesshëm, i cili duhet të kalojë paraprakisht në disa rishikime.

Shpesh për këtë lloj ndërhyrjeje jepen termat e ndërhyrjes së palës së tretë. Në fakt, ky përcaktim është më i gjerë, por nuk përjashton edhe ndërhyrjen e *Amicus Curiae*. Megjithëse mund të ketë mbivendosje ndërmjet roleve të ndryshme, duhet bërë një dallim midis një *Amicus Curiae* nga njëra anë dhe nga ana tjetër e një dëshmitari apo eksperti.

Ndërhyrësi me cilësinë e *Amicus Curiae* nuk është palë me të drejta të plota në proces dhe nuk mban anën e asnjë pale në proces. Argumentet mbi përmasat e të drejtave të njeriut në çështjen ku ai ndërhyn janë roli i tij, rol që mund të kryejë në fakt disa funksione.[10]

---

9. Ibid

10. Këto funksione lidhen me ofrimin e informacionit në formën e ekspertizës ligjore, njohurive ligjore, ose informacionit faktik; ndihmesën për kuptimin e parimeve dhe hollësive të legjislacionit mbi të drejtat e njeriut dhe barazinë; ndihmesën në zbatimin korrekt të legjislacionit në çështje të caktuara; krijimin e një platforme për ndërhyrje

Rregulli i dhënë për këtë ndërhyrje është se, pala ndërhyrëse me këtë cilësi nuk duhet të komentojë mbi faktet, ose mbi themelin e çështjes, pasi në të kundërt humbet thelbi bazik i kësaj ndërhyrjeje.

Koncepti i *Amicus Curiae* dhe aplikimi i tij ka avantazhet dhe disavantazhet e veta, duke marrë parasysh parimet dhe politikat e ndryshme mbi të cilat funksionojnë gjykatat dhe tribunalet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Avantazhet e përdorimit të këtij instrumenti nga institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut lidhen me; sfidat e mëdha me të cilat përballen këto institucione në kuadër të volumit të madh të jurisprudencës së krijuar nga instrumentet ndërkombëtare, rajonale dhe lokale të mbrojtjes së këtyre të drejtave, gjë që mund të plotësohet dhe saktësohet nga *Amicus Curiae*; sasia e madhe e ligjeve, konventave, vendimeve dhe praktikave shtetërore, parimeve të përgjithshme të së drejtës përbëjnë një problem madhor për gjykatat, ndaj edhe *Amicus Curiae* mund të sjellë informacion të vlefshëm për to; një nga të drejtat e njeriut brenda konceptit të procesit të rregullt ligjor lidhet me gjykimin brenda një kohe të arsyeshme të çështjeve në gjykim, ndaj edhe *Amicus Curiae* mund të ndihmojë gjykatat e të drejtave të njeriut me prova materiale domethënëse; *Amicus Curiae* mund të jetë një mjet për teknikën e lobimit për të influencuar politikën dhe mbuluar koston efektive të aksesit në informacion,[11] numri i çështjeve dhe ngarkesa e punës në tribunalet ndërkombëtare mund të menaxhohet duke përdorur *Amicus Curiae*.[12]

Nga ana tjetër, mendimi kundër përdorimit të këtij instrumenti lidhet me faktin se mund të krijohen argumente të dyzuara, të cilat çojnë në konfuzion dhe përplasje,[13] procedura e konfidencialitetit mund të rrezikohet, mungesa e besueshmërisë në anën e *Amicus Curiae* mund të

---

të mëtejshme në rrafshin e mbrojtjes juridike; përfaqësimin e interesit publik; rritjen e besimit, respektit, sigurisë dhe reputacionit të ndërhyrësir dhe marrësit gjyqësor; rritjen e vëmendjes për ndërhyrjen si "watchdog" të të drejtave; etj. Shih: *Manual Praktik mbi Amicus Curiae* (Draft 15.10.2017), përgatitur nga Ivana Roagna & Arta Vorpsi, fq. 6-7

11. Sarah Williams and Hannah Woolaver, *The Role of the Amicus Curiae before International Criminal Tribunal*, 'International Criminal Law' Riview 6, 2006, fq. 151-189

12. Karen O'connor & Lee Epstein, *Court, Rules and Worload: A case study of rules Governing Amicus Curiae participation*, 'The justice system Journal' Volume 8, Number 1, viti 1983

13. Ibid

çojë në padrejtësi dhe mungesë objektiviteti në gjykim.

Pavarësisht argumenteve 'pro' dhe 'kundër' *për përdorimi*n e kësaj ndërhyrjeje, ato *në favor janë më të shumta dhe praktik*a po tregon që *përdorimi korrekt sjell dobishmëri në administrimin e drejtësisë.*

Subjektet ndërhyrëse, me cilësinë e *Amicus Curiae*, në varësi të sistemit të aplikuar ligjor të të drejtave të njeriut mund të jenë të ndryshme. Si të tilla mund të jenë organizatat jo qeveritare me objekt veprimtarie mbrojtjen e të drejtave të njeriut, klinika dhe qëndra universitare, akademikë të vjetër të fushës së mbrojtjes së të drejtave të njeriut, avokatë, institucione të pavarura të të drejtave të njeriut, organizata të specializuara ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, etj. Sikurse shihet numri i tyre është me një përfaqësim të gjerë dhe ka tendencën të rritet, duke zgjeruar rrethin e subjekteve që mund të marrin këtë cilësi.

Amicus Curiae mund të jetë një ndërhyrje individuale nga vetëm një prej subjekteve të sipërcituara, por kjo mund të marrë edhe formën e ndërhyrjes së përbashkët nga më shumë se sa një subjekt.

Avantazhi i veprimit në këtë mënyrë është se, pala e tretë mund të mbështetet te një ekspertizë më e gjerë, të ndajë ngarkesën e punës, të shmangë përsëritjet dhe t'i japë më shumë peshë ndërhyrjes, me qëllim që të shmangë rrëzimin e saj.[14]

Procedura e ndërhyrjes *Amicus* mund të përdoret për të mbushur boshllëkun që lidhet me aksesin e kufizuar në drejtësi *të të varfërve. Ndërhyrja në këto kushte mund të përdorët për të sjellë në qendër të vëmendjes interesat e të varfërve dhe shtresave* vulnerabël *në çështje ligjore në të cilat, interesa të ti*llë mund të jenë neglizhuar apo injoruar.

Sistemet ligjore të të drejtave të njeriut dhe përdorimi i *Amicus Curiae*

Shtrirja e përdorimit të *Amicus në një sërë sistemesh ligjore për mbrojtje*n e të drejtave të njeriut jep një perceptim të qartë të faktit se, kjo ndërhyrje nuk është dhe nuk mund të konsiderohet si një paraqitje formale dhe pa peshë, por si një ndihmesë dhe kërkesë plotësuese, që ndikon në përfaqësimin e një spektri të gjerë pikëpamjesh dhe interesash, në të njëjtën linjë me vlerën demokratike të pjesëmarrjes së barabartë.

14. *Manual Praktik mbi Amicus Curiae* (Draft 15.10.2017) përgatitur nga Ivana Roagna & Arta Vorpsi, fq 13

Duke depërtuar në këtë mënyrë te procedurat ligjore gjyqësore dhe jo vetëm te ato, *Amicus Curiae* kthehet vetvetiu në një element praktik *të konkretizimit të vler*ave të shtetit të së drejtës *në një shoqëri demokratike.*

Sistemet e të drejtave të njeriut në botë sot kanë dëshmuar dhe dëshmojnë pranimin dhe pjesëmarrjen gjithnjë e më në rritje të *Amicus Curiae*. Le të analizojmë disa prej tyre.

- *Sistemi Evropian i të Drejtave të Njeriut.* Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, me tekstin origjinal të hartuar në vitin 1950 nga Këshilli i Evropës, përfaqëson një traktat ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në kontinentin evropian. Ajo ka hyrë në fuqi më 3 Shtator 1953 dhe bashkë me 14 Protokolle Shtesë të saj (të nënshkruara dhe ratifikuara më pas) është dakordësuar nga të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës.[15] Konventa ka krijuar Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si një organ garantues për zbatimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut të afirmuara prej saj.

Çdo individ që beson se të drejtat e tij të afirmuara në këtë Konventë janë shkelur nga një Shtet -Palë Kontraktues i saj mund të ngrejë një padi pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në historikun e saj, kjo Gjykatë deri në vitin 1998 ka qënë një organ gjyqësor me kohë të pjesshme që dëgjonte çështjet, vetëm pasi ato ishin marrë në konsideratë nga Komisioni Evropian i të Drejtave të Njeriut, si edhe nuk ka qënë direkt e aksesueshme nga individët dhe organizatat jo qeveritare.

Vetëm pas hyrjes në fuqi në vitin 1998 të Protokollit nr.11 të Konventës, kjo gjykatë u transformua në një organ gjyqësor me kohë të plotë dhe direkt e aksesueshme prej "viktimave" të shkeljes së të drejtave të njeriut. Pikërisht ky Protokoll qartësoi rregullat e aplikueshme mbi ndërhyrjet e *Amicus Curiae*, duke i dhënë mundësi presidentit të gjykatës që të ftojë, ose t'u japë leje shteteve anëtare të Konventës Evropiane (jo palë në një procedurë) dhe çdokujt tjetër të interesuar, veç aplikantëve, për të paraqitur komente të shkruara, ose në raste përjashtimore për të marrë pjesë në dëgjesa.[16]

---

15. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut është ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqiperise me ligjin Nr.8136, datë 31.07.1996

16. Shih nenin 36 të Protokollit 11 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNj)

Mbi këtë bazë rregullatore, individë dhe organizata joqeveritare me fokus veprimtarie mbrojtjen e të drejtave të njeriut, kanë mundur të kryejnë ndërhyrje *Amicus* në procedurat e gjykimit të kësaj gjykate.

Është fakt historik se, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka pranuar një ndërhyrje *Amicus*, për herë të parë në vitin 1981, në çështjen *Young, James & Webster vs. United Kingdom*.

Kjo gjykatë e pranon ndërhyrjen "Amicus" vetëm nëse është "*në interes të administrimit të duhur të drejtësisë*",[17] por nëse kjo ndërhyrje nuk i shërben drejtësisë, kur ka një precedent të qartë që e bën ndërhyrjen të panevojshme, ose kur kërkesa për ndërhyrje përsërit thjesht atë që palët apo ndërhyrje të tjera *Amicus* kanë prezantuar, si edhe kur kërkesa për ndërhyrje nuk ka ndonjë lidhje të ngushtë me çështjen në gjykim, atëherë Gjykata i refuzon aplikimet për të paraqitur para saj opinionet *Amicus*. Pranimi i kërkesave për paraqitjen e këtyre lloj opinionesh duhet të përmbushë disa kërkesa proceduriale, si për shembull, kërkesa që ato duhet të paraqiten "*jo më vonë se 12 javë pasi* është bërë njoftimi i aplikimit te *Pala Kontraktuese përkatëse*".[18]

Normat e procedurës, sipas nenit 44/5, kërkojnë që komentet me shkrim të paraqitura nga *Amicus* duhet të jenë në një prej gjuhëve zyrtare të Gjykatës, përkatësisht gjuhës angleze dhe asaj franceze.

Gjykata në përgjithësi i pranon kërkesat e paraqitura për leje të ndërhyrjes si *Amicus Curiae*. Ndërkohë që është evidente se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kurdo që lejon këto ndërhyrje i përmbledh pikëpamjet e *Amicus* në vendimin e saj përfundimtar.

- *Sistemi Inter-Amerikan i të Drejtave të Njeriut.* Organet kryesore të këtij sistemi janë Komisioni Inter-Amerikan i të Drejtave të Njeriut[19] dhe Gjykata Inter-Amerikane e të Drejtave të Njeriut.[20]

Sipas rregullave të aksesit në këtë gjykatë, vetëm shtetet anëtare dhe organet e Oganizatës së Shteteve Amerikane, përfshirë Komisionin

17. Normat e Procedurës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, rregulli 44 (2), (a)

18. Ibid, rregulli 44 (1), (b). Megjithatë, afati 12 javor mund të zgjatet nga presidenti i Gjykatës, nëse ka një shkak të bazuar për këtë shtyrje

19. Komisioni Inter-Amerikan i të drejtave të njeriut është themluar në vitin 1959, si organ autonom i Organizatës së Shteteve Amerikane (OSHA) dhe më pas u bë organ i saj. Kjo organizatë, pra, OSHA i ka fillesat e saj që në Konferencën e parë të Shteteve Amerikane në 1889-1890

20. Gjykata Inter-Amerikane e të Drejtave të Njeriut është krijuar në vitin 1979

Inter-Amerikan, mund t'i drejtohen gjykatës. Por, megjithatë, një qasje më liberale e Gjykatës vihet në dukje lidhur me opinionet *Amicus Curiae*, sepse ka pranuar edhe ndërhyrjet nga ana e individëve dhe e organizatave jo qeveritare.

Gjykata Inter-Amerikane e të Drejtave të Njeriut ka një "praktikë Amicus" më të gjerë se sa homologia e saj në Evropë.[21]

Faktikisht kjo Gjykatë nuk ka refuzuar asnjëherë aplikimet për të paraqitur opinione *Amicus*. Rregullat proceduriale të gjykatës lejojnë në mënyrë *të qartë Amicus Curiae*, për të paraqitur komente mbi faktet që përmbahen në aplikim apo vlerësime ligjore mbi objektin e gjykimit në procedurë nga Gjykata në çdo pikë, gjatë procedurave kontradiktoriale.[22]

Opinioni *Amicus* duhet të paraqitet brenda 15 ditëve nga kryerja e një dëgjesë publike. Nëse Gjykata nuk mban një dëgjëse publike, opinioni *Amicus* duhet të paraqitet brenda 15 ditëve nga data kur vendoset afati për paraqitjen e argumenteve përfundimtare. N*ëse aprovohet nga presidenti i G*jykatës, opinioni i përcillet menjëherë palëve për vlerësimin e tyre.

Në ndryshim nga praktika dhe rregullat e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, normat e procedurës së kësaj Gjykatës Inter - Amerikane nuk parashikojnë ndonjë kërkesë substanciale, siç është "*interesi i administrimit të duhur të drejtësisë*".

Megjithëse rregullat proceduriale të kësaj Gjykate nuk janë shumë të qarta për lejimin e ndërhyrjeve *Amicus Curiae*, këto ndërhyrje deri tashmë janë të pranuara përgjithësisht.

- *Sistemi Afrikan i të Drejtave të Njeriut.* Ngjashëm me sistemin Inter-Amerikan të të drejtave të njeriut, në sistemin Afrikan organet kryesore të tij janë Komisioni Afrikan[23] dhe Gjykata Afrikane e të Drejtave të Njeriut.[24]

Në mungesë të parashikimit nga Karta Afrikane, normat e procedurës të Komisionit Afrikan të miratuara në vitin 2010 lejuan për herë të parë

21. D Shelton, *The participation of nongovernmental organizations in international judicial proceedings*, (1994), 88/4 'American Journal of Intyernational Law', fq. 638
22. Normat e procedurës të Gjykatës Inter-Amerikane të të Drejtave të Njeriut, neni 44
23. Karta Afrikane krijoi Komisionin Afrikan të të Drejtave të Njeriut. Ky Komision filloi aktivitetin në 2 Nëntor 1987, në Adis Abeba të Etiopisë. Shih: www.achpr.org/about/
24. Gjykata Afrikane e të Drejtave të Njeriut është një Gjykata kontinentale e themeluar nga vendet afrikane për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Afrikë. Ajo plotëson dhe forcon funksionet e Komisionit Afrikan të të Drejtave të Njeriut. Shih: https://en.wikipedia.org/wiki/African_Court_on_Human_and_Peoples%27_Rigths

qartësisht ndërhyrjet *Amicus Curiae*.[25] P*ërp*ara *këtij viti*, parashikimet e dispozitave t*ë Kartës Afrikane kishin mungesa dhe nuk patën një bazë ligjore të* qartë për lejimin nga ana e Komisionit Afrikan dhe pranimin e opinioneve *Amicus*, çka sidoqoftë sidoqoftë nuk e ka penguar Komisionin Afrikan, që në disa raste *të lejojë* paraqitjen e këtij lloj opinioni.[26]

Megjithatë, nga studime të kryera mbi përdorimin e *Amicus Curiae në këtë sistem, rezulton se numri i këtyre ndë*rhyrjeve ka qënë i pakët, ndonëse Komisioni është treguar i gatshëm të pranojë këto nd*ërhyrje në çështjet në shqyrtim. P*or nga ana tjetër, impakti i tyre është e vështirë të vlerësohet në vendimet përfundimtare. Komisioni ka diskrecionin të ftojë autorët e opinioneve *Amicus* për të prezantuar pikëpamjet e tyre në procedurën verbale, pa u bërë ndonjë dallim nëse kjo gjë ndodh kur opinioni mund të jetë paraqitur me shkrim paraprakisht. Ndërkohë, nuk ka të përcaktuar një afat se, kur duhet të paraqitet opinioni "Amicus", sikundër nuk ka një udhëzues *nëse opinioni duhet të paraqitet në një gjuhë të veçantë.*

Gjykata Afrikane e të Drejtave të Njeriut u krijua për të plotësuar mandatin protektiv të Komisionit Afrikan, duke ushtruar juridiksion këshillimor dhe kontradiktorial. Vetëm Shtetet e Unionit Afrikan, çdo organ i këtij Unioni, ose organizatat afrikane të njohura prej tij mund të kërkojnë një opinion këshillues mbi çdo çështje ligjore lidhur me Kartën Afrikane, ose ndonjë instrumenti tjetër përkatës ndërkombëtar të të drejtave të njeriut.

Megjithatë, nuk ka një procedurë të qartë që individët dhe organizatat joqeveritare mund të marrin pjesë në procedurat gjyqësore si *Amicus Curiae*, për të ndihmuar Gjykatën të arrijë në vendimin e drejtë për çështjet të kontestuara ligjore. Ndërhyrësi *Amicus* mund të paraqesë një opinion të shkruar në parim dhe mund të marrë pjesë gjatë dëgjesës verbale.

---

25. Normat e procedurës të Komisionit Afrikan, miratuar në Maj 2010, rregullat 85 dhe 96 (1)

26. Në nenin 52 të Kartës Afrikane gjendet një bazë fillestare mbështetëse, që autorizon Komisionin të marrë informacion, që e gjykon të nevojshëm për të zgjidhur një çështje në shqyrtim nga "*Shtetet e interesuara dhe nga burime të tjera*", plotësuar kjo nga neni 46 i Kartës, që e lejon Komisionin të dëgjojë nga "çdo person i aftë për ta sqaruar atë".

Ndërhyrjet *Amicus Curiae* në kontekstin shqiptar

Duke prezantuar një koncept të ri për kontekstin shqiptar, *Amicus Curiae* ndeshet me një situatë të paqartë dhe të mangët ligjore, që rregullon përciptazi dhe në mënyrë të pjesëshme procedurën e ndërhyrjes së tij në këto raste.

Më konkretisht mund të thuhet se, Kodi i Procedurës Civile *bën fjalë për konceptin e ndërhyrjes nga një palë e tretë në procesi*n civil, por jo për ndërhyrjen *Amicus*. Koncepti i ndërhyrjes s*ë palës së tretë në Kod,* në mënyrë të drejtëpërdrejtë lidhet me objektin e padisë, ose me përfundimin e gjykimit, duke i dhënë të drejtën kësaj pale edhe për ngritjen e padisë. Sikurse legjitimohet ndërhyrja për të mbështetur njërën apo tjetrën palë në proces, duke u bashkuar në gjykim për ta ndihmuar atë.[27]

Një dispozitë ligjore q*ë ofron konceptin e ndërhyrjes Amicus Curiae* gjendet në ligjin "Për Mbrojtjen nga diskriminimi" ku parashikohet, se: "*Gjykata mund t'i kërkojë komisionerit në çdo fazë të procedimit të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen*".[28]

Në këtë mënyrë, dispozita e sipërcituar krijon mundësinë që Komisioneri *për Mbrojtjen nga Diskriminimi të ndërhyjë me cilësinë e palës së tretë në një proces gjyqësor,* por edhe të paraqesë opinione *Amicus*, mbi bazën e kërkesës së gjykatës.

Veç faktit se kemi mungesë rregullimesh ligjore për mundësimin e ndërhyrjes *Amicus* ka situata faktike, kur institucione të pavarura të të drejtave të njeriut në Shqipëri kanë ndërhyrë me opinione "Amicus".

Të tilla ndërhyrje ka kryer institucioni i Avokatit të Popullit me inisiativën e tij ne dy raste, pranë gjykatës dhe pranë organit të prokurorisë.[29] Kjo ndërhyrje nuk ka ardhur si pasojë e kërkesës nga ana e gjykatës, por duhet thënë, gjithashtu, se rezulton që gjykata jo vetëm nuk e ka refuzuar paraqitjen e opinionit *Amicus*, madje edhe e ka marrë në konsideratë këtë opinion në vendimin përfundimtar. Megjithëse këto ndërhyrje janë

27. Shih nenet 189 dhe 191, të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë
28. Shih nenin 36/4, të Ligjit nr.10221, datë 4.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi"
29. Sipas të dhënave nga sistemi "doculive", i administrimit të ankesave në institucionin e Avokatit të Popullit rezulton se, në vitin 2003 Avokati i Popullit i është drejtuar me një ndërhyrje *Amicus*, Gjykatës së Apelit Durrës. Po kështu, në çështjen me nr.doc.201203967, Avokati i Popullit i është drejtuar me një ndërhyrje *Amicus* Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë

emërtuar si *Amicus Curiae* nga ana e Avokatit të Popullit, *në momentin kur në* 'to është shprehur një qëndrim në mbështetje të një prej palëve në gjykim, atëherë ndërhyrja nuk mund të konsiderohet më si e tillë.

Duke qënë se tashmë në Shqipëri ekzistojnë dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre disa institucione të pavaruara të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, konstatohet se Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në dallim nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe nga Avokati i Popullit, ende nuk ka krijuar një profil *Amicus Curiae*. Një konkluzion i tillë mund të nxirret edhe për organizatat jofitimprurëse, ose edhe për çdo subjekt tjetër që mund të paraqitet me ndërhyrje *Amicus*.

Në veprimtarinë e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë tregohet *për praktikën pozitive të pranimit* dhe konsiderimit të opinioneve *Amicus Curiae*, megjithëse i takon kësaj të fundit të vendosë se kujt mund t'ia kërkojë këtë lloj opinioni.

Vetëm pas ndryshimit të ligjit nr. 8577/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", në vitin 2016 është krijuar baza ligjore që parashikon se, kjo gjykatë mund të kërkojë opinion "Amicus Curiae", nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, ose nga organizma të tjerë, kuptuar këtu çdo organizatë shtetërore apo private, që ka mundësinë të ofrojë ndërhyrjen dhe opinionin *Amicus*.[30]

Megjithatë, edhe përpara ndryshimit të sipërcituar të këtij ligji, Gjykata Kushtetuese nuk është frenuar të kërkojë opinionin *Amicus* nga organizma ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut. Në shumë raste rezulton se, kjo Gjykatë ka parashtruar kërkesën për të pasur një opinion *Amicus Curiae* nga ana e Komisionit të Venecias, i cili përfaqëson një organ i specializuar rajonal ndërkombëtar për interpretime kushtetuese të të drejtave të njeriut.[31]

---

30. Shih gërmën "b", të nenit 44, të Ligjit nr. 8577/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", i ndryshuar.

31. Mund të përmendet këtu opinioni no.517/2009, i Komisionit të Venicias "Opinioni Amicus Curiae për Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë mbi pranueshmërinë e një referendumi për të abroguar ndryshimet kushtetuese", i miratuar nga Komisioni i Venecias në 13-14 Mars 2009. Po kështu mund të përmendim këtu edhe rastet kur Komisioni i Venecias ka dhënë opinione amicus për Gjykatën Kushtetuese, për çështje që lidhen me kthimin dhe kompensimin e pronës, si dhe të një prej ligjeve të paketës ligjore për Reformën në Drejtësi, Ligjit nr.84/2016 datë 30.08.2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Ajo që del e qartë nga kjo tablo konstatuese është se, ende nuk janë përcaktuar disa principe bazë, të cilat duhet të ndiqen për të vitalizuar konceptin dhe ndërhyrjen *Amicus në legjislacionin vendas në fuqi.*

Një koncept i tillë përcaktohet në një spektër *të ngushtë, duke nënkuptuar një person që merr pjesë në zhvillimin e procedurave me ftesë të gjykatave. Kjo situatë evidenton pamjaftueshmëri dhe m*ungesë të parashikimeve në ligj për mundësimin e procedurës *Amicus*, jo thjesht dhe vetëm në kuptimin e ngushtë të saj, por si një procedurë me parime të përparuara, ku çdo person mund të aplikojë në gjykatë për t'u legjitimuar apo pranuar n*ë një çështje si Amicus Curiae*, mjafton që ai t'u *përmbahet parimeve bazë të kësaj ndërhyrjeje.*

Në këtë këndvështrim, ligji duhet të përcaktojë procedura për ndërhyrjen *Amicus* dhe t'u japë gjykatave mandatin ligjor, që duhet të përdoret për përcaktimin e parakushteve ligjore proceduriale për pranimin, ose refuzimin, e kërkesës për ndërhyrje të tilla.

Konkluzione

Sisteme të ndryshme ligjore lejojnë ndërhyrjen e palëve të treta me cilësinë e *Amicus Curiae*, në nivele të ndryshme të juridiksionit të përcaktuar prej tyre, pa përjashtuar ndërhyrjen para organeve kuazi-gjyqësore.

Ndërhyrja *Amicus Curiae* siguron një legjitimitet me të madh demokratik të procesit të gjykimit, si edhe përmirëson potencialisht cilësinë e vendimmarrjes gjyqësore.

Kjo ndërhyrje mund të përdoret për të rritur e konsoliduar respektimin e të drejtave të njeriut dhe për të parandaluar shkeljen e të drejtave të afirmuara në këtë fushë nga instrumentet kombëtare dhe ndërkombëtare, ndërkohë që mund të kthehet në një ndërhyrje shumë të dobishme për të siguruar mbrojtje më të madhe të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Ndërhyrja *Amicus* duhet të justifikohet nga nevoja për të shtuar vlera në një çështje. Nëse një person aplikon për t'u bashkuar si *Amicus*, atëherë ai duhet të jetë i sigurtë që nuk po dublon parashtrimet e palëve, por po jep një perspektivë të bazuar në studimin konkret faktues, që në të kundërt mund të mungonte, dhe që nëse jepet mund të përbëjë kontribut të rëndësishëm për rezultatin apo vendimmarrjen e çështjes.

Procedura *Amicus* duhet të shihet si një mundësi për t'u përqafaqësuar nga ana e aktivistëve të të drejtave të njeriut. Gjithashtu, gjyqtarët, aktivistët e të drejtave të njeriut, praktikuesit e ligjit, institucionet e pavaruara të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, mund dhe duhet të vlerësojnë ndërhyrjen *Amicus*, si një mjet të fuqishëm, që ndër të tjera u jep zë të varfërve dhe individëve vulnerabël.

Në vendit tonë fillesat e aplikimit të kësaj ndërhyrjeje janë pozitive, por ende të brishta dhe të pamjaftueshme për t'i dhënë asaj pozitën që meriton.

Me qëllim që të sigurohet pjesëmarrje më e madhe nga subjektet *Amicus*, në kontekstin shqiptar nevojitet një qasje e re, çka duhet të krijojë pa mëdyshje mundësinë ligjore për këtë ndërhyrje, me qëllim që baza e pranimit apo e kundërshtimit të saj të jetë e parashikuar qartësisht.

Literatura:

Akte normative

- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (1950)
- Protokolli 11 i kësaj Konvente (1998)
- Konventa Inter-Amerikane e të Drejtave të Njeriut (1968)
- Karta Afrikane e të Drejtave t*ë Njeriut dhe Popujve (1981)*
- Normat e Procedurës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut
- Normat e Procedurës së Gjykatës Inter - Amerikane të të Drejtave të Njeriut
- Normat e procedurës t*ë Komisionit Afrikan të të D*rejtave t*ë Njeriut dhe Popujve*
- Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr.10221 datë 4.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".
- Ligji nr. 8577/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", i ndryshuar.

Doktrinë

- Levine, *Amicus Curiae in International Investment Arbitration:*

The implications of an increase in third-Party participation, 29 'Berkley Journal of International Law', 2011

- Gomez KF, *Rethinking the role of amicus in International Investment Arbitration: How to draw the Line Favorably for the Public Interest Litigation* (2012), 'Fordham International Law Journal'

- Gao HS, *Amicus Curiae in WTO Dispute Settlement: Theory and Practice,* 2006

- *Quasi - Party In the Guise of Amicus Curiae*, 'Cumberland Law Rewiew', Volume 7, 1976-1977, http://heionline.org

- L Bartholomeuszs, *The amicus curiae before international courts and tribunals*, 'Non-State Actors and International Law', 2005

- Wayne W. Schidt, *History, Purpose and Philisophy of Amicus Advocacy: The AELE Amices Brief Program*, http://www.aele.org/history.html

- Sarah Williams and Hannah Woolaver, *The Role of the Amicus Curiae before International Criminal Tribunal*, 'International Criminal Law Riview' Nr. 6, 2006

- Karen O'connor & Lee Epstein, *Court, Rules and Worload: A case study of rules Governing Amicus Curiae participation*, 'The justice system Journal' Volume 8, Number 1, 1983

- Shelton, *The participation of nongovernmental organizations in international judicial proceedings*, 'American Journal of Intyernational Law', 88/4, 1994

- Ivana Roagna & Arta Vorpsi, *Manual Praktik mbi Amicus Curiae*, Draft i përgatitur më 15.10.2017

Të tjera

- http://www.rbs2.com/amicus.htm
- http://legal-dictionary.thefreedictionary.com/amicus+curiae
- www.achpr.org/about/
- https://en.wikipedia.org/wiki/African_Court_on_Human_and_Peoples%27_Rigths

EDUKIMI LIGJOR I PUBLIKUT DHE ROLI I AVOKATIT

Eda NOÇKA
Drejtore Ekzekutive e Qendrës A.LT.R.I
Tiranë

Hyrje

Njohuritë mbi ligjin dhe edukimi ligjor i qytetarëve luajnë një rol thelbësor në çdo shoqëri demokratike ku sjellja, veprimet dhe marrëdhëniet mes tyre disiplinohen nga norma apo rregulla ligjore. Këto norma dhe rregulla janë ndonjëherë komplekse, duke iu nënshtruar ndryshimeve të vazhdueshme. Mungesa e njohurive, ose njohuritë e pamjaftueshme mbi ligjin dhe legjislacionin në përgjithësi passjell situatën ku qytetarët nuk kuptojnë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej tyre. Për më tepër, e gjitha kjo rrënjos një kulturë të mosrespektimit dhe moszbatimit të ligjit në shoqëri, e cila përbën kërcënim të qenësishëm për shtetin e së drejtës.

Aksesi i publikut në njohuritë mbi ligjin është themelor për garantimin e një sistemi drejtësie efektiv. Kështu, informimi dhe dhënia e njohurive për ligjin, mbi të drejtat, institucionet ligjzbatuese, përgjegjësitë, etj., nuk janë të lidhura vetëm me arsimimin juridik, por janë përbërësit e kulturës dhe nevojës qytetare për qasjen ndaj shtetit të së drejtës.[1]

Gjithashtu, edukimi ligjor i publikut (më poshtë: edhe ELP) ndikon drejtpërdrejt në marrëdhëniet e qytetarëve me organet e administratës publike. Duke patur dijeni mbi legjislacionin, qytetarët kuptojnë rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve të administratës publike. Kështu, ata janë në gjendje t'ia referojë çështjen e tyre organit përkatës, duke formuluar saktë kërkesat dhe ankesat që adreson.

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Analiza e Sistemit të Drejtësisë, fq. 215 http://www.reformanedrejtesi.al/sites/default/files/dokumenti_shqip_0.pdf

Përpos raportit të qytetarëve me institucionet e administratës publike, niveli i njohurive juridike luan rol kyç në sjelljen e vetë qytetarëve në sektorë të ndryshëm të jetës, qoftë në marrëdhëniet e tyre familjare, të punës, atyre juridiko-civile, qoftë në veprimet dhe vendimet e tyre në mbrojtje të shëndetit, sigurisë, mjedisit, etj. Njohja e legjislacionit që rregullon marrëdhëniet ku qytetarët janë të përfshirë, i nxit ata të respektojnë ligjin, i bën të shmangin veprimet e jashtëligjshme dhe të reduktojnë konfliktet.

Nëpërmjet përftimit të njohurive ligjore, si edhe rritjes së sigurisë që qytetarët ndjejnë në përdorimin e ligjit, ELP kontribuon edhe në forcimin e qytetarisë aktive dhe në një kohezion më të madh shoqëror.2 Qytetarët mund të organizohen dhe të bashkëveprojnë për të mbikëqyrur veprimtarinë e organeve të pushtetit shtetëror dhe administratës publike, të ushtrojnë presion me mjete demokratike mbi këto organe, për të nxitur mbarëvajtjen e çështjeve me interes publik.

Edukimi ligjor i publikut ka për qëllim t'u sigurojë individëve njohuritë e nevojshme lidhur me të drejtat e tyre dhe kuadrin ligjor në fuqi, si edhe për t'i aftësuar ata në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke u siguruar kështu akses në drejtësi. ELP i ndihmon individët të kuptojnë kur mund të kenë nevojë për mbështetje ligjore, çfarë lloj ndihme apo këshille mund të kërkojnë, ku dhe si ta kërkojnë atë. Në këtë kontekst, ELP është një proces që ka në fokus individin dhe dallon nga arsimi juridik, i cili është një proces që përfshin studentët e fakulteteve të drejtësisë apo të shkollave të profesioneve ligjore (si: avokatia, noteria, shërbimi përmbarimor dhe ndërmjetësimi).

Kuadri aktual strategjik dhe ligjor përcakton një sërë detyrimesh për masat që duhet të ndërmarrin institucionet në kuadër të ELP-së. Megjithatë, problematikat e evidentuara në lidhje me 'të dëshmojnë, se zbatimi i këtyre detyrave, si edhe bashkërendimi i përpjekjeve për marrjen e masave për realizimin e tij ka qënë i fragmentuar dhe nuk ka dhënë rezultate të kënaqshme.

Edukimi ligjor i publikut në kuadër të reformës në drejtësi

Reforma në sistemin e drejtësisë, e konceptuar mbi 7 shtylla bazë, që së bashku përbëjnë të plotë ndërtesën e sistemit të drejtësisë në vend, si një nga shtyllat e saj parashikon "Edukimin ligjor dhe arsimin juridik". Këto 7 shtylla të reformës në sistemin e drejtësisë janë edhe pjesët kryesore përbërëse

2. Po aty

të Analizës së Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri,3 mbi gjetjet e të cilës është hartuar Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë dhe Plani i Veprimit4 të saj. Këto dokumente, shërbyen si bazë për hartimin e ndryshimeve kushtetuese, si edhe të paketës së projekt-ligjeve që do të bëjnë të mundur zbatimin e kësaj reforme kyçe për integrimin evropian të vendit tonë.

Në kuadër të vlerësimit të situatës aktuale të ELP, Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri5 evidenton disa gjetje të rëndësishme si më poshtë:

1. Institucionet shtetërore nuk kanë projekte dhe plane për të promovuar e mundësuar këtë formë edukimi;
2. Nuk ka një strategji kombëtare për edukimin ligjor të publikut;
3. Nuk ka një koordinim dhe planifikim të mirë të edukimit vazhdues ligjor të publikut;
4. Nuk ka një ndarje të detyrave institucionale dhe të shoqërisë civile, për edukimin dhe informimin vazhdues ligjor të publikut;
5. Nuk konstatohet ndonjë institucionalizim i edukimit ligjor për shtetasit. Nuk ka ndonjë institucion koordinues dhe përgjegjës që të nxisë, organizojë dhe monitorojë këtë veprimtari të rëndësishme;
6. Deri tani edukimi ligjor është kryer me anë të projekteve dhe iniciativave të organizatave jofitimprurëse që veprojnë në këtë fushë dhe me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë.

Njëkohësisht, me evidentimin e problematikave lidhur me ELP, Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri identifikon edhe objektivat dhe qëllimet që duhet të përmbushë ELP në të ardhmen, të cilat, në mënyrë jo shteruese përfshijnë:6

1. Kombinimin e dhënies së informacionit të nevojshëm dhe zhvillimin e njohurive, rritjen e kapacitetit për të kuptuar dhe aftësive të nevojshme për të marrë vendimet e duhura në situata që lidhen me të drejtat dhe detyrimet ligjore;

---

3. Miratuar me vendimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar, nr.14, dt.30.07.2015 "Për miratimin e Dokumentit 'Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri'; Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, *Analiza e Sistemit të Drejtësisë*, fq. 215 http://www.reformanedrejtesi.al/sites/default/files/dokumenti_shqip_0.pdf
4. Miratuar me vendimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar, nr.15, datë 30.07.2015 "Për miratimin në parim të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për reformën e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri". https://reformanedrejtesi.al/sites/default/files/draft_strategjia_versioni_shqip.pdf
5. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, *Analiza e Sistemit të Drejtësisë*, fq. 223 dhe 226 http://www.reformanedrejtesi.al/sites/default/files/dokumenti_shqip_0.pdf
6. .Po aty, fq. 215

2. Dhënia e mundësisë për qytetarët që të orientohen brenda spektrit të gjerë ligjor, duke njohur të drejtat dhe detyrimet e tyre, dhe për rrjedhojë në disa raste duke i aftësuar në identifikimin paraprak dhe shmangien e problemeve të mundshme në të ardhmen apo përshkallëzimin e tyre;

3. Më shumë pjesëmarrje, vend dhe rol për profesionistët e së drejtës;

4. Mbështetjen e qytetarit për të (i) njohur të drejtat; (ii) kuptuar rolin dhe funksionet e institucioneve dhe mekanizmave të dhënies së drejtësisë; (iii) kuptuar konceptin e qytetarisë në shtetin e së drejtës; (iv) përditësimin e dijeve mbi legjislacionin e fushës së interesit.

Ndërsa format e realizimit të ELP-së duhet të përfshijnë:7

a) Informim dhe ndërgjegjësim të vazhdueshëm, masiv për çështje me natyrë dhe interes

të përgjithshëm dhe problematik për një aspekt të caktuar. Fushatat mediatike kanë qëllim të informojnë dhe sensibilizojnë në mënyrë të shpejtë dhe të shkurtër për një fenomen specifik, ndërkohë që burime më të qëndrueshme si një faqe interneti apo një linjë telefonike synojnë një përkrahje të vazhdueshme për një informacion më të hollësishëm mbi fusha të caktuara. Secila qasje sigurisht ka një avantazh të saj, por zgjedhja e secilës është gjithmonë në varësi të qëllimit që dëshirohet të realizohet nëpërmjet edukimit ligjor në një rast specifik;

b) Përgatitje, publikim dhe shpërndarje e materialeve informuese për një problem specifik, si për shembull: dhuna në familje, të drejtat e konsumatorit, artikuj në gazeta etj;

c) Historitë e suksesit ose jo, përmes të cilave reflektohet qëndrimi i drejtë apo i gabuar;

d) Njohjen me institucionet specifike, shërbimet dhe rolin e tyre kundrejt mbrojtjes së qytetarit, ose aksesit në drejtësi, të tilla si: ndërmjetësimi, noteria, ndihma ligjore etj;

e) Një faqe interneti që mund të jetë e specializuar në disa fusha specifike të së drejtës, ndaj të cilave qytetarët janë më të ekspozuar në veprimtaritë e tyre të përditshme. Ky edukim ligjor në këtë aspekt është i një natyre të përhershme dhe ka më tepër qëllim konsultativ dhe udhëzues për ushtrimin e të drejtave të qytetarëve se sa rol parandalues për mos shkeljen e tyre;

f) Ditët e hapura në institucione të ndryshme shtetërore dhe oraret publike të unifikuara;

g) Takime me profesionistë të ndryshëm të se drejtës.

7. . Po aty, fq. 215

Në tërësi, ELP-ja mund të organizohet dhe ofrohet nga burime dhe forma të ndryshme. Ajo mund t'u drejtohet qytetarëve në përgjithësi, politikëbërësve, ose segmenteve të caktuara shoqërore me një nevojë të veçantë.

Strategjia e reformës në sistemin e drejtësisë që pasoi Analizën e Sistemit të Drejtësisë ka përcaktuar si objektiv kryesor për ELP-në ***rritjen e ndërgjegjësimit qytetar për rëndësinë e zbatimit të ligjit.*** Për realizimin e këtij objektivi parashikohen të merren disa masa konkrete:8

1. Përfshirjen e edukimit ligjor në lëndët bazë të arsimit parauniversitar dhe pasurimin e kurrikulave dhe aktiviteteve ekstrakurrikulare të sistemit arsimor parauniversitar me elemente të edukimit ligjor në fushën e së drejtës penale, administrative, fiskale, civile dhe familjare, si edhe rishikimin e natyrës së informacionit që u ofrohet nxënësve, duke e vënë theksin te natyra juridike, jo vetëm moralizuese, e të drejtave dhe detyrimeve të fëmijëve dhe të të rinjve;
2. Përgatitjen e stafit pedagogjik me nivelin e domosdoshëm të njohurive juridike përmes përfshirjes së lëndëve të detyrueshme të edukimit ligjor në kurrikulat universitare të programeve të mësuesisë, si edhe përmes programeve *të trajnimit vazhdues;*
3. Rritjen e njohurive praktike mbi funksionimin e institucioneve vendimmarrëse, atyre ekzekutive dhe gjyqësore, si edhe nxitjen e aktivizimit të publikut dhe rritjen e kohezionit social përmes informimit mbi mënyrat e pjesëmarrjes në vendimmarrje;
4. Pasurimin e njohurive juridike të publikut përmes ngritjes së portaleve informative të natyrës praktike në fushën e së drejtës penale, civile, fiskale, administrative dhe familjare;
5. Njohjen me alternativat e zgjidhjes së konflikteve, larg vetëgjyqësisë dhe hakmarrjes, me qëllim parandalimin e kriminalitetit dhe të sjelljeve të kundërligjshme, sensibilizimin mbi avantazhet e zgjidhjes me ndërmjetësim dhe arbitrim të mosmarrëveshjeve përmes organizimit të fushatave masive edukative për publikun;
6. Rritjen e aksesit në drejtësi përmes ofrimit të informacioneve të thjeshta dhe programeve të posaçme informative për publikun mbi sistemin e drejtësisë;
7. Detyrimin ligjor të institucioneve shtetërore për mbështetjen e projekteve mbi botimin e librave të përdorimit qytetar "Ligji në jetën tuaj", si domosdoshmëri për njohjen nga qytetarët të normave bazë të legjislacionit

8. Strategjia e reformes ne sistemin e drejtësi, fq. 29, http://www.reformanedrejtesi.al/dokumenti-strategjik-dhe-plani-i-veprimit

evropian dhe shqiptar, kryesisht të normave dhe rregullave që lidhen me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, njohjen e detyrimeve dhe procedurave fiskale, të drejtat e konsumatorëve, të drejtën e informimit të publikut, detyrimin e institucioneve për trajtimin e kërkesave dhe ankesave të qytetarëve etj.

Strategjia e reformës në sistemin e drejtësisë u shoqërua nga Plan – Veprimi (PV) ku në pjesën e IV parashikohen masat që duhet të ndërmerreshin gjatë vitit 2015-2016 për përmbushjen e objektivave të sipërpërmendur.9 Një pjesë e mirë e masave të parashikuara rezultojnë ende të pazbatuara.

Strategjia e edukimit ligjor të publikut

Në Analizën e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri evidentohen problematikat e lidhura me ELP-në, duke vlerësuar se "*Institucionet shtetërore nuk kanë projekte e plane për të promovuar e mundësuar këtë formë edukimi.* ***Nuk ka një strategji kombëtare për edukimin ligjor të Publikut..***" (theksimi – yni).10 Gjetjet e Analizës së Sistemit të Drejtësisë shërbyen si bazë për hartimin e ndryshimeve kushtetuese, si edhe të paketës së projekt – ligjeve, që do të bëjnë të mundur zbatimin e reformës në drejtësi, pjesë e të cilës është edhe Projekt-Strategjia e Edukimit Ligjor të Publikut (më poshtë: SELP) në Republikën e Shqipërisë.

Për hartimin e SELP,11 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë është mbështetur jo vetëm në gjetjet e Analizës së Sistemit të Drejtësisë, por edhe në objektivat e Strategjisë së Reformës në Sistemin e Drejtësisë, që pasoi këtë analizë dhe ka përcaktuar si objektiv kryesor për ELP-në *rritjen e ndërgjegjësimit qytetar për rëndësinë e zbatimit të ligjit.* Për realizimin e këtij objektivi parashikohet të merren disa masa konkrete, të cilat janë mbajtur në konsideratë dhe janë shtjelluar në këtë projekt-strategji.

Gjithashtu, vënia në jetë e SELP-it përkon me fillimin e zbatimit të ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore të miratuara në kuadër të reformës në drejtësi. Kjo strategji synon të adresojë jo vetëm ELP-në në tërësi, por edhe dinamikat që paraqet Reforma në Drejtësi.

---

9. https://reformanedrejtesi.al/sites/default/files/draft_strategjia_versioni_shqip.pdf
10. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, *Analiza e Sistemit të Drejtësisë*, fq. 223 http://www.reformanedrejtesi.al/sites/default/files/dokumenti_shqip_0.pdf
11. Linku ku mund të gjeni projekt-SELP: http://www.altri.al/wp-content/uploads/2018/01/SELP-.pdf

Procesi i hartimit të SELP ka fillur menjëherë pas miratimit të Strategjisë së Reformës në Sistemin e Drejtësisë. Për përcaktimin e përmbajtjes dhe të politikave të këtij dokumenti strategjik, Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë (GENL) i ngritur pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, fillimisht janë mbështetur në problematikat dhe gjetjet e evidentuara në Analizën e Sistemit të Drejtësisë dhe në orientimet e Strategjisë së Reformës në Sistemin e Drejtësisë. Gjatë diskutimeve të GENL u gjykua e nevojshme që arsimi juridik të trajtohej përtej konceptit formal dhe përveç institucioneve arsimore të përfshihen edhe institucione dhe aktorë të tjerë, publik dhe private, me qëllim zgjerimin dhe shtrirjen e edukimit ligjor ndaj shtresave të ndryshme të shoqërisë. Më pas, për të zhvilluar një analizë më të thelluar të situatës aktuale të ELP në Shqipëri, u mblodhën të dhëna nga institucionet dhe aktorë të ndryshëm, të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në ELP,12 si edhe u zhvillua punë kërkimore për identifikimin e kuadrit ndërkombëtar ligjor dhe politik, që trajton ELP. Mbështetur në analizën e situatës aktuale të ELP, ekspertët përcaktuan vizionin, qëllimet dhe objektivat strategjikë të ELP për 5 vitet e ardhshme (2018-2023).

Procesi i hartimit dhe i përmirësimit të vazhdueshëm të përmbajtjes së SELP është karakterizuar nga gjithëpërfshirja e institucioneve publike dhee atyre të pavarura, akademikëve, ekspertëve, OSHC-ve dhe partnerëve ndërkombëtare, që kanë përgjegjësi/njohuri apo veprojnë në fushën e ELP. Gjithëpërfshirja e aktorëve të sipërpërmendur konstatohet në të gjithë fazat e hartimit dhe konsultimit të SELP. Në GENL të ngritur pranë Komisionit të Posaçëm dhe përgjegjës për hartimin e SELP përfaqësoheshin institucionet më të rëndësishme të sistemit të drejtësisë.13 Gjithashtu, në funksion të një gjithëpërfshirje sa më të gjerë u krijua Rrjeti i Konsultimit Publik të Profesionistëve për reformën në drejtësi pranë Komisionit të Posaçëm, i përbërë

12. U kërkuan të dhëna nga 11 ministri, 16 institucione publike e të pavarura, 61 bashki, 11 organizata ndërkombëtare, 33 ambasada dhe rreth 500 OSHC. Nga të gjithë institucionet e konsultuara kthyen përgjigje 72% e ministrive; 30% e bashkive dhe 50% e institucioneve të tjera.

13. Përfaqësues të Gjykatës së Lartë, Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Drejtësisë, Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Shkollës së Magjistraturës, Universitetit të Tiranës, Fakultetit të drejtësisë si dhe ekspertë ndërkombëtar përfaqësues të misioneve të asistencës ndërkombëtare për sistemin e drejtësisë në vendin tonë si : Euralius – BE, OPDAT-SHBA, Prezenca e OSBE-së, Komisioni i Venecias etj. Ftesës së Komisionit të Posaçëm për bashkëpunim në këtë proces ju përgjigjën pozitivisht edhe Presidenti i Republikës, Gjykata Kushtetuese, Ministria e Integrimit Evropian, Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, Avokatura e Shtetit, Avokati i Popullit, Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve, Dhoma Kombëtare e Noterisë, Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor etj., të cilët u përfaqësuan me ekspertë në Sekretariatin Teknik.

nga rreth 1900 përfaqësues të OSHC-ve, gjykatave dhe prokurorive të të tri niveleve, avokatë, profesorë të Fakulteteve të Drejtësisë, Shkollës së Magjistraturës dhe ekspertë të angazhuar në projekte kërkimore në fushën e drejtësisë.

Mbështetur në objektivat e dokumenteve strategjike të sipërpërmendur, vizioni i ELP-së për vitet e ardhshme është "***Qytetarë më të ndërgjegj***ësuar për rëndësinë e njohjes së ***ligjit, të*** të ***drejtave dhe detyrimeve të tyre, bazuar në nevojat specifike dhe nxitjen e aktivizimit qytetar për forcimin e shtetit të së drejtës"*** (theksimi – yni). SELP synon organizimin e një aksioni të gjerë dhe të vazhdueshëm, që do t'u sigurojë individëve, sipas nevojës, njohuritë e nevojshme ligjore për t'u përballur me problemet ligjore që mund t'u lindin gjatë jetës së tyre, t'i aftësojë për të kuptuar legjislacionin dhe të shmangin shkeljen e ligjit. Strategjia do të shërbejë për t'i ndihmuar individët, që bazuar në njohuritë mbi legjislacionin në fuqi, mundësisht të adresojnë vetë, problemet dhe shqetësimet që kanë. Në rastet kur vendosin të kërkojnë ndihmë dhe përfaqësim profesional nga një avokat, të jenë në gjendje të ndërtojnë së bashku me 'të strategjinë e ndërhyrjes ligjore dhe të jenë në gjendje të kuptojnë shërbimin që u ofrohet nga përfaqësuesi dhe zhvillimin e procesit administrativ, ose gjyqësor ku janë palë.

Nga ana tjetër, edukimi ligjor do të rritë ndërgjegjen qytetare të individëve, t'i nxitë të jenë aktivë në jetën e vendit, të respektojnë legjislacionin në fuqi dhe ta kërkojnë këtë nga administrata publike dhe individët e tjerë, duke mbajtur qëndrim kritik ndaj kujdo që i shkel ligjet, apo abuzon me to. Të rritë ndërgjegjen qytetare, duke kontribuar për mbrojtjen e zhvillimin e vlerave të shoqërisë demokratike dhe për zhvillimin pozitiv të vendit, për të ndjekur e monitoruar veprimtarinë e organeve të pushtetit shtetëror, por dhe të bashkëpunojë me to në të mirë të vendit e të interesit publik. Informimi e edukimi ligjor i publikut, gjithashtu, do të duhet t'i bëjë të aftë individët që të identifikojnë nevojën për përmirësime ligjore dhe për të marrë pjesë aktive në diskutimin e projektligjeve, programeve të zhvillimit të vendit ose të sektorëve të ndryshëm, që paraqiten për shqyrtim nga administrata publike ose strukturat publike kompetente.

Vizioni do të materializohet nëpërmjet **4 Qëllimeve Strategjike** për vitet 2018-2023, të cilat kanë në themel ELP në funksion të nevojave të individëve.

Qëllimi Strategjik nr.1: Sigurimi i ELP përmes përmirësimit 100% të kuadrit ligjor, institucional dhe financiar deri më 2023.

Qëllimi Strategjik nr.2: Garantimi dhe forcimi i bashkëpunimit efektiv

ndërinstitucional në nivel lokal, rajonal e kombëtar për realizimin e ELP.

Qëllimi Strategjik nr.3: Sigurimi i performancës efektive dhe efiçente të institucioneve publike dhe të pavarura, medias dhe shoqërisë civile përmes rritjes së vazhdueshme të kapaciteteve në ofrimin e ELP.

Qëllimi Strategjik nr.4: Ndërgjegjësim i publikut për rëndësinë e njohjes se ligjit, të drejtave dhe detyrimeve të tyre, bazuar në nevojat specifike dhe nxitjen e aktivizimit qytetar për forcimin e shtetit të së drejtës.

Aktualisht ka përfunduar procesi i hartimit dhe konsultimit të SELP me të gjithë aktorët e sipërpërmendur dhe pritet së shpejti miratimi i këtij dokumenti nga Kuvendi. Zbatimi i SELP do të realizohet nëpërmjet hartimit të Planit të Veprimit nën mbikqyrjen dhe koordinimin e Ministrisë së Drejtësisë dhe zbatimit të këtij Plani nga institucionet përgjegjëse për ofrimin e ELP të parashikuar nga legjislacioni në fuqi edhe në këtë dokument strategjik.

Roli i avokatit në edukimin ligjor të publikut

Një numër i madh dispozitash ligjore parashikojnë detyrime pozitive për një sërë institucionesh, publike apo private, të cilët janë pajisur jo vetëm me detyrimin e informimit të qytetarëve për të drejtat dhe detyrimet e tyre ligjore dhe veprimtarinë që kryejnë, por edhe me ndërmarrjen e hapave konkrete dhe praktike në ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe edukimin e tyre me njohuri ligjore të nevojshme, sipas fushave përkatëse.

Megjithatë, pjesa më e madhe e tyre rezulton të mjaftohen me vënien në dispozicion të informacionit për publikun në faqen e internetit. Ato nuk angazhohen në iniciativa të tjera për ta bërë këtë informacion sa më të prekshëm dhe të aksesueshëm për subjektet e interesuara. Përpos qasjes së kufizuar të ofrimit të shërbimit të ELP-së është konstatuar një mungesë e koordinimit të ofrimit të shërbimit të ELP-së. Si rezultat i mungesës së një qasje të strukturuar në këtë drejtim, mënyra e ofrimit të ELP nga këto organe ka rezultuar si në mangësi në ofrimin sistematik të këtij shërbimi, ashtu edhe në mbivendosje tematike të ofrimit të shërbimit të ELP-së.

Ligji nr. 9109, datë 17.07.2003 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", (i ndryshuar) parashikon në nenin 2 të tij se, ndër të tjera, "*Avokati jep ndihmë juridike nëpërmjet: a) këshillimit ligjor për çështje të ndryshme;.....f) veprimeve të tjera të ndihmës juridike që parashikohen në ligj".*

Ndërkohë, **në nenin 2 të** Statutit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë

parashikohet që kjo e fundit, si organ përgjegjës për rregullimin dhe kontrollin e ushtrimit të profesionit të avokatit në Republikën e Shqipërisë, ndër të tjera ka si objekt të veprimtarisë së saj edhe *nxitjen e dhënies së ndihmës juridike falas për ata që nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të pajtuar një avokat.* Po në Statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë (neni 3) pararashikohet se, veprimtaria e saj do të realizohet kryesisht nëpërmjet:

- ✓ Takimeve, seminareve, debateve profesionale, përgjithësimeve të përvojës së avokatëve, zyrave avokatore dhe dhomave të avokatëve;
- ✓ Rritjes **së aftësisë botuese me tematikë** juridike të avokatëve në organet e shtypit periodik;
- ✓ Krijimit, funksionimit dhe botimit të një buletini të pavarur;
- ✓ Pjesëmarrjes në takime **të organizatave dhe shoqatave të** huaja të juristëve të pavarur.

Ligji i ri nr.111/2017 «Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti» u miratua si rrjedhojë e problematikave të konstatuara në ofrimin me efektivitet të ndihmës juridike nga organet e ngritura në bazë të ligjit të vjetër (ligji nr.10039, datë 22.12.2008 "Për ndihmën juridike") për shkaqe të organizimit, të kapaciteteve të stafit që u punësua pranë tyre dhe buxheteve të pamjaftueshme që iu vunë ndër vite në dispozicion. Miratimi i ligjit të ri, në kuadër të reformës në drejtësi, dhe zbatimi i shpejtë i tij janë një faktor i rëndësishëm për ELP.

Në këtë ligj parashikohet se, institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji janë Ministri i Drejtësisë, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, Dhoma Kombëtare e Avokatisë (DHKA) dhe gjykatat.

Ministria e Drejtësisë në fushën e shërbimit të ndihmës juridike zhvillon politikën shtetërore për të siguruar akses efektiv në këtë shërbim; përgatit projekt-buxhetin, në përputhje me legjislacionin në fuqi; ngre Drejtorinë për Ndihmën juridike falas në varësi të saj; mbikëqyr zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore dhe ndihmon në vlerësimin e cilësisë së ndihmës juridike të dhënë, si edhe i propozon DHKA, në rast të shkeljes së dispozitave të këtij ligji, fillimin e procedimit disiplinor për marrjen e masave të pezullimit, ose heqjes së lejes së ushtrimit të profesionit të avokatit.

Drejtoria për Ndihmën Juridike Falas administron dhe monitoron shpenzimet për ndihmën juridike që rrjedhin si detyrim nga vendimet gjyqësore; mban kontakte me drejtuesit e gjykatave të rretheve gjyqësore për evidentimin e të dhënave të vendimeve për ndihmën juridike falas; menaxhon buxhetin e dhënë për ofrimin e ndihmës juridike nga shteti, për të cilën raporton te Ministri; lidh kontratat e shërbimit me avokatët për ndihmë juridike pas vendimit gjyqësor

në konsultim me DHKA sipas përzgjedhjes së aplikuesit; asiston qytetarët për plotësimin e formularëve për t›ju drejtuar gjykatave për kërkesat për ndihmë juridike falas; *informon qytetarët për parashikimet e ligjit lidhur me kriteret, procedurat, dokumentacionin dhe kushtet e përfitimit të ndihmës juridike falas nëpërmjet shërbimeve juridike ambulante, publikimeve, fushatave në televizion dhe median e shkruar, si edhe nëpërmjet masave të tjera të ngjashme.*

Dhoma Kombëtare e Avokatisë merr pjesë në përcaktimin e kritereve për përzgjedhjen e avokatëve, që japin ndihmën juridike falas dhe specializmin e tyre në fushat përkatëse sipas kërkesave ligjore; merr pjesë në përcaktimin e kritereve për vlerësimin e cilësisë së shërbimit të dhënë nga avokatët; merr masa disiplinore ndaj avokatëve etj.

Gjykatat shqyrtojnë kërkesat për ndihmë juridike falas e cila përfshin ndihmën juridike parësore, dytësore, si edhe perjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore dhe shprehet me vendim për pranimin apo jo të kërkesës, te cilin ia vë në dispozicion Drejtorisë së Ndihmës Juridike.

Subjektet përfitues të ndihmës juridike janë shtetasit shqiptare me vendbanim në territorin e Republikës së Shqipërisë, shtetasit e huaj që e perfitojnë atë mbi bazën e parimit të reciprocitetit, si edhe personat pa shtetesi.

Sipas ligjit, ndihma juridike jepet në format e mëposhtme: a) ndihmë juridike parësore; b) ndihmë juridike dytësore; c) përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, sipas ligjit, dhe përjashtim nga detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit.

Ndihmë juridike parësore është: i) dhënia e informacioneve në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor; ii) dhënia e këshillimit; iii) dhënia e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve; iv) dhënia e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore, ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore; v) përfaqësimi përpara organeve administrative; vi) dhënia e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore. Ndihma juridike parësore jepet nga punonjësit me trajnim të posaçëm, nga organizatat jo-fitimprurëse të autorizuara dhe nga klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë.

Ndihmë juridike dytësore është shërbimi juridik që ofrohet për përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën; ofrimi i

këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në çështjet administrative, civile dhe në çështjet penale, për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural penal. Dhënia e ndihmës juridike dytësore jepet nga avokatët që përfshihen në listën e miratuar nga DHKA, në bazë të kërkesës së personit që gëzon të drejtën për përfitimin e ndihmës juridike dytësore, sipas ligjit.

Nga leximi i dispozitave të mësipërme rezulton që avokatët, ashtu si edhe aktorë të tjerë të sistemit të drejtësisë, mbështetur në detyrat që duhet të përmbushin mund të luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e ELP.

Së pari, si në ligjin nr. 9109, datë 17.07.2003 «Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë» (i ndryshuar), ashtu edhe në ligjin nr.111/2017 «Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti» parashikohet detyra e avokatit "për këshillim" nëpërmjet dhënies së informacionit mbi mënyrat dhe mundësitë e zgjidhjes së një çështjeje konkrete juridike. Në këtë kontekst, këshillimi ligjor i dhënë nga avokatët ndaj klientëve të tyre është nje formë ELP në një fushë apo çështje të caktuar ligjore. Gjithashtu, në nenin 16 të Kodit Etik të Avokatit parashikohet se: "*Avokati duhet t'i shjegojë klientit ligjin dhe linjën e veprimit që ai do të ndjekë duke evidentuar pasojat e mundshme ligjore në favor ose në disfavor te tij. Avokati duhet t'i pergjigjet kerkesave të arsyeshme të klientit për informacion. Avokati duhet të informojë klientin e tij rreth çështjeve të rëndësishme që kanë të bëjnë me përfaqesimin në kohë me qëllim që klienti, në mënyrë të arsyeshme, të mbrojë veten, ose të shfrytëzojë një mundësi të ofruar nga ligji, duke perfshirë edhe çdo zgjidhje të ofruar nga pala tjeter*". Kjo detyrë e avokatit për të informuar klientin nuk është gjë tjetër përveçse një formë edukimi ligjor i tij.

Së dyti, ELP synon t'u sigurojë individëve, sipas nevojës, njohuritë e nevojshme ligjore për t'u përballur me problemet ligjore që mund t'u lindin gjatë jetës së tyre, t'i aftësojë për të kuptuar legjislacionin dhe të shmangin shkeljen e ligjit. Në këtë kontekst, nuk ka dyshim që ofrimi i ndihmës juridike parësore është një formë e ELP, ndërkohë që ofrimi i ndihmës juridike dytësore lidhet ngushtë me ushtrimin e profesionit të avokatit. Ligji nr.111/2017 «Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti» u njeh avokatëve një rol të rëndësishëm në ofrimin e ndihmës juridike dytësore. Megjithatë, nuk mund të mos u njihet avokatëve edhe kontributi i madh që ata japin në mënyrë të vazhdueshme në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së tyre pranë organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore.

Së treti, në një shoqëri të themeluar mbi respektin ndaj Shtetit të

së Drejtës avokati ka një rol të veçantë. Detyrat e avokatit nuk fillojnë dhe mbarojnë vetëm me një përmbushje të ndershme të detyrave, në mënyrën dhe masën e përcaktuar nga legjislacioni. Avokati duhet t'i shërbejë interesave të drejtësisë, si edhe të drejtave dhe lirive të atyre klientëve që i janë besuar për t'u shërbyer dhe mbrojtur. Është detyra e avokatit që jo vetëm të mbrojë çështjen/kauzën e klientit, por të jetë edhe këshilltari i tij.14 Në këtë kontekst, sigurimi i njohurive ligjore sipas nevojës të individëve me qëllim aftësimin e tyre për t'u përballur me problemet ligjore që mund t'u lindin gjatë jetës apo për të kuptuar legjislacionin dhe të shmangur shkeljen e ligjit, gjithashtu është detyrë e avokatëve, të cilët duhet të investohen në këtë drejtim dhe të bëhen kështu aktorë të rëndësishëm në ELP. Është në interes të drejtësisë në përgjithësi, por edhe të avokatit në veçanti, që nëpërmjet përpjekjeve për ELP të aftësojnë individët që të ndërtojnë së bashku me avokatin strategjinë e ndërhyrjes ligjore dhe të jenë në gjendje të kuptojnë shërbimin që u ofrohet nga përfaqësuesi dhe zhvillimin e procesit administrativ ose gjyqësor ku janë palë. Mbështetur në sa më sipër, SELP parashikon që avokatët të kenë një rol të rëndësishëm në ofrimin e ELP nëpërmjet marrjes së veprimeve konkrete edukuese, por edhe nëpërmjet përfshirjes së Dhomës Kombëtare të Avokatisë në Rrjetin Kombëtar për Edukimin Ligjor të Publikut, që do të ngrihet pranë Kuvendit dhe që do të këtë për funksion të koordinojë dhe bashkërendojë veprimet për ELP në nivel ndërinstitucional dhe kombëtar, si edhe do të sigurojë zbatimin e SELP dhe rishikimin e vazhdueshëm të saj.

Për sa më sipër, avokatët dhe DHKA janë aktorë të rëndësishëm në ELP, rol të cilin mund ta ofrojnë në mënyra dhe forma nga më të ndryshmet si, për shembull, nëpërmjet këshillimit ligjor të klientëve të tyre, ofrimit të ndihmës juridike parësore, ofrimit të informacionit ligjor në faqet web apo rrjetet sociale të DHKA apo zyrave të avokatisë, takimeve, seminareve, debateve profesionale, botimeve me tematike juridike të avokatëve në median e shkruar, pjesëmarrjes në emisione/debate televizive me tematikë juridike, botimit të një buletini të pavarur etj. Një shembull i suksesshëm i ELP është edhe nëpërmjet botimit të revistës "Avokatia" dhe trajtimit të temave të ndryshme ligjore për lexuesin.

14. Neni 1.1 i Kodit të Sjelljes i CCBE për Avokatët Evropianë.

Literatura:

- Analiza e Sistemit të Drejtësisë, miratuar me vendimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar, nr.14, dt.30.07.2015
- Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë dhe Plani i Veprimit, miratuar me vendimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar, nr.15, datë 30.07.2015
- Projekt-Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut
- Ligji nr. 9109, datë 17.07.2003 ”Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar)
- Ligji nr.111/2017 ”Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”
- Statuti i Dhomës Kombëtare të Avokatisë
- Kodi Etik i Avokatit

FJALOR SHPJEGUES

Av. Vladimir F. MOLLA
Studiues i së drejtës,
Korçë

(*Vijon nga numrat e kaluar*)

I

inçest

E. m . – Lat. **incestus,** mb. **(in , castus:** jo i dëlirë; **inçestum,** e.m.: fëlliqësi.

1. Bashkim në martesë ndërmjet të afërmve e ndaluar prej ligjit.

- absolut. Bashkim, ndalimi për të cilin nuk mund të ngrihet prej një përjashtimi (martesa ndërmjet të afërmve në linjë të drejtpërdrejtë, ose nëpërmjet vëllait dhe motrës).(Neni 10-1 i K.F.).

- relativ. Bashkim, ndalimi për të cilin mund të hiqet prej një përjashtimi (martesa ndërmjet të afërmve në linjë të tërthortë, vëllezër e motra, mund të lejohet prej gjykatës kur vërtetohen shkaqe me rëndësi). (Neni 10-2 i K.F.).

2. Marrëdhënie seksuale të inkriminuara ndërmjet të afërmve si dhunim, ose cënim seksual.

inçestuoz

Mb.- Lat. **Incestuosus,** që rrjedh prej inçestit (fëmijë inçestuoz), i prekur prej inçestit (bashkim, ose birësim inçestuoz).Kr.: **adulterin**.

in extremis (in ekstremis)

Shprehje lat., që do të thotë: "*në çastin e fundit*", sidomos "*në çastin*

e fundit të jetës" ende e përdorshme në këtë kuptim. Martesë **in extremis** e lidhur në shtratin e vdekjes. Për shembull, martesa e Adolf Hitlerit me Eva Braun është lidhur në çastet e fundit të jetës të tyre.

in extenso (in ekstenso)

Shprehje lat., që do të thotë "*në gjithë shtrirjen e saj*", "*në mbarë brendinë e saj*". Për shembull, llogaridhënia gjatë një seance **in extenso**.

indicje

Shenjë e dukshme dhe e mundshme, për një send që ekziston. Numër, me anën e të cilit shprehet një raport ndërmjet dy madhësive. Raport ndërmjet dy cilësive apo çmimeve, që tregojnë ndryshim: indicje e çmimit.

Në kuptimin juridik: shenjë që mund të tregojë ekzistencën e një fakti. Por kjo ekzistencë nuk mund të nxirret nga indicjet, përveçse kur këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën (pika 2 e nenit 152 të K.Pr.Penale).

infas

Fjalë me origjinë nga tr., me anën e së cilës kuptohej përmbaruesi (ekzekutori) i testamentit. Është vendosur në nenin 2 të ligjit të "Testamenteve", hyrë në fuqi më 28 qershor 1922.

inkriminim

Nga folja *inkriminoj*.

Masa që lidhen me politikën penale, që diktohen prej autoritetit kompetent (në parim, pushteti legjislativ), që krijon një mënyrë sjellje të përcaktuar (jo domosdoshmërisht një krim), një shkelje duke përcaktuar elementët përbërës (themelues) të saj dhe dënimin e zbatuar. Kr.: **pafajësi.**

Shprehje e përdorur edhe në një nga nenet e KEDNj: *Nullum crimen, nulla poena sinae lege – Nuk ka krim e as dënim pa ligj*.

inkriminoj

Lat. E ulët, **incriminare -** me akuzuar, **me ngrit një** një akuzë.

1. Nga ana e legjislatorit: Ngre një fakt në llojin e një shkelje penale (krim, delikt, kundërvajtje etj.).

2. Nganjëherë sin. Në gjuhën gjyqësore lidhur me akuzimin (e një personi), i cili ka tërhequr edhe persona të tjerë, i ka inkriminuar ata në kryerjen e veprës penale, ose edhe kur asnjeri prej tyre nuk ka marrë pjesë në kryerjen e saj inkriminohen me pa të drejtë si fajtorë.

in solidum

Term latin, me anën e të cilit përcaktohen *"të gjitha"***.** Përdoret për të karakterizuar disa detyrime (shih: *detyrime* **in solidum)** dhe, si përjashtim, gjykime që vendosin të tilla detyrime në ngarkim të një personi: *dënim* ***in solidum*.** Kr.: **solidar, i pandashëm**.

intra vires (hereditatis)

Shprehje lat., që përfshin gjendjen e një pasurie trashëgimore deri në konkurrencën e aktivit trashëgimor, i cili përdoret për të karakterizuar detyrimet apo borxhet e një trashëgimtari, ose legatari, në rastet kur këta nuk përgjigjen për detyrimet e tjera që rëndojnë mbi pasurinë trashëgimore, deri sa të konkurrohet me atë që ka fituar nga kjo trashëgimi. Për shembull, trashëgimtari që pranon trashëgiminë nën beneficin e inventarit, nuk mund të detyrohet për borxhet veç **intra vires** (pika 1 e nenit 694 të K.C. të vitit 1929). Ant.: **ultra vires**. Kr.: **pro viribus.**

Intelektual/e

Mb.-lat**.: intellectualis.**

1. Jo material, jo i prekshëm, që përbëhet prej një realiteti moral, i cili nuk varet nga një mbështetje fizike.

- (e drejtë). E. që nganjëherë u jepet zotërimeve jo trupore (**intelektuale),** objekti i të cilëve është thellësisht intelektual, jo material (e drejta mbi një klientelë).

- (falsifikim). Lloj falsifikimi në një shkresë, që prek vetë thelbin

e saj, duke shkatëruar elemente kryesore përbërëse të identitetit të personit. Flasifikimi quhet intelektual kur hartuesi i shkresës bie vetvetiu në lajthim. Për shembull: gjatë plotësimit (mbushjes) të një dokumenti të gjendjes civile lidhur me një person të caktuar, nëpunësi pa dashur hedh në dokumente të dhëna që i përkasin një personi tjetër, të cilat ndodhen brenda së njëjtës fletë, ose dokumenti i personit të gabuar ndodhet i sapo mbushur para nëpunësit, dhe të dhënat e tij hidhen në dokumentin e tjetrit të ardhur fill pas tij.

- (i pronësisë). Term (gjenerik) gjinisor që përfshin pronësinë letrare , artistike e industriale.

2. Që ka të bëjë jo me realizimin, por me konceptimin e një akti përkundrejt *material (pika 8).P.sh.: autori intelektual i një shkelje.

in terminis

Shprehje latine, që do të thotë: "*në kufi të fundit*", çka përdoret nganjëherë për të karakterizuar një vendim gjyqësor, me anën e të cilit i është dhënë fund një mosmarrëveshjeje.

interim

E.m. në lat., me të cilin nënkuptohet: "*gjatë kësaj kohe*".

1. Gjëndje e përkohëshme, sipas së cilës, një nëpunës ngarkohet përkohësisht me një funksion, që papritmas ka mbetur i lirë, duke pritur caktimin përfundimtar të titullarit të ri të postit *ad interim - në zëvendësim.*

interimer

1. (adm.). Thuhet për një person i ngarkuar përkohësisht që të zëvendësojë titullarin e një funksioni, qoftë gjatë një mungese provizore, qoftë për kohën midis ndërprerjes së ushtrimit të funksionit dhe marrjes së tij prej pasuesit.

2. (soc.punë). Thuhet për një punonjës me titull të përkohshëm i vënë në dispozicion të një ndërmarrje për një kohë, ose afat të përcaktuar me punëdhënësin.

inter partes

Shprehje lat., që do të thotë: "*midis palëve*". Përdoret për të treguar efektin relativ të kontratave, që shfaqet gjatë gjykimeve, karakteri detyrues i të cilave apo autoriteti nuk ekzistojnë në parim, por vetëm në vështrim të palëve pjesëmarrëse (mbështetje në të drejtën e tyre mbi diçka), jo në vështrim të të tretëve .Ant.: **erga omnes**

interpretim

Interpretimi, është forma intelektuale e mosbindjes, sipas J. Carbonier.

intuitus personae

Shprehje lat., që do të thotë: "*Duke pasur parasysh personin*". Përdoret për të treguar kryerjen e veprimeve të ndryshme (veçanërisht të marrëveshjeve), në të cilat personaliteti i njërës prej palëve ndikon në mënyrë esenciale në vetë marrëdhënien e lindur nga ku krijohet mundësia për t'i dhënë vlerë një gabimi (lajthimi) mbi personin, për arsye të aftësive të veçanta të natyrës së shërbimit që pritet prej tij etj. Për shembull: depozita, mandati (përfaqësimi) janë përfunduar **intuitu personae,** duke pasur parasysh besimin e depozitarit, të mandatarit etj.

Flasim herë- herë për **intuitu personae (nominativ),** për të përcaktuar dozën e vlerësimit personal që përfshihet në veprimin e kryer.

inventar

Veprim i urdhëruar nga ligji, gjykata etj., për të saktësuar gjendjen fizike nëpërmjet numërimit të sendeve të caktuara që përbëjnë pasurinë e një personi të caktuar.

- i sendeve nën uzufrukt. Marrja në dorëzim e sendeve në uzufrukt duhet të bëhet me akt noterial në përfundim të një inventari të hollësishëm ku shënohet çdo e dhënë që ka të bëjë me sendet e marra në uzufrukt. Inventari mund të bëhet edhe me shkresë private, kur për këtë bien në marrëveshje të dy palët gjatë kryerjes së tij. Shpenzimet në këto raste janë në ngarkim të uzufruktarit, përveçse kur parashikohet ndryshe në aktin e

krijimit të uzufruktit (neni 247 i K.C.).

i/e ve

Lat. : **viduus, vidua,** që do të thotë bashkëshort, martesa e të cilit ka pushuar për shkak të vdekjes të bashkëshortit tjetër.

ixhab

Fjalë me origjinë nga tr., me anën e së cilës nuk kuptohet vetëm vullneti i testatorit i shprehur në një akt të hartuar, ose propozuar për hartim vetëm prej tij, por që ka lidhje të ngushtë ligjore edhe me personin e trashëgimtarit apo legatarit. Kështu, trashëgimlënësi disponon me testament në dobi të dikujt, por nevojitet edhe vullneti i këtij të fundit për të pranuar ose jo disponimin përkatës.

ixhra

Me origjinë nga tr., në kuptimin e kryerjes së procedurës në fazën përmbarimore të një gjykimi; vënie në ekzekutim i letër vendimit, letër gjykimit.

J

jabanxhi

Fjalë e huazuar nga tr., me anën e së cilës kuptohet një person i larguar prej vendit te tij dhe i vendosur në një vend tjeter përkohësisht, përgjithëmonë ose që kalon rastësisht në atje. Në vendin ku ndodhej, i ardhuri thirrej me këtë emër, i cili nënkuptonte një status të veçantë për jabanxhiun e një marrëdhënieje respekti dhe përkrahjeje me përparësi ndaj tij, kur ndodhej në kushte të barabarta me vendësit. Kjo marrëdhënie ka rrjedhur prej statusit të mikut, por ka dallime me atë. Statusin e mikut e kërkonte vetë i ardhuri me fjalët: “A do miq, a pret miq o i zoti i shtëpisë?!”. Ndërsa statusin e jabanxhiut pa e kërkuar kush e vlerësonte në shumicën e rasteve jo një person, por disa persona, jo në shtëpi, por në vende të ndryshme publike, duke marrë bashkërisht aty për aty vendimin

për zgjidhjen e "hallit" të tij. Deri në kohë të vona dëgjohej prej të moshuarve shprehja: "*Ndihmojeni atë,* se është jabanxhi!".Ja si e përdor fjalën **jabanxhi**, nisur nga përjetime vetjake, artistja e njohur, Myfarete Laze, në një intervistë të botuar në 'Gazeta Shqiptare' të datës 5 korrik 2009: "*... Në qytetin e këngës* (është fjala për Shkodrën – V. M.), *humorit, barsoletave, dhimbja zbutej nga fjala e ëmbël, nga ngrohtësia që ky qytet u fali jabanxhinjve, që asnjëherë s'e ndjenë veten të huaj*".

jatak

Fjalë me origjinë nga tr., që do të thotë shtroje (sinonim i fjalës *dyshek*). Përdorej në mënyrë të figurshme për ata persona, të cilët u krijonin lehtësirat e nevojshme dhe strehonin të kërkuarit nga Shteti për krime ordinere dhe politike. Pra i ndihmonin me të gjitha mjetet e nevojshme për t'iu shmangur hetimit, gjykimit dhe dënimit. Ka hyrë në gjuhën e folur dhe është përdorur me të njëjtin kuptim në vendin tonë edhe në kohët e mëvonëshme. Shembull: X (i kërkuari) ka për **jatak Y**(ndihmësin, strehuesin).

Kështu, në shtojcën e parë "Statutet dhe rregulloret e KANÇ", aprovuar ne Konferencën e dytë Nac.- Çl., shtator 1943, në zërin "Mbi Krimet" thuhet shprehimisht: "*Kush bëhet jatak* për kriminelët dënohet me vdekje*"* (shiko: Bernd Fischer, *Shqipëria 1943-1945*, fq. 40).

jerevi/a

Shtëpi e vogël brenda truallit të shtëpisë së madhe, ku rrinte rroja apo kujdestari me familjen e vet. Shpjegim që e kam dëgjuar për herë të parë nga Adelina Mazreku në një emision televiziv të datës 10 mars 2008.

judicatum solvi

Shprehje latine, me anën e së cilës nënëkuptohet garancia në të holla që kërkohet prej një të huaji, i cili ngre padi kundër një vendasi për të përballuar shpenzimet e gjyqit. Sipas nenit 16 të Konventës për statusin e apatridëve, hyrë në fuqi me 6 qershor 1960, çdo apatrid ka të drejtën në teritorin e Shteteve Kontraktuese t'i drejtohet lirisht dhe pa vështirësi gjyqit.

Në Shtetin Kontraktues, ku ka vendqëndrimin e zakonshëm, apatridi do të gëzojë të njëjtin trajtim sikurse dhe shtetasi vendës, të drejtën për t'iu drejtuar gjyqit, duke përfshirë asistencën gjyqësore dhe përjashtimin nga garancia **judicatum solvi.**

jurore

Rrjedh prej fjalëve latine **jus, juris. Është** këshilluar prej Terenc Toçit për t'u përdorur në vend të fjalës *juridike,* për arsye se fjala **jurore** rrjedh prej latinishtes, pra drejt për së drejti nga burimi, në ndryshim nga *juridike***,** që rrjedh prej gjuhëve neolatine, siç janë frëngjishtja apo italishtja (shih: Dr. Terenc Toçi, *E drejta Ndëshkimore*", botim i vitit 1926).

jus

Lat.: *e drejtë*. Në shqip *tagër* (e drejtë). Me këtë fjalë lidhen një sërë të drejtash që ka personi mbi një send të caktuar, gëzimin e fituar prej tij nga një e drejtë e veçantë etj.

Për shembull, e drejta e trashëgimisë mbështetet kryesisht në të drejtën e gjakut që lat. quhet **jus sanguinis.** E drejta e pronësisë, që në vetvete përmbledh tre tagra: të drejtën e përdorimit, të drejtën e gëzimit (mbledhjes të frutave) dhe të drejtën e disponimit, përkatësisht **jus utendi, jus fruendi et jus abutendi.**

jus soli

E drejta e truallit, e tokës, prej së cilës qytetari i një vendi fiton një status të veçantë.

Për shembull, sipas legjislacionit të disa shteteve, i linduri në truallin e një shteti të caktuar e fiton automatikisht (*ipso jure*) shtetësinë e atij vendi.

PËRSIATJET E KALAMANDREIT

Dallimi midis përgjegjësisë së mbrojtjes dhe asaj të gjyqtarit

Njëherë, ndërsa po merrja pjesë në seancën që zhvillohej para kolegjeve të bashkuara të Gjykatës së Kasacionit, dëgjova që kryetari përmblodhi, me pak fjalë të mençura, dallimin ndërmjet përgjegjësisë së mbrojtësit dhe asaj të gjyqtarit.

Kryetari, tashmë në pension, një burrë me vlera shumë të larta intelektuale dhe morale, por me një mënyrë komunikimi paksa të vrazhdë e të rrëmbyer, nuk hynte kurrë në sallën e gjyqit pa e studiuar me shumë kujdes dosjen dhe rekurset e palëve; për çdo çështje ai njihte në majë të gishtave të gjitha veçoritë e faktit dhe të ligjit. I njihte aq mirë sa kur ndonjë avokat bishtnonte nga tema dhe tentonte të rrëshkiste drejt pikave të ngatërruara, pa kaluar as dy minuta, ai e ndërpriste duke e orientuar te problemet thelbësore, me një mori objeksionesh dhe pyetjesh që folësin e vinin vërtet në vështirësi. Kështu, përballë këtij burri kthehej diskutimi i çështjes në një lloj ndeshjeje gojëtarie të llojit trup me trup.

Avokatët që e njihnin ishin mësuar me këtë lloj dialogu në formë debati; dhe kur e dinin që seanca do të drejtohej prej tij mundoheshin të përgatiteshim për diskutim me seriozitetin më të madh, në mënyrë që të ishin në gjendje t'i përgjigjeshin çdo pyetjeje. Por, ndonjëri që nuk e njihte dhe paraqitej në seancë me fjalën e mbrojtjes të tjerrë mirë e bukur, pa frymë mbetej përballë breshërisë së pyetjeve.

Kështu ndodhi edhe kësaj here, kur një avokat nga provinca, i ardhur enkas në Romë për të mbrojtur një rekurs, filloi të recitonte solemnisht fjalën e mbrojtjes, të përgatitur muaj më parë dhe të mësuar përmendësh. Kryetari e ndërpreu menjëherë në mes, që në krye të herës, duke e ftuar që të përqëndrohej në pikat thelbësore të çështjes. Ai filloi të belbëzojë, të lëkundet, nuk përgjigjet… dhe, sikur të mos kishte ndodhur asgjë, fjalën

e mbrojtjes e fillon në pikën ku e kishte lënë. Shohim një ndërprerje të re, më të vrazhdë, dhe një pështjellim të ri. Më në fund, avokati që nuk ishte i zoti të përballej me këtë uragan, nuk diti të thoshte tjetër veçse:

- Ju po më pengoni të bëj detyrën. Protestoj dhe heq dorë nga fjala!

Dhe u ul. Atëhere kryetari u zbut dhe me një ton të përzemërt si rrallëherë i tha:

- Avokat, mos i merr për keq ndërhyrjet e mia. Do kishit të drejtë të qaheshit nëse do të ishit një konferencier, përballë të cilit publiku ka detyrimin të vuajë në heshtje, edhe pse nuk kupton asgjë nga fjalët që ai thotë. Por ju jeni diçka më tepër se konferencier: jeni avokat, pra, një njeri që flet për t'i bindur gjyqtarët që të gjykojnë mirë. E si mund të bindesh pa kuptuar asgjë? Prandaj, jeni i lirë ta përmbushni detyrën tuaj për të folur, por bëjeni në atë mënyrë që të na ndihmoni edhe ne të tjerët të kryejmë detyrën tonë, të kuptojmë se çfarë doni të thoni.

Te pavetëdija e një nofke

Avokatët penalistë i quajnë në zhargonin e tyre të zinj gjyqtarët, që parimisht priren më shumë nga ashpërsia sesa nga zemërbutësia, dhe që pafajësia u duket si mungesë respekti për dinjitetin e funksionit të tyre (mund të themi, u duket gati si një *crimen laesae maiestatis*[1]).

Por pse i quajnë "të zinj"? Mendoj se në pavetëdijen e kësaj nofke mund të gjendet lidhja me ngjyrën e vrerit, të cilën të vjetrit e quanin "e zeza". Gjyqtarë melankolikë, gjyqtarë të vrertë: fjalë me tingëllim të ndryshëm, por me kuptim të njëjtë. Ashpërsia e tepërt pothuajse gjithmonë varet nga një bllokim i rrugëve biliare, i cili bën të të duket e zezë edhe pafajësia e bardhëme.

Me respektin tim për jurisprudencën, klienti e humbi davanë

E kujtoj gjithmonë me maraz një rast, kur me mbrojtjen që bëra në apel e rrënova klientin tim, sepse nuk më dukej serioze të

1. *Crimen laesae maiestatis* (lat.) - termi e ka origjinën te e drejta romake, që përfshinte çdo krim kundër madhështisë së popullit romak dhe magjistratëve të tij. Më vonë, me këtë term filloi të nënkuptohej çdo krim kundër sovranit, princërve, feudalëve dhe, përgjithësisht, çdo krim kundër shtetit dhe magjistratëve të tij (shën. i përkth.)

mbroja një tezë në kundërshtim me praktikën e atëhershme të Gjykatës së Kasacionit: e bëra për maturi, për të respektuar jurisprudencën e gjykatës më të lartë. Por pas një viti, jurisprudenca e asaj gjykate ndryshoi katërcipërisht: po të mos isha treguar i matur do ta kisha humbur çështjen në apel, por do ta fitoja pas një viti në Kasacion. Kështu, duke e marrë shumë seriozisht respektin për jurisprudencën, u bëra padashur shkak që klienti im ta humbiste davanë.

Nën uniformën zyrtare, edhe cenet vetjake

Përballë shënjtërisë së seancës gjyqësore, me liturgjinë dhe zbukurimet e saj, shtrembërimi ritual i togës dhe mbikresës (paruka në gjykatat angleze) i shndërron gjyqtarët, ose na duket sikur i shndërron ata në simbole identike dhe të barasvlefshme të të njëjtit funksion, ngaqë të gjitha cenet e rënda vetjake arrijnë të mbulohen me uniformën zyrtare.

Mes këtyre ceneve, që kjo maskë do të donte t'i fshihte, duhet të llogariten edhe ato lëngime fizike, të ndryshme në njerëz të ndryshëm, që hera-herës ndodh ta dhunojnë natyrën e brishtë dhe të dhimbsur njerëzore. Por ligji i procedurës nuk i njeh këto cene: ai nuk pranon që magjistratët e ulur në seancë, të veshur me të njëjtën togë, mund të kenë moshë të ndryshme, shëndet të ndryshëm apo humor të ndryshëm; nuk bën dallimin mes të riut dhe plakut, sagllamit e sakatit, anemikut dhe pletorikut. Nuk e pranon që këto personazhe të palëvizshme dhe dinjitoze, që në ceremonitë solemne mbajnë veshje të purpurt dhe prej gëzofi, mund të jenë prekur nga ndonjë sëmundje e pashmangshme e pleqërisë, nga mëlçia që lëngon apo nga zemra që rreh me vërtik. Sipas teoricienëve, për procesin ka rëndësi forma, ajo që është e njëjtë për të gjithë; gjyqtarët janë të gjithë shëndoshë e mirë, modele të integritetit moral dhe fizik, me ndjenja të çelitura e nerva çeliku; për ta nuk shtrohet fare problemi i qëndrueshmërisë fizike, sepse nuk janë njerëz që epen nga pesha e dhimbjes, por abstraksione simbolike, që s'duan t'ia dinë nga uria dhe nga etja, nga lodhja e nga mosha.

Por avokatët e dinë që fati i çështjes së tyre mund të varet konkretisht edhe nga një krizë e mëlçisë apo nga një sindromë e moshës së vonë. Edhe vendimet mund të sëmuren nga artriti apo nga verdhëza, dhe simptomat e tyre zbulohen në përmbajtje të vendimit. Shpesh apelimi para një gjykate më të lartë i ngjan një kure detoksifikuese, të zgjedhur për

të shkrirë gurët e tëmthit; kundër vendimit të gjyqtarit të sëmurë kërkohet drejtësia e gjyqtarit të shëndoshë (ose, të paktën, e atij që vuan nga një sëmundje tjetër).

Efektet e ndryshme të kolegjialitetit

Në disa raste, ndodh që kolegjialiteti mund të jetë një bar qetësues që topit ndjenjën e përgjegjësisë vetjake; por në disa raste të tjera mund të jetë edhe bar forcëdhënës. Kolegjialiteti mund të shërbejë si mbështetje, kur merr guximin që të ecësh kundër rrymës; kur fryn furtunë është mirë të mos jesh vetëm, ngaqë kur njerëzit bëhen bashkë kapen për dore dhe mbajnë njëri-tjetrin që të mos gremisen.

Shqipëruar nga:
Dr. Henrik LIGORI

FTESË PËR BOTIM

Revista "AVOKATIA" mirëpret artikuj të autorëve avokatë, asistentë avokatë dhe profesionistë të tjerë të drejtësisë, të cilët mund të kenë mbrojtur edhe disertacione për të fituar gradë dhe titull shkencor. Të interesuarit për botimin e artikujve të tyre akademikë mund të konktaktojnë Kryeredaktorin e Revistës "AVOKATIA", Z. Ilir Dhima, në adresën elektronike: av.literum@gmail.com

Revista "AVOKATIA" është botim i Dhomës Kombëtare të Avokatisë që përmbledh artikuj akademikë mbi shpjegimin e koncepteve kryesore të së drejtës dhe mbi çështje të ndryshme ligjore, ndërthur debatin profesional mbi ligjet e reja të miratuara, vendimet e fundit të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe gjykatave të tjera ndërkombëtare. Rrjedhimisht, mirëpriten artikujt që trajtojnë tematikë ligjore të tilla si:

- Komente, analiza, opinione mbi çështje, probleme dhe zhvillime të ndryshme ligjore, brenda vendit;
- Artikuj analizues mbi praktikën gjyqësore të gjykatave shqiptare dhe ndërkombëtare;
- Analiza mbi zhvillimet ligjore ndërkombëtare.

Autorët që dëshirojnë të botojnë artikujt e tyre në Revistën "AVOKATIA", duhet të përcjellin në rrugë elektronike, në adresën e lartpërmendur:

- Artikullin e propozuar për botim në përputhje me rregullat e përmendura më poshtë;
- CV-në e autorit.

Artikujt e dërguar në Revistën "AVOKATIA" duhet t'i përmbahen rregullave të mëposhtme:

1. Titulli i shkrimit duhet të jetë konçiz e i qartë dhe të përçojë idenë

qendrore të artikullit;

2. Emri i autorit duhet të shoqërohet me titujt shkencorë dhe/ose funksionin përkatës;
3. Artikulli duhet të shoqërohet nga një abstrakt prej 500 fjalësh, i cili përvijon temën dhe argumentet kryesorë të trajtuar në artikull;
4. Artikulli duhet të pasqyrojë në mënyrë konçize dhe të qartë problematikat/çështjet e trajtuara dhe të shqyrtojë në mënyrë të qartë dhe profesionale argumentet. Shkrimi duhe të bazohet në arsyetime të argumentuara mbi qëndrimet e mbajtura, duke respektuar parimet e etikës dhe profesionalizmit;
5. Artikulli duhet të jetë jo më i shkurtër se 8 faqe dhe jo më i gjatë se 20, i shkruar në "Times New Roman", Madhësia 12, Formati A4, "Justified", "Line Spacing 1", ndërsa titulli në Font "Times New Roman", Madhësia e fontit 14, Bold, shkronja kapitale.
6. Artikulli duhet të jetë i pabotuar dhe të shoqërohet me bibliografinë dhe referencat përkatëse.

Pas vlerësimit të artikullit nga Bordi i Revistës "AVOKATIA", ju do të njoftoheni nga Kryeredaktori lidhur me vendimin mbi botimin e artikullit tuaj. Ju inkurajojmë të dërgoni artikuj pranë Revistës "AVOKATIA" dhe mirëpresim sugjerimet tuaja.

"Revista Avokatia"
Dhoma Kombëtare e Avokatisë
Rr. "Murat Toptani"
Qendra e Biznesit "Eurocol", Kati 7, Tiranë
Tel. +355-4-22-51-876
Cel: +355 69 27 42 425
E-mail: av.literum@gmail.com

SUMMARY

The 26th issue of the 'Advocacy' journal opens again by an "**Editorial**" entitled "**The independence, trust, and integrity – professional obligations for lawyers**", which emphasizes the need for respecting the function of lawyers as one of the essential preconditions for strengthening the rule of law and consolidating democracy. An overview of the Code of Ethics of the Bar Associations and the CCBE from this light, and especially the Code of Ethics of the Albanian Bar Association, shows issues which are mainly related with three principles, which lawyers are obliged to adhere to.

The "**Documents**" section carries a "**CCBE press release on the extraterritorial application of search warrants"**. The organization notes that such application might jeopardize the rights of the legal professionals and their clients to engage in confidential communication, referring to the integrity of lawyer-client communication as an indispensable precondition for a fair trial.

The next section, "**Constitutional law**", carries an article on "**Prohibition of the right to vote from a new Constitutional perspective**" by **Av. Dr. Viktor Gumi**, *Member of Tirana Bar Association*. He elaborates on the negative effects of Law No. 138/2005, whose content falls contrary to the spirit and letter of the Constitution of the Republic of Albania and with the rights guaranteed by the European Convention on Fundamental Human Rights and Freedoms. The author concludes that the Constitutional Court might have to revisit its decision on this law from the light of the case law of the Court of Strasbourg and once some time has passed for today's political emotions in Albania to be less influential.

The "**Opinion**" section offers an article by **Av. Vasil Bendo**, *Member of Tirana Bar Association*, entitled "**The Constitutional reform of the administrative law**". This is one of the most widely discussed topics at the moment with the Constitutional and procedural amendments failing

to provide the necessary guarantees for their implementation in practice. Therefore, the author suggests a two-instance administrative adjudication process organized proportionally to the ordinary jurisdiction system as the best solution. He proposes two options for introducing such a system, consisting of legal and organizational changes, which would require both legislative intervention and a political decision.

The same section carries also an article entitled "**A hasty, and not well-thought, normative intervention**", where **Av. Përparim Kalo** and **Av. Aigest Milo** from *"Kalo & Associates" Legal Firm in Tirana,* refer to the normative text of Law No. 19/2016 "On additional measures for public safety". According to the authors, such measures cause a unjustified burden for certain private entities, as well as costs that cannot be ignored, and that fall contrary to their economic freedom, and their right of protection of personal data.

The "**Criminal law**" section offers an "**Analysis of the international standards and local practice regarding application of arrest in prison**". Its author, **Av. Erida Skëndaj**, *Executive Director of the Albanian Helsinki Committee (AHC) in Tirana*, analysis the most important international acts recognizing and promoting the right to freedom and security, the case law of the European Court for Human Rights, the national legislation in this area, and the findings of the latest AHC monitoring report on arrest warrants issued by the two largest courts in the country, Tirana and Durrës.

The "**Legal Sciences**" section carries an article by **Av. Prof, asoc. Dr. Fatmir Tartale**, *Dean of the Faculty of Social Sciences at the Albanian University – Tirana*, on "**The effective use of expertise in discovering the truth in criminal proceedings**". With every type of expertise having its own specific characteristics, the author has chosen to focus on the actual possibility for securing proof through certain types of expertise, including: traceological expertise, forensic medicine, AND, and odor analysis.

The "**Family law**" section carries an article entitled "**The biotechnology challenges in law and their impact on the Albanian society**". Its authors, **Prof. asoc. Dr. Hemion Braho** and **Prof. asoc. Dr. Juelda Lamçe**, *Lecturers at the European University in Tirana*, provide an overview of the types of assisted reproduction and list some of the arguments in favor and other against such practice. They focus on the court case law in this regard, referring also to decisions of the Court of Strasbourg

and certain other countries on surrogate adaption. In conclusion, the article contains some considerations regarding the normative regulation of assisted reproduction technology in our country.

Next comes the "**Civil law**" section carrying an article on "**Assertion and silence as proof in court proceedings**" by **Ina Hoxhaj**, *a judge in the Judicial District Court of Pogradec*, currently *Acting Assistant Magistrate in the High Court of the Republic of Albania*. The author addresses this means of proof from the scientific perspective in the context of judicial practice. The author identifies also the gaps in the Code of Civil Procedures regarding assertion in court. In terms pf methodology, the author provides a historical overview, analysis, and a comparison with the legal means applied in the Republic of France and the Republic of Italy.

The "**Intellectual Property**" section carries an article entitled "**Agencies of collective administration of copyright**" by **Av. Dr. Oltion Spiro** from the *'Loloçi & Associates' Legal Firm* and *Lecturer at the University of Tirana.* The author explains why such agencies are very important links in the chain of effective implementation of copyright. This requires, on one hand, empowering these agencies with power to act, as well as contracting authority, on the other, for them to be able to balance their activity in terms of oversight and transparency of the process. The authors concludes that such means of control must be in the hands of the members of such agencies and those of the state bodies licensing them.

The "**Harmonization**" section carries an article entitled "**Meaning and use of *Amicus Curiae***" by **Alket Jaupi**, *Expert at the Ombudsman Office in Tirana*. The author explains the concept of '*Amicus Curiae*', and how it is used to have the best impact possible in court proceedings, legal systems of human rights, and in the Albanian context, where this opportunity could be applied by human rights activists and independent institutions as a powerful means of giving a voice those who do not have one, including vulnerable individuals and groups of people.

"**Public legal education and the role of lawyers**" is the title of the article that comes under the "**Horizons**" section by **Eda Noçka**, *Executive Director of the Albanian Legal and Territorial Research Institute in Tirana*. The author elaborates on the benefits of the implementation of one of the seven main pillars of the justice reform, which was part of the Review of the Legal System in Albania, whose findings served as the basis of the Justice Reform Strategy and its Action Plan, approved by a decision of the

Ad Hoc Parliamentary Committee of July 2015.

The editorial office decided to provide another "**Glossary**" under the "**Etymology**" section, which explains the meaning and origin of some specific terms, which are a result of a multi-annual research by **Av. Vladimir Molla**.

This issue includes also a **"Humor & Satire**" section, containing the permanent title "**Eulogy of Calamandrei**", which brings some anecdotes and personal experience of this distinguished Italian lawyer (1889-1956). This piece, which often reflect the often fragile relationships between the parties in a civil case – lawyers and judges – are translated into a proper and smooth Albanian language for our readers by **Dr. Henrik Ligori**, *the Deputy Chief Prosecutor for Serious Crimes*.

Finally, the "**Announcements**" section invites advocates, advocate-assistants, and other legal professionals to send their articles, explaining the criteria they have to meet.

Hyri në shtyp në 18.4.2018
Doli nga shtypi në 28.4.2018

SHTYPSHKRONJA KUMI